

Petraç Zoto



Kësër
bëhet
vonë
Tregime

SH-32

Z 92

Petraç
Zoto

Nesër
bëhet
vonë

•
tregime

49/140

SHTËPIA BOTUESE
NAIM FRASHËRI

Afrora

«Kam zënë nuse.»

Letra më ngriu në dorë. E lëshova përdhe, e mora përsëri, e lexova dhe një herë. Nuk u zija besë syve. Si kështu, mor Kudret? Pse, për nuse ke vajtur në Tiranë ti? Ti je ushtar, do edhe një vit që ta kryesh, nusja të duhet ty!...

Më erdhi e papritur edhe për një gjë tjetër. Unë vjehërr? Më dukej vetja fare i ri. Ja, gjer dje vajta në bujqësoren e mbrëmjes. Vërtet që një kohë burri dyzetyjeçar më qe dukur i moshuar, bile plak, po ndryshe atëherë. Kur i kalova të dyzetat (sepse sot unë jam plot dyzet e dy vjeç), vitet nuk më rëndonin hiç e unë nuk ankohesha për asgjë. Vetëm se ja, Kudreti u rrit, Luljeta u rrit, Turi po rritet. Sesi rriten kaq shpejt e s'i vëmë re. Kudreti me nuse!...

Çne kjo nuse kështu, pa radhë e pa kohë!

Djali asnjëherë nuk na kishte zënë në gojë punë nusesh. Nëna çeku e ngiste ndonjëherë. Dua nuse, i thoshte. Të mënd një nipkë dhe pastaj... Ehu, moj nënë, dhe ti... ia kthente ai. Mos na u bëj kaq plakë dhe... Atëherë Lola, ime shoqe, sikur zgjohej. T'i bëjmë nuse nga Suli, më thoshte. Ato suljotet janë shumë të mira. Për këngë e valle i do? I ke. Për punë i do? I ke. Të bukura e të hedhura? Si ato!

Unë vetëm qeshja. Kurse ai... Shi në të kthjellët! Dhe kur, pa! Dhe ku, pa! Nuse në Tiranë! Të lërë Tiranën një vajzë e mirë dhe të vijë në Shportëzë, gjer në këtë fshatin tonë të largët! Pastaj të thuash se ky Kudreti është ndonjë nga ata që të marrin më qafë! Çne, ore. Vjen ca i gjatë, më i gjatë se unë, por është thatuq. Dhe i turpshëm e i heshtur si çupë. Ai me ne mezi këmben dy llafe, si i kishte lidhur pizgat me atë të Tiranës? Mos bëj habi, po deshe!

Ka ngecur diku, thosha. Ej, ç'do të ishte ndonjë ajo që veç të gjente burrë! Se, ta ndërronte Tiranën me një fshat një vajzë e mirë e me mend...

Ishte një gjë e rrallë, bre, prandaj po më ziente koka. Vërtet kishte marrë nuse nga Korça Sefiu i Malos, ama të dy ishin me punë në Korçë. Vërtet ishte lidhur dhe Nazifi me një çupë nga Elbasani, ama të dy ishin mësues në fshatrat e Librazhdit. Ë, ishte martuar në qytet Seriu! Po për nuse që kishte marrë! Një çalamane që bariste si në katër lisa. Ai i humburi hyri kollovar. Fshatarët i vajtën për urim, e takonin Seriu e i flisnin, po ku! Si për ngushëllim. Kjo e keqe ta ketë gjetur dhe Kudretin tim? Obobo!... Të të marrë malli për nipkat e mbesat, të të zërë malli për djalin

dhe të shkosh t'i pjekësh në shtëpinë e tjetrit, gjer në Tiranë! Ose të të vijë ai, ama me një nuse që të të vijë turp t'ua tregosh njerëzve!... Eh, Kudret, Kudret!

Njëherë mendova të mos ia tregoja askujt. As gruas, as nënës, asnjeriu. Kushedi, mbase ishte një gabim, a një nxitim. Të prisja dhe ca. Mirëpo s'kam mbajtur kurrë të fshehtë. Edhe në jam munduar ndonjëherë, më ka brejtur pendimi e s'kam duruar dot më shumë se një natë. Nuk jam i zoti. Nëna, njëherë, ma pikas sapo kapërcej pragun. Ç'ke, o djalë, thotë, ç'të mundon? E thotë me gojë a e thotë me sy, njëlloj. Unë i hapem menjëherë. Ndryshe, më ngjan se bëhem i lig, i pabesë, sikur bëj ndonjë faj.

Nejse.

— Kudreti ka zënë nuse, — u thashë.

— Ua! — ia bëri Lola, e gëzuar e si e trembur.

— Ç'emër ka nusja? — pyeti nëna.

Tjetër merak ajo! Unë atë kohë u kujtova për emrin. Afrora ia thonë, shkruante im bir. Afrora Zake. Sivjet mbaroi gjimnazin dhe hyri në kombinatin e rritjes së shpendëve. I ati është ushtarak, e ëma rrobaqepëse.

Çdo gjë më dukej e çuditshme në letrën e Kudretit, që nga emri i vajzës. Afrora, përsëritja me vete. S'më kishte zënë veshi emër të këtillë. Të them që s'më pëlqeu, gënjej. Të them që më pëlqeu, prapë gënjej. Vajzat me emër të bukur gjithnjë sesi më janë dukur. Unë ato nuk i përfytyroj dot si gjithë njerëzit e tjerë. Fjala vjen, sado që jam munduar, nuk i kam përfytyruar dot të ulen në tryezë e të hanë bukë, apo t'i shtrohen një pune çfarëdo. Kështu edhe për Afrorën. Vetëm se atë emri ma sillte ashtu, të bukur e si të pakapshme, kurse logjika, të shëmtuar, mos o zot.

Ç'është kështu, thosha me vete. Të të kisha këtu, o Kudret, e kishe hak një dru të shëndoshë. Se s'të kam rrahur qëkuri. Jo, nuk të kam rrahur kurrë. Unë dukem i vrazhdë në të parë, po mbi fëmijët s'kam ngritur dorë. E megjithatë ata janë të urtë e të dëgjuar. Të dëgjuar? A, lëre! Thëngjill i mbuluar ky Kudreti. I bindur e i turpshëm në të parë, por pa shih ç'vete e bën!

Njeriu, thonë, zë plaket kur i vdes nëna. Unë them më parë, kur bëhet vjehërr. Që atëherë fillojnë merakët. Si do të jetë nusja? A do të dalë e mirë? A do të m'i dojë njerëzit? A do të lindë fëmijë? A do të...? Po më parë cila është, nga ç'derë e nga ç'fis, si e ka qëndrimin e sjelljen. Ato pak të dhëna, që im bir më jepte në letër, nuk m'i shkoqitnin dot. Përpiqesha të bëja zap një pyetje, katër a pesë të tjera më kërcenin në kokë dhe cila e cila të më hiqte në anën e saj. Shqetësim që, lëre, lëre!

Lola sikur s'e vriste dhe aq. Ke parë ti? Më bëhej se krekosej që do të bënte krushqi në Tiranë. Nëna një e dy dhe pyeste për emrin. Edhe pse ia thashë disa herë, ajo prapë: «Po ç'emër është ky?» Unë e kuptoja ku rrihte ajo, po nuk desha ta ngitja atë muhabet. Kisha tjetër merak, më të madh: Si do të ishte kjo Afrora, që ia kishte prishur mendjen tim biri? Është një lajthitje, i dhashë karar dikur. T'ia shkullim nga zemra një sahat e më parë. Për të mirën e tij.

Me këtë mendje u ngrita e vajta në Tiranë.

Kudreti u lulëkuq porsa më pa. U përshëndoshëm ftohtë, me druajtje, sikur kishte hyrë në mes tonë një gjë e huaj që s'na linte të shfrenim lirisht.

Ai më pyeti për nënën, për të ëmën, për

Luljetën e Turin. Rrinte sa rrinte dhe kujto-
hej të pyeste për ndonjë njeri a për ndonjë gjë
tjetër. Mirëpo dhe pyetjet mbaruan, ca më te-
për kur përgjigjet e mia ishin të shkurtra e të
thata.

— Ç'erdhe? — e plasi më në fund, duke ngri-
tur sytë nga filxhani i kafes.

— Më kishte marrë malli për ty.

— Për Afrorën erdhe?

Unë trazova kafën dhe e piva përnjëherë.

— Si e zure këtë nuse kështu, pa na thënë,
pa...

— E dua, baba.

— Po ajo?

— Edhe ajo.

Të kuqtë i iku. Si kështu, ishte hapur si
vaji në arme këtu në Tiranë? Eh, kur m'u bë
qejfi që e hodhën në kryeqytet! Do të hapë
sytë, mendova atëherë. Në Tiranë e kisha bë-
rë ushtrinë edhe unë. Gjer atë ditë unë s'kisha
dalë nga fshati. As në Korçë nuk kisha qenë.
Dhe drejt e në Tiranë. Ç'pashë e ç'mësova aty,
vlenin sa për gjithë jetën e deritanishme. Një
herë në javë kishim liridalje. Eh, si i lustronim
këpucët e si i ndritnim me sidol pullat meta-
like! Dhe krap-krup nëpër shëtitore. Djem
ishim, na ziente gjaku e i hanim me sy çapkë-
net e kryeqytetit. Po më tepër jo, jo. Njëherë
një vajze i kishte dalë taka e sandales. Mu atje,
te hotel «Internacionali». Po jepte e merrte me
një gur në trotuar. O ushtar, të lutem më tha
mua. Unë ia rregullova si munda. Faleminderit
shumë, dhe më dha një shikim të ëmbël, të bu-
të, që të merrte mendtë. As vetë s'e di ç'iu për-
gjigja. Më duket se mbeta gojëhapur e s'i tha-
shë asgjë. Vetëm kaq. Një herë tjetër më qëlloi
të ulesha në kinema pranë një vajze me de-

kolte. Pse, i ngrita sytë, thua?... E, që ta ngas
llafin, më pëlqenin, perri më dukeshin, mirë-
po as nëpër mend s'e shkoja që unë dhe ndo-
njëra prej tyre... Kupton ti? Ku unë e ku ato!
Ku Tirana e ku Shportëza! I shihja sikur s'ki-
shin të bënin fare me mua, prandaj nuk më tra-
zonte asnjë.

Kurse Kudreti...

Dhe më rrinte përkarshi herë i druajtur, siç
e njihja, herë fare i pacipë, aq sa i druhesha
unë atij.

— Për martesë njeriu lipset t'i thërrasë men-
djes.

— I kam thërritur.

— Po ajo?

— Edhe ajo, të thashë një herë.

— Vjen në fshat ajo?

— Vjen!

Ndihej kaq i vendosur e kaq i sigurt në vet-
vete, sa bëra habi.

— Ti do ta shikosh vetë, baba.

Unë ta shihja? Jo, s'kisha vajtur për të parë
atë.

— Nuk të çoj në shtëpi të saj, mos ki keq.
Po ja, sikur të vinte Afrora këtu...

A, ç'më qenke bërë, mor Kudret! Ai e
kishte sjellë e ajo priste përjashta. Një të kër-
cyer bëri ai e doli nga klubi. Pas pak u kthyen të
dy të zënë për dore. Vetëm një vështrim shka-
razi i hodha. E gjatë, e drejtë, e bukur. T'i
rrembeje kokën. A, mor kopuk!

— Si je, baba, mirë? — më pyeti vajza dhe
më përshëndoshi, sikur të ishte Luljeta. Po ba-
lli i bulëzoi djersë. Edhe faqet iu bënë flakë.
Ama dhe, unë... thua më kishte zënë njeri në
ndonjë faj. Baba! Që kur e gjer ku?

Ajo matanë, unë këtej. Kudreti në mes. Ku-

dreti thirri kamerierin e bëri porosinë. Prapë u sheshua me ne heshtja e bezdisshme.

— E di ti ç'është fshati, moj çupë?

— Unë njoh Kudretin, — tha ajo dhe faqet ia mbuloi një purpur i lehtë. — Kam qenë në aksion.

Hëm, qesha me vete. Pse, njihet fshati me aksione? Në aksion çdo gjë të bëhet e bukur. Se është vetëm për disa ditë. Pastaj, mosha, shoqëria.

— Më ka folur dhe Kudreti.

Ama i ishte zgjidhur gjuha Kudretit?! Kushe-di ç'i kishte përrallisur! Shesh me lule do t'ia ketë bërë. Kemi fshat të zhvilluar, bëjmë mbrëmje vallëzimi. Xhanëm këto kështu janë, por...

Pikë gjumi atë natë. Sillu e vërtitu dhe mendja s'donte e s'donte të pushonte. Qëmton-te andej-këtej e më sillte ca martesë të pazakonta. Atë të Seritut një. Po ndryshe Seriu. Nusja e tij ishte një... Pastaj kjo Afrora donte të vinte në fshat e jo ta merrte Kudretin në Tiranë. Si, bre, si?... Të vijë nga Tirana një vajzë kaq e dukur! Ë, po, një djalë nga Suli mori nuse në Tiranë, po si ky Kudreti im. Më rrahu zemra nga ngjashmëria. Më rrahu zemra e më hyri një frikë. Një mot e më shumë Suli e fshatrat fqinje nusen nga Tirana e patën në gojë. Ishte e bukur dhe e folur, po thoshin që ishte ca mendjelehtë. Vishej e sillej si në Tiranë. Pa mbushur vitin, iku.

E, o Kudret, ç'na turpërove! Do të na vësh njollë, do të mbetesh i ve që në të ri! Se, që do të të lërë, kjo është si një e një që bëjnë dy.

Vraje e vraje mendjen, aty nga mëngjesi sikur e gjeta. Po të jetë për të prishur, sa më parë, më mirë, thashë. Kudreti ta sjellë njëherë në fshat... Të merrte leje. Kur t'i llangoseshin

sandalet me baltë asaj Afrorës, pa të shihte në do t'i shkonte ndër mend të thoshte më se fshati është i bukur dhe që atje mund të jetohej si në qytet! Ia thashë. Ndoshta e pikasi që e kisha me hile. Po më pas vura re se të dy u gëzuan. Dhe s'e bënë të gjatë.

Në krye të muajit çatisën. Gjer në Bilisht me urban, më tej me një zetar. Afrora qe e gëzuar. Puth nënën e puth Lolën. Luljetën për qafe. Mor, fluturonte, për besë! Që atë natë u ngrit të lante enët. Tjetër punë që Luljeta s'e la. U njoh shpejt me çupat e fshatit. Ke parë ti që s'e linin rehat gjer natën vonë?! Ne, si i thonë, as e pamë, as e zumë. Dy iknin, tri vinin, E shpunë dhe nëpër ara e vunë të punonte. E merrnin në shtëpitë e tyre. Rinia bëri një mbrëmje. Afrora, si të duket fshati? Mirë, ua, sa mirë! Është e afruar, thoshin, e afruar dhe e thjeshtë, sikur të jetë rritur këtu, me ne. Njëlloj si ajo e Sulit, haja veten unë. Luljeta e Lola sikur i ngrinin erërat. Kudreti mbahej ca si rëndë, ama gëzimi i pikasej që atje tej.

Dhe kështu, deshëm s'deshëm e premë që dasmën ta bënim porsa të lirohej Kudreti.

Pas kësaj zura ta shihja fshatin me një sy tjetër. Sikur unë të isha Afrora.

Që nga Maja e Hijes fshati ynë ngjan me një shportë me lule. Prandaj do t'ia kenë vënë këtë emër. Çdo shtëpi e ka një oborr të vogël me pemë e pjergull. Shumë jemi dhënë pas pjergullave tashti. Në rreshta përpjetë a në formë tende ato t'i zë syri kudo. U tufëzuan lopët e dhen-të, mbinë pjergullat. Se rrushi është bukuri, është shëndet pa bëhet edhe raki e sjell të ardhura. Oborret ke qejf t'i shikosh. Edhe luleshtrydhe gjen në to. Ndërmjet gjelbërimit skuqin çatitë e shtëpive. Njëra më e mirë se tjetra. Më të shum-

tat elbasance, tri dhoma e qilare poshtë. Vetëm plevicat e ahuret e shëmtojnë ca fshatin. Kanë mbetur si çibanë. Ç'presim, që s'u vëmë kazmën? Na dhimbsen, i meremetojmë e vëmë drutë e zjarrit a ndonjë rangull në to. Si jemi ne fshatarët! Pa to fshati do të dukej më i bukur, më i bukur e më i pastër.

Ja dhe shtëpia jonë. Si karabina e ngritëm pa ikur Kudreti ushtar. Bile që atëherë ndreqëm edhe një dhomë. Më pas shtrova dhe një tjetër. Lart s'i kemi rregulluar. Të blej gëlqere e dërrasa, që t'i kem gati kur të kthehet Kudreti, thashë me vete. Kam lënë një të ndarë të vogël për banjë. Tubat e ujësjellësit të ri kanë ardhur. Me të do ta futim ujin brenda.

E megjithatë, fshat është. Bulevarde s'ka, klube jo, kinema jo. Baltë po, me bollëk. Mos na mposhtet ajo nuse e brishtë dhe e bën si ajo e Sulit! A, mor Kudret! E mirë, e mirë nusja, po merakun është i madh. Se, në na ndodhtë e keqja, njerëzit do të thonë se kush vret lart, bie në hundëza. Ç'u duhej kjo kapë e gjelbër, do të thonë.

Kudreti na shkruante më dendur. Nganjëherë shkruante dhe Afrora. Dukej, kur vinte nga ajo Kudreti. Atëherë dhe letrat i dërgonin me adresën e saj. Mama, po qëndis një çentro për tryezë mesi. Unë po lë mënjanë lekë për një faqe muri. Ju i keni të gjitha, një faqe muri na duhet. Ta vëmë lart, në dhomën nga dardha e madhe. Kudreti thotë se ju do të zemëroheni. Po pse të më zemëroheni? Unë dua që në shtëpinë tonë të ketë një gjë prej meje. Këtë e solli Afrora, të thonë. Mos jam një çikë egoiste? Qesh ti, baba? Mua më pëlqen shumë e ju nuk do të ma prishni. Mirë? Mama, thuaj mirë! Babai s'më zemërohet mua, e di unë!...

A, moj shejtanel!...

Dasmën e bëmë në sallën e shtëpisë së kulturës. Atje i bëjmë dasmat tashti. Është e gjerë, ke ku të shtrosh tryeza dhe të mbetet edhe vend për të kërcyer. Në fshatin tonë e kemi shumë qejf kërcimin. Po bëhen dhjetë vjet që mori radhë. T'i lësh të rinjtë, e gdhijnë. Edhe ne s'mbitemi pas. Vemi, Jetnor, më thotë Lola ime kur bëhet ndonjë mbrëmje, pse të mos vemi? Rrimë dhe ca, shton më pas, pse të mos rrimë?

Kështu. Nuk e mbushi javën si nuse Afrora e doli në punë. Ç'punë, thua ti, në brigadën e arave. Zemrën në dorë unë. Mos na mërzhitet e i del nga zemra Kudreti, fshati, ne të gjithë. Mos na bëhet pishman e na ikën si ajo e Sulit. A, moj Afrora! Unë s'i them nuse. Ndoshta ngaqë, siç thashë, nuk mësohem dot ta shoh veten vjehërr. Sesi më duket. Do të thuash se, ç'bëri Afrora e ç'bëri nuse, po ajo është. Ashtu, ama më vjen për mbarë e më mirë. Edhe Lola Afrora i thotë. Në shtëpi vetëm nëna nuk i flet me emër.

Thashë që ajo nisi punë. Punë dimri, pastrim kanalesh, kullim, qilizëm. A, mor shokë të kryesisë! Po pse bre, nuk u gjend një vend për këtë nusen tonë? Vjen nga Tirana tjetra, e bën dot me kazmë? Apo të krisë e të ikë dhe kjo e të prishet një familje? Jo, s'e keni parë mirë. Kooperativa ka punë të lehta. Unë kam qenë brigadier dhe e di që kaq gjë mund të bëhet. Ajo ka qenë në kombinatin e shpendëve. Në kombinat s'kemi, ama pulari kemi. Pse s'e caktuat atje? Hajde, nuk e bëtë as këtë, po mund ta kishit vënë në brigadën e frutikulturës. Unë punoj vetë në frutikulturë. Punë e pastër. Të tërheq. Do ca zanat, ama, të hyn në qejf e nuk të lodh...

Shkoi një javë, shkuan dy. Afrora gjithë ajo:

gjithmonë me gaz. Gazi i shtëpisë, për nder. Apo s'duhen me Kudretin. Në sy e në gojë e shohin njëri-tjetrin. Qerrata Kudret, kur doli i zoti!

Në sy e në gojë e shohim të gjithë. E kjo s'më pëlqen. Dashuria e tepërt, përkëdheljet e tepërta, gëzimi i tepërt, sikur më trembin. Seç kanë një gjë që më ngjajnë si të përkohshme. Prandaj më përzihen me një ndjenjë frike e dhembjeje. Një drithërimë që s'më ndahet.

Nuk jam ankuar ndonjëherë në kryesi. Në jemi njerëz që e hamë punën e s'na mbetet shkas për ankime. Po për Afrorën vajta.

— Të kujtohet nusja e Sulit? — i thashë kryetarit.

— Ajo që iku?

— Po. E mirë ishte. Mund të shtronte vezë, po ta kishit parë më ndryshe si kryesi.

— Si më ndryshe?

— T'i kishit dhënë një punë më të lehtë, sa të mësohej. Ka ndonjë gjë që duket si e parëndësishme, po për dikë peshon shumë.

— Ti tani e ke fjalën për nusen e Kudretit? E kemi biseduar. Për një muaj Lumka merr lejen e lindjes. Do ta vëmë në vend të saj, te zogat.

Më erdhi mirë: M'u hoq një peshë nga shpirti. Ata e kishin menduar vetë. Merrte udhë kjo punë, s'kisha pse të merakosesha më. Kot i kisha sharë me vete. Më i duruar lipset të jetë njeriu. Të mos e prishë zemrën kollaj. Dhe unë s'e kam zakon të rrëmbehem, dreqi ta hajë.

Nejse. Në mbrëmje u thashë në shtëpi kë-shtu e kështu. Afrora sesi më pa.

— Ti, baba, ke hall për mua? Unë s'të kam thënë ndonjë gjë. As Kudretit s'i jam ankuar...

Unë e pashë në sy. Mërzi e përgjërëm tok. Ndiente zor që kisha vajtur në kryesi për të, por edhe sikur i erdhi mirë. Ndofta për punën, që është zanati i saj, ndofta për kujdesin tim a të shokëve të kryesisë. Kushedi.

Dhe punon e jeton me ne Afrora, nusja nga Tirana. Mbrëmë Lola më pëshpëriti që ajo është shtatzënë. M'u rrotullua mendja. Është një si hutim, si të ta them unë ty. Gjysh që tashti?! Po kur të ardhka mirë! o kur të duket se rritesh, hedh rënjë, bëhesh më i fortë e më me peshë! M'u përhi vetja i moshuar me një tufë fëmijësh përqark dhe Afrora gjithnjë aty. Mua më paska lodhur një merak i kotë. Jam sfilitur në vet-vete për hiçmosgjë. Dora-dorës që çlirohem nga kjo, ndihem më i qetë. Dhe më i gëzuar.

Krisma të heshtura

— Këtu do të shkojë. Patjetër! — tha partizan Tarja. — Ma ha mendja që nuk do të presim shumë.

Ai kaloi përmes njëfarë koriyeje me driza kullumbrish dhe zuri vend prapa një tumbe lajthish mu përmbi rrugë. Rruga çante ndërmjet arave mbjellë me grurë. Bimët ngriheshin nga ugaret. Bari mugullonte gjithandej. Lajthitë kishin lëshuar resa të gjata dhe aty-këtu sytha të butë e të blertë. Kishte zënë të bënte ngrohtë dhe era sillte aromë njomësie. Vetëm drizat e kullumbrive ishin krejt të zhveshura. Ato dukeshin të thata e pa jetë.

«Çudi, mendoj komandanti i patrullës, die-lli po ai është, pse kullumbritë lulëzojnë me vonesë?»

— Ej! — ia bëri partizani tjetër, që quhej Vaso.

Tutje u dukën tre kalorës. I pari e ngiste kalin pak më përpara se të tjerët, të tre me galop.

— Qeni! Paska marrë shoqërues. E ka nuhatur ç'e pret dhe e ruan lëkurën. A, jo, mor, jo, s'na shpëton dot, sikur kushedi ç'të bësh!

Kur kalorësit u afruan dhe ca, ai kërceu në rrugë e thirri fort:

— Hilmi Zallishta, qëndro aty!

Kalorësi i parë ia tërhoqi frerët kalit. Dy të tjerët u ngjeshën pas tij.

— Je i dënuar me vdekje!

I dënuari me vdekje u përpoq të fuste dorën në xhep, po s'pati kohë. Partizan Tarja qëlloi. Qëlloi dhe Vasoja. Që me krismën e parë Hilmi Zallishta u palos. Kali u tremb e u hodh me vrull anash. Të vrrarit i ngeli këmba në yzengji. Kali u tremb edhe më shumë dhe e tërhoqi zvarrë. Dy shoqëruesit patën kohë t'i kthenin kuajt e tyre mbrapsht dhe t'ia mbathnin përkulur njësh me jelet e gjata.

Partizanët iu afruan të vrrarit. Ai më në fund mbeti plandosur përtokë, i zhgërryer e i çjerrë si mos më keq. Në fytyrën e ngërdheshur kishte lënë gjurmë tmerri që pati ndier në çastet e fundit. Njëra dorë i kishte ngelur në xhep. Partizan Tarja ia hoqi dhe u çudit. Gishtërinjtë si kthetra të Hilmi Zallishtës ende mbanin shtrënguar një revolver të vogël dhe tok me të një kartëmonedhë njënapolonëshe.

— Bre! — ia bëri tjetri.

— Kur deshi të rrëmbente revolen, dora i ka zënë dhe napolonin. E ka dashur shumë!

— Bre! — ia bëri prapë pas pak partizan Vasoja.

— Ç'ke? — tjetri ktheu kokën nga ai.

Vasoja mbante në dorë një tufë me kartëmonedha. Ai po i shikonte me sy të zgurdulluar I kaloi nga njëra dorë te tjetra, pastaj i shtrëngo-i fort me të dyja. Ishte një veprim i pavetë-dijshëm. Tares iu bë se gishtërinjtë e shokut po merrnin formën e kthetrave. Ai e pa përsëri dorën e tradhtarit, pastaj të shokut dhe, i ngrysur në fytyrë, tha prerë:

— Lëri aty!

— Ç'thua, ore?

— Lëri, të them!

Partizan Vasoja ia nguli sytë, por, kur vuri re sa me rreptësi po e shikonte komandanti i patrullës, vetiu i hapi duart e i lëshoi napolonat. Ata ranë mbi kufomën e tradhtarit të ndëshkuar, disa shkanë përdhe, nja dy i mori era e i flakëriu në hendek.

— Shkojmë!

Tarja u nis i pari dhe pas tij, duke i hequr këmbët zvarrë, eci dhe Vasoja. Ecnin në heshtje. Kjo nuk qe një heshtje e zakonshme. Të dy bisedonin me mend. Po nuk flisnin se duhej ta përmendnin ndodhinë e porsangjarë, aspak të këndshme. Njëri ndiente përçmim për atë ndodhi, tjetri thoshte me vete se shoku qe treguar kapadai. Në fillim ky kishte kujtuar se tjetri bënte shaka, por, teksa ecnin e ecnin dhe Tarja as kokën nuk e kthente prapa, provoi të bënte një përpjekje për t'ia ndërruar mendjen.

— Dëgjo, o Tare, nuk është punë me mend.

— Është, është, po hajde ti!

— Përse të shkojnë kot gjithë ato para, bre? Një tjetër do t'i ketë kësmet, atëherë pse të mos i marrim ne?

— Ne s'kemi dalë për pará.

— S'është punë prej të mençuri, them. Kthehemi? Komandës i duhen paratë.

— Jo! — tha dhe një herë ai që e kishte të drejtën e komandës.

« E po, e bëre beli që ke qejf të komandos. Sot t'u dha rasti dhe po e përdor për të bërë një budallallëk me brirë!»

Derisa arritën në batalion, nuk këmbyen më asnjë fjalë. Po të flisnin, s'ishte çudi të ziheshin. Këtë e kishin kuptuar që në fjalët e para.

E takuan zëvendëskomisararin, prej të cilit e patën marrë detyrën.

— E qëruam! — tha komandanti i patrullës.

Ai ia dha zëvendëskomisarit gjithë ç'kishin marrë nga Hilmi Zallishta.

— Ai i kishte xhepat plot me napolona, por i lamë aty.

— Pse?

«Hë, prit kur të të japë ndonjë paravesh të mirë, o mendjehú!» tha me vete Vasoja.

Ai po parashijonte njëfarë kënaqësie, duke menduar se zëvendëskomisari do të vinte re ç'gabim kishte bërë Tarja. Po Tarja shpejtoi t'i thoshte atij që kishte pikasur te partizan Vasoja një lakmi të tillë, saqë ai ishte trembur. Pse të ishte aq i babëzitur pas parave Vasoja? Kjo atij Tares, i ishte dukur gjë e keqe për një partizan, prandaj...

Tarja fliste e fliste dhe zëvendëskomisari tundte kokën në shenjë pranimi. Madje dikur ai u vrenjt në fytyrë e iu kthye Vasos:

— Kështu, o Vaso?

— Paratë gjithnjë duhen, shoku Mina. Përse të kalben bashkë me atë fëlliqësirën? Ose përse t'i marrë ndonjë vulëhumbur, Paraja pará është, si për partizanin, si për...

— Ashtu vërtet, paraja pará dhe neve na duhen, ti mirë e the. Ama, për ca napolona ne nuk humbasim njeriun!

Vasoja ngriti supet. I hutuar, pyeste më sy cili njeri do të humbiste e si do të humbiste. Iu bënë lëmsh në kokë vetë ngjarja, sjellja e Tares, fjalët e zëvendëskomisarit. I dukeshin të gjitha të habitshme e të pakuptueshme. Le, po zëvendëskomisari po e qortonte!...

Ai tha me vete se edhe zëvendëskomisari po rrëmbehej njësoj si Tarja. Që të gabonte një Tare, hajde de, por zëvendëskomisari...

Kur u nda prej tij, sikur u lehtësua. Pastaj ndjeu një si boshllëk. Më tej zuri ta mundonte dëshira që të takohej prapë me të. Diçka kishte mbetur e pashkoqitur mirë. Ai, Vasoja, duhej t'ia thoshte zëvendëskomisarit. Ose zëvendëskomisari atij. Si e çfarë, nuk e dinte, s'e kishte të qartë. Po që duhej, këtë e ndiente.

Ai farë lëmshi iu mblodh në bark, i kërceu në kokë, po i mbështillej në trup dhe shtrëngimi ia rrihte tëmthat.

Ashtu ra mbrëmja.

Gjumi të çlodh e të qetëson. Pa dhe sikur të mos flesh, në heshtjen e natës mund të mendosh më nge. Dhe u jep udhë mendimeve të trazuar, që ditën të ngatërrohen më keq. Këto tha me vete kur u shtri të flinte. Po gjumi nuk iu afrua fare, fare. Sa më tutje shtyhej nata, aq më i largët i bëhej ai. As mendimet nuk i shtroheshin. Si të ndërkryera dhe ato. Po ç'ishte kështu, xhanëm?

Agushi flinte punë e madhe. Kur e kur gërhiste lehtë. Gërhitjet e tij ia shtonin bezdinë.

Nuk e mundon gjëkafshë, ndaj fle si shqerrë, tha me zili për të. Njeriu që s'ka ndonjë brengë, fle dhe majë drizës.

— Agush. o Agush!

— Hë!

— Fjete?

— Pse, ore, për këtë më zgjove ti?

— Jo, mo, po...

— Ç'ke?

— Ne sot ishim...

— E di, ma the një herë. Mos i mbushe gjë?

— Ama llaf!

Agushi e pa që e shkeli dhe u ngrit shesh.

I dha një cigare dhe e ngau në krah që të vijonte.

— Për frikë thua ti? Hiç, ore! Një krismë dhe aq. Kali e bëri fërtele, e zvarrisi gjer tutje. Si për t'i marrë dhe ai hakun e tij. Por... ai qeni i kishte xhepat na, dinga me napolona!

— Ashtu, ë! E pastaj?

— Unë bëra t'i merrja, Tarja s'më la. Dëgjon ti? Kur erdhëm këtu, më kallëzoi te shoku Mina. I tha që, vallaha, pikasi tek unë një babëzitje, një lakmi...

Agushi kroi kokën. Tha:

— Është një i zgjuar ai Tarja, pa-pa-pa! Ta këndon kartën në xhep.

— Po unë s'bëra gjë, bre, dëgjon ti apo jo?

— Lakmia për parà e prish njeriun, — shtoi Agushi, sikur të mos e kishte dëgjuar fare kundërshtimin e shokut. — Ia ha, si krimbi drunë, çdo gjë të mirë që ka në shpirt, e bën të egër, makut, zemërgur.

— Ama pa para s'jeto het.

— Jo, s'jeto het.

— Atëherë, si? Ja, ne do të shporrim push-tuesin. Do t'i përmbysim të pasurit. A nuk do të bëhemi ne vetë zotër të vendit?

— Doemos.

— E po si, zotër dhe pa pará?

— Do të punojmë e do të rrojmë.

— Pa pará?

— Do të kemi aq sa të na duhen.

— Sa duhen?

Agushi deshi ta shihte në sy, po s'dukej.

— Kjo të mundoka ty? Rri, ore, se s'ta kemi ngenë!

— Jo, bre, po meqë erdhi llafi...

— Çdo llaf me konak. E ke dëgjuar Dulen e fshatit tonë ti? S'e paske dëgjuar. Mirë. Ky Dulja i Shemos na ishte goxha djalë, punëtor e i muhabetit. Po sesi u pleks e u martua me një sakate që kishte 100 napolona flori prikë. Sa i shtiu në dorë florinjte, u mbyll në vetvete, e askush nuk e dinte ç'bënte në shtëpi e si e shkonte kohën. Më pas i përzuri nga shtëpia të vëllezërit. U zunë e u përfolën për ibret. Pastaj bleu ara e shtoi bagëti. Më tej bëri shtëpi të re e plevica dhe hambarë të rinj. Mendja i punonte si e si të shtonte mallin e gjënë. Le me të vëllezërit, që s'u pajtua e s'u pajtua, por u zu dhe me fshatarët. Njërit i mori kaun, tjetrit arën. U bë makut. Njerëzit nuk donin ta takonin në udhë, jo më të kishin të bënë me të. I hyri në shpirt babëzia.

— Pastaj?

— I shkonte llafi e bëri shumë të zeza. Pastaj, the ti? U bë Hilmi...

Ndërsa Agushi tregonte, Vasos i shkonin nëpër mend copëza nga jeta e tij. Dikur u shkëput nga rrëfimi i shokut, s'po e dëgjonte më. Ishte në gjendje të trazuar shpirtërore dhe po shihte brenda vetes si për të gjetur mbështetje a një shpjegim të pranueshëm për atë që kishte ndodhur.

Çirak në një kafene. Punë me të rendur, shërbeji këtij, hidhu tek ai tjetri. Mbrëmjeve i zoti i kafenesë hapte sirtarin dhe merrte paratë. Bobo, ç'para mblidheshin brenda ditës! Edhe ti, qerratuc, ke ndihur për këto, i thoshte Vasos. Hyzmeqar, o djalë, do të thotë hyzmet edhe qar.

E thashë mirë? Hyzmet edhe qar! Po të bëhesh i mbarë e të kesh mend në kokë, po të punosh shumë e të kursesh, e hedh fukarallëkun, ja, siç e kam hedhur unë. Dhe ai i jepte ndonjë lek. Këta lekë, ata që i linte i ati për të vajtur në kinema a për ndonjë akullore, ndonjë bakshish, të gjithë ai i vinte në një qese e i ruante me shumë kujdes. Nuk prishte për asgjë, me shpresë që një ditë ta hidhte fukarallëkun dhe të bëhej zot i vetes...

— Po të hyri krimbi i parasë, ëhë, vetëm në varr shërohesh. Bëhesh Dule, bëhesh Hilmi, bëhesh... e ç'nuk bëhesh, vetëm njeri s'je më.

Befas Vasoja ndjeu një të cimbisur në bark, pranë xhepit të vogël të pantallonave. Diçka iu kujtua e u trondit. U kthye në anën tjetër që Agushi të mos ia pikaste turbullimin. Nuk po përqendrohej dot më. Ajo pullë vend s'e linte të qetë.

Kur e patën kontrolluar Hilmi Zallishtën, i patën gjetur dhe dy monedha ari. Krejt i befasuar, ndërsa Tarja po shikonte një dokument që Hilmiu e kishte në xhepin e brendshëm, Vasoja shpejt e shpejt i futi florinjte në xhepin e vogël. Ky që një veprim i beftë e i shpejtë, gati i pavetëdijshëm. Më pas i pati harruar. Por ja, po e kujtonin ata vetë. Sikur kishin marrë zjarr dhe e digjnin vendin përreth.

— Tarja ta punoi. Mirë të të bëhet. Se ne nuk e bëjmë këtë luftë që të marrim manatë e Hilmiu e të Duleve... Fjete?

— Ç'është ai gjumë!

— Mjaft e lodhe kokën. Për paratë e atij qenit merakosesh ti? Le të kalben tok me të! Nesër i thuaj shokut Mina që gabove dhe gjen karar. Hajt, me natë të mirë!

Agushi u shtri e prapë fjeti.

Bëri të flinte dhe Vasoja, po punë e kotë. U shtri më kurriz, u kthye anash, njëlloj. Ai vendi pranë xhepit të vogël përvëlonte. Përvëlimi i mori gjithë barkun e iu ngjit në tërë trupin. Koka i digjte. I bëhej se ndrynte në vetvete diçka të fshehtë e të rrezikshme, që i ishte mbledhur xhumbë tek ajo pullë vend. I hoqi nga xhepi monedhat e arta. Ajo gjëja e fshehtë dhe e frikshme iu ngjit në dorë. Bëri t'i hidhte e s'i hodhi dot. U ngrit e gërmoi me gishtërinj një gropëz në dheun e butë, i futi atje florinjte e i mbuloi. Pastaj u shtri e i mbylli sytë. Kapakët nuk i rëndonin hiç fare dhe shtrëngimi i sillte një mundim të dyfishtë. Në trurin e tij hynin njerëz e ngjarje. Ai nuk donte, madje u përpoq t'i përzinte, por nuk qe e mundur. Hynin e përlesheshin e ai djersinte.

U ngrit përsëri. Me duart përdhe, po kërkonte ethshëm gropëzën e vogël. Sapo e gjeti, rrëmoi nxitimthi dheun e shkrifët. Shpejt e ndjeu në gishtërinj tehun sfilites të monedhave të fshehura. Nuk i mbajti fare në duar. Mori vrull e i flakëriu ashtu, me gjithë dheun që i zuri dora. Dheu u shkërmoq e ra më parë. Kokrri-zat zhurmuan pranë si pika të rënda shiu. Florinjte tringëllinë tutje, dridhshëm, si me ankim, duke shkarë nëpër shkurre e ferra. Pastaj s'undie më asgjë. U platit përnjëherë çdo zhurmë. Heshtje, qetësi. Fëshfëriu era në degët e një shkoze. Sikur i mbajti iso frymëmarrja e lehtë e shokut përbri. Sa qetë flinte! Pa endërruar hiç krahun, si të kishte rënë në dyshek me pupla.

Po grisej ngadalë e butë perdja e natës. Zbardhëllimi vinte i paqtë e i freskët. Ashtu si pa u ndier, maja e shkozës po skiconte veten në kaltërsinë ende të mugët të ditës së re.

Fillojmë...

Ai ecte në rrugën me dëborë. Dëbora të ndjell gjumë. Ose të fut në mendime. Si ta sjellë rasti. Ai ecte dhe mendonte. Mendimet vinin vetë, pa i ftuar, i shtilleshin një copë herë në kokë dhe iknin, ashtu lehtë e pa u ndier, sikurse kishin ardhur.

«Vangjel, morën në telefon nga Bilishti, Keni një mbledhje në orën katër pasdite. Kola të pret atje.»

Leni e kishte parë me dhimbsuri e kishte shtuar si për vete:

«Sa shumë dëborë që bie!...»

Ç'shoqe e mirë ajo Leni! Gjithë fol e qesh. Njerëzit e gëzuar janë të lumtur. Dhe pranë të lumturve ndihesh gjithnjë i gëzuar. Ja, nëna e nusja. Të dyja të mira, Të mira, të dashura, lum si ai. Duart e tyre tëngrohta i ndien gjithmonë.

Të nënës në fanellën e trashë, të nuses në çorapet e gjata dhe në ato kallcet që i përvesh bukur mbi këpucët alpine. Ndërsa kapotën, një pallto e shkurtër e kavalerisë italiane e çarë në të dyja anët si fund me kinda, e ka kujtim nga intendent Nuriu. Ia pati dhënë atë ditë kur u nis për në Panarit. Ajo ishte prej stofi të fortë e dukej si e re, por i rrinte te gjunjët.

Përse i donin në Bilisht?

Ngarkon dëbora në dëborë. Pllaskat e mëdha bien ngadalë butë-butë, si flokë pambuku. Dhe ç'frushullimë e ëmbël!... Dhe ç'qetësi mahnitëse nëpër të!... ,

Një shtëpi e veçuar nga fshati u shfaq papritur, sikur kishte dalë nxitimthi për t'i prerë rrugën. Oxhaku vilte tym pareshtur. Përreth tymit ciflat e dëborës kaltëronin me një bukuri që të merrte sytë. Kaltëronin e shkriheshin, a thua se aq ishte misioni i tyre, sa të krijonin atë bukuri të rrallë. Tymi i shkrinte i babëzitur, pastaj mekej e nuk shkonte dot më lart, i thithur nga ajo mizëri e pafund.

Përse ishte mbledhja?

Po të qe për shkollat, do t'i kishin njoftuar me kohë. Atëherë ndonjë punë e terrenit, kushe-di. Kola ishte sekretar i organizatës së partisë, ai zëvendës. Një organizatë për 17 fshatra. Punë shumë, telashe shumë. Saqë ishte aty Kola dhe e thërritnin dhe atë, ndonjë punë me rëndësi e terrenit. Patjetër.

* * *

Një mbledhje fare e shkurtër. Një detyrë e ngutshme. Ta kryeni që sonte, tha sekretari i Frontit i nënprefekturës.

Të dy me Kolën vajtën drejt e në postë e telefonuan komunën. Të dalë Leni, thanë.

— Leni, moj, ne tani do të nisemi, kupton? Kur të vijmë atje, të jetë mbledhur organizata. Qartë?

Telefoni përcolli gatishmërinë e mirësinë e shoqes së tyre komuniste. Hiç të mos kishin merak për porosinë. Vetëm të niseshin sa më parë, se, ja, po errej.

* * *

Katër orë të tjera në dëborë, që tani arrinte gjer në gju. Në orën tetë e gjysmë të mbrëmjes arritën në klasën ku do të bëhej mbledhja. Fuçia që kovaçi i fshatit e kishte kthyer në por kër-ciste. Skuqnin anët e fryra si barqe bualli.

Shokët u hapën e lëshuan vendet pranë porit. Leni u bënte vend afër zjarrit.

— Ulu këtu, ti, Vangjel! Atje, ti, Kolë! Hiqini palltot!

Ata iu bindën. Leni afroi një bankë dhe i nderi mbi të palltot e kallkanosura. Pastaj e ngri-ti edhe më fitilin e llambës.

Heshtje. Asnjëri s'foli. Asnjëri s'pyeti. Por, ndërsa i lanë të çlodheshin e të ngroheshin ca, një pyetje e heshtur shëtiste nëpër gjashtë palë sy. E mori fjalën Kola. Tha se rëndonte mbi të gjithë barra e vështirë e aksionit. Atëherë secili dha mendimin e vet. Pak a shumë u shoshitën që aty fshatarët e pasur të zonës, të cilët nuk kishin pranuar të dorëzonin drithin e tepërt. Një kontroll natën, në befasi, do të qe me fryt. Patjetër. Si në luftë. Jo, pse si në luftë? Në luftë tamam. Derisa ata të poshtër kundërshtonin urdhrat e

pushtetit popullor dhe s'bëheshin fare merak për ata që vuanin urie...

Vangjel Nunit i hyri e ngrohta në zemër. U mbështet pakëz në kapotën e nderur mbi bankë. Fytyra iu vesh me avull. I mbylli për një çast sytë. Një butësi... O, sa i ëmbël vinte gjumi!... Ai shkundi kokën e drejtoi trupin. Leni e pa. Kur nisën të bënin ndarjen e fshatrave ku do të shkonin menjëherë pas mbledhjes, ajo u foli me sy shokëve. Vangjel Nuni e kapi atë shikim. Çfarë, kujtonin se ishte lodhur aq sa ta mënjanonin nga aksioni? Ai ende mbante rrobat e partizanit. Nuk e shihnin ata, nuk e vinin re?

— Jo, mos e diskuto, kupton ti apo jo.

Ndërsa perëndoi atë kotjen e lehtë e aq të ëmbël, ai po mendonte nga e si t'ia nisin aksionit. E kishte bërë zakon që mbarimin e një pune ta quante fillimin e një tjetre. Ashtu asnjëra s'i dukej e rëndë. Se, sa për punë... Merr këtë të fundit ti. Nga ta zije? Si ta kryeje? I vete tjetrit si njeri. I thua që njerëzit vuajnë për bukë. Pushteti është i tyre e lipset t'ua sigurojë. Po si t'ia bësh kur dikush s'do dhe e fsheh? Ky dikush është armik. Ballist. Armik e shkuar armikut. Jo në llogore, jo me pushkë. Ama më i lig. Se fshihet. Se përdridhet.

* * *

Natë e qetë. Natë pa hënë. Cingërimë, hesh-tje.

Qetësinë e grisi një ulërimë ujku, diku në korijen përtej lumit, fare pranë fshatit ku u caktuan për të vajtur Vangjel Nuni e Latifi. Qetë iu përgjigjën me të lehura lebetitëse. Lehën një copë herë të mirë, kush e kush më

fort. Pastaj pushuan. Ujku nuk u dëgjua më. Përsëri zotëroi heshtja. Heshtje dhe ftohtë. Dëbora e trashë që platitur përtokë si një kafshë e stërmadhe që ka zënë pusi. «Gërllu-gërllu» ia bënte lumi. Kërcitnin akujt që donin të trasheshin e uji i pengonte.

Kur mbërritën në fshat, Latifi i tha:

— Kthehemi nga unë, marrim një të ngroh-të e hamë gjëkafshë.

— Kur të mbarojmë. Jemi vonë, kupton ti apo jo, — foli Vangjeli dhe u nis për nga qendra e fshatit. Takuan Hamdiun, kryetarin e këshillit popullor, i cili po i prishte dhe hynë në zyrën e tij, një dhomë e kullës, si i thoshin në fshat shtëpisë së vjetër, që dikur e përdornin taksidarët. Hamdiu e ndezi me të keq llambën me vajguri dhe e vuri në buhare. Llamba bënte shumë tym. Megjithëse u përpoq ta ndreqte, e ngriti dhe e uli disa herë fitilin, përsëri një-lloj. Tymi i zi të digjte sytë. Mbase fitili ishte prerë shtrembër. Cepi më i gjatë e lëshonte tymin katellan. Po mbase edhe vajguri ishte me ujë. Hamdiu u mërzit dhe e la.

Vangjel Nuni foli. Qytetin e kërcënon uria, tha. Spekulatorët këtë ditë presin. Gjendje e rëndë. Pushteti porositi të veprohet shpejt dhe me ashpërsi. U ka dalë borxhit atyre që e fshehin, se nuk na e duan shëndetin.

Hamdiu i ngrinte e i ulte vetullat e trasha. Dukej ca si përgjumësh, megjithëse kureshtja, mendoj Vangjeli, duhej t'ia kishte nxjerrë gjumin. Latifi rrinte ngrehur sikur trembej se mos tjetri harronte pa thënë ndonjë gjë. I shkuan edhe një herë në shoshën e hamendjes fshatarët e pasur që mund të kishin drithë të tepërt.

— Raif Qenska, — tha Latifi.

— Ëhë, — pranoi Hamdiu.

— Sabriu.

Prapë një miratim me kokë.

— Dalipi.

Hamdiu përpëliti qerpikët e iu kthye Latifit.

— E, o, Dalip Mançka! — shtoi i riu.

— Ëhë, — ia bëri tjetri e uli sytë.

Vangjel Nuni u ngrit. Nuk priste më koha.

Sa më parë, aq më mirë. Se edhe nata thellonte.

Hamdiu trazoi hirin dhe nxori ca patate të pje-

kura. Vangjel Nuni bëri habi, se nuk e kishte

vënë re kur i futi në shpuzë. Apo i kishte vënë

që më parë? Latifi fërkoj njërën në duar e ia

zgjati. Patatja thërmohej në dorë. Secili mori nga

një, i frynin e i hanin dhe biseda reshti.

— Tani hë!

— Çfarë?! — pyeti si me habi Hamdiu.

— Të nisim kontrollin.

— Tashi?!

— Po përse folëm ne, or tungjatjeta?

Latifi ia nguli sytë.

— Daleni, të mos rrëmbehemi! — tha me të butë Hamdiu.

— Unë them që edhe kaq u vonuam shumë, kupton ti apo jo, — ia priti Vangjel Nuni.

Vetullat e Hamdiut u ngritën e u ulën përsë-

ri. Ai i pa me radhë njërin, pastaj tjetrin. Latifi

e Vangjel Nuni këmbyen nga një shikim. Hesh-

tje e nderë. Pse u habit ky kryetari? Përse

kishin folur dy orë e ca?

Qelqi i llambës ishte nxirë krejt. Hamdiu e

hoqi dhe bëri ta fshinte me një copë letër. Qel-

qi krisi e i mbeti në dorë.

— Ptu, tersi! — shau ai.

— Për sonte na mbaroi punë! — tha me sha-

ka Vangjel Nuni.

— O shoku Vangjo, po tashti, në mes të na-

tës... Ne s'jemi gjermanë, o të shkretën!...

Dy të tjerët ngrinë. Ja ç'na qënka! Sikur u dha nga një dackë. Edhe Hamdiu vetë e kuptoi që fjalët e tij bënë përshtypje të keqe.

— Të gdihet njëherë. Pastaj shohim e bëjmë.

— Si të gdihet, që ta marrin vesh e të ngelemi me gisht në gojë?

— Si do ta marrin vesh? Pse ta marrin vesh? Këtu i kemi, s'kanë ku venë.

Vangjel Nuni u ngrys në fytyrë. Iu duk shumë i dyshimtë qëndrimi i kryetarit të këshillit. Latifi, që e pikasi shqetësimin e tij, e kapi për krahu Hamdiun.

— Ore Hamdi, a nuk na e thua ca më shqeto?

— Si shqeto, ç'shqeto? Ne jemi pushteti i popullit.

— E pastaj?

— Nuk na ka hije të bëjmë gjurulldi në mes të natës. I thërresim në mëngjes e ua vëmë këmbët në një këpucë.

— Pse e paske kaq në merak shqetësimin e tyre ti?

— E thashë një herë ne jemi pushtet i popullit.

— Thirri mendjes, kryetar! — u nxeh Latifi. — Ç'thamë gjer tani ne? Apo erdhëm këtu për patatet e tua?

— E, e... Për ty është këput fiq e ha, por... Pse, or jahu, e merrni kështu ju? Fundja unë jam kryetar. Njerëzia do të thonë: ja ç'bëjnë këta të pushtetit, ja ç'bën kryetari!...

Vangjeli u ngrys edhe më e heshti. Shikonte sa atë, sa Latifin, dhe mendja nisi t'i punonte te një dyshim. Kur u përmend emri i Dalipit, Hamdiu seç pati. Mos vallë kishte të bënte me

të? Dhe donte ta mbronte, ja, ashtu, duke e shtyrë aksionin, që të merrej vesh...?

— Porosia është për sonte, kupton ti apo jo, — tha prerë.

— E dëgjova, — mërmëriti Hamdiu.

— Hiç s'ke dëgjuar! Ose...

Hamdiu ngriti kokën.

— Më mirë të them që s'i ke hyrë fare në të. Mbase s'do që t'i hysh.

— Dale, or jahu, mos na bëj kaq të lënë ti. Gjumi apo e ftohta do të na e nxjerrin sekretin, xhanëm? Me të dhënë sabahu, i thërresim këtu. Në anë tjetër bëjmë dhe kontroll. Ku ta dish? Mund që e sjellin vetë.

— Në atë krah fli! Pse, s'u ke thënë gjer tani ti? — ndërhyri Latifi, që s'po e mbante vendi. Ziente përbrenda dhe shikonte me inat Hamdiun. Hamdiu sytë përdhe. Si i mërzhitur, si i zemëruar.

— U kam thënë.

— Atëherë? — Vangjel Nuni iu afrua.

— Ç'humbasim, po t'u themi dhe një herë?

— Kohë humbasim! Suksesin e aksionit humbasim! Kjo punë e do shpejt dhe papritur. Ndryshe dështojmë, kupton ti apo jo?

Hamdiu i shtrëngoi buzët me kryeneçësi.

Po na bëhet pengesë, tha me vete Vangjel Nuni dhe aty për aty vendosi ta mënjanonte nga aksioni. Më mirë një më pak, sesa... Mirë, po si do të vente për kontroll pa kryetarin e pushtetit? Nuk lejohej. Hall tjetër ky! Befas u kujtua që Latifi bënte pjesë në këshillin popullor të fshatit dhe mori frymë i lehtësuar.

— Do të vemi ne të dy me Latifin, — tha.

— Ti rri këtu. Ose shko në shtëpi. Dhe, po i the ndokujt...

— Ç'llafos, bre Vangjo!

Ai s'e ngau më tej, se pati frikë mos e mahiste më keq. Po për të ndenjtur, nuk ndenji.

Deri te shtëpia e Dalip Mançkës asnjëri s'foli. Vangjel Nuni s'ndihej i qetë. Si do t'i vente filli këtij aksioni, që kishte nisur kështu, me një kundërshtim aq të beftë e të dyshimtë? Mos vallë duhej të kishte përfshirë në grup edhe ndonjë tjetër... Fshati vetëm një komunist kishte, Latifin. Po mund të merrnin ndonjë të ri, fjalla vjen, atë Vaitin ose Fevriun...

Hamdiu doli përpara e trokiti në portën e Dalipit. U përgjigj me hungërimë një qen i madh. Qeni lehu me një zë të ngjirur, u derdh në oborr dhe gërvishti me thonj portën që brenda.

— E, Gudo, e! — e qetësoi një zë burri. — Kush është?

— Hape!

— Kush je ti, more?

— Unë... Hamdiu jam. Hape!

Heshtje. Heshtje si në përgjim.

— Po ç'do në këtë vakt, mor i uruar?

Ai nga brenda u vonua ca, gjersa e lidhi qenin, që s'pushonte së hungërituri. Pastaj u luhat një dritë e zbehtë në hajat. Hapa të ngadaltë, që zvarriteshin. Llozi lëvizi e çerçiveja e portës krakëlliti si një sorrë e trembur. Në pragun e portës, që u hap sa të kalonte një njeri i vetëm, u dha një burrë i gjatë, ca i kërrusur, me një xhakëtë shajaku hedhur krahëve dhe një kandil në dorë. Burri nderi kandilin përpara. Drita qëndroi nga pakëz te Hamdiu e Latifi. Kur i erdhi radha Vangjel Nunit, kandili ra përdhe e drita u shua.

— O, ej! — ia bëri i zoti i shtëpisë.

— Shpejt kanë zënë të të dridhen duart, Dalip Mançka! — e thumboi Latifi.

— E po... pleqëri, o djali i Sefes, pleqëri. Do

të vini në tonën ju, unë s'vij dot në tuajën...
E po... si e keni hallin? Se mbetëm dhe në të
errët.

— Kemi një punë me ty.

— Po tashti... kështu...

— Shko na merr një fener, Latif! — urdhëroi
Vangjeli.

— Fener? Ja, vete marr unë, — tha Dalipi
e menjëherë u çapit praptazi.

Hyri brenda e s'u ndie një copë herë.

— Mos na bëjë ndonjë avaz? — dyshoi La-
tifi.

Hamdiu s'ndihej fare. Dalipi po vonohej. Më
në fund ai u kthye me një fener të madh të
ndezur.

— E po... ç'e mirë ju solli?

— Të na japësh drithin e tepërt, — tha La-
tifi.

— Drith të tepërt? Cuk, s'kam.

— Po patate?

— Cuk. Emri i zotit, në ju gënjej. Ca pak
që kisha, i shita me kohë.

— Kur i shite?

— Ehu, që në vjeshtë.

— Do të bëjmë kontroll.

— Kontroll? Ç'është ky kontroll?

Ai i hetoi me radhë dhe u ndal më gjatë te
Hamdiu.

— Kështu, o kryetar?

— Kështu, — tha shkurt Hamdiu.

— A, a! Po këtë shokun ç'e kemi?

— I dërguar nga nënprefektura.

— A, a! E po... saqë bëtë emër...

Para se të hynin brenda, Vangjel Nuni i tha:

— Për ty është më mirë të na tregosh vetë.
Se, pastaj, kupton ti apo jo...

— Ç'është ajo, ç'është ajo! Të bëni kontroll,

o ti i nënprefekturës. Mirë nuk është vërtet, se jemi nën pushtetin popullor... E po... saqë bëtë emër... Hajde, urdhëro! — dhe i bëri dritë.

Shkuan përmes hajatit e u futën në një dhomë përdhese me patoz. Dhoma ishte e pasuvtuar. Në trarë vareshin kurora misri e qepë. Ca patate mbledhur në një qoshe. Njërën anë të murit e zinin dy hambarë të mëdhenj.

Pas tyre hyri dhe Dalipi, e shtyu derën dhe ndenji prapa saj.

— Mos e mbyll! — tha rreptë Vangjel Nuni dhe bëri kujdes.

Latifi e mori fenerin dhe i pa hambarët që sipër.

— Këta ke gjithsej?

— Këta. Emri i zotit...

Heshtje. Shikime që hetojnë. Sytë e Dalipit, dhomën përreth. Herë shtruar e herë ngucur, po me ngulm.

— Epo... kur është kështu, nja dy shinikë misër edhe mund t'jua jap. Ka dhe më keq, e di. Po më shumë s'bëj dot. Jemi një bylyk...

Vangjeli e peshoi me sy. Pra, ky Dalipi donte t'i përcillte sa më parë. Për fare apo që t'i hiqte nga ajo dhomë? Vështrimi i tij u kryqëzua me atë të Latifit. Pastaj të dy hodhën shikimin mbi kryetarin e pushtetit. Hamdiu rrinte ende si i prekur, si i zemëruar. Por në çast sikur ndjeu shikimin e dy të tjerëve, ndaj iu afrua Dalipit.

— Dalip, na e rrëfe me të mirë, — tha.

— Cuk, s'kam, bre Hamdi, edhe ti nuk beson?

— Unë, po kush?

Hamdiu e ngriti zërin. E para herë që fliste me zë të lartë. Deri atëherë qëndronte si i tër-

hequr, sikur nuk donte të binte në sy e të dëgjohej. Përse e kishte ndryshuar ashtu përnjëherësh qëndrimin e tij? E kishte prerë me vete që kishte bërë gabim, apo...

— Mua mos m'i shit këto! Hajde!...

— E po... e thashë, nja dy shinikë... Se, në vjeshtë...

— Kë gënjen ti, more?

Hamdiu ky?! Për t'u çuditur! Vangjeli u ngrah e Latifi i tha diçka me zë të ulët, por ai nuk e dëgjoi. E kishte mendjen tek ata të dy. Dalipi vijoi me të tijën:

— Ja, ju jap dhe ca patate. Se...

Këto përpëlitate flisnin qartë. Ai donte t'i përcillte. Latifi ia drejtoi fenerin e ia mbajti mu në fytyrë.

— E ç'thua?

— Ca patate, thashë.

— A do të na tregosh vetë?

— Cuk, s'kam! — dhe ai u mblodh e u mbështoll me xhaketën që mbante krahëve.

Vangjel Nuni fërkoj mjekrën me dorë. Në të zëncim besë ne ty, kupton ti apo jo... Dalipi iu vodh shikimit të tij të rreptë. Ai iu kthye prapë Hamdiut. Gëlltitej si me ngërç, i sillej rrotull, po Hamdiu s'e shihte në sy. Atij i ishin përtharë buzët. Në rrugë u dëgjuan hapa kafshësh dhe një turfullimë kali. Pastaj një trokitje e lehtë në portën e jashtme. Lehu përsëri qeni. Lehu fort, me inat e kërcënim. Dalipi fërgëlloi e bëri nga dera.

— Dale, prit, kupton ti apo jo. Shko ti, Latif!

Latifi s'e bëri të gjatë. Kërkëlliu sërish çerçiveja. Pasi një bisedë me zë të ulët.

— Kush je ti?

— Unë Saboja jam, më dërgoi babai.

— Përse të dërgoi?

— Të ngarkoj drithin... S'je Metja i goçe Dalipit ti?

— Hyr brenda, hyr!

— Po hajvanët?

— Futi dhe ata.

Qeni s'kishte të reshtur. Sikur do ta ngrinte fshatin në këmbë. U kthye Latifi. Sytë e të treve iu drejtuan Dalipit. Fytyra e tij ishte bërë dhé. Tri kafshë samari shkrofëtinin në oborr.

— He, he! — përpiqej t'i qetësonte ai që i kishte sjellë.

Kur dolën të gjithë aty, ai u tremb.

— Aherë unë, qysh të bëj unë, goçe Dalip? Dalipi nuk nxori zë.

— Prit njëherë, pa të themi ne, — e urdhëroi Vangjel Nuni.

Hingëlliu një kalë në ahur.

— Pushoje qenin, Dalip! — tha Hamdiu, — Pushoje dhe hiqe që atje! Na bëj dritë, o Latif!

Dalipi bëri t'i fliste qenit. Zëri mezi i doli. E kishte lidhur mu te dera e së ndarës ndërmjet ahurit dhe plevicës. Kur hynë atje, u bë e qartë gjithçka. Në errësirë e pa zhurmë një djalë e dy gra po përpiqeshin të fshihnin në plevicë thasë me grurë e misër. Të dy kuajt në ahur ishin të samarosur. Dalipi kishte bërë gati nja tetë barrë. Me sa dukej, kur hyri të merrte fenerin, u tha të vetve t'i fshihnin përsëri.

— A, pa, pa! — ia bënte Hamdiu. — Ku do t'i shpije, bre? Po kush ta tha njëherë? Kush të tha e kur ta tha kaq shpejt?

Dalipi hiç. Fol, o gur, fol, o mur.

— Të këtilla gjëra punoke ti! Dhe vetë e thua

pastaj që Hamdiu nget më mirë kopaçen nga kalem! Po ti, ç'nget më tepër ti? Paudhësitë nget! Fshehtësitë nget! A, o shoku Vangjo! Dhe unë...

— Hiç asgjë, kupton ti apo jo. Tani bëj de-tyrën! Në mëngjes ky drithë të çohet në Bilisht!

* * *

Ai ecte dhe mendonte. Punë, probleme, të shumta, të vështira. Mbaron një, fillon një tjetër. Radhazi, pa ndërprerje. Por, sa më e vështirë një punë, aq më i madh gëzimi kur e kryen.

Ecte dhe ndiente kënaqësi. Dëbora kërciste nën këmbët e tij. E bardhë, e pastër, e qetë. Rrezet e ndritshme iu vërsulën bardhësisë së paanë.

Në orën shtatë e gjysmë u gjend në shkollë.

Klasat ishin të fshira, porët të ndezura. Siç e kishte merak vetë. Punët e mëngjesit ishin kryer punë e madhe dhe pa qenë ai. Leni hyn- te e dilte nëpër klasa.

— Mirëmëngjesi! Si dolët, Vangjel?

— Ç'bëhet, moj Leni, kupton ti apo jo! Një- zet barrë nisëm në qytet.

— Ne ca më shumë.

Ajo kishte qenë në fshatin e qendrës së ko- munës. Dukej e lodhur dhe e pagjumë edhe ajo, po faqet i skuqnin.

«Shoqe e mirë», tha përsëri me vete Van- gjel Nuni me një ndiesi të ngrohtë mirënjohjeje e falënderimi. Pastaj hyri në klasë. U ngroh pakëz ashtu në këmbë pranë porit që brambu- llinte, pastaj mori fletoren e planit. Orën e parë kishte gjeografi. Do t'u fliste për malet e Shqipërisë.

«O malet e Shqipërisë...»

Iu kujtua Naimi... Kaq shumë i paska da-

shur? Malet dhe Shqipëria. Dy vjet e ca partizan e kishte njohur edhe ai, ndaj dhe i donte. Iu kujtuan shkurrishtet ku mezi ecej. Një pyll i dendur me dushk. Më tej ca ahe të mëdhenj. Duken të pafund, s'ka hyrë kurrë sëpata në ta. Boriga e pisha që i sulen qiellit. Dhe kullota alpine...

Mëngjes!

Mëngjes!

Nxënësit e përshëndetnin, lëshonin nga një kopace prapa porit e shkonin në bankën e tyre duke hukatur duart.

Buzët e tulta të kryemësuesit u hapën në një buzëqeshje të gjerë, që kërkonte të përfshinte gjithë nxënësit dhe diçka tjetër përtej tyre. Si një ditë më parë rrugës me dëborë, si në mbrëmje po pranë këtij pori, si këtë mëngjes herët tek hante përsheshin me qumësht të ngroh-të që ia kishte bërë gati nëna e Latifit, i erdhi përsëri ajo kotje e ëmbël, që vjen ngadalë, e butë-butë, si prehja vetë.

— T'i bie ziles, presor?

— Erdhën të gjithë?

— Erdhën! |

— Bjeri!

Shkoi te tryeza e u kthye nga nxënësit.

— Fillojmë...

Një njeri pa emër

Dita po thyhej. Vizitorët u rralluan. I fundit, një plak që bënte shumë pyetje e mbante shënime, po largohej si me mëdyshje.

— Ejani prapë, — i tha atëherë Bilali. — Mbase është ndonjë shkencëtar, — iu drejtua shokëve kur plaku iku.

Ethemi pa orën. Me Taton shkuan të hanin drekë. Genti u ul në një nga ato këndet e vogla të çlodhjes, që kishin sajuar aty-këtu nëpër pavijon. Ndihej i lodhur. Gjithë ditën më këmbë me vëmendje vazhdimisht të ngrehur. Veçanërisht kjo e lodhte.

— E? — ia bëri Bilali.

— Kishe të drejtë, — tha Genti.

Kur punonin për ngritjen e pavijonit dhe ndonjëri ankohej nga ajo punë e pazakontë, Bilali ia bënte: «Dale, dale!» Ai kishte qenë në di-

sa panaire ndërkombëtare. Daljet jashtë shteti Bilali i kishte të shpeshta. Njiheshin që më parë. U takuan njëherë afër stacionit të taksive. Për ku nxiton kështu, e pyeti Bilali. Me shërbim, i tha Genti. Ku? Në Tropojë. Po ti? Edhe unë me shërbim. Ku? Në Milano. Dhe nuk e thoshte për mburrje, ashtu i qëllonte vërtet. Ndryshe Genti. Ai e kishte për të parën herë. U gëzua kur i thanë. U gëzua shumë.

Bilali shkoi të rregullonte nja dy eksponate, që i dukej se nuk ishin vendosur mirë, andej nga fundi i pavijonit. Genti po pushonte dhe në mend kishte zallamahirë që do të krijohej pas pak, nja një orë më vonë, kur të vërshonin sërish vizitorët.

Hynë dy të rinj, një vajzë e një djalë. Ata s'kishin nevojë për ciceron. Zënë për beli, shikonin më nge dhe i shpjegonin njëri-tjetrit me të çuçuritur. I ndoqi me sy dhe vetiu vuri buzën në gaz.

Në atë kohë u duk prapë ai.

Gentit i ténkiti zemra si nga një parandjenjë e keqe. Ai njeri që i kishte tërhqeur vëmendjen edhe pak më parë, hyri si hije e trembur që e ndjekin e s'di ku të fshihet. Ishte e treta herë që e shihte në pavijonin shqiptar. Njeri i heshur. Seç kishte një gjë të veçantë në të ecurën, si mbi vezë, në shikimin e druajtur e përgjues, në fytyrën e flashkët. Një si mundim lexohej në tërë fytyrën e tij. I gjatë, pak i kërrusur, poshtë syve i vareshin dy si qeska. I ngjante një nëpunësi që s'i ka ecur karriera dhe, më në fund, ka dalë në pension, por është i lodhur e s'di si t'i shtyjë ditët. Kishte veshur po atë kostum gri, kishte lidhur të njëjtën kravatë ngjyrë miu e kishte mbathur po ato këpucë me gomë të trashë sintetike. Me to nuk ndihej fare.

Shikimet e tyre u takuan. Vetëm një çast. Secili u përpoq të tregonte se ai shikim ishte krejt i rastit. Vizita e këtij njeriu veç nuk qe e rastit. Çfarë donte? Përse vërtitej aty?

Ai kaloi nga njëri eksponat te tjetri, i ngeshëm, me duart prapa. Shikonte eksponatin dhe me bishtin e syrit Gentin. Bëhej të pyeste për diçka dhe përsëri tërhiqej. Qëndroi para një kostumi të një krahine të Jugut. E pa me shumë vëmendje, gjatë, madje si me përmallim.

Si ndenji një copë herë të mirë para atij kostumi, bafas u kthye e pyeti me një zë si të shuar:

— Che ora é?

Gentit iu duk e çuditshme. Tha me vete se do të ishte një nga ato të papriturat e vizitorëve tekanjозë. Ia tregoi orën e ai tjetri bëri sikur e kontrollloi të tijën. Pyetja qe e kotë, ose thjesht për të hyrë në bisedë.

— Veshje e bukur, — tha vizitori.

Genti pohoi me kokë.

— Mbahet ende, mbahet?

— Pjesërisht. Sidomos në koncerte e shfaqje artistike.

— E di, i kam parë.

Ky interesim ishte i zakonitë, ndërsa pyetja «mbahet akoma, mbahet» seç fshihte një kërshëri tjetërlløj.

— A mund të ma shitni?

— Ne nuk shesim me pakicë.

— Unë paguaj, sa të kushtojë.

— Ne nuk shesim. Kush dëshiron, këtu e pëlqen, pastaj kontrakton.

— Unë dua vetëm një.

— Kur është kështu, mund ta zgjidhim nëpërmjet ambasadës.

Tjetri sikur u ngërdhesh. Qeskat poshtë syve iu frynë edhe më dhe iu mavijosën.

— Unë nuk jam nga ata që më bën favor ambasada juaj.

Këto fjalë i tha shqip.

Befasia gjithnjë sjell habi e hutim. Po një befasi e tillë sjell edhe shqetësim.

Vizitori qenkësh shqiptar. Një shqiptar që s'priste të mirë nga ambasada, domethënë i arratisur politik. I ç'kohe ishte, vallë? Ç'krime kishte bërë, kur e ku?

Këto pyetje vetiu ta përqethin shtatin.

Genti u trondit dhe pa nga Bilali. Bëri kujdes. Në fillim që të ruante gjakftohtësinë. Nuk duhej t'i linte të kuptonte se i kishte bërë përshtypje. Ndenji i ngrehur dhe e vëzhgoi me vërejtje. Tjetri e la ta shihte sa të donte. Unë t'u shfaqta, thoshte qëndrimi i tij, të shohim se ç'do të bësh tani.

Në të parë ai njeri nuk ishte as i vrazhdë, as harbut. S'e kishte atë pamjen e krekosur prej kapadaiu të ndërkrayer, siç i përfytyrojmë shpesh kriminelët. Në të kundërt, dukej si një dardhë e zbrujtur. Kjo e bënte edhe më të dyshimtë. Kushedi kush qe e ç'kishte bërë në jetë! Ndonjë ujk plak, i rrahur me vaj e me uthull.

Çifti i të rinjve po ikte. Bilali gjithë atje tej. Nuk e kishte parë atë njeri? Eh, or Bilal! Pse s'po vinin vizitorë të tjerë? Gentit iu bë se pikërisht ai njeri e kishte kurdisur vetminë. Përse? Kushedi. Ky ishte një dyshim i kotë, megjithatë tronditës.

— Ta zëmë se quhem Nasuf.

As emrin s'ia tregoi. Njeri pa emër? I ishte shkërmoqur tok me tradhtinë? Emri Nasuf nuk thoshte asgjë, madje fshihte çdo gjë.

— Çfarë kërkon, o i ashtuquajturi Nasuf? Nuk

besoj të kesh ardhur nga malli për veshjen popullore.

— Ku e di ti që është e krahinës sime?

— Ndreqe gojën! Po të ishte jotja krahina, ti do të ishe atje.

— Ta zëmë se është ashtu.

— Tërë me «ta zëmë» i paske ti?

— E kishim gjetkë llafin. Ti the në më ka marrë malli. Unë përgjigjem: po, më ka marrë.

— S'e besoj.

— S'e beson? — Ai u duk i habitur e si i çmeritur. — Mos e beso. Unë nuk e merrja me mend kurrë që një ditë ta bëja këtë bisedë me ty.

Genti pati një fërgëllimë.

«Me mua? Pse pikërisht me mua?» tha me vete disi i turbulluar. Dhe prapë hodhi një sy nga Bilali. Ai aty. E kishte parë vizitorin vallë? Kushedi. O Bilal, po ktheje, ore, njëherë kokën! Ai hiç.

Hynë një grup të rinjsh, potershëm.

— Shko, shko, — ia bëri i quajturi Nasuf.

Duke shoqëruar të rinjtë, Gentit iu dha mundësia, po s'e bëri veten, t'i thoshte Bilalit për vizitor Nasufin. Do të dukej frikacak në sytë e tij e sidomos në sy të Nasufit, i cili me siguri po e vëzhgonte që larg.

Kur u kthye, vizitori ishte ulur e po e prishte. Gentit nuk i pëlqeu që tjetri ishte ulur, vetë ndenji në këmbë.

— E ç'e do ti atë kostum?

Ai ngriti supet.

— As unë vetë s'e di. Të të them që do të vesh ndonjëherë, jo, jo, s'kam ndër mend.

— Atëherë?

— Kam ardhur tri herë në ekspozitë dhe të tria herët këmbët më sjellin vetiu këtu. Është një trill? Nuk e di. Paska ca gjëra, në dukje të

vogla, që të lënkan mbresa të veçanta e të forta e që s'u bën dot ballë.

Ai heshti si të priste ngacmim. Genti s'foli. Pak më parë po mendohej t'i thoshte se, saqë ishte nga ata që nuk mund t'u bënte ndonjë nder ambasada, të mos priste gjë as prej tij, pasi në Shqipëri për të njëjtën gjë ka një qëndrim si nga ambasada, ashtu dhe nga entet tregtare. Kurse tjetri i doli gjetkë. Ishte ndonjë i penduar?

— Unë kam qenë ballist, — tha vizitori. — Dhe jo një ballist dosido.

Gentit iu përqeth shtati. Ndjeu neveri. Kish-te lindur pas Çlirimit e ballistët i njihte nga rrëfimet e të tjerëve. Që në fëmijëri kjo figurë iu bë simbol i së keqes.

Pra, ai njeri paskësh qenë ballist! Në dukje i qetë, në fjalë si i drobitur, megjithatë... Jo, s'e kishte përfytyruar kështu ballistin. Po ai tjetri e tha vetë. Dhe kishte guxuar të vinte në pavijonin tonë?! Përse? Ç'donte aty? Dhe ai, Genti, rrinte e bisedonte me një ballist!

E pa rreptë. I erdhi ta shporrte me shkelma. Mezi u përmbajt.

— Po, kam qenë. Dhe me bindje, bile. Po krime s'kam bërë.

Djali e pa drejt në sy.

— Të thotë mendja se të besoj?

— Luftë ishte dhe lufta nuk është lojë shahu, ku e heq dhe e vë prapë një figurë. Por unë nuk e lashë veten të bija në pozitë e një kriminelin ordiner. Bile kisha neveri për sjelljet vulgare e dallkauke të mjaft prej tanëve...

Genti ziente përbrenda e ishte në hall ç'të bënte. Pse kishte gjetur kohën t'i hapej kur ai ishte vetëm? Pse po i shfaqej atij e jo ndonjërit prej shokëve të tij?

Ca rastësi të tilla askush s'i dëshiron. Ai po i

bënte thirrje kujtesës. Mos e kishte shkelur diku? Mos kishte dhënë çikë? Ku e si? Shqetësimet e telashet për ngritjen e pavijonit, lodhja e tensi-
oni i dy ditëve të para, tendosja për të qenë i
matur në dhënien e përgjigjeve, përballimi i
ndonjë ciniku a skeptiku, të gjitha këto s'ishin
asgjë para rrëfimit që po i bënte njeriu që i tha
vetes Nasuf. Ku donte të dilte ai? Ç'e kishte
shtyrë ta bënte këtë rrëfim pa ia kërkuar kurr-
kush?

— Lëri këto, se s'të shkojnë! — i tha prerë.
— Ç'kërkon këtu?

— Ç'kërkohet? — pyeti tjetri i hutuar. Në sy-
të e tij të lodhur e të shpëlarë regëtiu një ndje-
si zemërimi. Regëtiu një çast të vetëm, pastaj u
tërhoq e u tulat. — Seç më shtyu të vij, seç ndje-
va kur e pashë këtë kostum... Ndofta e tëra kjo
zë fill që më parë? Kushedi, kushedi. Jo s'e
them dot kur.

Genti e pa me dyshim. Këto dëngla shiti
gjetkë, deshi t'i thoshte. Tjetri ia pikasi mendi-
min dhe sytë i përshkënditën nga fyerja. Një
mendje i tha të ngrihej e të ikte menjëherë. Një
tjetër e urdhëroi ta gëlltiste fyerjen e të rrin-
te. Nënqeshi hidhur. U përpoq të gjente ndonjë
fjalë të përshtatshme. Duhej t'i thoshte diçka,
të jepte një përgjigje. Por, për habinë e tij, u bë
gojac, fjalët iu ngatërruan në kokë e s'po e gje-
nin shtegun. Fundja, e përse, tha dikur i dësh-
përuar.

Dhe djersiti.

Ishte një pyetje që ia bënte vazhdimisht ve-
tes. E megjithatë, në vend që të qetësohej, veç
ngacmohej prej saj. Sa kohë po bëhej që thoshte
e çthoshte kështu? Ndoshta që atëherë, kur i qël-
lloi të udhëtonte në një kupe me një profesor
çek. Profesori çek vinte në Paris në një simpo-

zium ndërkombëtar. Sesi e mori vesh që bashkuhdëtari ishte shqiptar dhe luajti vendit. I hoqi syzet, picërroi sytë, e pa gjatë ngultas, me një vëmendje drithëruese. E shikonte gjithë duke iu afruar dhe, si hodhi një sy përreth, me një zë tjetër, të ndryshuar çuditërisht, pyeti si për vete:

«Si mundët ju të shkëputeni nga rusët?!»

Pyetje dhe habi. Admirim e vuajtje. Dhe mbja tragjike e një kombi të shtypur, që këlthiste përmjet shpirtit të brengosur të një atdhetari, i cili e vuante fort humbjen e dinjitetit kombëtar.

Të ashtuquajturit Nasuf iu bë se e goditën me tokmak kokës. Për kë e merrte profesori? Dhe ç'pyetje, o, ç'pyetje të hidhur që i kishte bërë! Më në zor s'e kishte ndier veten ndonjëherë...

Askujt e asnjëherë nuk guxoi më t'i thoshte që ishte shqiptar. Po kjo s'e ndihmonte më. Pësimi kishte ngjarë. Që me atë pyetjen-tokmak. Diçka krisi brenda tij. Diçka u shemb për të mos u ngritur më. Shpirti i mori të plasur, ai e ndiente. Ishte një mundim i ri. Psherëtiu thellë. Cili ishte? Ku shkonte? Përse? E ndjeu veten të humbur, të tepërt, pa shpresë. Ç'i duhej më jeta. Ç'ta bënte? Në të vërtetë ç'të bënte më tej?

Ato ditë në qytetin ku jetonte jepnin koncert disa këngëtarë shqiptarë. Papritur e dogji kërsëria të shihte ndonjërin prej tyre. S'kishte parë asnjë njeri nga Shqipëria e sotme. Si ishin këta njerëz? Kishte lexuar shumë, kishte dëgjuar shumë. Po, për të parë, asnjëherë. Siguroi një biletë dhe vajti. Kërkoj me sy, pyeti për artistët. I pa tek zbritën nga një makinë, të shoqëruar nga artistë vendës. U afrua e i vërente sikur

ata të kishin zbritur nga një botë tjetër. Sa më tepër i shikonte, aq më kureshtar bëhej dhe ndiente se si një ngathtësi e çuditshme, si ngërç, po i mpinte gjymtyrët. Artistët hynë në sallë duke folur e qeshur me njëri-tjetrin. Hyri dhe ai. Deri në njëfarë kohe ishte një shikues apatik. Po ja tek u këndua një këngë popullore që e kishte dëgjuar që në vogëli. Ç'ngjau më pas, nuk varej më nga ai. Pësoi një tronditje të një lloji krejt të veçantë. Trupi i ngriu, sikur ia kishte zënë cërma. Pastaj një drithmë e fortë. Ndjeu se po përlotej. Deshi ta mbante veten dhe atëherë u bë më keq. Lot e djersë. Shikuesit përreth zunë të pëshpëritnin. Ai u ngrit e doli nga salla...

Ishte kujtimi i një dobësie të tij. Ai u përmend e përpëliti sytë i trembur nga ato që sollin ndër mend pa dashje. Djali i pavijonit ishte atje, me shikim të vrenjtur. Priste t'i përgjigjej.

— Ç'kërkoj, the? Pa di dhe unë! Eh, u përhapëm nëpër botë si zogjtë e korbit. Më tej unë nuk u nakatosa, po ç'e do.

— Pse s'u ktheve?

— A mund të kthehesha?

— Qeveria jonë bëri amnisti.

— Nuk më zë amnistia mua!

— Po dënimi të zë?

Ai lëvizi supet sikur po ia shkante kush litarin në qafë. Kur e mblodhi veten, iu vizatua një buzëqeshje e shpëlarë, e ftohtë.

— Domosdo, — tha, — domosdo.

— E pra, pse s'u ktheve? Kryeje dënimin dhe jetoje si njëri i penduar.

Mbeti për një çast i hutuar. Trembjen nuk e largoi dot. Në plogështinë e tij kapitëse ajo binte menjëherë në sy.

— Kjo është tjetër gjë, — tha.

U duk se e mbylli atë shteg. Dhe Genti s'pati aspak dëshirë ta ngiste më tej. Le të përpëlitej në mëdyshjet e tij! Ç'donte më? Këtë të thoshte! Mirëpo, si për inatin e tij, ai nisi ta tirrte gjatë.

— Ca kohë më parë në një aeroport më prishte një ndodhi e rrallë. Dy djem në moshën tënde ia dhanë pasaportat rojës së doganës dhe bënë gati për kontroll valixhet. Doganieri ngriti kokën e i pa djemtë në sy. Shqiptarë? Kaloni! Nuk i kontrolloi fare. Dhe ishte një doganier që rrëmonte edhe nën astar. Udhëtarët u habitën. Mua më mbetën sytë mbi të dy djemtë. Ç'është kështu, thosha me vete. Më shpoi si gjemb gëzimi e krenaria e tyre. Njëherë më shkrepiti të thosha dhe unë që jam shqiptar. Po shpejt u përmbajta. Ç'isha unë? A më përkiste mua krenaria e të qenit shqiptar? Tek ju është një e drejtë që e gëzon edhe një foshnjë, e di. Po për mua..

Atë kohë ansambli juaj ishte në Gjermani. Nuk mbaj mend në vajta unë më parë apo e gjeta atje ansamblin. Rastësisht pashë një afishë. «Po vij në shqiptarët», shkruhej në të me gërma të mëdha dhe pas këtij titulli të habitshëm valltarë si në sulm. U tulata vetiu. Bëra të ikja e s'ika dot. Vajta në nja dy shfaqje. Sillesha midis tyre para se të hynin a kur dilnin, po si në një shkretë. Nuk u shfaqta e as që flisja, kuptohet. I largët, i huaj, më thoshte mendja se, po ta dinin cili isha, do të më çafërlitnin. Nga një qytet në tjetrin i shoqëronin mërgimtarë kosovarë. Shikonin shfaqjet dhe i ruanin, kështu dëgjova të flitej. Nga kush i ruanin? Ç'mund t'u ndodhte artistëve? Më shkoi një mendje se në ata «kush» hyja dhe unë. Po ç'isha unë?...

I shihja si një qen i rrahur.

Ika me të shpejtë. Që nga ajo natë më është bërë eksiq gjumi. Thashë që kam pasur bindjet e mia. Bindjet nuk janë lëvere që vjetrohen e i flak në ferrë. Unë nuk u isha ndarë. Dhe shpre-soja. Prit me ditë, prit me muaj e prit me vite. Mllef që rritej e rritej. O, ç'torturë qenka të presësh kaq gjatë! Mllef i bëhet qelb...

Këtu ndaloi si për t'u mbushur me frymë. Dukej i lodhur, i dërrmuar, si ato bindjet e tij të ronitura, po sytë i flakëronin. Genti disa herë u bë gati ta ndërpriste, po pastaj mendoi se nuk ia vlente. Fytyra e zbehtë, trupi i flakshkët, i squllur, qeskat mavi poshtë syve Genti iu bënë se ishin të gjitha plot qelb. Nga ai qelbi që i ishte mbledhur vite të tëra.

— Kam pësuar shumë deziluzione në jetë. Kam ngjerruar zhgënjimin në dashuri, në kumar, në tregti. Zhgënjimi politik qenka më i hidhuri. Nuk jam as qorr, as budalla. Këtë prestigj ne nuk do ta arrinim kurrë. Edhe fantazisti më i ndërkryer ndër ne zor se mund ta merrte me mend. Më duket vetja leckë, një leckë e flakur tej, që askujt s'i hyn në punë e askush s'pyet në bëj hije mbi dhë.

— Ti do të doje të mos ndodhte kështu?

— Guxoj të them jo. Gëzohem e hidhërohem.

— Sepse e sheh lidhur ngushtë me interesin tënd.

— Si ta shoh ndryshe?

— Zhgënjimi yt është e mira e kombit.

Ai nuk u përgjigj menjëherë.

— Ti mos më mat me veten, — tha më pas.

Genti e pa ngultas. Po, tjetër njeri ai, tjetër brumë, tjetër formim. Ndryshe e kuptonte jetën dhe politikën, natyrisht. Dhe këto nuk janë gjëra që bëhen e zhbëhen në një ditë. As

në një vit a dy. Sa keq, tha me vete, sa keq kur njeriu merr shtrembër dhe ecën në rrugë të gabuar. Mund të bënte kaq gjëra të mira, mund të gëzonte frytin e ëmbël të punës së tij të paqme, mund t'i shikonte njerëzit drejt në sy. Sa keq...

— Pse m'i the të gjitha këto?

— Ndieja nevojë t'ia thosha dikujt.

— S'ke pasur me kë t'i bisedosh?

— Desha t'i zbrazem një shqiptari të Shqipërisë së sotme.

Heshti e u mbyll në vetvete.

Genti nuk ia mori fjalën. Pra ai tjetri ishte zbrazur. Vetëm kaq. Çudi... Mos vallë duhej ta shtynte drejt atij hapi burror që të kthehej e t'i nënshtrohej dënimit, mandej të shijonte pendimin e vërtetë?

E pa sërish e u mat t'i fliste, po sytë e tjetrit tanimë dukeshin të shuar. Nuk tregonin asnjë interes për atë që mund t'i thoshte Genti. Mërmëriti një tungjatjeta të thatë, u kthye e iku ngadalë, fare pa zhurmë, ashtu si hije, siç kishte hyrë. Po vinte Bilali dhe Genti deshi ta kthente përsëri njeriun si hije. Por u kujtua që emri i tij ishte i rremë. Ai nuk kishte dashur t'ia tregonte të vërtetën. S'ka më keq sesa të mos kesh kurajë të thuash cili je. Është një fatkeqësi e madhe. Ai tjetri e ndiente këtë dhe e vuante. Vajti në pavijon, u shfaq dhe iku. Po ngryste ditët e fundit andej, larg, i vetmuar dhe do të mbaronte një ditë diku, si njeri pa emër.

Vështrimi i përmalluar

— Stop! — thirri me inat regjisori.

Ai nuk tha gjë tjetër dhe ishte ende shpejt për t'i dhënë fund punës së ditës, megjithatë operator Timoja filloi çmontimin e kamerës. Pas tij dhe të tjerët, si me komandë, zunë të mblihdnin kabllot, kasetat e mjetet e tjera të xhirimit. Asnjëri s'fliste, por nxitonin të kryenin punën dhe t'i shmangeshin bezdisë së ndehur mbi ta si një mjegull hidhnake.

Saimi, që luante rolin kryesor, ktheu krahët e u çapit ngadalë drejt bufesë së pikës turistike. As ai nuk pati dëshirë të këmbente ndonjë fjalë me shokët e grupit të xhirimit apo të bënte ndonjë pyetje. Po sikur ndokush ta thërriste, ai do të kthehej menjëherë i gatshëm të fillonin nga e para, ngaqë e kuptonte se ai ishte shkaktar që puna kishte ngecur në vend. Prandaj i bënte ha-

pat të vegjël e të ngadaltë. Mirëpo askush s'e thirri. Shokët bënë sikur s'e vunë re largimin e tij.

Regjisori u ul mbi një gur atje ku u ndodh dhe ua nguli sytë fjollave të tymit mavi të cigares që ndiqnin njëra-tjetrën, në fillim me ngut, pastaj përherë e më me plogështi. Ai i shikonte si i përhumbur. Ishte i lodhur e i mërzhitur, madje më tepër se i mërzhitur.

Episodi për të cilin po punonin prej disa ditësh, ishte një moment kulmor i filmit. Kishte punuar tok me autorin që teksti të ishte sa më i ngjeshur. Nuk mbante shumë fjalë. Më tepër duhej të flisnin mimika e aktorit, gjestet e veçanërisht vështrimi i përmalluar i syve të tij. Prandaj e kishte zgjedhur atë vend me bukuri të rrallë. Det, mal, shushurimë madhështore.

E megjithatë Saimi nuk po mallëngjehej. Asnjëra nga dublat nuk i afrohej përfytyrimit të regjisorit.

— Jo me inat, Ilir, — tha operatori e u ul përbri tij.

— Ky vend kaq i bukur, këto fjalë kaq poetike... Çudi... Çudi! Saimi me siguri nuk është mirë. Diçka do të ketë...

— Veç hallit që s'po e realizon dot atë që pritet, nuk besoj të ketë tjetër, Ilir. Ai e ndien. Ndjenja është më e fortë dhe më e shpejtë.

— Si thua ti, pse s'po e kap mirë?

— Po ta dija, nuk do të lodheshim.

— Atëherë më thua dot ç'të bëjmë më tutje?

— Tani për tani të shkojmë me të.

Regjisorit nuk i shtyheshin këmbët. Ç't'i thosh-te Saimit? Për se të bisedonin? Puna e tyre e përbashkët ishte filmi. Fjala e parë aty do të vente. Asnjë bisedë ndërmjet tyre, madje as dhe një shikim nuk do ta kapërcente dot episodin.

Ç'të thoshin, që shkonte mirë? Kjo nuk ishte e vërtetë dhe këtë e dinte dhe Saimi. Që s'shkonte mirë? Saimi do të mërzitej edhe më shumë.

Iliri përbrenda ndiente një si mëri për veten, shokët, tërë grupin e punës e për Saimin ca më tepër. Po që t'ia shtonte dëshpërimin, jo, nuk donte kurrsesi. Shpesh ai harronte gjithçka dhe i mbetej në shpirt një dhimbsuri e thellë për aktorin e mirënjohur. Se e shihte që dhe ai vuante. Mbase do të qe më mirë të shkonin për të zënë peshk. Saimi ishte amator i peshkimit. Të rrinin ca në breg të detit. T'i hidhnin grepat në ujë e të prisnin, të prisnin. Hapësira e pamatë e ujit, pllaquritja e valëzave, era e freskët plot avuj jodi e kripe dhe mbi të gjitha pritja e goditjes së peshkut... Pa sikur t'u shkonte mbarë e të zinin ndonjë koce, sidomos Saimi...

Timoja u ngrit e bëri nga bufeja. Regjisori i vajti pas me mëdyshje, sikur zbatonte një urdhër që s'i pëlqente.

Saimi ishte ulur në një tryezë me tre të panjohur. Ai diçka po u tregonte. Në sytë e tij shkëndijonte një vështrim i butë e i ngrohtë. Regjisori e pa që nga xhami e u habit. Edhe pak, edhe pak, tha me vete, duke pikasur te Saimi atë zbutje të dëshiruar, atë ndjenjë përmallimi që, atje te sheshi i xhirimit, s'po e arrinte. Ndërkohë Timoja hapi derën me zhurmë. Saimi ktheu kokën. Me t'i parë ata të dy, sytë e tij të kaltër i përcëlloi një si tym i hidhur. Ata u pulitën e u turbulluan.

Ai bën çmos të harrohet, mendoi Iliri. Unë, me praninë time, ia thërmokam atë përpjekje. Duket i kujtoj dështimin. Cilido prej nesh ia kujton. Dhe dështimi rëndoka, peshoka shumë. E ndien ti, e ndiej unë, e ndien Timoja. More, ç'them, e ndien gjithë grupi dhe fort, bile. Por,

si kështu, takimi me njerëz të panjohur e sjellka në atë gjendje që unë po e kërkoj me aq ngulm? Apo janë të njohur a miq të tij? Në qentë kështu...

Saimi u ngreh pak, në mëdyshje t'i ftonte apo jo, mirëpo operatori e pas tij regjisori shkuan në një tryezë tjetër, në qoshe të bufesë. Edhe andej Iliri veç Saimin shikonte, po me kujdes, që të mos binte në sy të tjetrit. Sa keq, nuk po e kapte më ajo gjendja e mëparshme gati e ekzaltuar.

Timoja seç tha dhe e goditi me bërryl.

— Pse mërzitesh? Ne jemi mirë me xhirime. Sikur edhe dy ditë të tjera të mos bëjmë dubla të vlefshëm, prapë jemi mirë. Marrjet e deritanishme janë të mrekullueshme.

Kishin bërë goxha punë. Ai e dinte. Por, meqë s'po e arrinin dot episodin më të rëndësishëm për të, regjisorit i zbehej kënaqësia e i dukej se xhirimet e deriatëhershme nuk ishin kushedi çë.

— Do ta zëmë, ç'ke ti! Pastaj ka dhe marifete të tjera.

I dinte dhe ato. Njeriun mund ta nervozosh, mund ta inatosësh, madje mund ta bësh edhe të qajë, po që ta mallëngjesh me zor, qenkësh e vështirë. Ky duhej të ishte një mallëngjim i fuqishëm e jo një emocion i zakonshëm.

Hynë me zhurmë çunat e grupit të xhirimit. Afruan një tryezë dhe u ulën tok me Timon e Ilirin.

Tre të panjohurit u përshëndetën me aktorin dhe dolën. Timoja i bëri një shenjë Saimit dhe ky u afrua e u ul me ta. U dëgjua zhurma e makinës. Mandej një përshëndetje me bori. Derisa u largua ajo e zhurma s'dëgjohej më, askush s'foli. Më tej u këmbyen dy-tri fjalë e përsëri heshtën. Biseda nuk ecte, sado që përpiquej Juniku.

Dikur Iliri u anua nga Saimi e i tha me zë të ulët:

— Vemi për peshk?

Saimi e pa me bisht të syrit. Një gufim. Sikur iu largua shqetësimi e regjisori iu duk i afërt e i dashur. Po vetëm për një çast. E bën që të krijojë mjedis të ngrohtë, mendoi. Pse, kaq poshtë kam rënë? Si më ndodhi kështu?

— Më flihet, — i tha shkurt atij.

Ç'është ky inat, mendoi regjisori. Ku e kam mërzitur? Apo vetë dështimi i episodit i krijon këtë inat?

Të tjerët pritën.

— Pa mua Saimi nuk vjen, — tha Juniku.

Saimi s'foli, po u ndie ngushtë e u ngrit të shkonte. Nuk rrinte dot më. I dukej se ndër-mjet tij e grupit të xhirimit qe hapur një hendek, i cili, pas çdo prove të pasuksesshme, zgjerohej e thellohej. Veçanërisht ndër-mjet tij e regjisorit.

Një gjë kaq e vogël, ja, ca lot malli, që s'i vinin e s'i vinin, bëhej shkak që puna të mos ecte. A mos e kapte emocioni kontraktues i kameras? Edhe po, sido që ai kishte mjaft përvojë. I hynte fshehtazi frika nga dublat e pasuksesshme? Ishte dhe kjo. Po mbi të gjitha ndiente njëfarë mangësie që s'e shkoqte dot. Ishte një mangësi e pakapshme, midis të tjerave e mbi të tjerat. Ai nuk po e zinte, ajo ende nuk po shfaqej. Ky ishte një mundim edhe më i madh. Aty qe pengimi. Dhe, kur nuk të ecën puna, s'ke kurajë t'i shohësh njerëzit në sy. Edhe ata të druhen. Pas kësaj lind bezdia. Ai e ndiente, e ndiente shumë.

Tha se do të flinte dhe vërtet vajti e u shtri në shtrat, po për gjumë nuk i shkonte mendja. Ia kishin ngrohur zemrën për një copë herë ata

të tre. Si e qysh? Me admirimin që i shprehën? Nuk e dinte veten për lavdidashës, megjithëse s'ka artist që të mos e dojë përkëdheljen e admirimin, ca më tepër aktori. Ai e dinte. E dinte dhe e pranonte, madje jo një herë inkurajimi e kishte nxitur çuditërisht shumë. Kësaj here tjetër gjë e kishte qetësuar: ata të tre e patën tërhequr në vorbullën e një gëzimi të beftë, të sigurtë. Ishin nga ata që afrohen pa të keq. Sidomos shoferi. Si e kishte emrin? Më kot u mundua t'ia kujtonte. Apo s'ia kishte thënë fare? Çudi. Ka njerëz që pa i njohur, pa ua ditur as emrin, të bëhen të afërt e të sillen të shpenguar... Po për një copë herë e kishin bërë të harronte hallin e atyre ditëve.

Shtrati gërviti. Saimi përsëriste padashur fjalë nga të rolit. I vinin vetë e ai i pranonte me qejf, se ishin të tijat. Po pse ndiente një si boshllëk, një si ftohtësi, një si...

Në mëngjes u ngrit më herët se ditët e tjera.

Shushurinin borigat. Përplaseshin valët në shkëmbinj dhe jehona përcillej tutje. Një mjegull e bardhë kishte zbritur gjer në mes të mallit ngjyrëhiri. Aty-këtu ajo çahet nga ca shigjeta ngjyrë jargavani. Vinte era luleshtrydhe.

Saimi eci ngadalë. Këmbët iu lagën në barrin me vesë.

Natyre e bukur, për besë! Gjynah të mos punosh, mendoj.

Prapë iu bë se po fliste me gjuhën e personazhit. Ishte ai e jo Saimi. Po kur do të bëheshin një? Deri kur? Ai psherëtiu. A do të shëtiste këstu personazhi që duhej të mishëronte? A do të shijonte mëngjesin e freskët, kaltërsinë e valëzave, këto pikla të argjendta... Bah, mund t'u kushtohet ai këtyre bukurive mahnitëse? Pa dyshim, njeri ishte dhe ai. Por...

Arritën shokët. Saimi padashur kishte vajtur te vendi i xhirimit. Dhe, për çudi, sikur hoqi çuça nga ajo snkrirje që po përpiquej të bente. Mos vallë po e linte vuilneti? S'ishte më këmbëngulës në atë që kërkonte? «Punë e vështirë kjo jona. Si je një ditë, nuk je tjetrën. Po personazhi të kërkon të jesh si do ai e jo si ta ka qejfi ty. Si do të donte ai, personazhi, të isha në këtë mëngjes të bukur?...»

— Mirëmëngjesi!

— Mirëmëngjesi!

— A dëshiron t'i shikosh dhe një herë dublat që kemi bërë? Do të bëjmë dhe një tjetër. Ka mundësi ta realizojmë më mirë.

Pas pak, kur aktorët ishin veshur e grimuar, Iliri i tha Saimit:

— Ti e di vetë: dhjetë vjet larg, ke vuajtur, të ka zënë malli sa s'thuhet, kthehesh me bindjen se këtu dhe vetëm këtu bëhet lufta e vërtetë për lirinë e mëmëdheut. Po të dalin natyrshëm këto, figura mbushet me jetë, bëhet e besueshme, bindëse.

Me një komandim pa fjalë të Timos grupi i xhirimit u bë gati. Regjisori hipi mbi një shkëmb.

— Erdhëm, më në fund, o zot i mirë! Ja mëmëdheu i shumëvuajtur! Ja malet e çukat me majat gjer në re! Ja qielli i kthjellët, që e shohim me sytë e mendjes kudo që të jemi. Ja...

Saimi u ngreh. Vështroi andej nga tregonte me gisht regjisori, u nder i tëri, puthi tokën, e buzët e tij shqiptuan fjalën mëmëdhe. Bukur, ngrohtë, plot mall. Mirëpo pas fjalës së parë iu rendit papritur një varg për malet e Shqipërisë... Krenaria për vendin e përshkoi të tërin. Atij iu drithërua zemra. Deri këtu mirë. Sytë i shëtiten si në një kërkim të ethshëm.

«Po shtroje shikimin, pse ashtu, çfarë kër-

kon?» ia bënte me vete, si me frikë, regjisori.

Saimi nuk arriti dot deri tek emocioni i plotë i mallimit. Ai e ndjeu këtë dhe u ftoh. Regjisori psherëtu. Timoja më kot e mbante syrin në objektiv. Po ndehej sërish shqetësimi i parë, Saimi e ndjeu deri në pejëzat më të holla të qenies së tij dhe i erdhi inat me veten. Kaq i dobët, kaq pa vullnet, kaq... Po ç'e pengonte, xhanëm, ç'e pengonte?... Pikë e zezë, sa e vështirë është ndonjëherë një gjë që në vështrim të parë të duket fare e lehtë! Ndryshe i qe dukur ai episod kur pati lexuar skenarin.

U dëgjua uturima e një makine. Të gjithë mbajtën vesh, a thua prisnin njeri a diçka. Ndoshta ngaqë s'kishin ç'të bënin e ç'të thoshin.

Te kthesa doli një kamion. Makina e mbrëmshme? Saimi u përpoq të shihte shoferin. Ai ishte. E njohu e sepse u gëzua. Kamioni qëndroi në anë të xhades. Shoferi hapi derën e kabinës dhe zgjati kokën.

— Tungjatjeta, shokë!

— Tungjatjeta! — iu përgjigj për të gjithë Juniku.

— A bën të shohim pak?

— Rrini! — tha regjisori dhe i porositi aktorët të bëheshin gati e të fillonin nga e para.

Shoferi e mbylli derën. Në kabinë ishte dhe një fshatar, sytë e të cilit rrokën me një shikim plot kërshtëri tërë grupin e xhirimit, aparatet e montuara, regjisordin majë shkëmbit, a thua se kërkonte dikë. Mbase s'kishte parë herë tjetër grup kineastësh. Kur ndeshi aktorin, kërkimi sikur mbaroi. Ai u mahnit, pastaj ia nguli sytë me dëshirë e kënaqësi. Ishte kënaqësia e njeriut që fare papritur takon një të njohur të dashur. E pa një copë herë të mirë pa folur,

mandej iu kthye shoferit si t'i thoshte: «Mirë e ke ti, ai është!»

Ndërkaq rifilloi xhirimi. Aktori-qiraxhi e mbajti kalin e iu kthye mëmëdhetarit — Saim:

— Mbërritëm, zot i mirë!

Saimi zbriti ngadalë e bëri disa hapa duke përpirë me sy detin, qiellin, malet.

— Mëmëdhe i shtrenjtë!...

Po këtu doli nga roli e iu kthye regjisorit.

— E kapërcyem, — tha. — Nuk u përkula të puth tokën.

— S'prish punë, Saim! Vetëm më natyrshëm, jo sikur reciton.

— Hëm! Ke parë ti që ashtu më del vetiu? Çuditë...

Ajo që vuri re befaz, e bëri ta ndërpriste fjalën.

Fshatari kishte zbritur nga makina e po i afrohej. Ecte nxitimthi, me sytë mbi të, sikur përreth të mos kishte njeri a gjë tjetër. Kur u ndodh mul pranë aktorit, pëshpëriti me emocion:

— Mirë se na erdhe!

Saimit i bëri shumë përshtypje. Një fshatar i panjohur po e përshëndeste si një të njohur për të cilin e ka pikur malli. Dhe sa thjeshtë! Dhe sa ngrohtë! Dhe sa natyrshëm!

Mos ishin parë e njohur diku? Jo, ai nuk i harronte kollaj fytyrat e të njohurve. Emrat i harronte, fytyrat kurrë. Fshatari dukej nga ajo anë.

Aktori ndjeu diçka të paprovuar ndonjëherë në ato ditë të mundimshme. Një si dhimbsuri, një ndjenjë mirënjohjeje, një dëshirë për ta përçafuar. Ishin afërsisht të një moshe.

Mos vallë atë kishte kërkuar? Në atë shikim ngulmues, pasi kishte shqiptuar fjalën «mëmë-

dhe», pas krenarisë nga takimi me natyrën aq joshëse, ndoshta pikërisht ai duhej të shfaqej? Me të duhej të piquej?

Fshatari iu afrua edhe më. Edhe Saimi bëri një hap. Duart e tyre u shtrënguan fort. Fshatari ia hodhi dorën në qafë dhe e ngjeshi në gjoksin e tij.

— Ti nuk më njeh e unë emrin s'ta di, se ti ke shumë emra, po për të njohur të njoh.

— Të faleminderit!...

Aktori foli i ngashëryer. Grupi i xhirimit u ndeh.

Fshatari shpejtoi në kabinën e makinës, mori një qeskë të mbushur me rrush e u kthye.

— S'më ndodhet gjë tjetër, merri!

Fytyra e aktorit u zbut, sytë iu njomën, në zemër iu derdh një valë e ngrohtë.

— Të falem nderit, o njeri i mirë!

— Hiç asgjë! Unë lipset të të falënderoj. Ti na je bërë i shtëpisë, të duam e kemi mall. Dhe kur piquemi kështu fare papritur... Po ti sot më nxore dhe një mall tjetër, atë të babait. Kështu na erdhi dhe ai kohë më parë...

— Si, domethënë ti...

— Është një histori e tërë. A vjen sonte nga ne? Gruaja do të gëzohet, fëmijëve do t'u bëhet zemra mal.

Aktorit iu rrëmbushën sytë.

— Ja, atje poshtë e kam shtëpinë. Fare pranë. Kur të mbaroni, vij e të marr vetë.

Lot përmallimi në sytë e Saimit. Jo, nuk shikonte më andej-këtej, nuk kërkonte gjë. E kishte thithur të tërin takimi me fshatarin, ftesa e tij, përfytyrimi për të atin, me të cilin e kishte shëmbëllyer.

— Motor! — pëshpëriti regjisori.

Po nuk qe nevoja. Që më parë e pa u ndier

operatori kishte hipur mbi kabinën e kamionit dhe po xhironte.

— E zumë! — thirri ai.

— Dale, po vendi, mizanskena...

— Ka ku të vejë më mirë? Fare natyrshëm. Episodi u mbush, iu shtua njeriu! Ajo që i mungonte, u gjend. E bukur, e pastër, e plotë!

Saimi ngriti kokën. Grupi i xhirimit ngazëllente. Timoja fliste me frymëzim. Juniku po e përshëndeste që matanë kamerës, duke tundur grushtin lart. Edhe ai e ngriti dorën. Pa me dashuri operatorin, regjisorin, i pa shokët me radhë dhe e përqafoi prapë fshatarin. Ndiante dëshirën t'i përqafonte të gjithë.

Mos m'u lut

Filloi si me shaka. Unë nuk them që shakaja s'është gjysma e së vërtetës. Ndonjëherë bën dhe më tepër. Flisnin për Rushanin. Njëra nga mjelëset hiqej sikur mbante anën e tij. E kishte me Nexhin.

- Pse, si të duket Rushani ty?
- Burrë me mustaqe!
- Mos u tall, është babai yt.
- Po ta kisha baba...
- E çë, po ta kishe?
- Do t'i lutesha t'i priste!
- Ua, kjo! Ç'ke me to ti?
- Nuk i shkojnë hiç. Në tërë atë fytyrë të kuqe ca qime të ashpra sivake... e shëmtojnë.
- E kemi përgjegjës, — ngulmoi tjetra.
- Vërtet, si shumë ndenji përgjegjës. Nuk do të bëhet nënkryetar?

— Si flet kjo! Kaq kollaj qenkan këto punë?

— Unë çuditëm si s'është bërë akoma kryetar!

— Edhe kryetar ka qenë Rushani. Kur sektori ynë ishte kooperativë më vete, atë kishim kryetar. Që në fillim. Ti akoma s'ishe lindur.

— Atëherë në fshat s'ka ç'detyrë të provojë më.

— E transferoke në qytet ti?

Nexhi s'u mendua fare dhe e këputi më të fortën:

— Ky Rushani nuk ka qenë asnjëherë kooperativist!...

Këto fjalë i vajtën në vesh Vesafit. Prej tij, dihej, do të shkonin në të Rushanit. Rushanit iu bë se i iku kapela nga koka. I tha tjetrit t'ia përsëriste dhe një herë. I dukej një gjë e çuditshme, e pabesueshme. Për së dyti Vesafi e torri gjatë. Rushani u mërziu edhe më shumë. Ai zgurdulloi sytë. Të bëhej se do ta rrihte shokun për lajmin e keq. Zbërtheu kopsën e dytë të këmishës e futi në gjoks dorën e tij të madhe dhe e fërkoj fort deri lart, ku një si ngërç po ia zinte fytyrën. Vështrimin tutje, po pa parë gjë.

E dinte që e mbanin nëpër gojë. Po kaq liksht, e për më tepër Nexhi dhe ato vajzat, që ai i kishte vënë në punë të mirë... Kujtdo që i bënte një të mirë, ai ia kërkonte mirënjohjen. Jo me të thënë. Ishte një gjë e zakonshme, kaq e natyrshme, dhe cilido duhej ta kuptonte vetë. S'ka njeri të mos e kuptojë. Kështu mendonte. Pra, gjersa flisnin dhe ato, diçka ziente. Mos po i sillej rrotull ndonjë ndërrim tjetër? Sidomos kjo e tronditi. Për një çast e besoi. Të ketë marrë flaka çatinë, mendoi, dhe unë të mos shoh gjë?

Ai e pa me qortim Vesafin. Vesafi rrinte si

guak e dukej më i dëshpëruar se vetë Rushani. Ka hallin e tij, tha me vete. Po më shkanë këmbët mua, i rrëzuar është dhe ky. Dhe sepse iu dhimbs. Nga kjo e mblodhi veten.

— Prapa krahëve shajnë dhe mbretin, — tha.

— Vetë e ke fajin! — ia ktheu Vesafi.

Vesafi me siguri e kishte fjalën për Nexhin. Nuk kishte dashur ta vinin mjelëse.

Në zyrën e vogël erdhi dhe Lumani. Vesafi nuk u druajt prej tij, ia tha ç'kishte dëgjuar.

Lumani e hoqi nga buza bishtin e cigares dhe me të ndezi një tjetër. Rushani e pyeti me sy. Ç'i thua |ti kësaj? Lumani tundi kokën. Kush flet me gojën e vajzës? Këtu më rri, iu përgjigj Rushani.

Hamendjet e tyre të heshtura mbetën pezull.

— S'të duan në fshat ty, Rushan, jo!

Rënkimi i Vesafiti shkoi tjetrit deri në zemër. Rushanit mënd i shpëtoi një psherëtimë, por u gëlltit.

— Ma do puna të ndeshem e të përflitem, — tha si filozof. — Po i bëre një të mirë njeriut, ta di. Po i bëre shumë, mësohet e i thotë mendja se je i detyruar. Ashtu pastaj s'ka të ngopur. Një herë t'ia prishësh, të shiti!... Unë për këtë fshat e për këtë kooperativë...

Ai donte të thoshte që kishte shkrirë jetën a diçka të tillë, po s'e tha. Ishte nga ata që janë të aftë të përmbahen. Njeriu që i hapet kujtdo e për çdo gjë, është qurravec, mendonte. Ai që ankohet, qaraman.

Atij i erdhi inat e u prek. U prek e për-humbi në mallëngjimin e vet.

Një jetë e tërë që po bëhem copë, tha me vete. Shokët e mi ku e ku! Unë iu dhashë fshatit, u lidha me të. Zunë të më thërresin Rushani

i Sopit. Gjë e mirë, ë? Më është bërë qejfi, s'them jo. Mirëpo këtu... Pse të mos ma dinë, bre? Ç'më kanë kaq inat? U dhëmbin sytë të më shohin në krye të fshatit? Apo u lodhën me mua?

Ai u tremb nga pyetja që i mbiu aq papritur.

Kush, vallë, flet me gojën e Nexhit? Jemi ngrënë me të atin. Çekan i kam ndenjuri Arifit. Tashi është rregulluar punë e madhe burri i botës dhe unë budallai kujtoja se ai ka harruar! A, o xhan, si është fshatari! Ta vë vath në vesh e pret ditën. S'është çudi që dhe Gëzimi... Dendur sikur po ngjitet këtej.

Gëzimi ishte djali i Arifit. Qëkurse ai doli agronom, Rushanit iu shpif një e keqe në shpirt. Druhej se mos ia sillnin në sektor. Si të merrej vesh me të? Ku ta dish, ai mund ta zëvendësonte dhe si përgjegjës sektori. Pa mund ta vinin kryetar. Thoshin që ishte i zoti. Gëzimi u emërua në fermë, pastaj në seksionin e bujqësisë, po ç'bëri ajo, mjaft të kujtohej ndonjëri andej lart dhe...

Ishte një si frikë shpagimi, që e ndiqte vazhdimisht dhe shpesh e mundonte keq. Ai nuk ia pohonte as vetes, po Nexhin e vuri mjelëse që ta kishte mirë me Arifin e pas tij me Gëzimin. Në komitet ishte. Ai u pati thënë nja dy shokëve në rreth që Gëzimi s'bente për në komitet, ashtu, punë biografie, i ati ua kishte sjellë majë hundës, mirëpo kjo s'piu ujë. Dhe tani atij i kishte ardhur në të djathtë, mund ta thoshte një fjalë e t'i dëgjohej. Prej vitesh, që me bashkimin e kooperativave, s'e shihnin më me syrin e parë. Vërtet s'e hiqnin dot si kuadër, s'u prishte dhëmbi gjer atje, po ja, e telendisnin sa në një detyrë në tjetrën. Me agronomin e sektorit majë më majë. Në organizatë një e dy dhe ngrihej problemi i drejtimit e organizimit të punës.

Ai Fiorenci njëherë... Ç'i mbante iso dhe ajo Leta, mesuesja. Mirë e kishte ai që s'donte ta pranonin, po ç'e do, s'ngui kembe. Mës e nxistë ajo Nexhin? Si shume shoqëroneshin...

— Ie isna unë, i shkoja shokut mendu e ia numëroja të tëra, — tna Vesafi.

Rushani u permblodn. E kuptoi që e kishte lëshuar veten. Pa Vesafin pastaj Lumanin e tna ngadale:

— Jo, nuk bën.

Po sytë i shkanë vetiu te rafti i vjetër. Nja dy gazeta, ca dosje, nja dhjetë a pesëmbëdhjetë libra të plunurosur dhe mbi ta, mbështetur në një vazo lulesh, një kartolinë e vogël. Në vjesh-tën e shkuar Sekretari i Parë i Partisë në Rreth kishte qenë në një mbledhje të kooperativës. Rushani bëri çmos që ai t'i kthehej në shtëpi. Sekretari s'ia prishi. Me të dhe kuadrot kryesorë të kooperativës. Këtu, madje, ia bënë qejfin mal, ngrinin shëndete për Rushanin. Te Rushani të më ngordhë gomari mua, ia bënte njëri dhe rrëkëlle gota... Ca ditë në fshat veç për këtë ngjarje u fol. More, thuaj ti, po Rushani... E duan në rreth Rushanin... Po shkoi nja një javë e sikur u harrua dhe kjo. Çudi me këta fshatarët! Pastaj sekretari i dërgoi atë kartolinën. Ndonjëri pëshpëriste që Rushani mburrej me të. Rushani s'ia merrte për keq. Le të kishte dhe ai tjetri e le të mburrej dhe ai!...

Atij i qeshi nuri. U ngroh e u trimërua. Kot ishte shqetësuar. Ja, Lumani aty, Vesafi aty. Kokenë linin. Fjalën dy s'ia bënin. Jo, nuk duhej t'i ankohej sekretarit. E, po të ngjitej ndonjëherë vetë në Sop... Ndërkohë ai s'do të rrinte duar-lidhur. Ashtu kokulur e i squllur ishte më keq.

— Ka bërë kërkesë për në Parti, the? — pyeti si rastësisht.

— Më ka thënë dy a tri herë, — tha Lumani.

— Koka e saj! — ia bëri Vesafi.

Rushani u shtir sikur nuk e dëgjoi. Kaq duhej. Lumani e dinte vetë.

— Shkoni tashi, se kam punë, — tha. — Dërgoma ca këtu atë çupën. — iu drejtua Vesafit.

Kur hyri Nexhi, ai ishte kërrusur mbi ca fletë shpërndarë në tryezë. Në gishtërinjtë e tij stilolapsi lëvizte me ngathtësi. Dukej se ai s'e merrte dot seriozisht si një mjet pune, ndaj sikur s'i zinte besë.

— Më deshe gjë?

Ai ngriti kokën. Po të më thotë për shakanë e mbrëmshme, do t'ia këput copë: mos e bëj veten, të mos flasim, mendoi vajza. Por Rushani s'e ngau fare atë muhabet.

— Gjene me atë punën e ujit ti?

— Jemi keq. Fshati s'ka, stallat s'kanë. Uji i përroit nuk u bën mirë lopëve.

— Atë nge kemi tashi? Na zien koka për fushatën!

— Fushatat s'kanë të mbaruar.

— Ë? Këtë e the mirë. Po ka fushatë e fushatë.

— Të kam parë dhe në ditë me diell, thonë.

Rushanit i lëvizi buza e sipërme. Furça si-vake u drodh.

— Ti do më mësosh mua?

— Jo unë, nevoja.

— Çupë! Më të shkurtra! Ë, xhan! Ke bërë pesë pare shkollë dhe çoç të duket vetja. Shkollën tëndë unë...

Nexhi u bë kureshtarë. Ç'skollë kishte Rushani? E kishte dëgjuar të fliste për punë kuresh. Ne në kurs... Kur isha në kurs në Tiranë...

— Unë të hoqa nga foragjerja e të bëra mjelëse...

Ajo fërgëlloi. Unë të vura, unë të heq, donte të thoshte ai? Rushani vërtiti stilolapsin me nervozizëm. E sertë, mendoi. Kokën e të atit ka. Unë bëj çmos të harroj, këta... I erdhi t'i përvishej njëherë si dinte ai. Ose urtë e butë t'i thoshte: «Çupë, që tashti je e pushuar». Por jo nuk duhej ashtu. Le të merrej Lumani. Më mirë. Vetë e kishte kërkuar. Arifi ngrinte këmbën e ai do t'ia ngulte një gozhdë. Do të bëhej ca gjullurdi. Ashtu i hidhej urov nëpër shkallë dhe Gëzimit...

Rushani gati po ngazëllente. Ai e zotëroi veten. Vërtet me zor, ama ia doli, dhe vetë u çudit sa me të butë u soll më tej.

— Ti rrëmbehesh, — tha. — S'bën kësisoj. Por unë nuk të zemërohem.

Ai mbase donte t'i thoshte dhe ndonjë gjë tjetër, po vajza iku me nxitim. Nexhi nuk e vuri re ndryshimin e tij në fjalët e fundit. Ajo s'i dëgjoi fare ato. Butësia ishte një gjë fare e vogël, kundrejt hakërrimit të mëparshëm. Nexhi ia kishte pikasur që në fjalët e para. Ai nuk e pa asnjëherë në sy, ndërsa nën mustaqe lëkura i dridhej vazhdimisht. E vënkësh ai mjelëse! Cfarë, edhe për të punuar u dashkësh mirësia e dikujt? Ajo donte të mbahej me zotësinë e saj. Vetëm të saj! Po të mos qe e zonja, po të mos e bënte punën mirë, atëherë po, le ta hiqnin!

Dhe këtu për të parën herë ajo e shkoi ndër mend që me Rushanin s'kishin marrëdhënie të mira si familje. E dinte me kohë. Njëherë e ëma e pa me Esmanë, vajzën e vogël të Rushanit, dhe i tha të mos e kishte shoqe. Po pse, moi mama? Se ashtu! Është zënë babai me xha Rushanin? Ty s'të duhet gjë! S'kishte pyetur më. Ndoshta

sepse me Esmanë nuk i hahej muhabeti. Ajo ua varte mësimet. Mirë jemi dhe kështu, thoshte. Dhe s'vajti më tej se e teta. Ftohtësia ndër-mjet dy familjeve i ishte dukur si hiri që lë pas një zjarr i shuar.

Atij i ka djegur dyfish, tha me vete dhe sikur u pendua që kishte bërë shaka. Se ajo ndiente ftohtësinë, po jo ndonjë mëri.

Që nga zyra drejt e në stallë. Njëra nga shoqet e pyeti me sy. Ë? Hiç, ia bëri Nexhi dhe vijoi punën e lënë në mes.

Pas pak në stallë u duk Lumani.

Ai ishte magazinier. Fare pranë e kishte depot, po rrallë hynte në stallë. U vërvit ca andej-këtej, diçka shikonte, për diçka interesohej. Kur shoqet vajtën të merrnin jonxhë, ai iu afrua Nexhit.

— Ç'kemi, Nexhi?

— Ja, punë.

— Ia more dorën ti, je çupë e shkathët.

— Falemnderit, po këto shko ia thuaj Rushanit.

— Pse Rushanit? Ç'hyn Rushani këtu?

— Atij i duket se unë e ha bukën kot.

— Jo, Nexhi, s'e njeh mirë Rushanin ti.

S'e njoh? Ashtu qoftë, tha shikimi i saj. E ndjeu që biseda s'qe e rastit. Kjo hamendje i erdhi bashkë me një shqetësim.

— Ti më pate thënë për atë kërkesën, — tha Lumani.

— Ta bëj?

— Dale njëherë, ta shohim.

— Pse më sorrollatni?

— Kush të sorrollat? Mos lësho llafe të këntilla!

— Më fal!

— Të bëhesh komuniste, s'është kollaj.

— ... ?

— Dalin ca gjëra. Ajo puna e babait në luftë... Pastaj me kooperativën. Troç ta themi, Ariefi nuk ka dhënë për kooperativën. Hyr e dil, sikur ajo është han me dy porta.

I gjatë, kockëmadh, me gropëzat e syve të thelluara, ai dukej se trembej vetë nga fjalët që tha. Lumani s'e hiqte cigaren nga goja. Të bëhej se tymi i duhanit e kishte nxirë e tharë ashtu.

— Kjo punë është, si të thuash, pleqtë i hanë mollçinat, fëmijëve u mpihen dhëmbët. Prandaj njeriu lipset të baresë me mend në kokë. Të ecë si në akull. Pak po krisi, hiqe këmbën! Ariefi është rrefyer ca kokëshkretë... Po ne do ta shohim. Se as për Gëzimin s'është mirë pastaj...

Vajza u bë më e vëmendshme. Ç'donte me Gëzimin ai? Po bënte ajo kërkesë, jo i vëllai. Apo e kishin dhe me të? Ndoshta dhe me të atin?

Nuk dëgjoi në tha gjë tjetër Lumani. Shqetësimi iu rrit. S'i rrihej në punë, i vinte zor t'i shikonte shoqet. Ato do ta pyesnin. Ç't'u thoshte? I dukej se kishte bërë një gjë të keqe, një nxitim, një mburrje, as vetë s'ia vinte dot emrin. Pse i shtrembëronin ndodhitë e jetës së të atit? Kështu ishin vallë? U bë flakë në fytyrë. Iu kujtua një gjë e thjeshtë, fare e thjeshtë, ja ajo, që babai i kishte mësuar ta shikonin cilindo drejt në sy. Kush të shikon në sy, është i ndershëm, nuk di të gënjejë.

Njëherë mendoi t'i thoshte Letës. Ç'ke ti, i kishte thënë ajo. Ti vetëm bëji sa më parë dokumentet. Po dhe për këtë s'qenkësh lehtë. Lumani po e pengonte që në hapin e parë. Leta e shihte të lehtë, Florenci jo. Është ca e përpjetë, po do ta ngjitim, i pati thënë ai në sy të shoqes. Ua, e përpjetë! E pse? Nexhi është kaq e mirë. Ç't'i shash? Leta seç ishte kujtuar papritur: Ti thua mos na e presin qumështin?... Vi-

te më parë Vesafi ndiqte tetëvjeçaren e mbrëmjes. I kishte vajtur disa herë me vonesë në klasë dhe një mbrëmje ajo s'e pranoi. Ai një e të Rushani. Ku e ke atë listën e qumështit për mësuesit? Ç'e do? Nëma ca këtu! Dhe e kishte fshirë emrin e saj...

Leta bënte shaka. Edhe Nexhi vetë kishte bërë një ditë më parë. Por...

S'i pritej sa të shkonte në shtëpi. Do të bisedonte me të atin. Atë po e mundonte kureshtja për ato gjëra që ende s'i dinte mirë. Sapo iu dha rasti, tha:

— Ç'i ke bërë ti, baba, atij?

— E dija që një ditë do më pyesje, — tha ai.

— Ç'i kam bërë? Para kooperativës, në fshat u ngrit kolektiva. Unë desha të hyja, Rushani s'më linte. S'ke ç'të dorëzosh ti, më tha. Po ti, i thashë, ku i gjete, ti që më sillesh si një kulak i ri? Se dhe ai si unë kishte qenë. Reforma i dha tokë e bagëti. Unë e ca të tjerë mbetëm me atë pak tokë që kishim, meqë ngisnim qymyrin, s'ishim bujq. Ai u bë tym. Mua të më thuash kulak ti, mua? Ti, që në luftë ke qenë indiferent! Pse paskam qenë indiferent, apo nuk mbloodha gëzhojat e nja dy pushkëve që hodhe ti? Ai u fye më keq. Dhe llafi solli llafin.

— Pastaj?

— Më tej unë bleva një mushkë tjetër dhe zura punë në Ndërmarrjen Lëndëdjegëse.

— Ti krise e ike, unë mbeta këtu, — tha nëna e Nexhit.

— E çë se mbete? Rushani s'ha njerëz që!
Nexhi u bë sy e veshë.

— Atij i erdhi mirë që ika. E hoqa qafe, mendoi, kushedi. Po kur e pa që më ecte, dërgoi shkresë të më ndalonin nga puna.

— Tërë ato që hoqëm, — tha e ëma e Nexhit.

— E ç'hoqëm? Për mirë na doli. Unë nuk desha t'i jepja çikë. Që të mos kish ku të kapej me mua. Ashtu punova më mirë. Dhe për ju u kujdesa ca më shumë.

— E la ky, e nishe ti, — tha nëna. — Dëgjomëni mua, mos e ngani më. Ai po sillet mirë, të dha punë për bukuri, ju s'e lini që s'e lini. Mos e nga ardhjen, thonë, se del gjarpri. I thonë Rushan atij. I shkon llafi, ka të bëjë. I vjen i madhi i rrethit gjer këtu.

Të tre s'dinin ç'të thoshin më. Kjo kishte bërë përshtypje në fshat. S'e dinte njeri në ishine të vërteta apo jo, por kohë më kohë lëshohej ndonjë fjalë për miqësinë e Rushanit me Sekretarin e Parë të rrethit. Kartolinën, njëherë, e dinin të gjithë. Ajo ishte atje, në zyrën e Rushanit dhe, kush të donte, mund ta shihte vetë. Thoshin që, kur zbriste në qytet, Rushani i shkonte në shtëpi.

— Nuk do Rushani, jo! — tha Arifi pas pak.

— Po Lumani?

— Lumani? Njeri i mirë, derëziu po pa çap. Kush s'ka çap, do kërkojë të mbahet gjëkund. Ai e kurdis orën me të Rushanit.

Arifi i kishte fjalët të pakta. Me gojën e Lumanit folka Rushani, mendoi Nexhi. Në një gojë pështyjnë ata të dy. Ata të dy dhe Vesafi tre. Po tjetër?

I ati kërkoi me duar sipër xhepave të pantallonave, u ngrit e doli në trem, ku varte xhaketën, dhe u kthye me kutinë e duhanit në dorë. Dukej që s'ishte aspak i qetë.

— Ti po na hap telashe, moj çupë. Më tepër vetes sate. Po unë s'të shaj.

Nexhi gati u përlot.

— S'ke besim ti, baba?

— Jo, s'e thashë.

Vajza e pa në sy. Kjo është më trime nga Gëzimi, mendoi Arifi për të. Ai u pendua për fjalët që i tha. Pse ta trembte? Nisi prapë, tha me vete. Sa bëjmë gjë ne, na del përpara Rushani. Kaq kohë që këndon gjel këtu, ka bërë një- rrez me vete. Dhe e mban inatin si derri plum- bin.

Ai e hetoi të bijën. Do t'ia dilte, vallë? Dhe si ta ndihmonte? Nuk ishte një gjë që i përkis- te vetëm asaj.

Nexhit kurrë s'i kishte shkuar ndër mend që t'i dilnin pengesa për pranimin në Parti. E kishte me shumë dëshirë dhe kujtonte se, porsa t'i thoshte sekretarit të organizatës, ai do ta përgëzonte... Mirëpo takimi me Rushanin, fjalët e Lumanit, biseda me prindërit, i krijuan një gjendje dvshimi. Ishte para një ngjarjeje të ma- dhe për të, e njeriu në këso rastesh gjithnjë ka njëfarë shqetësimi. Ca më tepër kur ngjarja afron e papritur sheh që nuk cenka si e ka menduar...

Nexhi e ndieu thellë shqetësimin, madje si- kur ndryshoi. Rrinte shpesh e menduar. Nga- njëherë sikur hutohej. Shoqet u bënë merak. Ndonjëra e ngacmonte për t'i hequr mërzinë. Mos të ka zënë qymvri andei nga avteti. Ne- xhi? Si shumë vete! Nexhi vinte buzën në gaz, po me pahir. Ato bënin habi. C'kishte pësuar? Ajo ishte më lavrakia. Pse e kishte syrin të kë- putur? Nexhi vec buzëqeshte. Po s'kam gjë, ç't'ju them unë?

As natën nuk gjente qetësi. Vërtitej në shtrat e s'e zinte gjumi, i shkonte ndër mend gjithë bëmat e ditës. Nië javë e ca s'ishin bërë të gjallë as Lumani, as Rushani. Nië shaka me shoqet ajo dhe hop, i ngritën veshët! Ishin frikësuar nga shakaja e saj? Bah, një burrë si Rushani, që e kishte mik sekretarin e parë! Po ky sekretari...

Ashtu befas i lindi një mendim. Sikur t'i shkruante një letër? E kishte mik Rushanin? Mirë, le ta kishte! Po ajo do t'i thoshte të vërtetën. Pastaj ajo nuk do t'i kërkonte vendin e përgjegjësit, de! Përgjegjësi veç të mos i binte më në qafë as asaj, as familjes së saj. Pse, ç'ishte ai? Dhe të mos mbante pas vetes ca njerëz të pazotë e lajkatarë. Pra më mirë atij sesa...

Dhe i shkroi që të nesërmen. Dua të hyj në Parti, kam bërë kërkesë, po nuk do Rushani. Pse më pengon? Ç'ka me mua ai? Në është zënë njëherë me babanë tim, s'ia kam fajin unë. Unë dua të bëhem komuniste.

Kaq. Të tjerat do t'ia thoshte me gojë. Ai do ta thërriste në komitet. Patjetër!

Letra i krijoi një besim çuditërisht të madh dhe ia hoqi si me dorë rëndesën që i shtrëngonte zemrën. U ndie e qetë, e sigurt. Si s'e kishte bërë më parë këtë gjë? E nisi letrën dhe eci me mend pas saj. Autobusi vinte në qendër të kooperativës në orën 12. Dhe kthehej menjëherë. Në orën 16 letra mbërrinte në qytet. Sekretari do ta merrte të nesërmen në mëngjes. Po mund t'ia shpinin në mbrëmje. Sekretar i Parë ai! Pastaj e përfytyroi duke lexuar letrën e saj. A, jo, Rushan s'e ke mirë kështu!...

Nexhit i rrahu zemra nga kjo pandehmë. Ndihej si flutur. Ashtu gjithë ditën. Në mbrëmje pati një mëdyshje. Mos vallë ishte nxituar? A duhej ta bënte problem deri te Sekretari i Parë i Rrethit? Pak punë kishte ai...

Dhe iu kthye përsëri shqetësimi. Pas kësaj herë qetësohej, herë mërzitej. Po gjithë në pritje. Ngrysej e gdihej ajo e ngrehur, qiçër. Si do të vinte më tej kjo punë. Shkuan ditë e asnjë zë.

Një pasdite në të përpjetën e fshatit, u dë-

gjua një uturimë makine. Një gaz, tha njëri dhe Rushani e nja dy të tjerë dolën me ngut. Gazi ndaloi te sheshi para zyrave të sektorit. Zbriti sekretari. Rushani shpejtoi ta takonte.

— Mirë se na erdhe, shoku Mendu! — dhe u zgjat ta përqafojë. Sekretari i dha dorën, po ftohtë. Rushani s'e bëri veten. Të tjerët panë njëri-tjetrin.

— Urdhëroni! — foli Rushani duke treguar hyrjen e zyrave.

— Janë të freskëta këto zyrat tuaja?

Rushani qeshi. Shokët e tij bënë habi.

— Vemi nga shtëpia? Një gotë dhallë, një... — nxitoi të thoshte.

— Hëm! — ia bëri sekretari.

Të tjerët e nuhatën që i sapoardhuri ishte qejfprishur dhe nga kjo u ndeh një si druajtje. Rushani, që dukej si i përjashtuar nga çdo merak, i bëri shenjë njërit dhe ky, i gatshëm, nxori disa karrige e sekretari u ul aty.

— Si veni me fushatën?

— Korrja në mbarim. Një makinë shirëse ka defekt. Më shumë me riparime sesa në punë.

— Sa po arrini?

— Do t'i zëmë dy a tre kuintalë për hektar më shumë se vjet.

— Sa?

— Asaj arës te lumi ia morëm 40-kuintalëshin. — Rushani e vuri kapelën mbi sy dhe sytë mbi sekretarin. — E patë?

— Unë pashë kallinjtë e lënë në arë!

Rushani u step e bëri një hap prapa. Sekretari u vrenjt.

— Një metër katror tre kallinj! Po në dhjetë, në njëqind, në dhjetëmijë? Bëhen shumë, apo jo?

— Bëhen.

— Atëherë?

— Po... s'ia dalim dot. Ç'të bësh më parë, ç'të shohësh më parë!...

— Si bëjnë të tjerët?

— Të tjerët? Hall mbi kokë. Secili e di ku i pikon çatia.

— Çatia juaj pikon grurë! Si bëre me «Dajtin»?

Rushani rrudhi vetullat. Edhe këtë e dinte?! Ka njerëz të zellshëm /që njoftojnë, mendoi. Kishin mbjellë një goxha parcelë me kultivarin «Dajti». Ai dha prodhim të mbarë po nuk e korrën me kohë dhe u ronit shumë.

— Patëm ca dëm. U hëngrëm me agronomin dhe ai...

— Nuk të duket se po hahesh si shumë?

Rushani i vërtiti sytë si një ka zevzek që s'do të hyjë në brazdë. U kreshpërua e u mat t'i kundërshtonte. Po më parë sepse deshi një mbështetje. Më kot i kërkoi sytë e vartësve. Ata shikonin përdhe. Në sy po e shikonte vetëm shoferin i sekretarit, Taku. Rushani sepse mbajti një shpresë dhe tek ai, por shpejt e kuptoi se as atij s'i dhimbsej. Në të kundërt, sikur po gëzohej. Ca kohë më parë kishte qenë po në Sop dhe po ky Rushan i kishte dhënë një kurorë me qepë. «Merri, Taku!» — dhe pas kësaj kishte shtuar: «Ç'thotë shoku Mëndu për mua?» Shoferit i ishte përshtirosur. S'është e thënë të pish gjithë butin që të provosh verën. Mjafton një gotë. Pas kësaj Taku bënte habi me sekretarin. Dhe me të kapërcyer lumin, e kishte hapur këtë bisedë.

«Te Rushani do vemi?»

«Në Sop, — i kishte thënë sekretari. — Për Rushanin, por jo te Rushani.» Takut i pëlqeu përgjigjja...

Ashtu i hutuar, pa ditur ç'të thoshte e ç'të

bënte, hodhi sytë në anën tjetër dhe pa të vinte drejt tyre një vajzë. Buzagaz, me një fustan basme të kaltër stërpikur me të bardhë.

— Si jeni, shoku Mendu?

Ai ia shtrëngoi dorën dhe e pa me vëmendje.

— Nexhi je ti?

Vajza u gëzua që ai e njohu.

— Ç'kemi këtej? — e pyeti sekretari.

— Keq me ujin e pijshëm. Vetëm një çezmë kemi. Edhe ajo e ka pakësuar ujin e rrjedh si rakia nga kazani. E zëmë natën me koçan misri që të mbushet ca rezervuari. Ditën, gra e vajza rrinë në radhë.

Sekretari u çmerit. Ai pa Rushanin. Vërtet kështu?!

— Vend dreqi, s'ka ujë, — tha Rushani.

— Po te shkëmbi i Komitit?

— Atje ka.

— Pse s'e sillni?

— Është larg. Fshati ynë është rrëzë shkëmbinjtë, ku s'e arrin dot dreqi, jo më uji.

— Që të mos e arrijë as dreqi, e kanë bërë fshatin kaq lart, ti ke të drejtë. Kanë pranuar kushte të vështira të parët tanë, që të siguronin jetën.

Rushani e ndoqi me një si mëdyshje.

— Vete një djall e gjysmë. Jemi kooperativë malore, s'kemi takat.

— Këtë kalem e punuake mirë! Atë tjetrin e përdor nga fshirësja! Bëmë goxha luftë të Shkëmbi i Komitit. Njësitë i Sopit i goditi gjermanët në krah e na dha dorë. S'e vunë në kalem rrezikun djemtë e këtij fshati.

— Unë isha vetë atje! — u hodh Rushani.

— Ishe, po ke harruar.

— Unë?!

— Me sa duket...

- Rushani e ka pusin, — vërejtji Nexhi.
- Bëje dhe ti, kush të pengon?
- Gjetkë s'del ujë, ti e di më mirë. Pastaj, me pus do t'i ngopim lopët? Ne kemi thënë që kanalin e bëjmë me punë vullnetare.
- S'do ti, Rushan? — pyeti sekretari.
- Jo unë. S'është puna te një njeri.
- Nganjëherë po.
- Çalojmë nga organizimi, — tha Nexhi. — Na bëhen punët lëmsh, njëra zë tjetrën. S'i shohim gjithnjë me syrin politik.
- Ç'flet, moj çupë?! Je në të ti?!
- Rushani, që s'ishte përmbajtur dot, shtrembëroi buzët e vuri gishtin në kokë dhe e vërtiti si turjelë. Ai u kthye nga sekretari. E po, le ta shihte dhe ai sa mendjelehta ishin këto vajzat e reja. Me atë shikim ai tha dhe tjetrën, që s'duhen lejuar të bëjnë gabime të këtilla. U ngroh, u buçkarit, i erdhi përmbarë. Sa më tepër gafa të bënte ajo, aq më shumë i rritej vlëra atij.
- Unë kam mendimin tim, — këmbënguli vajza.
- Mirë, xhanëm, mendimin tënd, po matu një çikë ë, xhan! S'e di ti ku të qorrollisin këto të trasha që këput!
- Ti e vërtit fjalën nga të vjen për mbarë.
- Unë?! Unë?! Mua më thua kështu ti?!
- Vajza u turbullua e iu mor goja. Rushani ia qepi shikimin sekretarit. E kemi a s'e kemi për detyrë t'i ndihmojmë këto buzëqumështet? Ndryshe shkasin!
- Dale, dale, — ndërhyri sekretari. — Pa hë?
- e nxiti Nexhin.
- Po ja, le të marrim qoftë dhe punën e ujit.
- Përse s'është zgjidhur deri tani?
- Se s'duam telashe!

— T'u vëmë emrin që kanë gjërave, — kërceu Rushani. — Unë e thashë, s'kemi këllqe.

— Posi, na e mbushe mendjen! — ia bëri Nexhi. — E sheh këtë shtyllë ti? Me atë gjykimin tënd drita elektrike në Sop do të vinte pas nja njëqind vjetësh.

— Ç'na i ngatërron gjërat ti? Hajde, baba, të të rrëfej arat! Kur unë ngrija shtylla e shtrija linjat për atë elektrifikimin, që thua ti...

— Kjo i binte maces me lugë! — e ndërpreu sekretari.

Rushani ngrysi vetullat me kryeneçësi. Sekretari iu kthye Nexhit:

— Sa vjeç je ti, moj vajzë?

— Njëzet e dy.

— Ke qenë partizane?

— Partizane?! — Vajza ngriti supet. — Unë atëherë s'isha lindur.

— Po pse s'ishe lindur?

Ajo qeshi e hutuar.

— Duhej të kishe lindur e të ishe rritur, të dilje partizane, të bëje Reformën Agrare e të ngrije kooperativën, atëherë po, mund të flisje, siç po flet, faqe këtij burri!

Rushanit iu ndez fytyra.

— Shoku Mendu!...

— Shoqja Nexhi, thuaj më parë! Ajo e kishte fjalën e asaj jepi përgjigje.

Rushanit iu bë sikur i ranë me shuplakë. I erdhi turp e inat. Duke u përmbajtur me zor, tha:

— I kam dhënë këtij socializmi unë, shoku Mendu, dëgjon, dhe s'lejoj që...

— Më shumë i ke dhënë apo i ke marrë? Me këtë ta matim veten.

— Të lutem shumë!

— Hiç mos m'u lut!

Askush nuk i ishte drejtuar ndonjëherë ash-

tu. Asnjëri nuk i kishte folur ndonjëherë aq ashpër. Ai s'e njihte këtë gjuhë. Ishte kaq e pazakonshme, kaq e papritur, saqë harroi para kujt gjendej. Po vetëm për një çast. Pastaj u përmblodh. Ky ishte një kërcënim. Rrotulloi sytë. Nja dy shikime të habitura. As Lumani aty, as Vesafi, as ndonjë tjetër që mund t'ia merrte anën. Por, mund t'ia merrte?... Nuk ishte parë djersë në ballin e tij. Gjithë i kuq në fytyrë, e para herë që zverdhej.

...Në kthim asnjëri s'fliste. Makina ecte në udhë të vështira e Taku bënte kujdes. Kur dolën në xhade, e shtoi shpejtësinë. Uturinte motori. Makina çante ajrin e freskët të mbrëmjes. Era përplasej në kabinë e shkiste anash me fishkëllimë. Të dy e kishin qejf shpejtësinë dhe po e shijonin.

— E, mo Taku. Ç'na thua?

— E fortë! — tha Taku.

Nuk u mor vesh nëse shoferi e kishte për vajzën apo për ndodhinë në Sop. Njëlloj. Sekretari ia mori një kënge. Ai këndonte ngadalë e shtruar. Kishte zë të trashë, të plotë e të ngrohtë. Ia priti me zell Taku. Zëri i tij ishte i fortë e ca i pabindur. Sekretari këndonte e vinte buzën në gaz. Ai i donte njerëzit kurajozë dhe nënqeshja e tij shprehte kënaqësi e jo qortim për stonimet e Takut.

Hija e një dyshimi

Kur tringëlliu zilja e pushimit të madh, Lina doli menjëherë nga klasa, ia dha regjistrin një shoqeje dhe nxitoi për në shtëpinë e së ëmës. Kështu bënte përditë, nxitonte shumë, ndryshe nuk mund të arrinte në atë pak kohë sa i lejonte pushimi.

Ashtu me të shpejtë ngjiti shkallët e pallatit, vërtiti çelësin në bravë dhe e shtyu derën me vrull. Pa u kujdesur ta mbyllte nga pas, bëri nga kuzhina, por u ndal e trembur në mes të korridorit. Nëpërmjet derës gjysmë të hapur të dhomës së pritjes një burrë po e shikonte me habi. Ç'ishte ai burrë? Edhe i njohur, edhe jo. Diku e kishte parë, po atë çast nuk u kujtua.

Burri qe ulur në kolltukun dyvendësh. Ai e ngriti dorën si për ta përshëndetur, po s'e bëri këtë, ua shkoi flokëve, duke u munduar t'i shtron-

te. Ai vazhdonte ta shihte Linën si me habi. Atëherë ajo e mblodhi veten, i bëri shpejt e shpejt ata pak hapa që e ndanin prej tij, iu afrua me mirësjellje e i zgjati dorën.

— Si jeni?

— Mirë...

Lina e humbi e nuk po i jepej ta pyeste kush ishte e çfarë donte aty. E papritura sikur e trembi. Ajo pa përreth me frikë. Atëherë i panjohuri tha:

— Monda është matanë.

Ama ishte Monda? Ajo mori frymë e lehtësuar dhe u sul në kuzhinë. Monda ishte aty vërtet. Me penuarin e vjetër, me mëngët përveshur, diçka po kërkonte në bufe. Edhe se hyri Lina, ajo s'e ktheu kokën.

— Monda, ç'është ai burrë, moj?

— Ku?... Si?...

Lina ende s'po e vinte re tronditjen e kumatës.

— Sikur e kam parë...

— Ku është rakia?

— Ja, moj, s'e sheh?

Befas e pikasi hutimin e saj. Vrenjti vetullat dhe hetoi padashur. Mondës një çehre i ikte, një i vinte. Linën e gërrici fort një dyshim. Hutimi i së kumatës, dera e mbyllur...

Monda shkoi ta qeraste atë burrin. Lina mori shishen e qumështit në frigorifer, e mbushi xhezven dhe e vuri të ngrohej në furnelën elektrike. Këto ishin ca veprime krejt mekanike. Mendimet e saj rrihnin tek e papritura e atij çasti. Ç'ishte kështu? Ç'po ndodhte? Ç'kishte ngjarë?...

Në shpirtin e dëlirë të Linës po rrokullisej një dhembje. Që matanë vinte biseda e atyre të dyve. Një bisedë me gjysmë zëri, e copëtuar,

e trembur dhe ajo. Linën nuk po e mbante vendi. Mendoi të ikte me vrap. Menjëherë! Ku? Në shkollë? Në punën e së ëmës? Tek i vëllai? Ku të mundte, veç të ikte. Po nuk iku. E ngrohu qumështin, e shtiu në një termos të vogël, lau xhezven dhe e vuri në vendin e saj, hoqi edhe prizën... Ç'mbetej tjetër? Nuk i bënte zemra ta hapte derën, se do t'i shihte ata të dy. Ç'tu thoshte?

Më në fund kafshoi buzën e doli. Monda e ai burri e kthyen kokën nga ajo, po Lina tha një «mirupafshim» nëpër dhëmbë dhe nxitoi përjashta. Shkallët i zbriti dy e nga dy.

* * *

— Kunata? — pyeti burri në dhomën e pritjes.

— Po, motra e Lekos, — u përgjigj Monda.

Padashur ajo e shoqëroi me mend të kunatën. Për ku po vraponte, vallë?

— Djalin e ka në çerdhe. Çdo ditë në këtë orë i çon një gotë qumësht.

Monda e dha këtë farë shpjegimi duke u përmbajtur me të keq. Rrinte si mbi gjemba. Shtëpia qe rrëmujë. Sikur t'i përshtatej rrëmujës, Agroni e kishte lënë xhakatën pa kujdes mbi një kolltuk. I hodhi një sy dhomës, pastaj hetoi vjedhurazi mysafirin.

— Atëherë kështu, — tha ai dhe u ngrit.

— Të mos keni merak.

Sapo iku ai, Mondës iu prenë fuqitë e u plas në kolltuk. Një i huaj në shtëpi, turbullimi i saj, dera e jashtme mbyllur... Mbyllur ishte? Po, po, ajo e kishte dëgjuar mirë vërtitjen e çelë-

sit. Nga kjo kishte shkuar me të shpejtë në kuzhinë. Vërtet, pse kishte vajtur atje?

Një valë gjaku iu ngjit në fytyrë. Faqet iu bënë zjarr, koka i ziente.

* * *

Lina e bëri gati me vrap rrugën për në çerdhe, pastaj po ashtu edhe atë të shkollës. Nxënësit po hynin nëpër klasa. Iu duk krejt e pazakontë që çdo gjë që bëhej me të njëjtën rrugë, si me shkujdesje, madje si me mospërfillje.

Mirë që kishte hartim. Shkroi temën në dërrasën e zezë, dha njëfarë shpjegimi dhe shkoi e u ul pranë dritares me vështrim të përhumbur përtej xhamave. Rrinte aty me duart të lidhura në gjoks, e trembur, gjakngrirë. Një gjë e tmerrshme. Kjo ishte tema e mendimeve të saj, që as i zinte e as i lidhte dot. Ato vrundullonin të përmbytura në kokën e saj, dukeshin e zhdukeshin si rrokullisja e ca gurëve të mëdhenj në një faqe mali.

Pra, Monda e tradhtonte Lekon! Ajo, e urta, e bukura, e dashura! Si kishte arritur deri në atë pikë? Bobo, ç'turp!

Pesha e atij turpi i rëndonte në shpirt. Vetëm ajo e dinte. E kishte zbuluar padashur, papritur, fare rastësisht. Nuk do të donte kurrë të bënte një zbulim të tillë. Të rëndët e tij s'e mbante dot. Kujt t'ia shkarkonte? Me kë ta ndante? Me nënën? Me vëllanë? O, atij jo! Ai ishte shumë nervrik. Ai do ta vriste Mondën. Ose veten. Bobo, sa tmerr! Ah, që s'ishte në qytet i shoqi! Me të qe më ndryshe. Atij do t'ia thoshte me lehtësi. Po mundej dhe nënës. Mundej? Nëna e gjorë! Sa shumë e donte Lekon! Ajo e donte dhe nusen. Sa do të dëshpërohej!...

Lina përpëliti qerpikët. Ngashërimi iu ngjiti në grykë. Ndihej e dobët, e mjerë, fatkeqe. O, sa e lumtur qe atë ditë gjer para se të vente në shtëpinë e së ëmës! Nganjëherë nuk e vëmë re lumturinë dhe kujtohemi që e kishim pranë vetëm kur ndodh ndonjë fatkeqësi. Po, fatkeqësi. Ja një fjalë e gjetur! Tamam fatkeqësi. Po si kishte rënë aq poshtë Monda? Ajo linte përshtypjen që e donte shumë Lekon. Të gjithë kështu kujtonin...

Linës i theri në shpirt. Ndjeu thellë dhembjen e një humbjeje që kurrë s'e kishte menduar se mund të ndodhte. Ishin afërsisht të një moshe. Duheshin si shoqe. «Të shkojmë si motra, unë s'kam motër, ty të kam.» Pale sa shumë kënaqej nëna nga kjo... Po pse, pse?...

Iu mbushën sytë me lot, po nuk qau. I qante zemra.

Befas Monda iu bë e largët. E largët dhe e frikshme. Nuk ia kujtonte dot tiparet. I bëhej se e shihte duke u përpëlitur në një vend të papërcaktuar dhe s'po e kuptonte në i dhimbsej, apo e urrente. Monda dukej herë e pikëlluar, herë llastohej. Pastaj iu bë sikur i vëllai, Lekoja, nuk jetonte më aty dhe ajo s'e dinte ku qe e si qe...

Zilja e trembi. Lina mezi e mori veten. Një nxënëse i mblodhi fletoret. Mësuesja i përfshiu nën sjetull tok me çantën dhe iku nga shkolla pa u përshëndetur me njeri. Me të dalë jashtë, s'i bënë këmbët të ecte. Ngjarja e tmerrshme shkonte përpara saj dhe i kërkonte shpjegim. U përpoq ta sillte dhe një herë ndër mend me tërë hollësitë. Mbi to dilte fytyra e pikëlluar e Mondës me atë shikimin e përhumur, që s'merrej vesh në qe ankim apo lutje.

Fare kot iu kujtua që atë ditë Monda e kishte

pasur pushim. Edhe shtëpinë e kishte ngritur për të larë e pastruar. Pikërisht aty ndjeu se diçka nuk shkonte. Pse nuk shkonte? Mblodhi supet. Mbase ajo nuk kishte ndër mend të takohej me atë... dashnorin, por ai vetë kishte gjuajtur rastin... Tani po i kujtohej që shpesh fliste për një Agron, Agron, me të cilin punonte në një zyrë dhe që ishte shumë i mirë. Shumë i mirë? Si s'kishte turp!... Pastaj tamam në kohën kur Lina vente për të marrë qumështin për Altinin... Monda e dinte. Vetë ajo i kishte thënë ta linte qumështin tek ata, se ishin më afër. Dhe i kishin dhënë dhe një çelës...

Një plasaritje e vockël në murin e shëmtuar të dyshimit. Ndjeu dëshirën të çërpiste më tej atë plasaritje. Një dëshirë e brendshme tepër nxitëse. Ç'do të dilte pas skërfitjes?

O, qenkësh Monda! Monda, ashtu si e kishte njohur deri atë kohë.

«Lina, ti je kaq e mirë, kaq e mirë, dhe unë të dua shumë! Motër s'kam, të kam ty. Të jemi motra e shoqe, mirë?»

Dhe që në bisedat e para i kishte treguar për një idil që kishte pasur me një shok klase në vitin e fundit të gjimnazit. Pastaj për një propozim në vitin e parë të universitetit. Po Lekoja, moj Monda, i di Lekoja këto? Si s'i di! Unë ia thashë që sapo u njohëm. Pse, i fsheh gjë Maqos ti?... Më tej, pasi kishte lindur Dean, një djalë që e njihnin të dyja, i pati thënë: Kur lindin, femrat prishen, shëmtohen, ti je zbukuruar, je bërë më e brishtë, më e ëmbël, si më e afruar... Dëgjon ti, Lina? Dhe sesi më pa. Mua m'u zu goja, s'i thashë asgjë. O, ç'inat! Ai do të kujtojë që unë...

Kishte arritur para portës së ndërmmarrjes artistike, ku punonte e ëma. Zgjati kokën te sporteli e u zbraps. Sikur ta linte për më vonë?

Le të bëhej e fortë e të duronte dhe ca. Të paktën deri në mbrëmje.

U kthye pa e takuar të ëmën.

Ndoshta e zmadhonte dyshimin e saj. Monda... jo, kurrësi!

Si një zog i plagosur bënte përpjekje të ngrihej, të kapej ku të mundte, ja, qoftë dhe në atë që Monda e dinte orën kur Lina vinte për të marrë qumështin, qoftë dhe në rrëmujën e shtëpisë. A ishte koha e vendi për dashuri? Në singëritetin e saj të deritanishëm, në...

Po mbase ai i poshtri kishte hyrë dhe, duke e parë vetëm, e kishte mbyllur derën dhe ishte përpjekur ta shtinte në dorë. Monda që zënë ngushtë. Ndoshta... Mirë, po pse s'i dha udhët atij kur vajti Lina?

Njëherë mendoi të sulej drejt e te Monda e t'i thoshte: «Si e bëre kështu ti? Sado e keqe sjellja jote, të paktën ta di, se hamendjet po më torturojnë.» As këtë s'e bëri. Sapo u nis, i erdhi turp. Si mund t'ia thoshte ato fjalë? Jo vetëm kaq, po si do ta shikonte në sy? Vërtet, si do t'i fliste e ç'do t'i thoshte këtej e tutje?

* * *

Monda mbeti një copë herë me kokën mbështetur në duar. Një e papritur e pakëndshme, madje e shëmtuar. Pse e kishte mbyllur derën? Pse kishte ardhur ai?... S'priste puna t'ia sillte materialin pasdite?... O, jo, kot i binte më qafë! Por... Lina kishte të drejtë të dyshonte. Mbyllur në shtëpi me një burrë... Rrëmuja, hutimi...

Dhe ajo, Monda, s'i që përgjigjur fare. Ç'ti përgjigjej? Çdo fjalë e saj, në vend që ta sqar-

ronte gjendjen, do ta ngatërronte më keq. Le që ku kishte mendje t'i jepte shpjegim!

Në këto mendime e gjeti Lekoja. Që t'i shmangej bisedës me të, vuri lavatriçen dhe filloi të lante. Lekoja nuk e pyeti se pse po i bënte punët me vonesë. Ai nuk e bezdisi as për të ngrënë. Mori ç'gjeti në dollap dhe hëngri pa bërë naze. Me të vjehrrën që më ndryshe. Asaj i tha që i kishin shpënë një material, i cili duhej përfunduar sa më parë. Vetëm kaq, asgjë më tepër.

Larja e rrobave ishte një nga punët që ajo e bënte me qejf. Zhurmën e lavatriçes e shoqëronte gjithnjë me përfytyrime të këndshme. Kësaj radhe përfytyrimet e këndshme ishin larg, megjithatë, duke larë rrobat, shqetësimi u zvogëlua disi. Lina më njeh mirë, mendoj, nuk ka përse t'i shkojë mendja për keq. Dhe në i shkof-të, do të ma thotë mua së parës e unë do t'ia sqaroj si ndodhi.

Atëherë u dha më shumë pas punëve të grumbulluara për atë ditë. Brengën ia mposhti lodhja. Pastaj ishte dhe ai mendimi nanuritës për Linën.

Në mbrëmje hapi televizorin e u ul në divan. E vjehrra po bënte darkën. Lekoja se ku vajti. Dea topolake i vinte rrotull. Ajo mallohej gjatë ditës në kopsht dhe në mbrëmje ia kërkonte me ngulm përkëdhelitë. Monda nuk ia kishte qejfin dhe e largonte. Mos, mos, të keqen mami, mami është e lodhur. Po, ishte e lodhur. Trupin e ndiente të kapitur, kokën të zbrazët. Nuk mendonte asgjë. Vetëm aty-këtu i shkonte mendja te Lina. Mezi i pritej ta shikonte. Ajo vinte përnatë. Po kësaj here po vonohej. Apo nuk do të vinte fare?

Kur erdhi ajo, Monda bëri çmos ta shihte

në sy, po Lina iu shmang. Ajo mbante në krah Altinin. Ngeli një copë herë në këmbë, pa e lëshuar fëmijën. Binte në sy që s'dinte si të sillej dhe ishte si e ngrehur. Monda i kërkoi sytë e saj punë e kotë, Lina i vidhej atij shikimi. Dikur Monda i tha të ulej. Lina mërmëriti diçka pa kuptim, më tej gjeti një shkak e iku. Mondën e lëshoi zemra. Pra, Lina jo vetëm dyshonte, po dhe e dënonte.

Shikonte më kot televizorin. Pamjet iknin para syve të saj pa lënë asnjë gjurmë. Kurrë s'i kishte qëlluar si atë çast: të hapte sytë e të mos shihte, të mbante vesh e të mos dëgjonte. Erdhi dhe Lekoja. Dea iu ngjit atij. U shtruan të hanin darkë. Monda hante me pahir dhe hetonte me sy sa të shoqin, të vjehrrën. Asnjëri s'dha shenjë se kishte marrë vesh gjë. Lina s'u kishte treguar. Nuk kishte pasur kohë, apo s'kishte dashur?! Megjithatë, dyshimi i saj... Si do t'i bënte ballë atij dyshimi? Nën hijen e tij a do të vijonte më shoqëria e tyre aq e mirë? Kurrsesi. Lina e bëri beli që atë natë. Sytë e ëmbël e të mirë të Linës, me dyshimin e përhershëm në bebëzat e tyre, do të ishin tortura e saj, ndëshkimi i pashpallur, por i vazhdueshëm.

* * *

Ankthi i Mondës e nxiti Linën të largohet pa vajtur mirë. Ai ankth dëshmonte ca më tepër për fajin e së kumatës. Ngulmimi i saj për ta parë në sy iu duk sa i paturpshëm, aq dhe mundues, e sikur e dënonte për mendimet që Lina bluante për të. Së ëmës s'i tha gjë. «Prapë i them, mendoj. Se mos është ndonjë njoftim i gëzueshëm dhe të shpejtohem.»

Provoi në vetvete shijen e sakrificës. Dhem-bjen po e mbante vetë. Hëpërhë. Se, po ta mbante gjatë, ca më keq po ta mbante përngaherë, bëhej dhe ajo bashkëfajtores.

Mirëpo kaloi e nesërmja, pastaj e pasnesërmja e ajo s'tha asnjë fjalë. As vetë nuk po e kuptonte ç'e ndalonte. Në shtëpinë e së ëmës vinte si më parë. Po nuk ishte më e shpënguar. Me Mondën mezi këmbente ndonjë fjalë. Secila e përgjonte njëra-tjetrën me sy. Kur shikimet e tyre puge-shin, Lina ulte kokën se i dukej që shikimi i së kumatës i thoshte «të keqen motra, të bën zemra të më marrësh më qafë?». Atëherë ajo matej t'i thoshte: Si s'ke turp! Por, kur ngrinte kokën, lexonte tjetër gjë: Ti me të vërtetë beson që unë...

Ky kuptimi i dytë e bënte të lëkundej. Duke qenë midis dy ndjenjash, vuante më shumë. Me vete ishte e bindur që nënës do t'i tregonte. Por me kalimin e ditëve sikur ndiente nevojën e një shtyrjeje. Shpejt a vonë nëna do ta vinte re. Ajo çoç kishte pikasur. Me siguri. Ja, kohë më kohë sesi e shikonte. Sapo ta pyeste pse i sillej ftohtë së kumatës...

E parajetonte atë çast kur do të lirohej nga një barrë e do të ngarkohej me një tjetër edhe më të rëndë. Pas rrëfimit e vërteta e hidhur ndahet më dysh, ama ajo, Lina, merrte mbi vete barrën e akuzueses. Po sikur Mond'a të ishte e pafajshme? Lina, të keqen motra, e beson ti, e beson? Ç'përgjërim! Mundësinë e pafajësisë së saj nganjëherë e ndiente me zemër. Apo ishte thjesht një dëshirë? Sidoqoftë, thellë-thellë ishte pikërisht kjo ndjenjë që e pengonte të hapej.

* * *

Në fillim Monda vendosi t'ia tregonte të shoqit. Nuk kishte bërë ndonjë gjë të keqe dhe ai s'kishte pse të mos i zinte besë. Që atë natë, kur mbetën vetëm, ajo i tha për materialin. Ishte një studim për normat e punës. E solli Agroni, tha. Na e kërkojnë nesër në komitet, po drejtori don-te ta shihja njëherë edhe unë. Mos pyet si e kisha shtëpinë! Plaçkat mbledhur, mbulesat hequr, pa fshirë. U zura ngushtë, megjithatë e fto-va brenda. Patjetër, e ndërpreu i shoqi duke e afruar. Mondës iu duk gjë e ulët të vijonte rrëfimin, ndërsa ai po e përkëdhelte. Do të ishte një-farë përfitimi për t'ia thënë kalimthi, sa për të shkuar radhën, kur ai s'ishte i vëmendshëm. Të nesërmen iu bë më i vështirë. Pastaj sikur i dha karar kësisoj. Derisa Lina s'po thoshte gjë, shqetësimi im është i kotë.

Shtyhej në kohë ndodhia, shqetësimi ndryhej, po nuk shkulej.

* * *

Lina nisi të mbyllej në vetvete. U druhej nje-rëzve, madje dhe të shoqit. I dukej se, po të mos bënte kujdes të veçantë, po të fliste shumë, fjala do të dilte vetiu atje tek i dhimbtë.

Ashtu, ulur në një të ndarë të vagonit, mendimet i vërshuan. Kishte qenë në Tiranë për provimet e atestimit. Në stacion kishte mbërritur he-rët, megjithatë kishte zënë vend. Shoqja ende s'po vinte. Lina shikonte herë nga dritarja, he-rë njerëzit që hynin në vagon. Më tej hoqi dorë nga ky lloj kërkimi. Liza do të më gjejë, kot që mundohem, mendoi dhe mbështeti kokën në tryezën e vogël pranë dritares.

Pas pak dikush u ndal para saj. Lina bëri ta shihte, por, meqë nuk ishte shoqja, s'i dha rëndësi.

— Mund të ulem?

Zëri i atij njeriu iu duk disi i njohur. Ajo ngriti kokën e u drodh. Përballë qe ai, burri që kishte gjetur te Monda. Zemra iu përpëliti. Vetiu u ngrit, shikoi përreth, pastaj u mblo dh kruspull në cep të kolltukut dhe uli kokën.

— Ne njihemi bashkë, apo jo? — pyeti ai dhe ndenji kundruall saj.

«O, sa i pacipë!» tha me vete Lina.

— Jemi takuar edhe te Monda.

Zëri i tij nuk ngjasonte me atë të asaj dite. Qe më i butë, i sigurt, madje i ngrohtë.

«Me këtë ngrohtësi ia ka marrë mendjen Mondës», tha me vete Lina, pa e ditur as vetë se përse pikërisht zëri iu duk shkaktari kryesor. Guxoi dhe e pa. Krejt ndryshe nga sa e pati njohur në atë çast të shkurtër. I qeshur, i çiltër, i afruar. Kurse atë ditë... atë ditë sikur ia kishte ngulur njeri thonjtë në grykë. Tani nuk e kishte veshur këmishën ngjyrë lilaku. Lina ashtu e përfytyronte: me fytyrën zjarr, veshur me atë këmishë. Sa i shihte ndokujt këmishë ngjyrë lilaku, tëng ia bënte zemra.

— Mondën e njoh prej kohësh. Edhe ajo më njeh mua. Kemi disa vjet që punojmë bashkë. Është e zonja në punë... Dhe është shumë e mirë.

Ai ndenji dhe e pa gjatë Linën që heshte. Ai, që me sa dukej kishte pikasur diçka, s'rrinte dot pa folur.

— Unë ia çova atë materialin Mondës, se na duhej me ngut. Ia dhashë dhe bëra të ikja. Mirëpo të linte Monda?! Si kështu, tha ajo, ti s'na ke ardhur ndonjëherë, urdhëro! Ti e njeh vetë,

më mori për krahu e më futi brenda si me pahir. Unë hyra e mend u pengova në togun e plaçkave që kishte bërë gati për t'i larë. E pashë në sy si për t'i kërkuar ndjesë. Ajo u skuq. Të dy u penduam menjëherë. Unë, që kisha hyrë, ndër-sa shtëpia ishte lëmazhdë, ajo, që më kishte ftuar, megjithëse shtëpinë s'e kishte në rregull. Një herë tjetër, Monda, i thashë. Po ajo më tregoi me dorë dhomën e pritjes. S'kundërshtova më. Gomar, thashë me vete, e vure në bela Mondën. Ajo sapo më kishte qerasur, kur erdhe ti...

Dalëngadalë Lina po thëthihej nga rrëfimi i tij. E dëgjonte me vëmendje të ndehur, e shikonte në sy e në buzë. Ku ia kishte ngrehur pusinë e gënjeshtërisë? Mos po i përgatiste dhe asaj ndonjë grackë?

— E ngacmoj ndonjëherë. E rregullove shtëpinë, i them. Por ajo sesi më shikon e sikur i dridhet buza. Unë vetëm tani po e kuptoj psenë.

Lina ngriti kokën si për ta pyetur ç'kishte kuptuar.

— Nuk keni folur asnjëherë për atë ndodhi?

— Jo. Po përse?

— Përse! Po ti paske dyshuar!

Lina nuk ia mori fjalën. Me heshtjen e saj kryeneçe ajo donte t'i thoshte që kjo ishte punë për të.

— Çudi, s'më kishte shkuar ndër mend, — tha ai.

— Cila?

— Por, ne jse. Unë e respektoj Mondën, e kam shoqe të mirë. Kur hyn në zyrë, na qesh fytyra. Keni nuse të mirë. E kemi lulen e bukur të ndërmarries.

Lina fërgëlloi. «Ky nieri nuk gënjen, s'ka pse gënjen» tha me vete dhe u ngazëllye. Pohimi që i beftë, ai erdhi së brendshmi.

Me të zbritur në stacion, shkoi drejt e te Monda.

— Isha me atë, — i tha.

Me kë, pyeti me sy Monda, po, për të folur, s'foli.

— E, moj, me atë burrin që punon me ty!

Monda u skuq lehtë. Ishte me atë, mirë, e pastaj?

— Më foli për atë ditë. Po ti... po unë...

Sytë e bukur të Mondës flakëruan. Ajo përpëliti qerpikët.

Lina ia zuri të dyja duart dhe ia afroi në gjoksin e vet.

— Ndoshta unë duhej të isha shpjeguar me ty, — tha Monda.

— Ti? E pse ti? Fajin e kam unë. Unë u tregova e dobët, sfilita veten dhe ty me dyshimin tim të marrë. Oh, sa të lodhka hija e një dyshimi!. Pse na hyn në shpirt ky krimb, pse? Pse të mos e ruajmë të pastër e të fortë ndienjen e besimit, që është kaq e bukur? Ishte një dobësi nga ana ime dhe unë nuk ia fal vetes.

U panë sy ndër sy. Lehtësimi që ndienin në shpirt, e bënte të kotë çdo lloj shpjegimi.

Pas dënimit

Nuk e kishte menduar aq të vështirë takimin me njerëzit, pasi kreu dënimit. E ndjeu thellë posa zbriti në qytet. Rrugë të njohura, fytyra të njohura. I bëhej se e tregonin me gisht. E shikoni? Është Lipja! E, mo, ai magazinieri që e futën brenda! Ai sytë përdhe. Shpejtonte anës trotuareve që të binte sa më pak në sy. Do të donte të bëhej i padukshëm. Menjëherë. Po kjo s'që e mundur, atëherë u jepte këmbëve! Edhe në shtëpi sesi e pritën. Një gëzim i trembur, që i ngjante më tepër shqetësimit. Erdhe? Po tani? Mita qau. Ai hoqi përbrenda. Sa e rëndë qenka, sa e rëndë, tha vetë me vete dhe fjalët i rralloi.

Zunë të vinin njerëz për ta parë. Të paktë, më të afërmit, po vinin. Aj bënte habi dhe nervo-

zohej. Ç'donin? Përse? Se, mos kthehej nga kurbeti!

Qoftë e shkuar, i thoshte ndonjëri e atij i dukej se tjetri tallej. Fytyra i ndërronte çehre, durart s'i gjenin vend, sytë në qilim. As përgjigje jepte, as kokën s'e ngrinte. Qoftë e shkuar i themi atij që ka hequr një sëmundje. Njeriu shërohet e pas kësaj nuk i vjen turp t'ia kujtojnë. E pyesin e ai përgjigjet me qejf dhe biseda ecën. Kurse atë askush s'e pyeti si e kishte shkuar. Ai askujt s'i foli për atë të shkuar.

Rrallë dilte nga shtëpia. Kur e ndalte ndokush rrugës, mërmëriste ca fjalë të pakuptueshme dhe bënte çmos të ndahej sa më parë. Të mbyllej në vetvete, të strukej në brengën e vet, të zhytej në vetmi dhe të rrinte sa më në hije, ja dëshira që e mbërtheu në ditët e para.

I dhanë punë në ndërmarrjet e ndërtimit. Do të donte diku gjatë e mirë s'i erdhi, po nuk e tha. As së shoqes nuk iu ankua. Madje dhe me vete qesëndisi. Mos do ndonjë punë zyre? Apo të t'i japin prapë çelësat e depos? Ëhë! Dhe qeshi hidhur. Po në punë vajti. Që të nesërmen. Jam Filip Caku, i tha shefes së kuadrit. Ajo ngriti kokën, po nuk e pa në sy. Le që ku t'i gjente sytë e tij! E, di, tha, pastaj. Po sytë e saj sikur thanë tjetër gjë. Pse, ç'u bë këtu?

Ai mori një pusullë për në kantierin e prodhimit. Njeriun tek i cili e drejtuan, e njihte. Ia dinte dhe emrin. Llambi e quanin. Ishin afërsisht të një moshe dhe ishin takuar herë këtu e herë atje si bashkëqytetarë. Edhe Llambi gjithë një-lloj.

— Ku të të vë unë ty?

Pastaj kishte kruar kokën me kalem. Ca qime të rralla e të gjata iu ngatërruan. S'dinë nga t'ia mbajnë, po i vë në bela, mendoj Lipja.

— Hë, i sheh ato hekurishte? — Llambi tregoi me dorë një kënd të kantierit. Ca shufra të ndryshkura dukeshin ndërmjet hithrave e barishteve të tjera të gjata. — Merru me to. Drejtoji, sistemoji. Mirë?

Ai filloi në çast. Ia diti për nder përgjegjësit që i dha një punë veçuar nga të tjerët. Le të ishte e rëndë, le të ishte e vështirë, vetëm pa njerëz të tjerë. Këtë donte. Ai e dinte nga përvoja si zënë ato pyetjet e pafund. U druhej, o, sa u druhej! Ndërsa, kur punon më vete, në do, takohesh me njeri, në s'do, rri në qejfin tënd.

Hekurishtet ishin hedhur aty kushedi që kur. Të shtrembra, të kokolepsura si mos më keq. Ende pa nisur mirë, duart iu gërvishtën e iu gjakosën. Ai nuk ua vuri veshin. E mori me vrull. Ajo punë donte forcë.

Pas pak kaloi aty Llambi. Dukej se vinte për t'i dhënë ndonjë udhëzim si ta bënte atë punë, po sepse s'tha asnjë fjalë. Ndenji dhe e pa një copë herë të mirë. Lipës iu bë se ai ia kishte merakun. Pastaj iu duk si mbikëqyrës. Atëherë rënkoji përbrenda. Ai s'e la punën dhe nuk e vuri re tjetrin kur iku. Vetëm se, kur arriti të shkulte e të ndreqte një masë të mirë hekurishtesh, u ndie i kënaqur. Ishte kënaqësia e mundit që diçka jep. E kishte provuar dhe atje. Kënaqësia kishte një burim tjetër edhe më të madh. I dhënë pas shkokolepsjes së atyre hekurishteve, kishte harruar kush ishte e të tjera si këto. Të harrohesh, o, qenka gjë e mirë! Në mbrëmje duart i dhembnin, madje i rëndonin si dy kërcunj. Ndryshku ia kishte ashpëruar e kjo i sillte një bezdi të madhe. I lau te çezma e kantierit, i lau në shtëpi, njëlloj: sapo thaheshin, ato ashpëroheshin përsëri. Dukej sikur ndryshku kishte hyrë në gjithë poret e lëkurës e ia shtrëngonte

keq. I fërkonte e i lante vazhdimisht. Edhe kjo ishte një si harresë. Të nesërmen gjeti një palë dorashka të vjetra prej leshi. Me to punohej më mirë. E megjithatë bezdia e ndryshkut nuk iu nda.

Dikur iu bë se dikush po e vëzhgonte. E ktheu paksa kokën. Një burrë i paktë, me një kapelë strehëgjërë, vazhdonte ta shihte. Lipja punonte, burri e shikonte. Ku ta paskan gjetur, tha ai e iku. E tha si me keqardhje, e tha si me dy kup-time. Lipes i dogji. Ai grumbull hekurishtesh ishte aty prej kohësh. Vërtet, atë paskëshin pritur? A thua askush nuk e bënte dot atë punë? Këto ishin ca hamendje, që ia shtonin sfilinë, se, ku dhemb dhëmbi, vete gjuha, ajo dihet. Prapë-seprapë atij i erdhi më keq kur Llambi i tha që të mblidheshin të gjithë aty te sheshi përballë, ku do të nisnin një pallat të ri. Ja, tani fillon, mendoi. Do të ishte me të tjerë, nuk u mënjanohej dot. E, eeh!

Puna e re që e zhurmshme. Në një anë buldozeri, në tjetrën ekskavatori. Njëri sheshonte, tjetri gërmonte. Punëtorët hiqnin dherat që mbëteshin anash. Bëheshin nja dhjetë. Më të shumtët të rinj. Ata flisnin me zë të lartë, bënë shaka e qeshnin me të madhe. Kjo ishte një gjë e mirë, e këndshme, po nuk i përkiste atij. Ai ndihej i vogël, i huaj, i harruar. Pësja e fajit të dikurshëm po i rëndonte përherë e më shumë. I ishte druajtur takimit me punëtorë të tjerë, që t'u mënjanohej shpjegimeve që do t'i kërkonin, siç është e zakonshme kur shihemi me shokë pune të rinj. Por ata s'ia kishin ngenë. Mbase s'ishte mundësia në tërë atë zhurmë.

Një mëngjes pranë tij zuri punë ai burri me kapelë strehëgjërë. E pa kur iu afrua, kur e la mënjane xhaketën prej doku të zbërdhulët, kur

përveshi mëngët e këmishës. Kishte krahë të hollë, pa qime, si prej qoseje. Ai tha kështu për duart, se fytyrën s'ia pa dot, ngaqë ia mbulonte kapela e madhe. Ishte më i gjatë se ai.

— Mos u mërzit, — tha dikur ai.

Lipes iu bë se i foli kapela me strehë të gjerë.

Shkoi një kohë ashtu. Lipes sepse i ngjante që do të ndodhte diçka e nuk e përcaktonte dot se çfarë. Punonte e mbante vesh, i ngrehur, gjithë merak e kujdes.

— Për njeriun janë dhe të mirat dhe të këqijat. Kështu e ka jeta. Prandaj thonë që ajo është si deti, herë e qetë e herë më dallgë, dhe jo fushë me lule.

Ishte një e folur e mefshtë, si pikat e imta të shiut. Lipja i hodhi një shikim shkarazi. Veç kapelës dhe shpinës së përkulur s'pa gjë tjetër. Ai njeri e ruante fytyrën.

— Po ti kush je?

— Leksi jam, s'më njeh? Hallexhi si ti.

Unë nuk jam hallexhi, deshi të thoshte Lipja, po u përmbajt.

Kaloi dhe nja një orë.

— Haj të pimë nga një kafe! — tha ai tjetri.

Lipja i vajti pas, sikur zbatonte një urdhër. Shkuan në mensë. Nuk kishte njeri. Leksi drejt banakut, Lipja në hapat e tij.

— Ulu atje, — tha Leksi e i tregoi një tryezë pranë dritares.

Ai i solli kafet. Surbën në heshtje. As në bufe s'e hoqi kapelën, madje e kishte ulur edhe më. Lipes nuk i ra në sy. Ai as që donte ta shihte, as atë, as ndonjë tjetër. U vidhej shikimeve të të tjerëve.

— Ju jepnin ndonjëherë kafe?

Lipja bëri sikur s'dëgjo. Tjetri nënqeshi. Le

të nënqeshte! Veç t'i kishte sa më të pakta llafet!

Kur dolën nga mensa, përballë vinte Llambi. Sesi e pa. Lipja prapë mendoi që ai ia kishte merakun, i dhimbsej. Po përse, vallë? Ndoshta nga ajo pak njohje që kishin pasur. Kushedi.

Pushimi kishte mbaruar, kishin rifilluar zhurmat. Ia filluan sërish dhe ata të dy. Kjo nuk ishte ndonjë punë kushedi çë. Madje duke shtrënguar bishtin e lopatës, nuk e ndiente ashpërsinë e ndryshkut në lëkurën e duarve.

— Hoqe keq atje?

— Jo, jo.

— Edhe ti s'e bën veten!

— Të drejtën them. Me të dalë në gjyq, na shpunë në një kantier. Punonim e jetonim.

— Hëm! Burgu burg e puna punë, pse të të ushqejnë kot së koti. Më mirë ta nxjerrësh vetë.

Kaloi një kohë e gjatë pa folur. Ai mendoi se njeriu me kapelën e madhe s'do të bëhej më kureshtar. Ai ia shkulte fjalët si me darë. Ç'njeri!

— As më thua, si re brenda?

Lipja u drodh e i mëshoi lopatës. Dheu i hedhur me forcë ra tutje e u shkërmoq.

— Kaq të vështirë e paske? Apo as vetë s'e ke shkoqitur?

Ej, ç'të shkoqitur!

Në fillim dy-tri kile mollë një shoku. Pastaj një arkë të tërë. E ç'është një arkë për gjithë atë magazinë? Pastaj diçka tjetër. Vete të marrë mish, dhe shitësi i ruan pjesën më të mirë. Ja tek e lajmërojnë të shkojë e ta marrë divanin, të cilët kanë dalë të bukur e s'bien përdhe. Ëmbëlsohet nga përfitimet e tërthor-

ta, i vjen mirë, i duket se është dikushi, se e çmojnë e ia kanë nevojën...

Po ç'm'u qep ky, a nuk e merr vesh që unë s'kam dëshirë as t'i kujtoj këto e jo më të flas me të, tha me mend dhe e vëzhgoi me dyshim njeriun me kapelë strehëgjjerë.

— Më fal që të pyeta!

«Po ky lexon në kokën time?»

— Unë të kuptoj. Njeriu ka të fshehtat e veta e s'do t'i bisedojë me të tjerët. Çdo njeri e ka një gjë që dëshiron të jetë vetëm e tij.

— Jo, bre! Në do të dish, unë dola deficit.

— Po përse?

— Se dola!

Tjetri bëri të ngrihej e ta shikonte në sy, po s'u ngrit. Me sa dukej, u pendua. Iu vu punës dhe heshti. Dikur tha:

— Pasditeve aty nga ora gjashtë unë dal e pi ndonjë birrë te «Familjari». Po të duash, eja.

Dhe u ndanë. Lipja shkoi në shtëpi, u la, bëri nja dy punë të vogla shtëpie, ra e fjeti nja një orë. Kur u ngrit, ora ishte gjashtë pa pesë. Iu kujtua ftesa e njeriut me kapelë. E mo, posi, ia bëri njëherë. E shoqja se ku vajti. Fëmijët s'ishin brenda. Ai u mërzit. Prapë iu kujtua Leksi e prapë tha se s'do të vente. Shkoi ora gjashtë, gjashtë e një çerek. Ai gjithë aty. Pastaj vetiu u vesh. U vesh e doli. Doli e këmbët e shpunë, si pa dëshirën e tij, te «Familjari». Hyri e nuk po orientohej dot. Bënte të shikonte e i vinte zor. Se edhe të tjerët e shikonin. Dikush po ia bënte me dorë. Ishte në një tryezë andej nga fundi. Lipja iu afrua. E njohu pa e parë. Leksi kishte veshur një kostum dopiopet me stof kazmiri anglez, po ca të vjetruar. Në

kokë kishte ngjeshur një kapelë tjetër, edhe atë me strehë të gjerë.

— Ç'u bëre? Për pak mbarohet birra. Ka birrë të mirë.

Ai shtyu një karrige e i bëri vend. Dhe porositi. I trokitën gotat e pinë. Nuk folën. Lipja kishte një si merak se mos ai tjetri ia niste si atje, në punë. Po Leksi s'kishte qejf të fliste. Ndenjën nja një orë dhe i këmbyen a s'i këmbyen dy fjalë. E po mirë, tha me vete Lipja dhe vajti në shtëpi mjaft i kënaqur. Birra kishte qenë me të vërtetë e mirë. Ai s'kishte pirë qëkuri.

Të nesërmen u duk fare e natyrshme që Leksi të zinte punë pranë tij. Ai nuk ndjeu bezdi. Madje e përshëndeti. Ditën e parë Leksi i ishte dukur llafazan, po që në mbrëmje e ndërroi mendimin. Leksi punonte kokulur. Papritur ai tha:

— Si është puna e njeriut! Vete e del deficit e pastaj ndryshon çdo gjë. S'je më ai i pari.

— Hëk! — ia bëri Lipja.

Fjalëmelhem ky njeri, tha me vete.

— Ama dhe ajo përgjigjja jote «Se dola!» s'hahet hiç. Ti s'je i sigurtë me mua. Nejse, edhe të drejtë ke, me një ditë njohje...

— Po...

— Nuk të dilte? Se e keqja sjell të keqen.

— Jo, bre! Me dy rroga ne shkonim mirë.

— Ka që s'u arrin. Por ti...

— Unë s'dola deficit ngaqë s'kisha ç'të haja.

— Mbase deshe të kishe më tepër. E mira e kërkon të mirën dhe njeriu çalltis ta gjejë.

— Edhe duke vjedhur?

Tjetri s'u përgjigj.

Kaloi një kohë e ai tha:

— Jeta është e çuditshme. Nganjëherë të shtrëngon të bësh sa e sa gjëra që s'të pëlqejnë, por që të sjellin dobi. Jetë kjo.

— Njeriu i ndershëm i shtrin këmbët sa ka jorganin.

— Nejse, ky është një gjykim naiv.

— Jo, bre! Mos kërkon të më nxehësh? Se, sado e pabesueshme të të duket, unë të them që vjedhja është gjë e pështirë. Njeriu i ndershëm nuk e ndyn dorën dhe rron me ballin lart. O, ç'gjë e lartë që është kjo! Ta dëgjosh nga unë, që e pësova. S'ka mësim më të fortë se ai që vjen nga pësimi!

— Të ndershmit e pësojnë, kjo dihet. Të mençmit dinë ta vërtitin.

— Ti qenke i çuditshëm. Sipas teje, mos vallë unë jam njeri i ndershëm, po ca naiv?

— Pa di dhe unë!...

— Ti më shfaqëson?

Streha e gjerë u ul gati përdhe. U duk se s'kishte dëgjuar a sikur u tremb nga ajo pyetje. Lipja u pendua. Larg po vete unë me këtë, mendoi e heshti dhe ai. Derisa shkuan, s'e hapën më gojën. Kur u ndanë, Leksi i bëri njëfarë shenje. Atje, iu duk Lipes.

Jo, nuk do të shkonte! Më mirë të rrinte në shtëpi. Pa shiko, po na i shtonte zullumet! Kështu e qesëndisi veten. Mirëpo u mërzit e doli. Eci kuturu, shkoi në të hyrë të qytetit, u vërtit ca andej, ashtu kot. Nuk kishte një-rëz në atë anë e tha me vete se do të bënte mirë të shëtiste edhe ca. Po sesi mori drejt qendrës së qytetit e ja ku u gjend në lokaln «Familjari». Sado që ishte përpjekur, s'e kishte hequr dot nga mendja njeriun me të cilin punonte. Ta takonte, të bisedonte. Çfarë? S'kishte

rëndësi. E tërhiqnin bisedat e tij. Ishin të mprehta, e shponin si me gjemb dhe pikërisht atje ku i dhimbte. E kërkoi nëpër klub, ashtu pa e ngritur kokën. Nuk ia zuri syri e bëri të ikte.

— Kë kërkon, Filip?

Ndjeu se u drodh. Në tryezën ngjitur që Llambi me një tjetër. Si s'e kishte vënë re? Ndoshita ai do të kishte qenë edhe të djeshmen dhe me siguri e merrte me mend se për kë kishte vajtur aty. Sepse i erdhi rëndë. Pse, vallë?

— Jo, ashtu, kot.

— Po të duash, ulu!

— Jo, faleminderit, do të shkoj.

— Si ta kesh qejfin.

Lipja iku e ndihej si i trembur. As vetë s'e dinte si e pse. Kaq e papritur ishte që Llambi të ulej te «Familjari»? S'kishte ndonjë gjë të veçantë. E megjithatë... Po ai pse s'kishte dalë? Më mirë! Ç'njeri ishte? Sesi i kishte folur për ndershmërinë. Është e habitshme, tha, si e kupton ndokush ndershmërinë. Jo zotësi për të bërë më shumë, po për t'ia hedhur dikujt, për të qenë i shkathët në pehllivanllëqe të pahijshme. Mirëpo ndershmëria nuk është mobilje që po(të të priset e ndreq a e ndërron. Të vihet nën lëkurën time ai, pa ta shohë ç'do të thotë ta humbasësh njëherë ndershmërinë...

Prapë me këto mendime dhe të nesërmen. Dikur drejtoi trupin e fshiu djersët me kurrizin e dorës. Djersë të shkaktuara nga një mundim i dyfishtë. Lexi punonte kokulur. Kapela i ishte pluhurosur. Atje ku bashkohej streha, përviqhej një njollë zgjyre. Dukej sikur ai s'kishte të bënte fare me bisedën e ditës së shkuar.

— Pse s'u duke mbrëmë?

— Vajte ti?

— Vajta.

— E, po... s'të arrin përnatë.

— Po ti sikur the që...

— Lëre ç'themi! Na e ka ënda të lëvdohe-
mi ndonjëherë. Një i urtë ka thënë që s'ka njeri
pa një hall e pa një cen.

S'ta mbush syrin, po ç'fjalë që nxjerr nga
goja! Djalli vetë, tha me vete e përsëri pati për-
shtypjen se foli jo Leksi, por kapela e tij stre-
hëgjerë.

Ky njeri e tërhiqte me bisedën e tij si në
hije, por ama e ngacmonte mu në plagë. Po dhe
i druhej, se shkonte ca si larg. Nga zemërgjerë-
sia e bënte? Kushedi. Mbase ashtu ia qante
hallin. I thoshte fjalë të këtilla, që ai, Lipja,
të mos e lodhte shumë kokën për fajin që kish-
te bërë. Por...

Llambi seç po fliste me ekskavatoristin. Du-
kej që ishte aty prej një copë here. Hidhte nga
një vështrim edhe drejt këtyre të dyve, si t'ia
maste punën a si ta qortonte. Lipja e ndjeu
veten si të zënë në faj. Punë bëni, apo llafe?

Ai i mëshoi lopatës. Po Leksi e kishte pa-
rë, vallë? Ndoshta prandaj e kishte prerë fja-
lën. Hë, ç'qenkësh një i rafinuar! Edhe kapela i
shikonte. Çudi!

Gjithë ditën e pati ndër mend. Nuk i kish-
te qëlluar kurrë që një njeri të zinte aq shumë
vend në mendimet e tij. Dhe ishte një njeri i
paktë, herë trim në të folur, herë mospërfillës
dhe herë nga ata që s'duan të duken. Prandaj,
ndoshta, e ngjishte në kokë atë kapelë strehë-
gjerë. Dukej se i dhimbsej Lipja e ia qante ha-
llin. Po ato fjalë ç'i kishte? Fjalë që të vënë
në mundim. Jo, do t'i thoshte. Nuk bënte mirë
që fliste asisoj! Nuk bënte...

Nuk i tha asgjë. Tjetri s'i dha rast. Dhe kjo

bëri që Lipja t'i kthjellonte edhe më tepër hamendjet e veta. Pse ky njeri rrinte vetëm me të? S'e kishte parë të shtrohej me ndonjë tjetër. Madje sikur u druhej. Me të tjerët mezi sa këmbente dy fjalë, me Lipen fjalët ujë. Dhe i kishte shfaqur ca mendime që...

Nisi të dyshonte, ndaj u bë më i mprehtë, më i vëmendshëm.

Ç'njeri ishte ky Leksi?

Pati dëshirë ta vëzhgonte në heshtje, por punonin të gjithë në një vend dhe u druajt. Njëri nga punëtorët e vuri re.

— Leksin do?

— Jo, jo.

— Si shumë e ke trashur muhabetin me të! Ç'të përrallis ky Aleko Dhosi?

Aleko Dhosi?

Lipja u patak. O, sa shpejt gënjehet njeriu! Leksi jam, dhe ai s'e kishte pyetur më. Dhe s'e kishte vrarë fare mendjen cili Leksi qe. Por... Aleko Dhosi... O, si s'e ngau më tej ai?

«A, tutkun, o tutkun! A, kokë, o kokë!»

Ai s'e donte rrojtjen. Një i deklasuuar, një... Ku kishte rënë drejt e tek ai? Dhe i qe afruar si sëmundje e butë. Si e kishte ngrënë ai? Kaq poshtë kishte rënë? Dhe sikur i vinte mirë që ai ia qante hallin. Eh! Vërtet, këtej e tutje ca njerëz si ai do ta trajtonin si të sërës së tyre e të hiqeshin se ia mbanin anën? Edhe pre u dashka të bëhej paskëtaj?

Jo, do t'ia përplaste faqe të gjithëve! Le të ishte dhe Llambi. Le të ishin të gjithë. Lipja do t'i thoshte faqe tyre... Çfarë do t'i thoshte?

U mpak e mbeti. E ndiente veten të fyer, të poshtëruar. Po Llambi, si s'i kishte thënë gjë Llambi? Sesi e shikonte, po për të thënë s'i

tha gjë. Apo ai vinte me mendjen që Lipja e
njihte? Patjetër. Dhe vetëm e shikonte, ashtu,
si për t'ia kujtuar. Domethënë bëj kujdes, o Fi-
lip, bëj kujdes. Po Filipi hiç. Tutkun fare.

Rrëmbëu lopatën e nisi punën. Ishte gru-
mbulluar një pìrg me dhe në një qoshe. Vap
e vap gjersa u bë qull në djersë. Atëherë e
lëshoi frymën me gulçe. Të tjerët ende s'ishin
ngritur nga pushimi i drekës. Ia zuri syri ka-
pelën strehëgjërë. Po shkiste ndërmjet punë-
torëve që t'i dilte përbri. Atij i erdhi krupë, si-
kur ndodhej para një kufome.

— Ç'janë këta xhinde që të kanë hipur?

Lipja e pa shtrembër. T'i binte me lopatë
kokës?

— Më thanë që këtu do të bëhet një pallat
i bukur shtatëkatësh, po ç'e do!...

— Ë?

— Të tjerë do ta gëzojnë. Unë e ti...

— Unë e kam apartamentin. Dhe shiko, kaf-
sho gjuhën!

— Si the?!

— Mos vër shenjë barazimi!

— Që kur kështu?

— Unë e di kush je ti. M'u hiq sysh!

— Hëm! Po ti, ç'e di veten ti? Mos të shkon
mendja se do të ta harrojnë që shpërdorove
pasurinë socialiste? Kur të shohësh majën e
veshit! Apo kujton se do të fshihen ata dy vje-
tët e burgut? Sa mbajnë mend këta, sa mbajnë-
në!

— Është një njollë, e di. Ndërsa ti je...

— Jam si jam, në burg s'kam rënë.

O, edhe këtë ia tha! Ai e ngriti lopatën e i
mbeti pezull. Tjetri u zbraps i tromaksur. Shi-
konte me frikë Lipen, të tjerët. Filip Caku e
flaku lopatën. Fërkoj qafën e rënkoj. E kapi

për krahu e ia hoqi kapelën nga koka. Flokë të rrallë, një kokë e vogël e djersitur, fytyrë qoseje. U mat t'i jepte një grusht turinjve, por befas i erdhi ndot dhe e la.

— Mbushu! — i shfryu dhe e shtyu tutje. Tjetri s'u mbajt dot e ra, u lemeris e sa do t'ia jepte një ulërime. Pastaj e ngjeshi kapelën në kokë e humbi nën të. Lipja pështyu përdhe, mu te këmbët e tij.

Në udhëtim

Porsa e ndjeu peshën e lehtë të hejbeve e të velenxës, mushka grivë e la udhën që shpin-te te stiva e druve, bëri përanë përroit e doli në xhade. Aty shpejtoi hapat. Kali iu qep pas si manar.

— E morën vesh që po shkojmë në fshat, — tha vëllai.

Nuk qe për t'u çuditur. Dy muaj që ngarkoheshin nga katër herë në ditë me dru të rënda ahu. Vëllai i priste drutë në pyllin me ahe të mëdha dhe unë me të dyja kafshët i zbritja afër fshatit Shtyllë, ku i stivosja. Pra, i kishte lodhur kjo punë, ndaj, me të nuhatur që po largoheshin, kafshët nxituan xhadesë.

Them për to, ama edhe vetë isha shumë i gëzuar. Sedra nuk më linte ta shprehja mallin, të cilin me vështirësi e mbaja ndrydhur në zemër. Për një të vogël si unë, dy muaj larg shtë-

pisë dhe kjo që hera e parë, ishte një kohë e gjatë. Po tanimë ne po venim në fshat. Më prisnin nëna, motrat, shokët...

— Hipja kalushit, hipja! — më tha vëllai, Lami, ndërsa vetë, me një kërcim të shkathët, u gjend mbi samarin e mushkës.

Kalushi vinte i paktë, si një muez i ushqyer keq e mua më dhimbsej, po, meqë ngarkesë nuk kishte, s'prita që im vëlla të më thoshte për së dyti.

— Do të ecim sa të mundim sonte. Pushojmë nja tri a katër orë andej nga Luadhet e Gjançit. Pastaj e kemi ditën përpara, blejmë ndonjë gjë në Korçë dhe në mbrëmje jemi në shtëpi.

Mbrëmja e së nesërme na gjente në shtëpi! Tani që ishim nisur, padurimi im shtoej. Më bëhej se kishim ikur nga fshati vite më parë e s'më besohej që kthimi ishte aq i afërt, punë orësh. Unë i mbyllja sytë, por, për çudi, fytyrat e njerëzve të mi të dashur i shihja të mjegulluara. Mamaja më kishte mbetur në kujtesë te Stena, ku doli të na përcillte. Largohehim ne, ajo atje, kishte mbetur e ngurosur në vend, me lot në sy e dhembje në shpirt, saqë më ngjante se aty do ta gjeja përsëri.

Ecnim në heshtje. Ndonjëherë im vëlla ia merrte këngës ose vërshëllente. Edhe njëra, edhe tjetra, i shkonin për bukuri dhe unë e dëgjoja me ëndje. E doja shumë Lamin dhe digjesha nga dëshira që t'i ngjasoja. Ai ishte trim e punëtor i madh. Ta shikonit kur priste dru! Sëpata kërciste si mitraloz e bluashkat fluturonin përreth si gëzhoja. Le të ishte i trashë ahu, ai e hidhte përdhe...

Shkonim gjithnjë xhadesë. Griva s'e ndërpriste vrullin e nuk ndalonte fare. Qëkurse u

nisëm, kaluan dy orë të mira me atë ecje të shpejtë. Me ditë zbritëm nga Vidhkuqi në Leshnjë. Pastaj zuri të binte mbrëmja. Së bashku me mugëtirën, që përhapej grykave e gërxhëve, na shoqëronin ca shtëllunga të dendura resh. Retë trasheshin e merrnin forma të çuditshme. Herë ngjasonin me një tufë dhensh që kullotnin pllajës, herë si mushka e kuaj pa samar.

Si e lamë xhadenë e morëm Përroin e Gjançit, retë e pushuan lojën e shndërrimeve të shpeshta, u bënë njësh e u varën poshtë. Pas pak nisi një shi i rrëmbyer litar. Shiu që i ftohtë. Që në pikat e para zura të kërcëllija dhembët. I zbrita kalit dhe eca pas tij për t'u nxehur, po ca më keq. Opingat më shkisin, pantallonat e lagura më ngjiteshin pas shalëve e më pengonin të hidhja hapin. Diku nuk u mbajta dot, rashë e u laturisa me baltë.

— Pfu, ta marrë djalli, ta marrë! Taqo, mbahu për bisht të kalit!

Ashtu bëra. Kjo ma lehtësoi mjaft ecjen, ama këmbët i hidhja kuturu, pa parë ku shkelja. Kalushi hiqte keq. Ai hera-herës shtrembëronte vithet e mënt binte, kur unë pengohesha në ndonjë gur a xhungë dheu.

Shiu s'kishte të pushuar. Më bëhej se isha lakuriq, aq shumë i ndieja në mish pikat e mëdha e të ftohta. Për më tepër errësira e bëri një tokë e qiell, sa nuk shquaja gjë tjetër, veç kocaqes së samarit. Vetëm griva nuk donte t'ia dinte. Zilka e saj tringëllinte pareshtur, ajo nuk pyeste as për shiun, as për errësirën.

Dikur Lami qëndroi e m'u bë pranë.

— A ngrin shumë, ngrin?

— Jo, jo shumë.

— E, e! — ia bëri ai me mosbesim.

Llapashitej përbri meje, duke u përpjekur

të më kishte në kujdes. Shpesh këpuste të shara. Që e kishim pisk, nuk mundej ta fshihte. Vrundulli i shiut nuk po reshte. Ndonjë strehë gjëkundi jo.

Ndërkaq zilka e grivës pushoi. Kalushi u ndal përnjëherë e unë rashë në hundëza në vithet e tij të lagura. Pse kishte qëndruar griva? Lami u çapit ta shihte. Sa bëri dy hapa, e përpiu errësira.

— Ua! — lëshoi një pasthirrmë habie ai.

Edhe kalushi u çapit përanë mushkës. Duke mos iu ndarë atij, dallova konturet e trasha të një muri.

— Qenkemi te kisha! — tha vëllai si të thoshte: «Si e harruam në këtë?!»

Në zërin e tij, megjithatë, kishte diçka të papërcaktuar. Më përshkoi një dridhmë. Ai po shikonte portën e vjetër. Griva e kishte futur kokën nën strehë, po streha që e ngushtë dhe i mbronte paksa vetëm veshët. Zhurma e shiut në pllocat e çatisë ndryshonte nga ajo me të cilën më ishin mësuar veshët. Kjo që një zhurmë si kërkëllimë. Të bëhej se një përrua i fryrë buzë më buzë rrokulliste gurë përfund shtratit të tij.

— S'ka hajat, ta marrë djalli! — tha me mllef Lami. — Ç'i thua kësaj? Kanë bërë goxha kishë mu në rrugë e s'janë kujtuar për një hajat, ku të gjejnë strehë udhëtarët në kohë të keqe. Pfu! Apo s'i kanë vënë një alamet katinari!

Ai fliste dhe jepte e merrte me portën e vjetër. Unë pështyja ujërat që më rridhnin në fytyrë e më futeshin në gojë. Ç'po bënte vëllai? Mos i shkonte ndër mend të hynim në kishë? Si për të vërtetuar hamendjet e mia, ai vërtiti në duar drynin e madh. Ndërkaq griva e shtyu portën me kokë e dryni kaba ra përdhe. Me sa

dukej, ai qe i prishur, e kishin vënë për gjoja sa të dukej porta e mbyllur.

— U hap! — tha Lami, i gëzuar.

Kanatet u përplasën mureve e lëshuan ca krisma të thata. Boshllëku brenda nxinte më shumë sesa errësira jashtë. Zëri jehoi në brendësi. M'u bë se u përgjigjën turbull nja dhjetë zëra të tjerë. Prapë më kaloi një dridhmë në trup. Griva, që shihte më mirë se ne, s'e bëri të gjatë. Ajo hyri me kënaqësi në atë strehim. Në gjurmë të saj dhe kalushi. Lami më kapi për dore.

— Ua, sa dridhesh! — tha.

Unë hapa gojën, po fjalë s'nxora dot, veç ca tinguj e nuk u kuptua ç'thashë.

Sa kapërcyem pragun, ai e mbylli portën dhë ngeli një çast me sytë ngulur në errësirë. Lëvizjet tona erdhën e u bënë si një rrapëllimë. Pastaj, kur kafshët qëndruan, u ndeh një heshtje e menjëhershme, si e beftë. Sado që i çapëloja sytë, nuk shihja dot gjë prej gjëje, bile as tim vëlla, që më rrinte fare pranë. Po të mos shkundej herë-herës zilka e mushkës nga ndonjë shkrofëtitje a lëvizje e saj, do të kujtoja se kishim rënë në një pus të thellë. Një guvë në zemër të malit nuk është më e errët.

— Mos ki frikë!

Lami ma lëshoi dorën dhe kërkoi diçka në xhep. Dëgjova një çëf-çëf. E mora me mend se po përpicej të ndizte cakmakun. Një nga shkëndijat e shumta zuri, fitili u ndez dhe ndriçoi më parë fytyrën e lagur të tim vëllai, pastaj lëpju tavanin me kube dhe muret e boshatisura. Drita shtrihej e zbulonte diku një dritare si frëngji, më tej një fron, një kornizë. Gjithë duke u luhatur, ca më e dobët ngaqë shkoi më larg, drifa u rrek të përfshinte atë pjesë të zyrtë ku du-

hej të qe altari. Dhe... në ikonostas u zgjuan si të trembura disa figura shenjtorësh. Ashtu të vjetër, sikur u ndehën, gati të vërsuleshin e të na shqyenin që kishim marrë guximin të hynim në botën e tyre.

Me çakmakun në dorë, vëllai eci nja dy hapa. Sapo lëvizi ai, figurat e frikshme u tërhoqën si për të marrë vrull.

— Mos u tremb! Ja, sa të ndezim një zjarr.

— Zjarr këtu?!

— Zjarr, o, zjarr! Na, mbaje ca çakmakun!

I ngathët, me dorën si të ngrirë, e zura atë kallamidhe që një zanatçi e kishte bërë çakmak. Flaka e paktë më fshiku sytë. Ftoma e frika sikur morën një dackë nga ajo ngrohtësi e dorës që shtrëngonte çakmakun. Lami gjeti një dërrasë të thyer, qiti nja dy ashkla dhe i bëri spica-spica. Ma mori çakmakun dhe e vuri nën to. Flaka u qep pas tyre e nisi të rritej. Vëllai fërkoj duart. E theu në gju dërrasën e thatë e të krimbur dhe copat i vuri mbi spicat e ndezura. Atëherë Lami shkarkoi nja dy krahë dru, që i kishte vënë në njërën anë të ngarkesës së grivës për t'i pasur kur të kalonim natën në Luadhet e Gjancit. Njërën kopaçe pas tjetrës i shtroi në zjarr. Drutë e lagura cërritnin në fillim, po shpejt merrnin flakë.

— Mirë, ë? Oho! — ia bënte ai.

Unë i ndera duart e mia të mardhura. Ngrohësia po më përshkonte të tërin. Por, sido që kisha aq dritë e ngrohtësi përpara, prapa shpine ndieja se më përgjonin figurat e frikshme. Më bëhej se çapiteshin pa zhurmë dhe ja, nga çasti në çast do të më hidheshin tinëzisht përsipër.

Megjithëse me frikë, ktheva kokën t'i shihja. Shenjtorët ishin aty përbri njëri-tjetrit, në një

ikonostas të shtrembër. Njëri, hipur mbi një kalë të bardhë, me një shtizë të gjatë në dorën e ngritur lart, merrej me një përbindësh gojëmadh e dhëmbëmprehtë. Përbindëshi i kishte sytë të kërcyer e ngjyrën si të zhabës. Kali, ngritur kas përpjetë, dukej hëm sikur kishte marrë vrull ta godiste me potkonj përbindëshin, hëm sikur ishte trembur për ngordhje prej tij. Shenjtori i mesit, veshur e stolitur në ar, mbante në një dorë një shkop, kurse tjetrën e kishte ngritur deri në lartësinë e supit. Gishtërinjtë e tij të pleksur dukej sikur do të sajnin figura lepurushësh në murin kundruall. Në të dyja anët e tij, me fytyrat nga ne, qëndronin dy shenjtorë të vrenjtur. Ata ishin pikturuar gjer te këthiza. Thashë me vete se nuk do të kishte mjaftuar dërrasa ose boja, po mundet dhe ngaqë s'e meritonin të trajtoheshin njësoj me atë të mesit, që do të ishte i madhi i tyre. Breroren në ngjyrë të verdhë e kishin të madhe e nga kjo fytyra u ngjante edhe më e zbehtë.

Të gjithë, madje dhe kali e përbindëshi, sytë i kishin tek unë.

Vetiu i ktheva kurrizin zjarrit. Sepse pëlgeva t'i kisha shenjtorët përballë. Sikur asisoj do t'i mbaja nën vëzhgim.

Lami u ngrit e afroi një fron.

— Qite xhaketën, — tha. — Edhe këmishën. Qiti e nderi këtu të thahen. A i shtrydhe një çikë rrobat? Hë, mos më rri si i drunjosur! Po më merresh me ta si të mos kesh parë ndonjëherë. Ikonat ikona, kudo po ato janë. Ca piktura në dërrasë, që i kanë bërë kallogjerët e ngeshëm të manastireve. Varu torbën.

Pra, ai i kishte pikasur vështrimet e mia. Me siguri dhe frikën time. Më erdhi turp e u skuqa. Për t'u fshehur sidokudo, bëra shpejt e shpejt

ç'më porositi ai. Vetë vëllai m'i mori plaçkat e i qarkoi rreth zjarrit. Pastaj i mbushi torbat e kafshëve me krunde të qullosura e ua vari në kokë grivës e kalushit. Më tutje nxori nga hejbet bukë e djathë.

Filluam të mbllaçiteshim.

Kur e kur hidhja ndonjë shikim nga shenjtorët. Ngjanin fort të zemëruar. Le që kishim hyrë në kishë pa i përfillur, le që kishim ndezur zjarr në atë vend të shenjtë, po dhe po hanim pa të keq. U vinte gudi, patjetër. Apo inat?

— Ja ku na qenka dhe shën Jovani! — qesëndisi dikur vëllai.

Ikona e shën Jovanit ishte në qoshe të ikonostasit, matanë derës anësore të altarit. Ky rrinte brenda në lumë, me duart mbi kokën e një tjetri, përgjunjur para tij. Sytë i kishte të mekur, fytyrën aq të mjerë, sa të krijohej përshtypja se qe në hall të rronte a t'i përmblidhej pellgut. Mbase tretej nga smira ndaj një pëllumbi të bukur e gjithë shëndet që rrinte pezull në ajër mu përmbi ta.

M'u kujtua xha Jovani ynë. Plak i gjatë, i urtë, me mustaqe e flokë krejt të bardhë, ai ulej në sofat dhe vërtiste në duar një palë tespihe të verdha. Mund të rrinte aty gjithë ditën, pa folur e pa lëvizur fare. Kur vinte fjala për të, në mëhallën tonë plakat thoshin: «Xha Jovani? Ç'e nget atë, ai është shenjt!»

Nganjëherë i afrohesha, si me druajtje e plot kërshtëri, dhe e pyesja:

«Xhaxha Jovan, pse të thonë shenjt ty, o?»

Ai qeshte e qeshte. Dhe e qeshura e tij qe e butë, e shtruar, si e bardhë edhe ajo.

«Unë shenjt? Jo, mor bir, unë jam xha Jovani!»

Nganjëherë ia kërkoi tespihet. Ai m'i jepte.

Në duart e mia të vogla sesi dukeshin. Të mëdha batalle. Ama shkisnin në perin e hollë dhe unë luaja me to. Por kur, me të ardhur ndonjë shok, i lija ato e ngarendnim me shokun duke ndjekur njëri-tjetrin ose hipnim e hidheshim nga avllia përtej jazit, ai do të na fliste:

«Mosni, djem. Mos u hidhni ashtu, se ju pëlqet tëmblit!»

«Po nëna thotë që djemtë e mbarë i ruan perëndia, o xhaxha Jovan, e ti thua që jemi të mbarë!»

«Perëndia? Edhe i ruan, si, po ju mos u hidhni ashtu!...»

Ai që i mirë, i mençur e i dashur. Kurse ky i ikonës...

I shikoja ikonat dhe shtillja në kokë mendime të koklavitura. Perëndia e shenjtoret janë kudo e i shohin të gjitha ç'bëhen, kisha dëgjuar të thoshin, e më vinte çudi. Si mund të jenë njëherësh edhe këtu, edhe gjetkë, gjithkund në botë?!

Ndërkohë zjarri ishte bërë zot i gjendjes. Kërciste e thërrmonte prush përposh, ngrinte lart me krenari gjuhë flakësh, të cilat nuk drithëroeshin më. Rrobat avullonin e unë djersija.

— Kjo kishë qenka lënë pas dore me kohë, — vërejti im vëlla, duke parë përçark.

Vërtet, pllloçat e verdha qenë ronitur e ngrënë si të brejtura nga minjtë. Muret të palyera, me suva të rrëzuar, tërë pluhur e pezhishka. Një merimangë kishte thurur rrjetën e saj mu në breroren e shenjtit kryesor.

— Shikoji njëherë! Frikën u kanë kallur njerëzve, kurse s'bëjnë dot hall për vete!...

Tallej a s'tallej Lami!

Ai gjithmonë kështu fliste, për kishën e klerikët. Mbaj mend, kur do të shkante vullnetar në

hekurudhë, bëri fjalë me babanë. Babai nuk kish-te kundërshtim, le të vente vullnetar dhe mirë do të bënte, por jo të nisej tamam në atë ditë. Se ishte ditë pashke.

«Akoma me këto ti? Përralla janë të gjitha!» — i kishte thënë Lami babait.

«Si the, si?!»

«Përralla, thashë. Gënjeshtra me bisht!»

Mamaja kishte bërë kryq që të mos pësonte gjë djali. Babai qe tërbuar fare. Ai qe fetar. Megjithatë lëngoi e vdiq pa u plakur. Pas kësaj edhe mamaja ime e mirë arriti të thoshte:

«Pse s'i ndihi, pse? Vuajti e vuajti, sido që bënte përditë kryq e metani. Saqë s'i ndihi atij, unë e kam hedhur prapa.»

Megjithatë zakonet fetare ajo s'pati guxim t'i prishte. Edhe në kishë vente. Prej saj dhe mua më pati hyrë në shpirt një frikë ndaj gjërave të tilla...

Duke u thekur pranë zjarrit, rrebeshin s'po e ndieja më.

Mendimet e mia zunë të bënin udhë të largët. Fluturojnë shpejt mendimet. Në krahët e tyre shkon në çast ku të duash. Në Hënë, tek yjet, more dhe te Dielli vetë!... Futesh në thellësi të detit, shikon peshq gjithfarësh, zgjedh më të mirin e kthehesh sa të thuash pesë. Kapërcen lumenj e male, kap në vrap e sipër një lepur, një thëllëzë a ç'të të pëlqejë!... Se janë të tilla mendimet, pa s'i mban dot gjatë në një vend. Ca më tepër kur je djalosh i ri. Kështu, unë e bëra me një frymë rrugën për në fshat, hyra në shtëpi, përqafova me mall mananë dhe motrat, dola nëpër fshat e takova shokët. Tok me ta ngarendëm te lëmenjtë e kooperativës, që sapo ishte ngritur.

Vjeshtë. Gra e vajza zhvoshknin misër e fa-

sule. Punojnë si njëra-tjetra. Pa bëjnë turli shakara. Edhe me ne, djemtë e vegjël. Hë, hë, njëra ia nis një kënge me të zier:

*Ç'janë këta ftonj që na sjell lumi,
moj aman, aman.*

*Lami trimn' ç'e zënka gjumi,
moj aman, aman.*

*Haj ta zgjojmë e ta fejojmë,
moj aman, aman...*

Ashtu përgjumësh u hepova e mbështeta kokën në velenxë. Ndjeva turbull që vëllai u ngrit e ma hodhi krahëve xhaketen e tharë, e cila më mbështolli me ngrohtësinë e përftuar nga zjarri. Desha ta falënderoja për kujdesin. Desha t'ia shprehja kënaqësinë e madhe që po ndieja. Desha... Por isha aq i humbur, saqë fjalët e mia i merrte era e shkriheshin pa u dëgjuar fare...

Kur fle pranë zjarrit, njeriu bën gjumë të ëmbël. E në gjumë të ëmbël sheh ëndrra të bukura. Në ëndrrat e mia të asaj nate përpiquej heraherës të futej një gjë e murrme, e shëmtuar. Po bukuria ishte aq e madhe, ëmbëlsia ishte aq e madhe, ëndja ime ishte aq e plotë, saqë ajo gjë e errët nuk mundej kurrsesi t'i terratiste.

U zgjova herët.

— Mirëmëngjesi! — më përshëndeti Lami.

Unë fërkova sytë.

— Ama të fjetur! Si shqerrë!

Qesha i kënaqur. Duke u shtritur, rrotullova sytë. Lami i kishte bërë gatitjet për t'u nisur. Kafshët i kishte nxjerrë përjashta, vendin e kishte pastruar.

Në mugëtirën e mëngjesit kisha dukej edhe më e braktisur. Shenjtorët mezi shquheshin në ikonostasin e brejtur nga krimbat dhe minjtë.

Drita, që hynte nga hatullat, i shtynte skutave, dhe ata, të zbehtë, shikonin me mërzi, si të mekët.

— Tani hə, të nisemi!

Shiu kishte kohë që kishte pushuar. Toka kullonte. Era frynte fort dhe qe e ftohtë.

Një copë udhë vrapuam pas kafshëve që të nxeheshim.

— Shaloja kalushit! — tha Lami.

Ai mori hov dhe kërceu mbi ngarkesën e lehtë të grivës. Për të nxituar, griva e kishte merak vetë. Rruga kalonte përmes një pylli të vogël e të bukur me lisa. Lisat fëshfërinin e shkundnin pikat e shiut. Ashtu të larë e të fortë ishin të pastër e krenarë. Përtej tyre shtriheshin ca ara të punuara dhe luadhet e gjelbra.

Ende isha si përgjumësh. Vëllai ia mori lehtë e shtruar:

O sabah, o sabah i parë!

Çohu, mori vashë,

me ty kam një fjalë...

Duke u përkundur mbi samarin e kalit, mushkëritë më fryheshin gjyryk. Thithja i etur ajrin e freskët dhe tok me të dhe tingujt e asaj kënge. I thithja me tërë qenien time ata tinguj e nginjsha si me një musht të ëmbël.

Ashtu i kujtoj dhe sot e kësaj dite.

Gjithnjë të dua

Landa e pa Dushin që larg dhe deshi t'i shmangej. Nganjëherë ai bëhej i bezdisshëm, për më tepër atë ditë Landa kishte shumë punë. Ajo që marrë shumë me piktorin. Herë i vinte keq për të, herë e merrte inat. Po më të shumtën nuk dinte ç'qëndrim të mbante. Kur e shihte a kur fliste për atë njeri, Landa ndiente shqetësim. Një ndjenjë faji shkrinte në shpirtin e saj hidhësinë e vet.

Dushi e ktheu kokën, por bëri sikur s'e pa drejtoreshën dhe shkoi në anë të ndërtesës së zyrave për të prerë më shkurt në byronë e modeleve, ku punonte. E po mirë, tha me vete Landa e lehtësuar. Mirëpo papritur Dushi ndërroi mendje, u kthye e ia preu rrugën.

— Kisha një fjalë, — tha ca si i ngrysur.

Ajo iu afrua ta dëgjonte. Dushi u zmbrafs

dy hapa. Drejtoresha bëri një përçapje të dytë, tjetri, gjithë njëlloj, nuk e la t'i afrohej. Landës iu duk një veprim disi qesharak.

— Dua të bisedoj për një model të ri.

— E ke biseduar me Maksin?

— Unë dua të flas me ju.

— Mirë, hajde!

— Të vij tani? — Ai u nis pas saj, ngjiti një shkallë, me sa duket u pendua e shtoi: — Më mirë po vij pak më vonë, — dhe iku me të shpejtë.

Pa marrë kthesën ai, ia behu Maksi. Qëndroi në krah të Landës, duke e parë dhe ai Dushin që largohej si me ngut, sikur donte t'u fshihej sa më parë nga sytë.

— Ti doje të të afrohej? A, jo, është aq i zgjuar ai! Do ta merrje vesh që kishte pirë.

— Pi qëmenatë?

— Me natë, me ditë, si t'i teket. Pijanikët nuk kanë grafik!

Ajo ndjeu t'i rritej së brendshmi një psherëtimë. Sepse nuk deshë ta dëgjonte Maksi dhe shpejtoi të ngjitej në zyrë.

Gjatë ditës u mor me gjithfarëlloj punësh dhe e harroi Dushin. Ai vetë nuk u duk më. Të nesërmen po në mëngjes, ai po e priste atje, në korridor. Ishte mbështetur në derën e drejtorisë. Kësaj radhe bëri ai një hap e u zmbrafs Landa.

— Ç'ke kështu, Dushi?

Ai sikur ngriu në vend. U ndal, ia nguli sytë, i uli, s'diti ku t'i vinte duart.

— Unë e di ç'mendim keni për mua. Pushomëni, drejtoreshë!

Ishte një zë si më të qarë, i dhimbshëm, dhe ajo shtangu e trembur.

— Unë... ju... — rifilloi ai, po nuk tha gjë tjetër.

Landës i kishin thënë që ai pinte, por nuk e kishte parë ndonjëherë të dehur. Ndryshe nga ç'dinte ajo për të dehurit, Dushi nuk dukej aspak agresiv, përkundrazi, s'e kishte më atë tonin e zakonshëm shpotitës. Dukej sikur ajo zbrujtje e trupit ia kishte zbutur edhe zërin. Një zë si i njomur me lot.

Asaj iu dhimbs.

— Mirë, Dushi, shko.

— Unë...

— Shko tani!

Ai e pa në sy si të lexonte atje në ia kishte thënë drejtoreshës ato që donte dhe nëse ajo e kishte kuptuar. Në shikimin e tij ndihej dhe njëfarë mosbesimi, një si dyshim: «Mos bëra ndonjë gjë të keqe? Ë? Unë apo ti?»

Megjithatë ai u bind dhe, sido që mëdyshas, u çapit nga shkallët. Landa e ndoqi me sy. Kur ai s'dukej më, ajo ndoqi zhurmën e hapave të tij. Mbeti aty derisa humbën tutje dhe ata. Ndjesia e fajit dhe e pazotësisë iu shndërrua Landës në keqardhje. Si po humbet kështu ky njeri, mendoi me dëshpërim.

Më kot u mundua të punonte mbi një material që do ta shqyrtonte këshilli teknik. Lexonte dhe me mend shoqëronte piktorin modelist. A do të vente dot në repart? Mos binte gjëkund... Ç'do t'i thoshte Maks?

Ajo hapi derën e zyrës ngjitur me të sajën.

— Izmini, të lutem, thuaji pak Maksit të vijë këtu!

U ul prapë e mbështeti bërrylat në tryezë. Në çast u pendua. Përse e kërkoi Maksin? Ç'do t'i thoshte? Po ndërkohë u dëgjua një trokitje e fortë në derë. Trokitja u shoqërua me shtyrjen e dorezës. Maksi hynte kështu. Ai askund e asnjëherë nuk zihej ngushtë. Ai nuk kishte druaj-

tje. Shkonin tok në komitet a në ministri. Maksi hynte lirshëm nëpër zyra. Mund t'ju shqetësojmë disa minuta? Shoqja Landë është drejtoresha jonë. Ne donim... Dhe Landës pothuajse nuk i mbetej të thoshte gjë.

— Erdhi Dushi?

— Në punë e lashë.

— Ishte këtu. I dehur.

— E di, më tha.

— Ai vetë?!

— Njëherë, tha, një piktor u pi e pastaj vajti në drejtori.

— Ashtu?!

— Unë e shava. Ai mori qëndrim serioz. O, përgjegjësi! Më fal, shoku përgjegjës, s'të vura re! Hë, mor derëzi, i thashë, ku je rrumbullosur kështu që me mëngjes! Piva kafe me fërneta, tha. Ë, në qoftë se shoku përgjegjës ka nxjerrë ndonjë rregull që kafja të pihet me dhallë... Kujt i flet kështu ti? Mbaje veten, shef! Kuadrot e rëndësishme janë gjakftohtë... E, s'ta bën borxh? Unë jam njeri i rregullt, kam dinjitetin tim...

Landës iu kujtua një bisedë.

Dushi: — *S'kam dinjitet unë? Pa dinjitet jam unë?! Ë, po, shefi im është dinjitoz! Dhe kokonos!*

Landa. — *Ç'ke me të ti?*

Dushi: — *Ai ç'ka me mua!*

Landa: — *Maksi ta do të mirën.*

Dushi: — *E di.*

Landa: — *Si e di?*

Dushi: — *Se çdo gjë për mua e thotë në mbledhje ose në drejtori!*

Dhe me Maksin:

Landa: — *Dushi është i talentuar.*

Maksi: — *I talentuar? Hë! Po të ishte i ta-*

lentuar, nuk hidhej nga liceu artistik në Gjuhë-Letërsi. Po dhe Gjuhë-Letërsinë s'e përfundoi, mbeti gjysmak.

Landa: — Por punon, më kanë thënë që punon shumë.

Maksi: — Ç'të bëjë tjetër? Në shtëpi s'i vehet... Drejtoreshë, ai punon këtu.

Landa: — Le të punojë!

Maksi: — Vjen pasdite e rri deri natën vonë.

Landa: — Le të rrijë!

Maksi: — Sjell dhe shokë.

Landa: — Pa shokë mos mbetshim!

Maksi: — Ti e di, ti je drejtoreshë. Sidoqoftë, unë të thashë. Se, dihet ç'ndodh? Rregulli s'e lejon.

Landa: — Pse s'e merr në studion tënde?

Maksi fërgëllloi. Landa s'e kuptoi ç'pati.

Maksi: — Ti po më flet si ai.

Landa: — S'e dija.

Maksi: — Kot ma kanë dhënë studion thoni ju? Ka të tjerë që i dinë këto punë!...

— S'do njeri mbi kokë ai, s'e ka qejf disiplinën. Unë nuk e lë të shijë si të dojë.

— Ai të ka kritikuar. Nuk po çajmë në modele, tha në analizën vjetore. S'po bëjmë ndonjë gjë të re, po na i zë sytë vetëkënaqësia.

— E ka me qitje të largët.

Ajo nuk e pyeti përse.

— Ne s'jemi keq me modele. Nuk më takon mua t'ju them që prodhimet tona pëlqehen edhe në tregun e jashtëm. Por ai synon të mbjellë dyshim për mua. Dhe përpiqet të krijojë terren që të mos ketë orar pune. Të lëvizim, siç thotë ai, të njohim jetën e të gjejmë frymëzim për modele të bukura. Profka në diell!...

— Sesi flet ti, Maksi!

Ai lëvizi nga vendi e u mbështet më fort. Gati u kërrus mbi tryezë.

— Ti e sheh rrallë, unë jam përditë me të. Po na diskrediton, drejtoreshë! Të gjithë flasin. Ç'është ky liberalizëm, thonë. Jemi ndërmarrje e përparuar, s'duhet të lejojmë të na e fëlliqin ca legenë. Ja ku ta them unë: ai është i pandreqshëm. Nuk është njeri serioz. Sot e jep fjalën, nesër e shkel.

Ai tha me vete se edhe pak do t'ia mbushte mendjen përfundimisht, po Landa mendonte tjetër gjë. Maksi nuk e donte Dushin. Këtë e shih-te në buzëqeshjen e tij. Kur fliste për Dushin, nënqeshja i mblidhej në njërin cep të buzëve dhe nuk shkulej që aty.

Më duket se flet për cinizmin e tjetrit që të fshehë të vetin, tha me vete ajo. I ligu e kërkon ligësinë te tjetri, që të mos ia pikasin të tijën. Të jetë i tillë Maksi? Ç'rol lot ky njeri në jetën e tij? Vërtet e ka në punë, por e lidh me të dhe krijimtaria. Sa peshon përcmimi i këtij në vlerësimin e pikturave të Dushit?

Maksi mbahej si një nga piktorët më të mirë të qytetit. Tablotë ia ekspozonin në vende të dukshme, sido që asaj nuk para i pëlqenin, i dukeshin ca si të fryra e të stisura. Vitin e kaluar nuk ia kishin pranuar punën në ekspozitën kombëtare. Ndodhi një keqkuptim, tha ai. Kurse Dushi tha se qe e para herë që Maksi nuk vajt vetë në Tiranë. Maksit i kishte djegur keq kjo fjalë. Ndërsa në rreth ai bënte pjesë në komisionet që çmonin punën e piktorëve. Ishte dhe në kryesinë e degës së Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve.

— Një vit në prodhim do t'ia sillte mendjen në vend, — tha më në fund Maksi.

Landa e vëzhgoi një copë herë, sikur s'e kish-
te marrë vesh.

Përse e kishte thirrur? Ajo prapë u pendua.

— Mirë, këtë do ta shohim, — tha e i bëri
shenjë të shkonte.

I dhimbte koka dhe e shtrëngoi me dy gish-
tërinj kockën midis syve.

U dëgjua një trokitje në derë. Ajo brofi në
këmbë.

Dera u hap ngadalë, si me druajtje. Një bu-
rrë në moshë pensioni, në vështrim të parë si i
mefshtë.

— Jam babai i Dushit.

— Ashtu?! Urdhëroni!

Ai u ul dhe e pati zor sa ta niste bisedën.
Por e nisi bram, drejt e ku i dhimbte:

— Po më prishet djali, drejtoreshë!...

Zëri i tij ngashërues shprehte alarm.

Landën e përshkoi një dridhmë.

— S'e di ç'po ndodh me të, ama e ndiej që
po i vërtitet një e keqe e madhe. Ka gabime, ka
të meta, s'them jo. Por është i ndershëm e i
qëruar, llagar e ka shpirtin.

«Cili prind shau fëmijën», mendoj ajo. Por
atij s'i tha gjë.

— Ngrihet natën e skicon, bën piktura. Më
pikon në zemër, se është shëndetlig. O bir,
them, ke dhunti të mira, si s'po të ecën një ç-
kë fati? Ai s'ka gjumë, e ha një brengë e madhe.
Ndaj...

— Që kur filloi të pijë?

— Si u nda me atë.

Ai tha «atë» e jo Blertën. Sikur u druajt
ta zinte në gojë emrin e ish-nuses së të birit.
Sikur u druajt a sikur iu dhimbs. Landa dyshoi.

— Ç'të të them, ai...

— Po e hoqët nga ajo punë, mbaroi fare. Shkas ju ka dhënë, e di, mund ta bëni kete, por... ajo punë e mban... Ajo punë dhe piktura. Po e hoqët...

Ai e këputi fjalën në mes. E përshëndeti Landën dhe iku, pa kërkuar që ajo t'i premtonte gjë. Landës i bëri përshtypje ai njeri. Sa thjesht e sa tronditës ia kishte shprehur hallin që e mundonte!

Mbylli sytë si për ta përjetuar. Pushomëni, drejtoreshë! Po më prishet djali, drejtoreshë! I njëjti tingëllim. Një rezonancë e dridhshme. Po kush u kishte thënë se do ta pushonin? Mos kishite lëshuar ndonjë fjalë Maksi? Mos pëshpëritej gjësendi e ajo s'e dinte? Apo ata vetë e parandienin dhe i dilnin përpara?

Edhe pse iku i ati i Dushit, Landa s'po e mblidhte veten. Ndihej e lodhur. Dhembja e kokës i ishte shtuar. Pati dëshirë ta takonte pikturin. Menjëherë. Po ç't'i thoshte? Përsëri provoi ndjesinë e vakët të gjendjes së papërcaktuar.

Po afronte ora e mbledhjes së këshillit teknik. Ajo iu vu ta lexonte materialin. Kur e kur nëpër të bënë majë Dushi e Blerta, babai i tij me dhembkën dhe merakun e madh të prindit, përsëri Dushi e pas tij Maksi, Ajo i mbyllte sytë e i hapte fort, që t'i shtynte në skutat e kujtesës, në pamundësi t'i harronte.

Pas mbledhjes Maksi seç donte t'i thoshte. Ajo bëri sikur nuk e pati mendjen dhe ai nuk e çoi më tej. Për më tepër që Izmini s'po lëvizte nga zyra.

— T'u ankua për Dushin? — pyeti Izmini kur Maksi doli.

— Se mos vetëm sot!

— E ka shok Bertin ky.

— Ç'Bert?

— E, moj, Bert Igrasinë, kushëririn e Dushit.

— E ç'del nga kjo?

— Të kujtohet Blerta?... Ç'vajzë e bukur! Dhe sa e donte Dushin, sa mirë shkonin të dy!... Më dhembin sytë, tha, dhe iku nga ndërmarrja jonë. Nuk duhej ta kishim lënë të ikte.

— Ti flet për të me simpati.

— E mirë ishte.

— Ishte! — Landa i mëshoi fjalës.

Tjetra bëri sikur s'e vuri re.

— Thonë se të gjitha i kurdisi ai, Bert Igrasia. Vuri dy shokë të thoshin që kishin shkuar me Blertën. Ç'gjë e pështirë, ë? Pas kësaj Dushi e ndau.

— Ti s'je në vete! — tha Landa e tronditur.

— Çfarë s'ndodh, moj Landë! Mirëpo dikush e pëson. Dhe dikush përfiton. Si e pse dhe çfarë, hajt ta gjesh! Kur e gjen, qëllon të jetë tepër vonë...

Landa u ngrit dhe shëtiti nëpër dhomë. Dhe mendimet gjithë tek ai. Ndarja me Blertën, malli për vajzën e vogël, po që s'rri me të, inati e përbuzja e ndokujt, përçmimi i Maksit. Sa peshojnë të gjitha këto në jetën e një njeriu!

Atë e ngacmoi edhe më tepër dëshira për ta takuar Dushin. Kishte kaq gjëra për t'i thënë. Si do t'i përgjigjej ai? A do t'i vinte rëndë për sjelljen e mëngjesit? Deri këtu s'duhej të arrinte!

Dhembjen e kokës nuk e ndiente më. As lodhjen.

— Të vij dhe unë? — pyeti Izmini.

— Jo, ti e di sa i ndjeshëm është ai. Do të

fyhet e pas kësaj rrezik të veshë mburojën e ironisë.

Dhe shkoi vetëm.

Me përparësen e kaltër gjithë njolla boje, Dushi iu duk më i dobët se ngaherë dhe si i mjerë. Ai u trondit dhe, krejt i heshtur, u mundua të vinte disi rregull përreth.

— Maksj rri matanë, — tha duke treguar me kokë telajon e madhe që e ndante me repartin në mes.

— Unë erdha për ty.

Ai shtroi një gazetë mbi karrigen e vetme, njollosur edhe ajo me bojë vaji, dhe ia zgjati drejtoreshës. Landa u ul. Brodhi sytë përqark, i ndali më gjatë te një telajo kthyer nga muri, pastaj bëri një pyetje që Dushi s'e priste kurrë:

— Di ç'është shtëpia ti, Dushi, bën ndonjë punë në shtëpi?

— Bëj edhe gjellë.

Ajo e pa me vëmendje. Mendoi se mos ai po tallej.

— Po, — përsëriti ai, — bëj. Kur nuk punoj këtu, unë i ndihmoj mamasë në punët e shtëpisë.

— Dhe kur s'vete në ndonjë klub?

Ai u bë flakë në fytyrë. Landa e pa ngultas.

— Po, shkoj ndonjëherë. Dhe e teproj. Është një gjë e ulët, që, si të them...

Ajo nuk e ngriti kokën ta shihte në sy. Nuk donte që tjetri ta gënjente përsëri. Ai i kishte premtuar se nuk do të pinte më. Mirëpo e kishte mbajtur fjalën nja dy javë, pastaj ia kishte nisur prapë, madje më keq. Ky mendim e ngurosi e nuk diti nga ta ngiste bisedën. Ndoshta Dushi e ndjeu ç'vlonte përbrenda saj,

sepse u mbyll në vetvete. Atëherë Landa e pa të udhës të vazhdonte.

— Më thuaj të drejtën, Dushi, je takuar më me Blertën?

Fytyra e tij u err.

— Kurrë!

— Nuk ke folur fare me të?

— Asnjëherë!

— Ti e ke dashur, kështu?

— Shumë!

Ai u ul mbi tryezën e punës. Dukej i këputur, po sytë i xixëlluan.

— Besoja se ishte një dashuri e rrallë... Qëllonte që, siç shëtisnim me shokë mbrëmjeve para godinës së fakultetit, shihja ndonjë makinë me targën e qytetit tonë. Ja, një gjë kaq e vogël ma sillte atje të tërën, të dashur gjer në dhimbje. S'e mbaja dot veten, dridhesha nga malli dhe nisesha ashtu si isha. Natën, majë kamionit, vetëm që ta takoja e të rrija me të qoftë dhe një orë...

« Çudi, mendoj Landa, ky nuk e vë në dyshim fajësinë e saj, megjithatë i dhimbset akoma.» E pikërisht atë çast iu kujtuan fjalët e Blertës. «Më dhembin sytë». Edhe Dushit i erdhën ndër mend ato fjalë. Dhe tok me to një dallgëzim gjaku i vërsboi në gjoks, në kokë, në fytyrë. Në kuptimin e parë ashtu ishte, si e merrnin të gjithë: «Nuk e shoh dot me sy.» Por ato fjalë kishin dhe një kuptim të dytë, të fshehtë, që vetëm ai mundi ta nuhaste. «Më dhemb shpirti kur e shoh.» Atë nëntekst u dha ai fjalëve të saj. Menjëherë, sapo ia thanë. Ndoshta brandaj i kishite thënë ajo. Që t'i kuptonte ai dhe vetëm ai. Po të qe ndryshe, ajo nuk do të ishte. E njihte mirë ai.

Ishte një dyshim sflitës, të cilin nuk kishte mundur ta platiste. Ai vetë e hiqte koren e plagës, e gërvishhte atë, e gjakoste.

— Sot e takova Lindën.

Drejtoresha mënd u ngrit nga karrigia. Landa ishte vajza e Dushit.

— Nuk e kisha parë prej kohe. Është bërë goxha vajzë. Më kishte dalë në rrugë... M'u hodh në qafë e më shtrëngoji me sa fuqi kishte. Dhe ndenji ashtu, me faqkat mbështetur në të miat. Sa? M'u bë një jetë, m'u bë një sekondë. S'di. Unë u përlota. Pastaj më erdhi turp. Desha ta qerasja, t'i jepja një pastë...

— Dhe pastaj... pive?

— Vetëm një gotë. Por më zuri menjëherë. Kur erdha te ju, isha i pirë.

Ky njeri ka dramë të fortë, tha me vete Landa dhe e pa në sy. Për ta hetuar, për ta mëshiruar, për të ditur ç'të thoshte më tej.

Sytë të njomë. O, sa shpejt njomeshin sytë e këtij njeriu! Por... pse me të pirë? Nuk kishte forcë? Po të vijonte ashtu, e pira do t'i bëhej ves.

Ajo donte t'i fliste. Shumë. Po ç'ti thoshte? Si? Si ta këshillonte? Fjalët iu dukën të varfra, të pafuqishme.

Papritur vuri re një tablo të kthyer përmbys.

— Ndonjë krijim i ri?

— Po bëj një portret të kompozuar.

Ai e ktheu mbarë.

Landa u befasua. Një grua e re dhe e bukur, me shikim të gjallë, hedhur diku plot besim e shpresë. Në duar shtrëngonte diçka, që ende s'ishte vizatuar qartë. Ndoshta ndonjë bobinë a mjet tjetër pune. Vetëm disa penelata, po ç'forcë! Ç'lëvizje! Dukej sikur ajo do të fliste që nga telajoja. Unë jetoj, unë jam e lumtur. Landa ve-

tiu u përpoq të gjente shëmbëllimin në jetë. Nuk i ngjante Blertës. Megjithatë iu bë se kishte diçka prej saj, atë gazin e çiltër shpërthyes. Po, për të ngjarë, nuk i ngjante.

— Si do t'ia vësh titullin?

— Gjithnjë të dua.

— Gjithnjë të dua?!

Ajo bëri habi. Tepër ngacmues ai titull. Cilën donte përherë ai? Gruan? Vajzën? Të dyja? Apo njeriun në tërësi?

Landës i kishin pëlqyer dhe pikturat e tjera të tij. Ndryshe nga natyra ca e zymtë e Dushit, krijimet e tij ishin të ngrohta, me dritë. Dhe të gjitha kishin një gjë të përbashkët, të pëlqenin që me të parë, pa arritur të mendoje si e përse.

— Ç'të ka thënë ai? — Landa bëri me kokë nga telajoja që ndante repartin.

— Nuk ia kam treguar.

— Edhe ai ka përfunduar një tablo. Ia ke parë?

— Po.

— Si të duket?

— Maksi mban kravata të bukura!

Landa qeshi padashur. Pastaj u vrenjt.

— E ke përgjegjës. Duhet të kesh më tepër respekt për të.

— A do ta dërgoni përsëri jashtë shtetit?

I vështirë, mendoi ajo dhe u përpoq ta kthente bisedën te piktura e tij, e cila vërtet po i pëlqente.

— S'e ka parë fare ai the?

— Jo.

— Si është e mundur?

— Ne nuk flasim kurrë për pikturat.

— Po më çudit!

— Ç'është e drejta, ai ka dashur. Megjithëse nuk shkojmë mirë, më ka thirrur në studio, edhe këtu e ka sjellë fjalën te punët e mia. Unë hiç.

E kam parë që është fyer, është kreshpëruar, por aq më bën!

— E përse?

— Ai çdo gjë mund të jetë, vetëm piktor s'është.

Ky ishte një gjykim i prerë, krejt mohues. Ai pohoi me kokë me vendosmëri atë që kishte thënë me fjalë.

— Sidoqoftë, nuk do të ishte mirë që këtë ta dëgjonte ai. Ti nuk duhet të kalosh kështu në ekstrem.

— Unë ia kam thënë në sy!

— Vërtet?!

Përnjëherë asaj iu bënë të qarta marrëdhëniet e atyre të dyve. Dhe sepse ndjeu një lehtësim. Por njeriu duhet të jetë shumë i fortë që të durojë t'ia përplasësh në sy një thënie të tillë, qoftë dhe sikur ajo në thelb të jetë e vërtetë, mendoi. Ai ka sedër të sëmurë. Dhe njeriu me sedër të sëmurë, kur është i dukur e me paraqitje të bujshme në shoqëri, fjalë të këntilla jo vetëm s'i pranon, por dhe s't'i fal kurrë. Pra, edhe hakmerret. Prandaj po bën çmos ta vërë poshtë ai?

Iu kujtuan fjalët e Izminit. Mos e kishte kurditur Maksi atë intrigë të ndyrë?

— Dushi, ç'e lidh Maksin me kushëririn tënd, Bertin? — pyeti si shkarazi.

— Nuk e di, por edhe Bertin i ka hyrë vetja në qejf.

— Ke të shkuar ti me të?

— Si karakter unë s'e honeps. Po jemi kushërinj.

Ajo mënd i tha se si atëherë i kishte besuar aq shumë dhe e kishte ndarë Blertën, por u përmbajt. Jo, nuk bënte. Ishte një temë tepër delikate. Duhej bërë kujdes, shumë kujdes. Po

të vinte fjala, ndoshta mund t'ia thoshte disi, megjithatë...

U dëgjua të hapej dera e zyrës. Hyri Maksi duke vërshëlyer.

— Ti nuk më the që do të dilje këtej...

— S'prish punë. Ja, po shikoj pikturën e Dushit. Të pëlqen?

— Hëm! — Maksi po shihte me vëmendje.

— Po, ka njëfarë ekspresiviteti.

— Ma merr mendja që kësaj here Dushi do të ketë sukses. Kjo do të pranohet në ekspozitë e do të pëlqehet, apo jo?

Maksi rrudhi buzën, ngriti supet dhe si nën zë tha:

— S'e besoj.

— E thua me gjithë mend?

— Është tepër intime, — tha ai dhe ngrysi vetullat. — Dushi s'heq dorë.

Landës i shkoi mendja te Blerta. Për të e kishte fjalën Maksi? Me sa dukej po. Dushi u bë nervoz.

— E po, u gjend kleçka! — tha dhe e mori pikturën që ta kthente me pamje nga muri. Piktori ia nguli sytë Maksit dhe shtoi: — Je i vetmi për të vënë bishta.

Maksi e gëlltiti fyerjen. Ai qeshi me qetësinë e njeriut që qëndron më lart se bashkëfolësit e i di mirë këto punë. Tha i krekosur:

— Njëherë Stalinit i çuan një vëllim me poezi. Pasi e lexoi, ai pyeti: Në sa kopje do të botohet ky libër? Ia thanë tirazhin. Stalini qeshi. E mira është të botohet në dy kopje, u tha. Njërën ta mbajë autori dhe tjetrën t'ia japë së dashurës!

Ai qeshi përsëri më fort, duke i parë të dy në sy. Landa nuk e kishte dëgjuar këtë thënie dhe i bëri përshtypje. Dushi, gjithashtu, e dë-

gjoj me interes, sido që në gojën e Maksit atij i dukej se çdo gjë shndërrohej për keq. E kishite inat dhe kohët e fundit s'e duronte dot. Padashtur ai pa Landën. Shikimi i saj sikur thoshte: Pse na e tha këtë? Asaj i shkoi në mendje se Maksi i përdorte thëniet e mençura të njerëzve të mëdhenj për t'i rritur vlerat vetes. Domethënë, shikoni ju kush jam unë, sa di e ç'di. Mbase ka njerëz që me këtë sy i shohin edhe punimet e tij dhe zbulojnë vlera artistike edhe atje ku ato mungojnë. Ndoshta.

— Bëhen intriga në sferën e krijimtarisë, Maksi? — pyeti ajo.

— Bah, çne! — ia bëri Dushi.

«Ky diçka di, — tha me vete ajo. — Por edhe të mos dijë, ka për ta mësuar.» Maksi sytë te piktura.

— Për ekspozitën është një komision i tërë, — sqaroi ai.

«Po, një komision. Të shkon kali në urë një herë, dy. Të tretën vepra e atij që ti s'e do, çan. Ç'duhet bërë që ta pengosh përgjithnjë? Do thyer diku gjetkë, që t'i neveritet vetë arti, të mos merret më me të. Një intrigë çfarëdo, ca thashetheme, shfrytëzimi i ndonjë dobësie për ta hequr nga puna...»

Ajo e hetoi Maksin zemërdredhur nga mendimet që bluanë për të. Mund të pleksej në të tilla gjëra ai? Ishte aq i pashëm, aq i sjellshëm! Dhe buzëqeshja s'i ndahej kurrë...

Iu kthye pikturës. Me një sy tjetër, më kërkues.

«Të këtë pasur parasysh Blertën, thua? Po mirë, e çë pastaj? Kjo thotë ca më shumë që ai e do akoma.»

— Dushi, mua më pëlqen, — tha. — Më pëlqen shumë dhe të uroj me gjithë shpirt!

Piktorit iu ndez fytyra. Një mirësi e ëmbël buroi në sytë e tij dhe i bëri ata të ngrohtë e të mirë si sytë ngazëllues të një fëmije të lumtur.

«Ky e do jetën, ka besim të njeriu, — mendoj Landa. — Kush dashuron, beson. Dashuria e gjen zemrën, njeriu i mirë të vërtetën, i talentuari suksesin.»

Ajo u ngroh nga ky mendim dhe ndjeu një lehtësim edhe më të madh. Besoi me të vërtetë që vepra e tij e re do të ishte e suksesshme. Bukuria e sidomos singëriteti i saj dëshmonin për një shpirt të gjerë e të pastër.

Përtej asaj që duket

Kompania u ndal në majë të kodrës. Ishte mëngjes herët. Frynte veri dhe bënte fresk. Gjethet e vogla e të lëmuara të bushit dridheshin lehtë dhe era shushurinte si me fishkëllimë.

Komandant Sejdini tregoi me dorë xhadenë. Ajo zbardhte atje poshtë e dredhonte në faqen e kodrës tjetër, deri te qafa e saj. Më tej nuk dukej më. Në të dyja anët e xhadesë shtrihej një djerrinë nja dyqind metra e gjatë, e gjerë më pak, me dhe të kuqërremtë e të plasaritur dhe ca gjembaçë e gurë gëlqerorë shpërndarë nëpër të.

— Pritën do ta zëmë në këmbë të kodrës, dy çape larg njëri-tjetrit. Të maskohemi mirë e mirë e asnjë të mos lëvizë. Kur të denden tërë makinat në këtë sheshtirë si gropë, atëherë do t'ia veshim të gjithë njëherësh.

Me t'i thënë këto ai bëri tatëpjetë, por, sapo hodhi një hap, diçka iu kujtua e u kthye nga shokët që i vinin pas:

— Mos ka të thotë gjë ndonjëri?

Dhe i pa me radhë. Shikimin e ndali te një djalosh fytyrëhequr dhe mendimi i parë që i shkoi në mendje ishte se si ai djalë i paktë kish-te sy aq të gjallë e vështrim aq të guximshëm.

— Kishe gjë ti, Syrja?

— Po, kam.

— Hë, shpejt, se s'na pret koha!

Sejdini tha me vete se nuk qe e mundur që ai njeri të mos kishte për të thënë diçka kudo e kurdoherë. «Ai mendonte se njerëzit e fuqishëm fizikisht kanë fjalë pak e punë shumë, kurse këta me trup të paktë s'i përfytyronte dot pa fjalë shumë. Megjithatë qëndroi ta dëgjonte.

— Nuk është vend i përshtatshëm për pritë,
— tha Syrjai.

Komandant Sejdini puliti sytë.

«Hë, ky Syrjai sikur më vete kundra! Po ç'ka, xhanëm, ç'ka? Apo i pëlqen ca si tepër kap-lloqja e tij?»

— Është fare i zhveshur, s'ke as ku mbrohesh e as ku tërhiqesh.

— Nuk kemi për të zënë istikame, jo! A më dëgjove mirë ti? Sa të ndalen makinat, ne do të bëjmë përpara.

— Por...

— S'ka «por» këtu! Ja sheshi, ja mejdani, ja dhe partizan kapedani! Nisiativa i përket atij që ka besim në vetvete. Sot ajo na takon neve, dëgjon ti?

— Mirë, s'thashë jo unë. Por partizani e mendon sulmin dhe suksesin, ama mendon edhe

ruajtjen e forcave. Nuk i lipset jeta vetëm për një çast, se kemi armiq të shumtë.

— Se s'i di unë këto! Hajde, baba, të të rrëfej arat! Sot ne do t'i bëjmë kërma, mos ki merak.

Syrjai nuk e zgati më, ai eci pas të tjerëve në udhë të qarta që zbriste tatëpjetë kodrës.

Partizanët u përhapën me të shpejtë. Komandanti i pa një për një e i porositi të qëllonin vetëm pasi të dëgjonin sinjalin, paçka se gjermanët mund t'u afroreshin. Dhe të mos hutoheshin. Gjermanët edhe bamp do t'ia bëjnë, domosdo, — tha komandanti, — por ne zemrën në vend e mendtë në kokë, si partizanë. Në pritë durimi e gjakftohtësia, ja ç'lipsen!

— Kështu. Dhe asnjë lëvizje. Ndryshe, na pikasin e na shkon munda huq. Hë, o trimat e xhaxhait! Hë, më jua hëngërsha dasmën!

Ai vajti përsëri te skuadra e Syrjait. Syrjai i kishte zbatuar porositë me përpikmëri. Komandant Sejдини i ra shpatullave.

«Djalë i mirë është e trim është, po ja, s'i rrihet pa dhënë mendje! Këtu s'duhet shumë mend, o djalë, tjetër gjë lipset këtu! Hë, më kupton?»

Dhe padashur kujtoi komisar Minanë, i cili nuk ia pëlqente këtë vetëbesim, madje dhe ia kishte thënë. Ai ishte ngarkuar me një detyrë tjetër në batalion dhe hëpërhë kompania kishte mbetur pa komisar.

«Po të ishte këtu Minai, mbase do t'ia kishte vënë veshin», tha me vete, pa dalë te përfundimi në do të ishte mirë a keq, sepse ishte i bindur në atë që bënte dhe, kur krijonte bindje për një gjë, nuk para ia kishte qejfi ta kundërshtonin.

Zuri vend edhe ai dhe i hodhi një sy die-

llit që po nxitonte përpjetë qiellit të kulluar.

Pas pak përtej kodrës tjetër u ngrit një re pluhuri. Pastaj u dëgjua një zhurmë. Ai mbajti vesh. Zhurma sa vinte bëhej më e madhe. Kur ajo u shndërrua në rrapëllimë, te qafa doli hunda e një makine, mandej makina e tërë, një tjetër, edhe një. U drodh xhadeja. Pluhuri u ngrit duman, si bisht i stërgjatë i makinave.

Kur u afruan edhe ca, komandant Sejдини dha shenjën me të thirrur dhe gjuajti i pari. Një zjarr i përnjëhershëm u derdh mbi makina. E para zuri të bënte dredha, hë të batohej këtu, hë atje. E dyta u përplas pas saj e ra në anë të xhadesë. Një gjerman deshi të hidhej, po mbeti i varur në spond. Të tjerët pengonin njëri-tjetrin e binin duke u rrëkëllyer.

Gjermanët u shtrinë ku mundën e si mundën në xhade dhe zunë të shtinin. Makinat dhe ata vetë u mbuluan me tym e pluhur.

— Hë, trima, hë se i përgjysmuam!

Komandanti qëllonte e picërronte sytë nga kënaqësia.

— Bëni gati bombat, djem! Nam e nishan të mos lëmë!

Mirëpo pikërisht atë çast një partizan po i jepte ca shenja të nxituara, duke treguar qafën e kodrës. Sejдини u kthye nga ajo anë. Aty kishte mbërritur një makinë tjetër, e cila nuk hyri në sheshtirë, ku po bëhej beteja. Ajo u ndal më larg. Ushtarët zbritën e morën përpjetë.

Komandanti fërkoj qafën. Ku dreqin kishte qenë kaq prapa ajo makinë! E kishin parë gjermanët e tjerë? Kushedi. Duhej t'i jepte fund sa më parë betejës, pa u dalë në brinjë ata që zbritën te qafa.

Gjermanët sikur e kishin marrë veten e po

ngjiteshin. Ai ia hoqi siguresën një bombe. Ashtu, me bombë në dorë, i fshiu me mëngë djersët dhe thirri:

— Përpara, djem!

Zallahi, krisma e tym, Sharje e përlëshje trup me trup.

Por u dëgjuan krisma anash. Gjermanët e tjerë po ua merrnin krahët. Komandant Sejdi-ni dha urdhër që partizanët të zinin rrëzën e kodrës. Me sytë e mendjes e pa Syrjanë, po shpejt e largoi që të ishte më i kthjellët.

— Duke luftuar e mos u jepni figurë, qenve!

«Hë, sa të dalim tek ata shkëmbinjte, pa le të bëhen mizëri, ne do t'i bëjmë përsesh!»

Në pozicionet e reja qëndruan fort. Gjermanët u tërhoqën.

Atëherë ai e solli prapë ndër mend Syrjanë dhe e kërkoi me sy.

«Kur i doli llafi, shejtanit!»

Nuk i erdhi aspak mirë që u detyrua ta pranonte këtë. Po s'ia zuri syri gjëkund e u bë merak. Pyeti për të vrrarët e të plagosurit. Askush nuk i dha ndonjë përgjigje të saktë.

«Ku është parë të mos e di gjendjen?» tha dhe i pikoi në zemër. I përpiu me sy ata që kishte pranë, kërkoi të vinin dhe të tjerët. Erdhën njoftimet e para, katër ishin plagosur.

— E, beteja betejë. Atje poshtë u bënë kopicë. Oh, ç'them kështu?! E po ne i kemi të shtrenjtë shokët, i kemi të shtrenjtë e të dashur.

Iu mblodh një lëmsh në grykë. Nuk mundi e nuk tha gjë tjetër. Shkoi i pa vetë tre nga të plagosurit. Prapë iu kujtua Syrjai dhe pyeti për të. I thanë që Syrjai ishte te përroi.

— Po ç'po bën te përroi, mos është plagosur?

— Jo ai, Pirroja.

— Çfarë, ore?!

— Pirroja është plagosur.

Pra, partizani i vogël qenkësh i plagosuri i katërt! Ai u vërvit te përroi, ku Syrjai po kujdesej për të. Si e kishte harruar kështu? Kjo asnjëherë s'i kishte ndodhur. Kurse Syrjai... Komandant Sejdini i mbërtheu këmbët e trupit i dha prapa. Ndjeu diçka të papërcaktuar. Po t'i kishte ngjarë gjësendi Syrjait, atij do t'i ngel-
ej peng për tërë jetën. Sapo mësoi që ai ishte gjallë, s'i bënë këmbët të vente e ta takonte.

«Hë, po ky Syrjai! Kisha merak mos ishte plagosur a vrrarë. U shkarkova nga një sèkëlldi e më hipi një tjetër. Si qenka njeriu!»

Padashur zuri të bënte me vete një analizë të betejës. Paçka nga tërheqja e pjesshme (kush mund ta merrte me mend që autokolona ishte ndarë më dysh?), fitorja s'qe e vogël. Më tepër se pesëmbëdhjetë gjermanë të vrrarë, tri makina të djegura e të shkatërruara...

Shkonte te përroi duke përgatitur përgjigjet për një bisedë të padëshiruar. Për habinë e tij, Syrjai nuk i tha asnjë fjalë, as kur u takuan, as kur Pirron e zuri gjumi ndërmjet të dyve. Vetëm një herë ai i hodhi një vështrim të çuditshëm. Ose kështu iu duk komandant Sejdinit. Atij i theri në shpirt ai vështrim. Priti që djaloshi t'i shkruhej, se kishte dalë e tija, por ai rrinte i heshtur, i heshtur e i zymtë. Ky qëndrim komandantit iu duk mospërfillës, ndaj po ziente nga inati.

— Hë, po ti pse s'thua që unë e dreqosa sot?

— Ç'kisha për të thënë, e thashë më parë.

Për të parën herë komandant Sejdini e pa në sy.

— Qe një rastësi, djalli e marrtë!

— Jo, nuk qe rastësi.

— S'paska qenë! Po ç'ishte atëherë? Hë, më thuaj, ç'ishte? Po të kishte shkuar fjollë, ç'do të thoshe ti?

— Atëherë do të kishim një rastësi.

— A, bre!

Komandanti e përpiu me sy. Syrjai i imët nuk u tund fare. Ai rrinte me shikim ngulur diku përpara dhe fliste ngadalë, si me vete:

— Ne jemi partizanë. Kemi dalë për liri dhe, sido që vullnetarisht, e dimë që detyra është detyrë.

— E çë?

— Si të japësh urdhër, ashtu do të bëjmë. Hidhuni në zjarr, hidhemi.

— Ty të thotë rradakja që mua s'më dhimbjen partizanët e i hedh në zjarr kuturu? Këtë kërkon të thuash ti?

— Nuk e kisha me atë kuptim.

— Po me ç'kuptim e pate? Hë, ç'ke?

Syrjai vrenjti vetullat e s'iu bë të fliste.

— Në s'të pëlqen komandimi im, thuaje troç. Mos ma rrokani llafin mua!

— Ti hem më thua të flas, hem të vjen thartë. Kritika është e hidhur, ajo dihet.

— A, bre!

«Ç'është kështu, po e duroj të më qortojë si të isha një fëmijë! Hë, ç'po ngjet kësisoj me mua?»

Ai bëri një përpjekje të mundimshme për ta zotëruar veten. Mirëpo nuk po gjente dot fjalë. E ndiente më tepër sesa e mendonte që Syrjai plotësonte bisedën e mëparshme të cinguar nga komandanti. Nga ai, Sejdini. Madje ca si vrazhdë. Hë, dhe tani atij i kishte ardhur më të dja-

thtë. Rasti i jepte guxim e siguri. Ngjarja e kishte vënë në një shkallë të epërme.

Papritur ndjeu një ngashërim e tha i mallëngjyer:

— E di ti që sonte s'kam vënë gjumë në sy?

— E di.

— Thua me të vërtetë?

— Unë s'i duroj dot ata që shtiren.

Sejdini u përpoq të merrte me mend ç'donte të thoshte tjetri me atë «e di», por iu duk e kotë. Syrjai nuk ia jepte syrin.

— E peshoja betejën si në zigare floriri. Nga tërë anët. Që të dilte pa humbje dhe mirë e bukur.

— Dhe na mblodhe atje majë kodrës që të na thoshe ç'kishe vendosur. Edhe këtë e di.

— E kisha menduar mbarë e prapë, të them! Por nuk e dinim që ata do të vinin në dy grupe. Kujt i shkonte në mendje kjo manovër.

— Komandantit duhet t'i shkojë. Edhe shokëve të tjerë t'u shkojë, por komandanti asgjë nuk duhet të nënvlerësojë.

— E, mor djalë! S'të ka rënë mbi supë një barrë e këtillë, ndaj më llafos kështu ti!

«Megjithatë, është i ndershëm e s'të bëhet t'ia prishësh zemrën», mendoi Syrjai për komandantin.

— Ti seç nise të thuash, — e nxiti Sejdini.

— Por tani...

— Thuaje, thuaje!

— E di ç'mendoja, komandant?... Që këndeje ne shohim kodrat e veshura me bush, qafën e xhadesë... Po ç'ka përtej? Përtej na i zë sytë kodra. Atëherë ç'mbetet të bëjmë? Të vëmë në punë sytë e mendjes. Ashtu po, zgjerohet pamja. Kurse ti...

— Thuaje, thashë!

— Ti s'u thellove. Komandantit i duhet të shohë më larg. Po s'pamë më tej, gjithnjë mund të na ndodhin të papritura aspak të këndshme.

Komandant Sejđini hoqi përbrendal e rruđhi vetullat. Nuk tha gjë. Nxori kutinë e duhanit dhe e drođhi cigaren ngadalë. Dukej që deshi të fitonte kohë. Syrjai e pikasi këtë e iu dhimbs. Nuk i erđhi mirë tek e pa në atë gjenđje të vështirë. E megjithatë s'e la bisedën në mes.

— Ti sot luftove si luan, mirëpo...

Sejđini e pa në sy.

— Po të ishe vrarë, mua do të më vinte shumë keq. Se je njeri i mirë. Sa për gabimin...

— Ç'gabim, bre?

— E thamë një herë.

Komandant Sejđini dëgjo i përhumbur, mađje një çast iu duk fare i panjerëzishëm. Sikur kishte marrë në dorë një gjemb dhe ia trazonte plagën pa mëshirë. Çiltërsia e tij ishte e habitshme, godiste në zemër.

«Nuk pajtohesh dot me ato që thotë, po s'të bëhet as t'i kundërshtosh. Fjalët e tij dјegin, përvëlojnë.»

Bëri dhe një përpjekje t'i provonte tjetrit që kishte pasur të drejtë në urđhrin e mëngjesit atje majë kodrës. Syrjai e dëgjo duke buzëqeshur. E la të shprehej deri në fund dhe, kur ai mbaroi, tha:

— Mua apo vetes kërkon t'ia mbushësh mendjen me këto që thua?

Dhe aty u panë sy ndër sy.

Biseda s'ecte dot më tej. Sejđini ziente përbrenda. I vinte inat me veten që s'po ia dilte dot, i vinte inat me Syrjanë, me bisedën e nisur, Nuk gjente fjalë, sikur i zihej goja dhe kjo e mundonte edhe më shumë.

E ktheu kokën nga Pirroja. Ai po e shikonte. Partizani i vogël pa atë, pastaj Syrjanë, Dukej diçka kishte pikasur nga fjalët e nga vrazhdësia e bisedës. Nuk flinte? Komandant Sejdini i erdhi zor prej tij. Kapërdui pështymën, pshe-rëtiu thellë. U përkul mbi djalin dhe u mundua t'i buzëqeshte.

— Xha Sejdin, Syrjai të do! — pëshpëriti partizani i vogël.

Sejdini i shkrepën sytë. Sikur ta kishte lënduar në plagë. Po plagën e kishte Pirroja. Syrjai ia kishte lidhur dorën e plagosur me një copë nga këmisha e vet. Komandanti ia preku lehtë, me shumë kujdes.

— Të dhemb, të dhemb?

— Më dhemb ca.

— Si e ka? — e pyeti Syrjanë.

— Do t'i shërohet shpejt, — tha ai.

Në çast u qetësua disi. E ndezi dhe cigaren, që po e vërtiste nëpër duar. E treti shikimin diku e menjëherë i erdhi si dallgë një përfytyrim. Po sikur... Po sikur!... Pirroja mund të ishte vrarë. Syrjai mund të ishte vrarë. Pa mund të ishin vrarë shokë të tjerë dhe ai vetë, gjithë kompania...

U përpoq ta largonte këtë përfytyrim të tmerrshëm. Por edhe kësaj nuk ia doli dot. Pësha e mundësisë së kobshme i rëndoi në shpirt dhe shpirti iu hap shpellë.

— Xha Sejdin, më pihet një cigare, — tha Syrjai.

Ishte si një goditje në pikën më të ndjeshme. Komandant Sejdini, që ishte në hall ç'të bënte e ç'të thoshte më tutje, s'e mbajti dot një psherëtimë. Kurrë nuk ia merrte mendja që tjetri t'i jepte një kthesë të tillë bisedës e ta lehtësonte aq shumë.

Dy të plagosur

Në luftim e sipër u gjendën përballë.

Sedat Çeta pa një llogore të vjetër në të dalë të korijes dhe shpejtoi ta zinte. Ishte afër saj, vetëm disa hapa, kur në anën tjetër u dha një gjerman. Nuk arriti të merrte shenjë mirë, ndaj u përpoq të qëllonte për së dyti. Mirëpo një pickim i mprehtë ia tejshkoi krahun. Gjermani u kalamend para syve të tij, mandej u vesh me një si mjegull. Si një re murrashe, që zbriste lehtë e pa u ndier, mjegulla ra menjëherë, gjithnjë duke u dendësuar. Ajo mbuloi gjermanin, llogoren, kodrinën, atë vetë. I hyri në trup e trupi iu zbut në lagështirën e ngrohtë. Kapakët e syve iu rënduan. Një gjumë i beftë u var në ta dhe i uli poshtë butë-butë, po me ngulm.

«C'është ky gjumë? Jo, nuk duhet të fle!»

Po trupi nuk iu bind, ai iu flashk e po i këshohej ngadalë.

Plasur në vend, gjermani nuk ndihej fare.

Ndërkohë luftimi ishte shtyrë përtej korijes. Partizani e gjermani mbetën të plagosur nga njëri-tjetri. I ndante llogorja dhe maja e shehtë e kodrinës.

I pari.

Sedati dëgjoi pushkë diku larg. Atëherë lëvizi pakëz dhe ndjeu fërkimin e rërës në trup.

«Ku jam kështu? Kohë për të fjetur është?»

Përppjekja për t'u ngritur ia lëndoi krahun. Dhembja që si e papritur. Moskujdesi bëri që plaga t'i lëndohej fort kur ai ende s'ishte përmendur mirë.

— T'ëmën, ore! — shau me zë.

Me dorën e shëndoshë përkiti krahun tjetër deri në bërryl. Dora iu lag. E ngjiti më lart, gjithë duke e përkitur. Burimi i gjakut e i dhembjes ndodhej nga një shuplakë sipër bërrylit. Mënga e fanellës ishte llangosur. Edhe e xhaketës. Gjaku kishte rrjedhur në tokën rano-re. Dheu e kishte pirë, duke formuar një pllangu të kuqe.

— Mirë të më bëhet! Kur i lashë kohë... Hajde, Sedat, hajde! Hidh, ore, njëherë sytë përpara! Pastaj, e pe gjermanin, mirë, po bjer barkas e ngopja. Që në këmbë ti, trimi me pallë! E qëlllove, po ç'e do, edhe ai të plagosi...

Kishte të nxehtë e fliste ngadalë tek hiqte me kujdes xhaketën e fanellën. E hoqi dhe kë-

mishën. Llëra skuqi e tëra. E fshiu me pëllëmbë ngadalë, butë. Plaga u hap gojë.

— Bre! — ia bëri dhe e shtrëngoi që të mos i kullonte më.

E grisi me dhëmbë mëngën e hequr të këmishës. E ndau në mes dhe e çafërliti gjer lart. I mbështolli përreth plagës të dy rripat e sajuar nga mënga. Prapë me dhëmbë dhe me dorën e shëndoshë i lidhi fort. Mezi e futi mëngën e fanellës. Xhaketën e mbajti sipër, veshur vetëm në njërin krah. Pas kësaj provoi një kapijtje, po dhe qetësi.

Krismat dëgjoheshin poshtë, përfund korijes. Pastaj zunë të rralloheshin.

Sedati bëri nja tre a katër hapa në atë drejtim. Trupin e ndiente të plogët, këmbët i hidhte si ta kishte zënë egjra. Nuk donte t'ia pohonte vetes që po mbahej me të keq. Krahu i plagosur i varej si i këputur. Edhe i dhimbte. Druhej ta lëvizte, por dhe ashtu, ngurosur, duhej përdorur njëfarë force. Shtrëngimi i muskujve, sado i lehtë, ia lëndonte plagën. Madje ajo i lëndohej dhe nga të ecurit. Bëri kujdes të ecte sa më lehtë, sa më butë. Iu kujtua që një partizani të plagosur në krah, Latifi ia pati lidhur dorën në gjoks, me një fashë varur në qafë. Sedati s'kishte me se ta lidhte. Mendoi të hiqte rripin e pushkës. Mirë, po pushkën si ta mbante? Gjithnjë në një dorë, do t'ij lodhej dhe ajo dhe... E ktheu krahun në gjoks. Sa për ta provuar. Gishti i madh kërkoi të kapej diku. Gjeti një vrimë në fanellë dhe vetiu e zgjeroi e u ngul aty. Ngelur në fanellë si çengel, ai gisht ia mbajti krahun të përthyer. Krahu nuk lëvizte më. Ashtu plaga iu rehatua.

Prapë mendoi për shokët. E dinin të vrarë? Apo ende s'kishte përfunduar beteja? Jo, nuk

dëgjohej më pushkë. Me siguri po e kërkonin. Si qe shkoqur prej tyre? Ja, e pati pikasur atë gjermanin dhe s'deshi ta linte që ai të zinte pozicionin zotërues. Ndoshta e dinin të vrarë. Saqë ai s'po dukej ndërmjet tyre...

I kishte pasur fare pranë Stefin dhe Qazon, mirëpo |beteja betejë, secilin e përthith zjarri i saj dhe... Ai s'u bëri zë kur u sul të kapte llogoren. Le që ku kishte kohë e mend për t'u thënë atyre! Dhe ata nuk do ta kenë parë. S'është për t'u çuditur. Tanimë, që beteja kishte mbaruar, do të shihnin që ai mungonte. Do të shihnin e do të bëheshin merak. Dhe do ta kërkonin. Patjetër. Po ai s'mund të rrinte duke pritur. Jo, bythëpambuk nuk ishte! T'i kërkonte dhe ai. Para se të binte nata, me siguri do të ishte me ta.

I dyti

Gjermani nuk qe vrarë. Zhurma e hapave të partizanit e solli në vete.

— Eh! — rënkoi padashur.

E pa partizanin që po largohej. Nuk e pas-kësh vrarë? Apo ishte ndonjë tjetër? Vetiu hodhi dorën në automatik. Ndjeu t'i vlonte për-brenda dëshira e gjahtarit, që e sheh gjahun fare pranë.

Partizani shkante tatëpjetë. Në atë anë korijen e ndante në mes një udhë. Ai ecte ngadalë, megjithatë zhurma e hapave të tij dëgjohej shumë. Ajo zhurmë gjermanit i shkaktonte një si gërvishtje në tru e në zorrë.

Sikur të kujtohej befaz për një gjë me shumë rëndësi, ai hodhi një shikim rreth e qark. Sytë iu zgurdulluan. Ku ishin të tijtë? Prej sa

kohe dergjej aty? Vetëtimthi e shkoi në mendje që gjermanët ishin tërhequr e u rrëqeth. Gjithçka përreth iu bë e huaj, e frikshme, armiqësore. I trembur, i hutuar, pa ditur ku ndodhej e ç'duhej bërë, prapëseprapë e vuri në shënjestër partizanin. Po tyta e shkurtër e automatikut dridhej. E shtrëngoi, po dridhjen s'e ndali dot. Gërvishtja që vinte nga hapat e atij që po largohej, gjithnjë e më fort po ia ngjeshte në tru ndjenjën e pasigurisë. Në çast e kuptoi se nuk duhej ta shkruhe. Do të që një veprim i marrë. Krisma do të vinte në lëvizje atë botë të heshtur, kërcënuese. Le që nuk do të qëllonte dot në shenjë. Partizani, që e dinte të vrarë, do të kthehej...

«Shnabel, në je i zoti, hëpërhë bëhu i padukshëm!»

Partizani hyri në koriye. Gjermani psherëtiu thellë. Një squllje ia pushtoi trurin e trupin bashkë.

«Nga mbiu ky njeri? Një orë më parë unë nuk dija në rronte mbi dhe. Prapë asgjë s'di për të. As kush është, as ku shkon. E pashë vetëm disa sekonda dhe shkruhe. Plumbi s'e zuri mirë. Po dhe ai shkruhe. Dhe më goditi, idioti! Më vjen të ulërij, po ja, ky njeri ekziston. Po ikën, pasi më la këtu dergjur si një ka të therur...»

Thellë në vetvete shpesh kishte ndier që një ditë do të ndeshje me dikë. Kjo ndeshje do të që krejt e veçantë, e papërsëritshme. I afërt e i largët njëherësh, ai dikushi me të cilin do të takohej diku, dikur, herë i shfaqej, herë i zhdukej. Ai zhytej në pafundësi për t'i dalë përsëri një ditë. Dhe ja, ajo dikur e ai dikush kishin ardhur...

E kapi një dëshirë e ethshme të ngrihej e

të vraponte, të ikte. Ku e përse s'kishte rëndësi, veç të ikte.

«Ç'është kështu, mos po luaj mendsh?!»

Ngriti kokën e u ndeh. Po, aty ndodhej llogorja që e pati lakmuar. E heshtur, e frikshme, i bëhej se ja, kushedi ç'do të nxirrte nga barku i saj e ta vërviste kundër tij. Pamundësia për ta pushtuar, tanimë vishej me diçka të fshehtë e të llahtarshme. Frika e bëri të kujtohej ku ishte.

«Të iki! Të fshihem!»

Ky mendim ia hoqi squlljen. Mirëpo, kur u përpoq të ngrihej, pa përposh një pellg gjaku dhe, me gjithë kurajën që donte t'i jepte vetes, zemra e lëshoi sërish.

«U thyen vërtet? Të më kenë lënë këtu, pa çarë kokën për mua? Do të kthehen. S'është e mundur ndryshe. Në të kundërt, ku vete nderi dhe krenaria e ushtrisë së Fyhrerit?»

Dhe priti. Priti gjatë në plogështi me një shpresë të vagëlluar e si të trembur. Por ata s'u kthyen. Çudia iu shndërrua në hakërrim e neveri. Pra, ata paskëshin ikur me bisht ndër shalë, duke lënë gjithë ç'nuk mund të vraponte vetë, edhe atë, tetar Shnabelin...

* * *

Mbrëmja erdhi me fëshfërimë gjethesh e duhma aromatike. Koriya hapte gjirin e saj të gjerë. Era e ndihmonte me zell. Frynte lehtë, po pandërprerë. I nginjur me to, ajri nanurisej në një përkundje përkëdhelëse. Nanurisja bëhej shushurimë. Koriya këndonte e në të njëjtën kohë i mbante vesh këngës së saj.

Ishte maj. Ditën bënte ngrohtë, në mbrëmje

freskia mezi durohej. Hëna s'kishte dalë. Qie-lli i errët xixëllinte nga yjet e panumërta. Xixëllimi i tyre i shtonte të ftohtës njëfarë dritë-herime.

Nata i platiti zhurmat. Si një kuisje e trembur, kur e kur e shponte ajrin e lehura e një qeni.

I pari, vazhdim

Sedatin mbrëmja e zuri në mes të korijes. Ec e qëndro, ec e çlodhu, ai kishte bërë goxha udhë. Në çdo dhjetë-pesëmbëdhjetë hapa bënte një ndalesë. Nuk ulej. Ulje-ngritjet i dogëndisnin krahun e plagosur. Çlodhej në këmbë. Rrinte ashtu, me këmbët hapur dhe me dorën e shëndoshë e ngrinte pakëz tjetrën që i mpihej.

Udha përmes korijes ishte e gjerë dhe në taban të butë. Aty-këtu shquanin ca të thelluara të ngushta, gjurmët e qerreve. Kur haste në to, Sedati mbushej me frymë e provonte një si ngazëllim, sikur shihte një njeri të njohur e të afërt. Ato të thelluara bënin ta ndiente praninë e njerëzve dhe tok me të, dhe shpresën që shpejt a vonë do t'i takonte.

Më pas qëndroi te një tumbë me lastarë të qëruar që zbardhnin.

— Sa nazike këto shkozat, jo!

Ai i njohu akoma pa i parë mirë. Në fletët e ngushta, të holla e të mprehta të shkozës fëshfërima bëhej më e zëshme, si fishkëllimë e lehtë. Ndryshe me dushqet. Në gjethet e gjera e të buta të dushqeve era mezi ndihej. Fëshfërima në to ëmbëlsohej e kthehej në një shushurimë të mekët. Pale në gjethe lajthie e pa-

nje! Ato e zbutnin dhe e bënin shushurimën si të ngopur me avuj qumështi.

Partizani u mbështet pas shkozës. O, sa mirë! Rehatimi e nxiti t'i puliste sytë. Po veshi i kapi një të lehur qeni. Zgjuar ishte a në ëndërr? Qeni lehu diku matanë korijes.

«Po më kërkojnë! A ta shkreh një herë? Jo, më mirë të eci e t'u dal përpara.»

U vu në ecje. Më lirshëm, më shpenguar. Përfytyroi takimin me shokët, gëzimin... Megjithatë nuk shkoi gjatë. Nxitimi ia përshpejtoi rrahjet e zemrës. Ajo goditi fort, me ca pulsimë inatçore. Goditjet i ndiente në tëmtha dhe në plagën e lidhur.

— Me atë të shtrenguar që i bëra krahut unë, zor se shkon gjaku poshtë. Ndaj më mpihet dora mua!

E la përdhe xhaketën. Zuri të hiqte fanellën. Plaga iu lëndua e i dhembti keqas. Dhembja ishte therëse, sikur ta kishte shpuar plagën me gjemb. I zgjidhi anët e mëngës lidhur mbi plagën. I rrotulloi vetëm një herë në shpështjellje. Më tej nuk shkonin. Ishin ndragur me gjak e gjaku i kishte ngjitur si me qiriç. Provoi dhe një herë. Si një kafshim i hidhur ngacmimi ia çoi sërish lëndimin në zemër.

— Dale, pa të bëj një avaz tjetër unë!

Përmori në dorën mbledhur kupë dhe e derdhi këtë ujë mbi leckat e llangosura. Plaga i dogji. Ai thithi ajër me gjithë mushkëritë dhe i fryu plagës.

— S'ka gjë, Sedat, duro ca. Ilaç është, të bëftë mirë!

Ngadalë e me kujdes e shpështolli mëngë-fashë. Freskia e natës e filladiti. Ndjeu një prehje të këndshme, të këndshme. Po si ta mbante gjithnjë atë freski?

Brodhi sytë përçark, a thua do ta gjente diku përgjigjen. Era i pëshpëriti me gjuhën e butë e të ëmbël të gjetheve me push të një panje. Këputi disa, zgjodhi më të madhen dhe e vuri sipër plagës. Gjethja e veshi plagën me njomësi. Ai e lidhi sërish. Po të qe ditë, do të kërkonte mëllagë të egër a ndonjë bar tjetër, që në fshat i përdorin në vend të melhemit. Veshi fanelën e, kur e mbaroi dhe këtë punë, një lodhje e ëmbël e kapiti. U mbështet në trungun e panjës, hodhi xhaketën krahëve e mbylli sytë. Ndoshta fjetei një copë herë. Ndoshta u kot në gjumë. Shkoi larg e pa gjithë ato gjëra. Ëndërra zhgjëndërr, kushedi, po ato ishin të ngjara...

...Atë ditë u zgjua herët. Tha se mos e zgjoi goditja e tundësit në mëti, po në të vërtetë gjumin ia pati trembur një merak. Dy partizanë flinin në dhomën ngjitur. Ai kishte biseduar me ta në mbrëmje. Dhe...

I zbriti shkallët në majat e gishtërinjve që të mos i zgjonte. Në ashef nëna tundte qumështin në mëti, kurse babai po pinte duhan. Motra, Esmaja, i ndihmonte nënës.

«Sedat, ç'të paska dalë gjumi menatë, o djallë?»

«Nënë, unë do të vete me ta!»

«Je ndër vete?! Të kam fill të vetëm!»

Babai e mati me sy nga koka te këmbët. Nëna priti që ai t'ia merrte anën, madje iu lut me shikimin e saj të merakosur dhe ai dukej se ziente si nga një duf e inat i përnjëhershëm, por, kur foli, tha tjetër gjë:

«Kur të vjen lufta në prag, o lufto, o bjer e vdis. Le të shkojë!»

Po të mos i vinte gjyç, Sedati do të sulej e t'i hidhej në qafë. Esmaja mbushi një tas me

dhallë, përsheshi bukën e ia dha. Nëna shikonte sa njërin, tjetrin. Bromzat e gjalpët notonin në dhallin e porsazbrazur në kusi. Ajo i pa ato, diç u kujtua, e mbushi lugën e drunjte me gjalpë e ia zgjati djalit.

Kur u hap dita, ai u nis tok me partizanët.

Në të dalë të fshatit një vajzë po rrëmihte kopshtin me bel. Sedati iu afrua gardhit e vërshëlleu lehtë. Vajzës iu ndezën faqet.

«Zenkë, a e di, moj, unë...»

Zenka i pa partizanët. Pastaj Sedatin.

«Edhe ti?»

«Pse, s'të pëlqen ty?»

«Jo, kush tha!»

«Që dashke dhe ti, mua më vjen mirë, ta dish. Me t'u kthyer, ne të dy...»

Vajza uli sytë. Kur i ngriti prapë, një ngjyrë e blertë vezullonte në njomësinë e tyre. Të dua, të dua, të dua! Të pres, të pres, të pres! — thërritnin bebëzat e ndritshme...

— Zenkë, moj, më prit! Do të vij unë, ta dish! Më merr të kegen Hitleri mua! Ja, më plagosi cazë... Ç'e do, akoma s'jam ngopur mirë e mirë. Këta djaj zaptues nuk u shuakan kollaj. Ama, pa i farosur, ti e kupton vetë, nuk vjen dita e dasmës sonë.

Ua shkoi dorën mjekrës e faqeve. Pati dëshirë të shihej në pasqyrë. Kushedi si dukej ashtu me mjekër e mustaqe!... Po ta takonte ajo, mbase nuk do ta njihte...

Vijoi udhën. Kujtimi e bëri më të lehtë. Gjumi iu largua një çast. Shkelte gjithnjë butë, me shumë kujdes, por ecte shpejt. Me opinga kau, siç kishte mbathur ai, pa plagën do të ishte bërë erë.

Kurri i malit u ndez! Purpuri i ngjante prushit të një zjarri të stërmadh, i kuq ku puqej

vija e përthyer e malit me qiellin, por që duke u larguar, zverdhej e zbehej. Më tutje qielli ishte ngjyer në gushëpëllumbi. Sa më lart dendësohej e kuqja, aq më e hollë bëhej mjegulla ngjyrë jargavani. Ajo zbriste poshtë e formonte ca shtëllunga të trasha që dyndeshin mbi kënetë e në të gjithë fushën, deri tutje, nga gryka e Devollit. Qyteti po dilte sipër mjegullës.

Agu i mëngjesit, bashkë me bukuritë plot ëndje, i solli dhe një dëshirë të papërmbajtur për të fjetur.

— Do të shtrihem pak, ja, mu këtu. Sa të marr një sy... Ditën përpara e kam.

Gjermani

Deshi të ngrihej, po s'iu bind këmba e plagosur. Kur u përpoq të mbahej vetëm mbi një-rën, u shemb përdhe e i ra të fikët. U përmend vonë, përplasi grushtet përtokë, sikur t'ia nxirrte inatin. E para herë që merrte plagë. Vetë kishte plagosur e vrarë jo pak.

U kthye anash e shtriu krahun. I nguli thonjtë në tokë, e shtyu trupin. Megjithëse në anën e sipërme, shtrirë si cung, këmba e plagosur i theri. Kërcëlliu dhëmbët. Nisi të hiqej osh. Këmba e palëvizur e shtypte me një peshë të dyfishtë. Pëllëmba iu zhvoshk e i dogji. Kur donte të çlodhej, merrte frymë me gojë hapur. Sa më tepër e shikonte korijen, aq më e largët i dukej. Mezi e arriti në të errur. Sapo u fut në të, e lëshoi veten e u dergj pa menduar asgjë. Gulçonte.

Duke u zhytur në perëndimin e vet, syri i madh i diellit flakëroi nëpër gjethe e atij iu bë se ai u tall me të.

«Unë perëndoj sonte, lind nesër, kurse ti, ëhël!»

Gjermani shtrembëroi fytyrën e ktheu kokën në anën tjetër. Por as ajo nuk e qetësoi dot, se pikërisht atëherë lehu një qen. Përgjoi i trembur. Lehja u përsëdyt. Ca mbytur, e largët. Atij dhe ajo iu duk si një përqeshje. Kafshoi buzët sa i bëri gjak dhe u plandos. Qeni vërtet dëgjohej larg, po do të afrohej. Ndoshta dhe ai partizani. Kishte vajtur në ndonjë fshat e po kthehej me shokë. Qenin e kishte vënë në erë...

Mendime të trazuara. Kllapia vinte nga të nxehtët e plagës, po dhe nga lodhja e frika. Pas çdo tumbe e shihte partizanin. Pas çdo tumbe e pas çdo trangu. Ai rrinte gati e do t'i hidhej sapa ai të mos e kishte mendjen. Pastaj partizani u bë i gjithkundshëm. Nuk po i sulej ende, ama tallej me të, ia ndërsente qenin, rrezet e diellit, fëshfërimën e erës...

I duhej një shkop, po nuk guxoi të lëvizte. Dhembjes i druhej më shumë apo zhurmës? Edhe njërës, edhe tjetrës.

Dikur kllapia e mundi frikën: lu bë se qe në udhëtim në det. Me kompaninë e tij. Ftohtë. Këmbët, sidomos njëra, i qenë enjtur e ai tërhiqej duke u mbajtur pas dikujt. «Ej, ti, ç'po merresh me këtë coftirë? Sa të na gëlltitë të gjithë, më mirë flake në det.» Ai deshi të shihte cili qe ai që i tha ato fjalë, po s'pati kohë, se akulli ku e hodhën u ça, uji brisk e mbuloi në çast, ndërsa një kafshë e madhe deti ia nguli dhëmbët e mprehtë në këllk...

U përmend. Dridhej i tëri. I bëhej se kishte dy zemra, njërën në vendin e zakonshëm, tjetrën në plagë. Jo, s'ishin zemra! E para e kishte emrin frikë, e dyta dhembje. Midis të dyjave u fut dhe një e tretë, e ftohta. Mizëria e

yjeve xixëlluese e shponte me spica të ngrira. Nofulla i shtrembërohej nga të dridhurat.

Kapi një degë që varej gjer poshtë, e hoqi trupin bran e u mbështet me të dyja duart në trungun e hollë të një dushku. Trungu u drodh e fletët zhurmuan. Disa degë iu përplasën në kokë, një filiz e përcëlloi në fytyrë. Ai vuri dorën të mbrohej. Po helmetën, ku e kishte helmetën? Ndoshta i kishte rënë kur u plagos. Ndoshta që më parë, kur rendte të zinte llogoren. Po përse i duhej llogorja? O, që të bënte një pykë e të tjerët t'u merrnin krahët partizanëve! Gjë boshe, si mundimi për të kujtuar që kur i mungonte helmata.

«Por, njeriu që harron një gjë kaq të thjeshtë, s'i ka punët mirë.»

Ashtu me të keq u fut në brendësi të korijes. Befas u tremb një zog e iku me klithma çjerrëse. Errësira u gris prej klithmave e u var e tëra mbi gjermanin. Përpëlitja e zogut i hyri në tru. Ndjeu se mënt po i çahet koka.

«Të dija më trim, Shnabel!» i tha vetes dhe qeshi hidhur.

Gjendej në një dumbusherë të dendur. U struk e dremiti me sy hapur. Dalldisje e jo gjumë. Kur e kur hidhej përpjetë. Përpëlitjet dhe klithmat çjerrëse të atij zogut nuk i ndaheshin.

Zbardhëllimi e gjeti as fjetur, as zgjuar. Dita vinte me një ngjyrë hiri të shpëlarë. Përfiakja e qiellit ia vrau sytë. I kuq, i madh, dielli po dilte mbi majën e malit duke e ndezur qiellin. Dhe prapë ai tallej me tetar Shnabelin. Ej, ti, s'paske ngordhur akoma?

Tetari, që desh ta hiqte mendjen nga këto pandehma të marra, u përpoq të shquante qytetin. Ja tek dukej atje tej, në rrëzë të malit.

Larg, shumë larg, i tëri gri dhe ai. Në atë gri mospërfillëse po vagëllohej një shpresë e mekët. Tanimë mbetej vetëm xhadeja. Po të ishte afër, të shtyhej këmba-këmbës, të fshihej në anë të saj dhe, kur të kalonte ndonjë makinë ushtarake, t'i jepte shenjë. Bëri më tej që të shikonte më mirë. Nja dy ara të lëruara, një gardh, pastaj shtëpitë e para të një fshati. Xhadeja nuk dukej.

Dëshpërimi që e kaploi atë çast, e kapërcente shqetësimin e mëparshëm. Ishte më tepër së ankth. «Ti je armik, ty çdo gjë të urren, ndaj do të ngordhësh.» I thoshin korija, era, dielli. Po frika u bë e kapshme sidomos kur u duk fshati.

Një zë gruaje u dëgjua në arën përtej. Gjermani zgjati qafën siç bën breshka kur do të shikojë përtej guaskës së vet. Dalloi valëvitjen e një fustani prej basme. Gruaja rrihte me kopan plisat e fortë. Dikur ajo drejtoi trupin, u dha flokëve prapa e hodhi mbi ta çepkenin e bardhë.

Në kokën e tetar Shnabelit u shpupurit një kujtim. O, qenkej Elfrida! Ç'donte ajo?

Unë e mora orën, i dashur. Është shumë e bukur. Shumë e bukur e me vlerë. Po ti s'më shkruaje asgjë për të. Të mos ketë ndonjë histori zbavitëse kjo orë?... Morëm për punë katër robër. Janë indianë ballkanas, ndoshta nga vendi ku je ti. Veç t'i shikosh! I ngacmojmë nganjëherë. Më tepër Elsbeti. «Po këta ç'meshkuj janë? Kanë përpara dy femra të bukura e s'i ngrenë një herë sytë», thotë ajo...

Copëza nga letrat e së fejuarës iu sollën vetiu në kokë, po nuk u kushtoi asnjë vëmendje. E përpiu një çast ogurzi: kur e përcolli, Elfrida iu var në qafë e i dha një lule. Ajo

nuk ia dha mirë ose ai s'e pati mendjen, dhe lulja i shpëtoi nga dora e ra në rrotat e trenit...

Iu bë se pa një fshatar me qeleshe të bardhë të ngjitej në korije. Ecte shkujdesur, duke u lëkundur, me xhaketën krahëve e sëpatën në dorë. Tetar Shnabeli shtrëngoi dhëmbët dhe hoqi këmbëzën e automatikut. Sytë e fshatarit u ngulën në të gjermanit me habi. Ama këtu më qenke ti? Këtë iu duk tetarit se thoshin ata sy. Patjetër. Pastaj fshatari s'u duk më. Mund të ishte shtrirë për t'u mbrojtur. Po të qe ashtu, pas pak ai do t'i afrohej tinës e do t'i jepte ndonjë goditje me atë sëpatën e rëndë. E ndjeu veten të humbur. Edhe sikur ta kishte vrarë, krisma do të dëgjohej në fshat. Do të sulleshin të tjerët. O, ç'marrëzi!...

Tetar Shnabeli u përpëliti. Sapo hapi sytë, u zvarrit me ngut në dumbusherë. Bëri nja dhjetë hapa dhe e rrëzoi kapitja. Përmendja i erdhi tok me kotësinë. Në korije s'pipëtinte asgjë. Ai pa përreth e pyeti veten:

Ç'kërkoj këtu? Ku jam? Kush jam?»

Dora i preku një send. I paskësh rënë ditari. Ishte një bllok i vogël me kapakë ngjyrë balte. Në faqen e parë adresa: tetar Shnabel Kums, kompania 3, regjimenti 20, posta ushtarake 22.457E. Po, një adresë e përpiktë. E përpiktë? E çë?! Ç'vlente? S'i hynte fare në punë. Shfletoi kot. «Çdo gjermani i takon të jetë një sundimtar». Këtë citat e kishte shkruar me gërma të mëdha. Më poshtë kishte shkruar dëshirën e vet: Dua të bëhem fermer... Çudi, si i pati lindur kjo dëshirë! I ati ishte avokat, ai vetë kishte studiuar për tregti, po ja që pati vendosur të bëhej fermer. Ndoshta që atë ditë kur vajti në fermën e vogël të së fejuarës. Dëshirën e kishte përfytyruar gjithmonë të realizueshme

me lehtësi. Ai ishte ushtar i Fyhrerit, që sundonte botën, dhe një çiflig për të nuk do të ishte kushedi çë...

E grisi fletën dhe e bëri copa-copa. I grisi dhe të tjerat pa i lexuar. I erdhi radha kapakut ngjyrë balte. Adresa dhe emri u shkoqën në grimca letre. Të vogla, të lehta, që i mori era.

* * *

Sedat Çeta u mbështet te gardhi.

— Motër!

Gruaja e la kopanin e u ndeh. Një djalosh fytyrëzbehtë po e shikonte me përgjërëm që nga gardhi. Gërmuqur në të, syzi e vetullzi, dukej i ri e i dobët.

— Sedat e ke emrin ti?

— Ashtu më thonë.

— I plagosur je?

— Ëhë. Po ti, ku më njeh ti mua?

— O, ty të kërkojnë!

Gruaja iu bë pranë dhe ia shkoi dorën për mes.

— Mbështetu në krahun tim, të keqen motra!

* * *

Shnabeli ndihej i sfilitur. Mundimi i plagës e i kapitjes. Mundimi i etjes. Mundimi i frikës. Ky mundim zotëroi mbi gjithçka. Kur lodhej shumë prej tij, e kaplonte ndjenja e kotësisë. Plaga do t'i gangrenizohej. Me siguri. Pra, nuk kishte shpëtim. Po sikur t'i zinte krimba?

Me t'i kujtuar, plaga zuri t'i kruhej. Po i hante gjithë trupin. Ndoshta nga djersa e plu-

huri, po atij iu bë se krimbat po i lëviznin. Dhe e përfshiu neveria për vete e për çdo gjë. Do të ishte një vdekje e tmerrshme. A duhej ta linte veten derisa...

Vetiu lëmoi me dorë automatikun. E kishte mbi gjoks. Nuk i ishte ndarë. E mori në duar dhe po e shikonte si me habi. Ndjenja e kotësisë shëtiti mbi hekur bashkë me shikimin e tij të squllët. Pastaj frikën dhe neverinë i mposhti etja. Mbase sepse padashur dora i shkau përdhe e iu lag në barin me vesë. E ngriti dhe i lëpiu gishtërinjtë, por etjen nuk ia shuanin dot. Ai u shtri në bark dhe zuri të lëpinte vesën me gjuhë. Dhe vijoi ashtu deri në një kapitje tjetër.

Një zhurmë. Fshatari me qeleshen e bardhë ky?! S'e ndante asnjë hap prej tij. Po, ai fshatari me qeleshe. Hakërrues, tallës. Ndjeu frikë. Tetar Shnabeli kërkoi me ngut automatikun. E mori në dorë rrëmbimthi, e shtrëngoi këmbëzën me sa fuqi kishte. Po, bah, këmbëza nuk shkrehet! E shtrëngoi përsëri e përsëri, punë e kotë. Fshatari qesh e qesh. E qeshura e tij vjen e zmadhohet, sytë po ashtu. Sëpatën e kthyer nga myka ia mban mu në ballë. «Hë, ç'do të bësh tashti? Hiç s'ke ç'bën, kjo të pret! Kjo ose krimbat. Nuk i sheh, nuk i ndien?»

Tetar Shnabel Kums u përhumbe rishtas dhe ashtu mbeti.

Nëpunësia e legalitetit

Seit Bardhyli e pa që nga dritarja qiraxhiun Miha dhe e priti aty. Kur arriti nën dritare, Miha, i tha me një frymë:

— Zoti mësues, merre gazetën. Ai i syrgjynosuri i paska nxjerrë veshët në kufi. Thonë se ardhka prapë.

Lajmi që sa i papritur, aq dhe tronditës. Mësuesi hapi lme ngut gazetën. Gjithë faqen e parë të «Gazeta e Korçës» e zinin njoftimet për këtë ngjarje.

Xhami i dritares po vishej avull. Përysh-ta nisi dëborë. Qe një dëborë e imët, e thatë, me kokrriza të vogla, shushulec. Binte me zhurmë, me një fëshfërimë të gjatë, të pandërprerë, si

oshëtima e një lumi të rrëmbyer. Mësuesi shikonte i përhumbur sikur mbante vesh fëshfërimën. Diçka e largët, e harruar po i sillej në kokë me gërgëmë. Si nuk e kishte shkuar asnjëherë ndër mend ç'bënin përjashta atdheut të përzënë të Revolucionit me Zogun në krye? Lidhjen e tyre me Shqipërinë e kishte quajtur të prerë një herë e përgjithmonë. Njoftimet e shtypit se Zogu do të shkonte në Austri a në Turqi, i kishte ndjekur për kuriozitet. Më tej për mjaft kohë Zogu nuk ishte ndier fare.

«Si e kam harruar krejt? Mos vallë kjo i ka ndodhur dhe Atij?»

Mendoi kështu dhe kishte ndër mend idhullin e vet, kryeministrin Fan Noli. Pandehma e bëri të dridhej. Qe një harresë e pafalshme, nga e cila mund ta pësonte Revolucionin dhe Ai...

E ftohta po i hynte në palcë. Palosi gazetën, ngriti jakën e palltos dhe doli. Njëherë tha të shkonte drejt e në Korçë. Ndiante nevojën të bisedonte me dikë dhe pastaj të qetësohej, po të ishin lajme të gënjeshtra a të fryra, ose po të ishin të vërteta. Mirëpo binte shumë dëborë. Shpejt iu zbardh gjithçka. Ishte një zbardhje e mjegullt, që të çoroditi.

Hyri në hajatin e shtëpisë ku rrinte dhe i përplasi këmbët në patoz.

— Hajde, bir! Kam bërë një zjarr në gllanik, që ta heq sakaq ftomën, — tha e zonja e shtëpisë.

— Qësa i përplase këmbët, thashë që çoc ke ti. Apo e kam gabim? Ndryshe bën kur je i gëzuar, sido që dëborë njëlloj shkundet, — qesëndisi Nuçi Kamenica.

Mësuesi ia tregoi ato që thoshte gazeta.

Një copë herë Nuçi i theku duart mbarë e prapë i menduar.

— Medemek u kthye zamani i Turqisë! Jo se kushedi ç'na dha e ç'na bëri dhe Fan Noli, po ja, pamë një çikëz liri. Fan Noli nuk t'i mblidhte këmbët në një këpucë.

Fanolisti Seit Bardhyli ndjeu dhembje në shpirt kur Nuçi Kamenica e shprehu si të mbaruar kthimin e Zogut. Bile për Fan Nolin foljen e përdori në kohë të shkuar.

— Qen që s'leh ai. Kësilloj hesapesh di t'i bëjë punë e madhe. Saqë bëri emër e u duk në kufi, prite kur të çatisë.

Seiti besonte se kjo, të paktën tani shpejt, nuk mund të ndodhte.

Por ditët e pastajme provuan që plaku kishte pasur të drejtë. Një javë vijoi sulmi i «çetave». Seiti zuri ta priste me ankth çdo ditë të re. Kurrrë s'ishte ndier aq i shqetësuar. Shkonte përditë në Korçë e kthehej natën. Lexonte tërë gazetatat që i binin në dorë.

Qeveria përpiquej t'i qetësonte njerëzit e thoshte se kishte marrë masa. Ajo u dërgoi nota Lidhjes së Kombeve dhe qeverive të Evropës. Por ato bënë veshin të shurdhër. Si për t'u tallur, Anglia pohonte për vete dhe i porosiste dhe të tjerët të mos përziheshin në ngjarjet e Shqipërisë, pasi ndërhyrjet nga jashtë do të sillnin ndërlikime të rrezikshme!

Papritur qeveria e la Tiranën e u vendos në Vlorë. S'kaluan veçse pak ditë e Zogu arriti në Tiranë, kurse Noli me shokë ikën jashtë shtetit. Tirana, Elbasani e qytete të tjera u zbrazën pa çak, pa bamp.

Seiti habitej. Ç'që ky panik, ky nxitim për të ikur, kjo frikë ndaj asaj që vinte?

— Frikë? Jo, o djalë, frikaç nuk është Fan Noli. E kam dëgjuar me këta veshë kur i bëri Zogun e bejlerët këpusha e shushunja. Një

frikaç nuk flet ashtu kur fuqinë e kanë të tjerët. Po ia hodhën, thuaj. Ia patën me hile. E gënjen, bir, e gënjen! Se dhe i mençmi mund të gënjehet.

Fjala e *gënjen*, e përsëritur, tingëlloi si një klithmë, si dëshpërimi vetë.

Mësuesi u mpak e s'qe i zoti të bënte asgjë. Përmbysja e tronditi. Shfletonte gazetat. Ato kishin zënë t'i thurnin lavde Zogut. Por ai nuk kënaqej me përgëzimet që i bëheshin gjithandej. Mblodhi menjëherë parlamentin. Formoi qeverinë e re, ku vetë mbajti, veç detyrës së kryeministrit, dhe atë të ministrit të Punëve të Brendshme. Ministrinë e Luftës e shkriu, po komandanti i përgjithshëm i ushtrisë varej drejtpërdrejt nga kryeministri. Kabinetet e Evropës e njohën dhe e uruan. Atë që ia kishin kursyer aq shumë Nolit, ia jepnin me të tepërt Zogut.

— Këtë e duan, se është shok i tyre, — tha Nuçi, që i priste drutë shkurt. — Po dhe Fan Noli... mirë e tha, zemëroi zotërinjtë, po s'i fitoi as çifçinjtë.

Seiti e shikonte në sy e fliste me mend:

«Jo më çifçinjtë, po dhe ti vetë ndjeve dëshpërim, keqardhje. Vetëm kaq. Dhe unë që i them vetes fanolist, ç'bëra e ç'po bëj? U treqa, prita e pres me ankth. Vetëm kaq. Ç'u zëmë kështu si nga ngërçi? Ç'na u bë veprimi?»

— Tashti, o djalë, u bë ç'u bë! Ti mos para u ndje. Se ata që s'të duan, ditën presin. Dita u ka ardhur.

— Që e dua Fan Nolin e jam ithtar i tij, kujt i prish punë?

— E, e, po ç'i kllat flamën! A shkon e drejta tek i padrejti?

Ai kishte përvojë. Përkrahësit e Revolucionit, ata më në zë, kishin ikur. Të tjerët po i

futnin në burg ose i pushonin nga puna. Kjo furtunë e arriti dhe mësuesin. Në të dalë të dimrit shkolla u mbyll. Për mungesë fondesh!! Fshatarët thanë se do ta mbanin me shpenzimet e veta si shkollën, ashtu dhe mësuesin. Bashkia e Korçës u përgjigj se ishte një gjë e lavdërueshme, po hëpërhë shkolla të mbyllej.

Pra, mësuesi fanolist u pushua, megjithëse askush e asnjëherë nuk ia tha këtë fjalë.

II

Të ndenjurit pa punë i sillte një mundim të dyfishtë. Nuk kishte ç'të bënte. Në shoqëri dilte fare pak, se i druhej çdo bisede. E dinte që e mbanin për të dyshimtë. As leximi, që gjithnjë e kishte pasur shumë qejf, nuk i pëlqente më. Për t'u marrë me ndonjë punë tjetër çfarëdo, s'që i aftë. Tani po e vërente që ishte fare i papërgatitur për jetën.

Zunë t'i shteronin mjetet e jetesës. Nëna e sëmurë, zënë ulok, motra në moshë martese, vëllai i vogël, të gjithë me rrogën e tij mbahe-shin. U pre rroga, nisi skamja që ia thith jetës lëngun e saj, atë substancë të padukshme, e cila sjell gëzimin, të qeshurën, krenarinë, forcën. Pa këtë lëng jeta shndërrohet në një-farë riti me shoetësimin kryesor si të ngryset dita. Fshehur tij nëna i jepte për të shitur djalit të vogël herë një gjë e herë një tjetër. Asaj i dhimbsej i biri, e shikonte sa vuante dhe mundohej ta lehtësonte sadopak, me shpresën që një ditë Seitin e saj të mençur, të cilin e pati shkolluar me aq vështirësi, do ta merrnin prapë në punë.

Sikur të mos ishin mjaft të gjitha këto, një

mëngjes në shtëpinë e tyre trokitën dy xhandarë e i thanë Seitit të shkante në punë angari. Do të bërtinin gurë për një godinë qeveritare.

— Unë jam mësues, — tha, duke kujtuar se ishte bërë ndonjë gabim.

— Qyr, qyr ç'a po thotë! Qenka msus zotnia e tij! Ec, mre, e mos na çaj kaptinën!

Deshi s'deshi, vajti. Dy ditë me radhë. Një punë e rëndë që ia çoi në torturë dëshpërimin. Jo aq se duart iu bënë flluska e këto i plasën e i digjnin. Jo aq se lodhej shumë e i dhimbnin gjithë eshtrat. Më tepër sepse xhandarët e trajtonin si një të burgosur. I flisnin me përçmim, talleshin që paskësh qenë mësues. Njëherë ai s'u përmbajt, po një shok e tërhoqi për këmishe e i pëshpëriti në vesh:

— Duro, nuk e kupton që e bëjnë kastile?

— Si kastile?

— Që të të mbushet shpirti, t'u këputësh ndonjë të sharë e të gjejnë se bap të të hedhin hekurat.

Pra, po i sillej rrotull burgu.

Ditën e tretë u ngrit e shkoi te Nuçi Kamenica. Atij ia qau hallin.

— Pisk e paske, — i tha i menduar ai. — Zuri të shtrëngojë këpuca. A, po dihet, more, dihet! Ky stan atë bulmet ka. Ndaj na qau gërmadha, porsa ia dëgjuam zërin...

Ai e këputi fjalën në mes. Seit Bardhylin e kapi një lloj mallëngjimi sa mënt qau.

— Ti rri këtu. Unë po hidhem gjer në Korçë. Do t'i shpie ndonjë gjë nënës sate të mirë e t'i them të mos ketë gajle. Udhës kam kohë ta vras mendjen si e qysh të bëjmë. S'kemi pará, se, po ta lyesh qerren, xhandari bëhet qorr, shurdh, budalla, si ta duash. Të pa njeri kur erdhe këtu? Jo, thua? Atëherë të fshihesh. Fu-

tu në plevicë. Se, po të gjetën, të rrasën në hapsanë. Si një e një që bëjnë dy. Rri në plevicë e më prit.

Kishte hyrë prilli. Pikonin strehët. Në male akoma zbardhte. Vatra-vatra dëborë kishte ende dhe në fushë.

Në fillim errësira e plevicës ia vrau sytë. Rrinte i mbledhur nga të ftohtët e shikonte përreth kot së koti. Kur iu mësuan sytë në gjysmëterrën, një botë më vete, e heshtur shpalosi praninë e saj intime e të patrazuar. Një sfurk druri e një kosh në anë të kashtës. Një zile e ndryshkur dhe një opingë e grisur në kamare. Një tigan jashtë përdorimit, varur në një gozhdë, e përmbi të ngulur në mur një vitell, sipër të cilit rrinin nja dhjetë legtyra thekrishte. Nga ana e oborrit plevica ndahej me gardh. Aty-këtu purtekat e thata ishin thyer. Pulat kishin çepkatur byk nëpër ato vrima dhe që andej hynte një dritë e bardhë, e paktë dhe e ftohtë. Muri përkarshi ishte prej guri. Balta e tharë midis gurëve ngjante si e braktisur.

Kur s'pati ç'të zbulonte më, shikimi i tij u ngul diku e atje ngeli si i varur.

«Si vajti kjo punë! Unë jetoja i dehur nga ëndrrat e dëshirat për përparim. Rrokopujë të gjitha e njëherësh! Ç'do të bëhet më tej? Gjer ku do të rrokulliset ky lëmsh i ngatërruar?...»

Befas diçka lëvizti. Në një vrimë të murit u zgjat një turi i mprehtë sa një hundë. Në pjesën e sipërme të asaj si hundë dy pika zhive, sytë e qenies së gjallë, që s'qëndronin në një vend as dhe një sekondë të vetme. Turriçka përgjoi ca, pastaj u ndeh si kokë gjarpri. Tkurrej e zgjatej, tkurrej e zgjatej. Për një çast Seiti kujtoi se ajo qenie ishte vërtet gjarpër e po bënte habi si kishte dalë pa iku akoma dimri.

Po ja tek mbaroi ai veprim i çuditshëm dhe, hop!, ajo gjëja si gjarpër u hodh poshtë. Ishte një goxha kafshëz sa një mace. Sytë-zhivë gjithë në përgjim.

Kërciti dera e plevicës. Kafshëza iu qep murit me thonj e u zhdruk në hatullat. Nxori dhe një herë kokën, e lau gjithë plevicën me vështrimin e qullët e prapë u fsheh.

— Ç'është, ç'është? — pyeti Nuçevica, që sapo hyri.

Seiti i foli për kafshëzën e pështirë.

— Ku e pe gojëkyçurin? Është qelbak!

Ajo i trazoi hatullat me sferk, po më kot.

— Ashtu është, pa kocka, llastikë. Hyn në qymez e i mbyt pulat. Sa të jenë. Hajdut, makut!

Nuçevica i kishte sjellë për të ngrënë thjerrza, gatuar me miell, hudhra e uthull. Shumë të shijshme.

Si iku ajo, ai përsëri u zhyt në kashtë. Qelbaku s'i hiqej nga mendja. Madje herë-herës i bëhej se e shihte akoma, ashtu si e kishte parë në të vërtetë. Si e kishte nxënë ajo vrimë aq e ngushtë? Si zgjatej e hollohej ashtu? Dhe ç'vështrim tinëzar e të neveritshëm që kishte!?

Papritur në fantazinë e tij ajo qenie mori trajtat e një njeriu. Një njeri që përgjon me durim, gjen një vrimë e hyn dhe vret ç'i del përpara. Një vrimë në kufi. Qelbaku shtrohet si në shtëpinë e vet, duke picërruar sytë-zhivë. Atë s'e dua, vriteni! Ky më bezdis, burgoseni! Ai s'më pëlqen, pushojeni nga puna e lëreni të ngordhë për bukë! Mbështillini të gjithë me përgjim, qullosoni me pështymë që t'u vriten trutë. Të mos kenë mendime. As ndjenja. Të

rrinë urtë, të tulatur e të më shërbejnë mua kur të dua e si të dua unë!...

U shkund ta largonte përfytyrimin. Që ta bënte më lehtë këtë, mori gazetën. Gjithë po ajo, «Gazeta e Korçës». Qiraxhiu Miha e sillte rregullisht, edhe pse mësuesi mungonte. Nucleonica s'e linte të shkonte dëm, ja, e përdorte në vend të pecetës. Lexoi kot, atje ku i vajtën sytë.

«Kryetari i Republikës pret Mitropolitin e Korçës. Hirësia e tij Jerotheos i shprehu Shkëlqesisë së Tij urimet që përfaqësonjësit ditë të zgjedhin atë njeriun që ka dorën e çelniktë për punët e brendshme dhe dorën e florinjte për punët e jashtme. Hirësia e tij i lutet zotit t'i japë shëndet Shkëlqesisë së Tij, Zogut, kryetarit të Republikës...»

Po, mitropoliti ashtu do të bënte. Se mos vetëm ai! Të nesërmen e rënies së Nolit, disa njerëz, që çdo ditë e përshëndetnin mësuesin me përzemërsi, i kalonin përbri hundë e buzë si të mos e njihnin fare ose sikur t'u kishte bërë ndonjë të keqe. Në fytyrën e tyre të vrerosur lexohej habia: akoma bën hije ky?! Njëfarë togeri në Përmet, adjutant regjimenti, me të nuhatur lëkundjen politike, e preu lidhjen e prefekturës së Korçës me atë të Vlorës, që të mos merreshin dot vesh për ndonjë qëndresë në dobi të qeverisë së Nolit. Shpejtoi t'i bënte një shërbim Zogut, që po vinte me galop. Një tjetër oficer në Zvezdë, i cili dy ditë më parë i kallëzoi komandantit të vet se ku fshihej një i arratisur, mik i Zogut, sapo Zogu hyri në Tiranë, arrestoi me ngut vetë komandantin. Një bej urdhëroi njerëzit e tij t'i çarmatosnin e t'i shtronin në dru ushtarët e karakollit, që e kishin zënë

në kufi kur desh t'i vidhej Revolucionit të Qershorit...

«Gazeta e Korçës» i përqesh këta, po vetë e bën si struci», tha me vete. Lajmin e kthimit të Zogut e dha me germa të mëdha. Kur ai u shpall president, shpejtoi të botonte artikullin me titull «E meriton». Pas kësaj zor të gjesh numër gazete pa dy a tre artikuj kushtuar «Shkëlqesisë së Tij». «Edhe të teshtijë Zogu, gazeta ka borxh të botojë një artikull...»

U kthye Nuçi. Me një shikim të mjegullt, as të trembur, as të gëzuar, veç pakëz kurioz, i zgjati një letër.

— Ma dha jot ëmë. Ta dërgoka një kushëri, njeri i madh në Tiranë. Nëna bënte çudi. S'është bërë i gjallë kurrë, tha, ç'e gjeti tashiti? |Dhe s'dinte në është për mirë a për keq.

Seiti e hapi me nxitim zarfin e bardhë, veshur përbrenda me letër të hollë të kaltër.

«Fort i dashur kusho!

Mëso se u emërova sekretar i përgjithshëm i ministrisë. Duke u gjetur në këtë pozitë të lartë, lus zotin për fatmirësinë e ma thotë zemra t'ia shpërblej, ndaj u kujtova dhe për njerëzit e mi, nga të cilët ti më je fare i afërt. Kështu, në paç ndonjë hall e nevojë, eja e më tako. Dua të të gjendem...»

Një kushëri i harruar i shtrinte dorën. Kushëriri i kishte bërë një ndryshim të vogël mbiemrit, nga Bardhyli në Bardhi. Fatri Bardhi, sekretar i përgjithshëm...

Letra vinte si me porosi, kur Seiti qe në hall e në nevojë si s'kishte qenë asnjëherë.

— Kushëri e ke, — tha Nuçi, — sidokudo mund të të ndihë. Ti s'do t'i kërkosh kushedi

gë. Ja, të hapë shkollën e fshatit e ti të vi-
hesh prapë mësues. Shko!

Në zemrën e mësuesit regëtiu një fije
shprese. Pra, nuk ishte shuar çdo gjë. Ku ta
dish? Ndofta vërtet qe një fat.

Dy ditë më pas nisej për në Përmet, që an-
dej në Vlorë e pastaj në Tiranë ajo karakatina,
kamioni me karroceri të gjerë si hambar e
me goma të mëdha e të bytymta, pa kamer-
dare. Ndoshta gjente një biletë. Nuçi i tha se
do t'i huante ca para. Po t'u tregonte zar-
fin me vulën e ministrisë, xhandarët nuk do
të guxonin ta pengonin.

III

Fatri Bardhi rrinte me bërrylat mbështetur
në tryezë e s'ia ndante sytë kushëririt.

Ishte rëndokop, me shpatulla të gjera, i sho-
gët. Herë pas here ngjishte në trup pallton e
re, si të donte të mbështillej më mirë e ta
nxirrte në pah a sikur trembej se mos ndokush
ia zhvishte papritur. Madje Seiti bënte habi se
përse e mbante veshur dhe në zyrë. Fatri Bar-
dhi përtypej, duke krojtur me dhëmbë buzën
e poshtme, a thua i mblaçiste mendimet. Po
kur fliste, i hante fjalët.

Duke vërejtur kushuririn, mësuesit vetiu
iuj kujtua qelbaku i plevicës. Ndoshta ngaqë
sytë e vegjël të Fatriut në ballin e tij të da-
lë e të tultë dukeshin si të shpuar me kleçkë.
Turicka e qelbakut shkollë e vinte në fytyrën
e njeriut matanë tryezës dhe sytë-zhivë i kall-
nin krupë mësuesit. Seiti puliti sytë që të lar-
gonte atë përfytyrim të përcudnuar.

— Kështu, o kusho. Ti më qenke alamet

djali e me goxha kulturë. Më bëhet qejfi që erdhe menjëherë. Po!

Ndërsa fliste, tiparet e fytyrës i merrnin mprehtësi. Lëvizte supet e shtrembëronte buzët. Vetullat i ngriheshin e i uleshin dendur.

Seiti e gjykoi si tip mendjemadhi e servili tok, dy vese që e bënë të paqëndrueshme fizionominë e tij.

— Ti mbase e di, baballarët tanë nuk kanë pasur të shkuar të mirë. Im atë iku nga Korça e i doli për mbarë. Po ne s'rröjmë në kohën e Babaqemos e nuk do të vëmë re gjëra të këtilla, apo jo? Po! Hë, sa për opinionin politik, kjo është tjetër gjë. Ti, kusho, ke qenë fanatik i Mjekrës...

Ai picërroi sytë si për të thënë: «I di unë këto, i di!»

— A e di që? Ca kohë edhe mua m'u turbullua mendja. Punë rinie. Po Mjekra iku, na la shëndenë. Erdhi si vrundull, sa për të na ngatërruar. Shyqyr që s'ndenji gjatë! Ik, o prift, shko në kishë, ç'të duhet politika ty! Po! Le e le, po merret edhe me vjersha e me këngë! Atij i thanë që tanët po hynin në Tiranë, ai i binte fyellit, medemek kornos. Ja, thuj, të kam rixha, është politika për njerëz të këtillë? Programi i Mjekrës çuditi dynjanë, Shkëlqesinë e Tij ca më shumë. Çarmatim, tha Mjekra. Mirë, qeshi me vete Shkëlqesia e Tij, atë dua dhe unë. Reformë agrare shpalli Mjekra. Zemra mal Shkëlqesisë së Tij. Se, me kë do ta bënte? Me kë e kundër kujt, a s'më thua? Dhe erdhi një ditë që kupa u mbush e Shkëlqesia e Tij tha: mjaft! Po!... Ama dihet më anë tjetër që Mjekra bënte ç'i thoshte Gurakuqi, një politikan i prapë, që donte t'ia shiste Shqipërinë Italisë...

— Gjer këtu! — bërtiti vetiu mësuasi.

— A, a, ty s'të erdhka mirë? Kushëri i dashur, fanolizmi ishte një rrufë e aq. Kë mban më shumë, s'i ka punët mirë.

— Për këtë më thirre ti?

— Jo, jo për këtë. Unë shpësoja të jesh shëruar. Por, meqë e patëm fjalën, pse të dogji ty? Vetë Faik Konica, kundërshtar i Shkëlqesisë së Tij, e pranon. S'e ke lëçitur artikullin e tij ti?

— Si jo! Po... kundërshtar the?

— E di tërë bota, ç'të çudit ty?

— Sorra sorrës nuk ia qit sytë.

Sekretari i përgjithshëm i ministrisë u mbështoll mirë me pallton e madhe. Sytë e vegjël gati iu mbyllën.

— Kushëri, për këto llafe xhandari të lidh në rrip të dyfekut dhe i ha ca vjet të mirë burg. Po! Po ne jemi tanët e unë s'dëgjova gjë, — tha ai e fërkoj duart, ndërsa padashur shkeli syrin me një kënaqësi të papërmbajtur.

«Qelbak!» sa s'ia plasi mësuasi, po shpejt u përmbloodh e fërkoj ballin.

— Prandaj e vrau Zogu Gurakuqin? — pyeti Seiti sa për të dalë nga ajo gjendje e vështirë.

— Jo Zogu. Kush tha që e vrau Shkëlqesia e Tij? Sido që ndyrësirat duhen qëruar që të mos qelbin dynjanë, Shkëlqesia e Tij s'ka zemër as të therë një pulë.

«E di, ç'më thua! Ai bile bën thirrje për rregull e qetësi, me dashuri vëllai e dëshirë ushtari! Për Luigiin hapi fjalë se e vrau i kushëriri, një djalosh anormal. Për Bajram Currin nioftimi u shkallëzua krahas rritjes së fuqisë së Zogut. Në fillim. «Vdiq Bajram Curri, gjetur i ngrirë në dëborë». Pastaj: «U vra Bajram Cu-

rri». Dhe më vonë kryeministri Koço Kota i dërgoi telegram përgëzimi prefektit të Kosovës për vrasjen e Bajram Currit...

Kështu e jo ndryshe! Koburja e kopaçja ka zënë kryet e vëndit. Përbri tyre papunësia e shtrenjtësia. Erdhën tok me Zogun e si binjake të tij po i rrinë besnike.

Fatri Bardhi gërmoi në një raft pas shpine e nxori një tog gazeta.

— Nuk e beson atë që thashë unë? Këndo këtu!

Seiti i hodhi një sy artikullit të nënvizuar. Shtylla e Faik Konicës. Po, e dinte, e kishte lexuar. Kush që i mençur, tek Faiku lexonte midis rreshtave. Dhe aty ai përsëriste si papagall:

«Noli nuk ma! kishte nevojën mua, Faik Konicës, se ishte vetë i ditur. Të, Ahmet Zogu, që je xhahil, thirri mendjes e kujtohu që ka të tjerë të ditur dhe që ty të lipsen...»

Sekretari i ministrisë kishte nënvizuar dhe artikuj të tjerë e ia shtrinte gazetën njëerën pas tjetrës. Diku lexoi kalimthi: «Fryma demokratike në Shqipëri mori një zhvillim kaq të shpejtë dhe, mund të thomi, kaq romantike, sa, në entuziazëm e sipër, nuk mori ndër sy pengimet që do të gjente.»

Këto i dogjën. Po, demokracia ishte keqpërdorur. Ishte lëshuar si një çezmë pa rubinet duke derdhur gjithkund ujin e vyer, i cili kishte përmbytur gjithçka, edhe vetë çezmën. Atij i dogji dhe ndjeu një si pendim. Pse, mos vallë që ishte fanolist? Kjo ndjenjë lidhej me të qenit ca si shumë ëndërrimtar?...

— Ja, e pe dhe vetë. Mirëpo, unë zot, ti zot, gomarin kush e kullot? Kusho, t'i thom këto, se të dua të mirën. Lipset ta dish se ai që rrëzohet, nuk ngrihet çdo herë. Në të marrtë ters,

pastaj... Shiu për të gjithë bie, ama ai që s'ka ombrellë laget. Ti ombrellë ke, më ke mua. Flasin më troç, si tanët që jemi? Shkëlqesia e Tij bëri republikën. Republika Atij i shkon si... si shala lopës. Besa po! As bojën s'do t'ia shohë. Mirëpo, u zihen sytë njerëzve me kaq? Zërua! Politika kështu e ka, tërë kështu bëjnë. Shkëlqesia e Tij i di këto punë. Grurë kërkon ta ketë me shtetet e tjera. Grurë do ta ketë edhe këtu, në vend...

«Njeriu, mendoj i lodhur mësuesi, aftësohet sipas qëllimit që i vë vetes. Dikush në dituri, dikush në dhelpëri. Ky anon i tëri nga të dytët. Kushëri e kam, shok jo. Ku kërkon të dalë?»

Përballë njëri-tjetrit të dy heshtën në pritje. I pari priste që i dyti t'i kumtonte nevojën për të cilën kishte vajtur me t'i dhënë shënjë. I dyti, që tjetri t'i thoshte më shkoqur ç'kërkonte prej tij. Në këtë duel të heshtur herë njëri e herë tjetri ulnin sytë për të mos u zënë në përgjim. Shpejt e kuptuan që nuk ngroheshin e pas kësaj secili bënte përpjekje të dilte nga takimi duke ia hedhur tjetrit.

Sekretari i ministrisë mori në dorë një vulë dhe po e vërtiste sipër tamponit.

«Qelbak, kërkon të më thyesh me anë të pozitës!»

Atë çast i ra në sy që kushëriri rrinte rëndë-rëndë në një kolltuk me shpinëz të lartë. Fatriu s'e hiqte nga dora vulën, si një mjet ku mbahej.

— Shkëlqesia e Tij ka merak të madh për shkollat.

«E di, ç'më thua! Ministrinë e Arsimit e shkriu dhe e katandisi në drejtori të Ministrisë së Drejtësisë».

— Ama pa rregull e qetësi s'bëhet. Ta kam llafin që njerëzit lipset të rrinë urtë. Ata që nuk rrinë e sjellin trazira, Shkëlqesia e Tij dëshiron t'i dijë. Cilët janë e ku janë, ç'bëjnë e ç'kanë në kokë.

Seit Bardhyli u tendos. Kushëriri po hynte në temë. Pa hë, pa hë! Bah, po si kishte harruar ai që Patriu ishte sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme?

Po tjetri u tregua më i shkathët.

— Kushëri i dashur, gjene flasim nesër, — tha. — Vij e të marr vetë. Ku ke rënë? Eh, unë harrova fare! — ai i ra ballit me dorë. — Ti je shpenzuar, pastaj je dhe pa punë. Kalo, të lutem, nga administrata. Ja, këtu ngjitur. Ose më mirë po të shpie vetë.

«Parapagim! — ia bëri me vete me mllef mësuesi. — Qeveri që nxit veset e jo virtytet. Me forcë erdhi, me forcë kërkon të mbahet. Xhandarë e spiunë i duhen. Xhandarë ka. Gjithë bashibozukët që e shoqëruan jashtë shtetit dhe ata që e pritën brenda. Për spiunë paska nevojë! Iu dashkan nga ata që gjer dje s'kanë qenë me të. Që të mund të futin hundët kudo ku takohen kundërshtarët e tij. Eh, dhe ti, o kusho, u kujtove për mua! S'vlen për mësues, the, ta bëjmë spiun... Ta paça borxh!»

Sikur ai të kishte guxuar e t'ia thoshte hapur, kushedi ç'do të bëhej. Ndoshta do t'i flakte ndonjë gjë fytyrës.

Askush nuk është i përjashtuar nga mundësia për të gabuar. Por ka gabim e gabim, dhe mësuesi nuk ia falte vetes që i kishte besuar asaj letre me vulën e ministrisë e ishte sulur pas saj deri në Tiranë. Po, ende ro-

mantik! Të shkundej, të çlirohej sa më parë nga ca besime të tilla naive.

— Të falem nderit për kujdesin, o Fatri sekretari! — i tha.

Tjetri u ngrys. Sytë e vegjël iu zvogëluan edhe më. Vetullat e trasha u ndehën sipër tyre si tela me gjemba. Që brenda asaj farë mburoje, që nga ato vrimat e ngushta, dilte një hakërrim i madh.

Duke bërë sikur nuk e vuri re zemërimin e tij, Seit Bardhyli shtoi:

— Nuk ta kisha dëgjuar zërin, po do të ishte më mirë mos të të njihja. S'pres ndonjë të mirë prej teje, të kam bërë hasha! Sa për ato dënglat e tua të trasha, shitja ndonjë tjetri. Gjej një si veten. Nuk do të heqësh keqsyfete të tilla ka sot sa të hanë qentë.

Sekretarit i ra vula nga dora.

— Ç'i ke këto ti? Mbylle grykën! Mbylle, të them!

Mësuesi mendoi se i kishte thënë ato që kishte dashur. Më tej, kot të harxhonte frymë e nerva. Nuk pa si u murrëtye fytyra e atij matanë tryezës. Nuk desh ta shihte më. Hapi derën dhe doli. Zbriti shkallët me të shpejtë e u gjend në rrugë.

Sapo bëri dy hapa, ia dha një shi i rrëmbyer. Ai nuk qëndroi, ecte përmes shiut.

Kur u qull i tëri, i iku ca zjarrmia e inati. Kapërceu rrugën e qëndroi nën një rrap të madh. Në fletët e tij të dendura shiu zhurmonte mbytur. Pluskonin pikat në pellgjet e rrugës. Fshiu me shami fytyrën e qafën. Shamia u lag menjëherë, po ai vijoi të fshihej me të, madje fërkoj dhe flokët.

Ja dhe Tirana! Gjithçka prej saj erdh e u mblodh në atë shi me shtambë, në atë udhë

me baltë e me rrapin e fortë mu në mes. Mirë që u gjend ai rrap!

Ç'do të bënte më tutje?

Një mendje i thoshte të kthehej te Nuçi Kamenica e ta fitonte bukën e gojës si ndihmës i tij. Një tjetër të ikte që atë ditë jashtë shtetit, siç patën bërë shumë të tjerë. Mirëpo asnjëra s'e kënaqi. Se, dufit, atij dufi që i vlonte përbrenda, si t'ia bënte?

Pluskonin pikat e shiut në pellgjet me ujë të turbullt. Zhurmonte rrapit degëshumë. Një vetëtimë çau retë. Krisma e rrufesë u përplas diku me rrapëllimë. Seitit iu bë se u përmbys rrapit i madh dhe e përshkoi një dridhmë. Po rrapit s'kishte pësuar gjë. Atëherë u mbështet pas tringut të tij të fortë.

Nesër bëhet vonë

Që në mbrëmje i thashë Ciles se do të shkoja në arat e malit, nga Padinat.

Kishte rënë shumë vesë! Pluhuri i rrugës ishte njomur e shkelja si mbi një cipë të hollë tine. Ecja gati me të rendur. E ka këtë të mirë agronomi. E shijon natyrën. Ku ka si ky ajër i pastër! Ku ka si kjo freski e agut! Po prapë s'thua dot që kënaqësia të vjon nga një gjë e veçantë, sado e rrallë. Mëngjesi i qershorit të rrëmben me dritën e tij të ëndshme. Natyra përpëlit qerpikët, zgjohet dhe del nga nata, si një nuse e bukur nga banja e ngrohtë.

Nuk e mora vesh si arrita në Padinat. Atë kohë ra dielli. Gjethet e lëmuara e të lagura të ahishtës u ndezën. Prushitja kishte një si drithërimë që të lëbyr sytë. Erdhën që larg e

ranë mbi një gorricë nja dhjetë pëllumba. U shpupurisën me potere gjethe e pendë tok si një përshëndetje e zhurmshme, po shumë e gëzuar.

Deri këtu shkoi shijimi i bukurive magjike të mëngjesit. Më tej bëri majë syri i mprehtë i zanatit. Një goxha arë qarkuar nga ahe të dendura. Me grurë? Bah, s'të zinte syri tjetër veçse tërshërë të egër. Çava përmes korijes e do-la në arën tjetër. Gjithë njëlloj. Janë disa ara radhazi në pllajën e Padinave. Bëhen nja dymbë-dhjetë hektarë. Dhjetë vjet më parë ishin lëndina. Po u hapën e u bënë tokë buke. Vitin e parë e të dytë u mbollën me patate. Dhe dhanë mirë. Pastaj me grurë. Grurë mbi grurë për vit, tanimë gruri ishte degjeneruar, ndërsa tërshëra e egër bënte qejf.

U ula e rrëmoval me dorë. Rrënjët e tërshërës-thellë, të gjata, të forta. Me siguri kishte krijuar nja gjashtë a shtatë mbirje. Dreq fare kjo e tërshërës së egër. E prish një rën në lërim, mbin tjetra, që është edhe më thellë. E than edhe këtë me helme, del e treta. O, si përshtatet! Dhe rritet shpejt, më shpejt se gruri, ia kalon atij e ia merr frymën, s'e lë të bëjë për-pjetë. Gruri, ashtu i shkurtër, i paktë, ende pa i mbushur mirë kokrrat, kishte zënë të zverdhej, E ç'mund të jepte ai kalli i mpakur që po nxitonte të piquej para kohe, si të donte t'i shpëton-te kështu mundimit të rritjes me të keq?

Hoqa përbrenda e ngela një copë herë gërmuqur mbi bimën e pazhvilluar. M'u bë se e kishim braktisur. Dhe m'u dhimbs, siç na dhimbset një njeri i sëmurë. Nuk më vjen turp të them që u përlova. Ndieja dhembje, po dhe njëfarë pendimi. O, duhej të kisha bërë diçka! Të mos pajtohesha me atë gjendje. Kurrë, asnjëherë!

Me këtë mendim zbrita në fshat e iu zbraza Ci-

les. Cilen e kam përgjegjës sektori. Ai është njeri i mirë e i zoti dhe i gojës, por, më dëgjoi në heshtje, si me mërzitje dhe, edhe pse unë mbarova e prita ç'do të thoshte, ai s'foli. Nuk i kishte bërë fare përshtypje apo ndiente dhe ai ato — që ndieja unë, ndaj e quante të tepërt të shprehej? Mua më erdhi inat. I thashë që ai s'bëhej merak, s'e çante kokën, fola për mungesë përgjegjësie, për paaftësi e çfarë jo! Pas kësaj ai u inatos e më në fund ia shkula ca fjalë. Planin e grurit e kemi të madh, tha. Ku ta mbjellim? Në fushë i bie t'i këmbëjmë kulturat. Zhukat sivjet i mbollëm me grurë, mot me panxhar. Se do tokë të mirë dhe panxhari! Pa do misri, patatja, jonxha! Kështu që Padinat... E po, kjo është vështirësia e punës sonë, i thashë. Të lodhemi ca më shumë kur bëjmë planin e ndarjes së kulturave nëpër ngastra. Mos, more, ia bëri ai e s'ma vari më.

Të nesërmen prapë u ngrita shpejt. Më është bërë zakon e tani më pëlqen. Vesha pulovrin e dola. Cilen e gjeta në zyrë. Erdhën njëri pas tjetrit brigadierët. Pastaj zunë të vinin fshatarët. Përshëndeteshin me njëri-tjetrin, bisedonin, merrnin punën e ditës.

— Doli dhe Ndoni, — tha Cilja.

Ndonin e kemi kryetar. Është nga fshati ynë. Ai vej e vinte te qoshja e shkollës, nja pesëdhjetë metra më tutje. Shikonte orën e pastaj sheshin bri stallave. Dukej priste makinën e po mërzitej.

— Ec e takoje, se të desh, — më tha përgjegjësi.

Ç'më donte Ndoni? M'u bë si vapë. E hoqa pulovrin, e hodha në sup e bëra drejt tij. Ai më pa që po i afrohesha ca si serbes dhe rrudhi vetullat.

— Mirëmëngjesi, Ndoni!

— Mirëmëngjesi! — mërmëriti i mërzitur.

— Soton pret?

Ai u vrenjt edhe më. Kur e di, ç'pyet, dukej se tha me shikimin e tij.

— Më kishe kërkuar?

— E, ashtu.

— Po përse?

— Eja në zyrë.

U dëgjua zhurma e makinës. Ajo u duk te kthesa e depove. Pastaj frenoi mu në këmbë të kryetarit. Ndoni hipi përpara. Unë hapa derën e pasme dhe hyra. Kryetari u ngrys. Nuk m'i hodhi fare sytë e as që më foli gjatë gjithë rrugës. U rehatova në gjithë ndenjësën e pasme e bëra sikur s'e vura re zemërimin e tij, po me vete vrisja mendjen ku e kishte.

— Mos u largo! — i tha Sotos kur u ndalëm para zyrave.

Mua asnjë fjalë. Hyri brenda e u kthye së pari në dhomën e rojës operative. Që aty në degën e prodhimit. Ashtu, pa e lëshuar dorezën e derës, dha një përshëndetje të lehtë e shtoi: Do të mblidhemi ca sot, Sefi? Që aty mori shkallët përpjetë, në degën e planit.

M'u bë se më harroi fare. I shkoja pas e përherë e më fort më shtohet mëdyshja në bëja mirë apo jo. Si doli nga dega e planit, Ndoni më kaloi përbri e prapë s'tha gjë. Atëherë dhe mua më hipën. Ç'jam, budalla? — mendova. Mos e kisha tepruar? Sapo ai tha se më donte në zyrë, unë iu qepa pas. Ai hyri në zyrën e tij. Unë mbeta në korridor. Pashë orën. Po të mos më thërriste deri më shtatë, do të ikja pa i thënë. Atë çast ai hapi derën me vrull.

— Hajde, ore, ç'pret?

Hyra. Ai mbyli derën e shkoi zuri vend. Zyrë e madhe. Ndryshe nga gjithë të tjerat. Tryeza

e gjatë fare e re, karriget të reja. Pata dëgjuar që kishte dërguar furnitorin gjer në Pogradec për to. E kishte hapur njëren dritare dhe tyli i fryrë si tullumbace erdhi deri tek unë.

Nuk e dija në duhej të ulesha apo jo. Sec pata një si hutim. Desha ta pyesja e ashtu po lexoja në sytë e tij.

«Ti doje që të ta thosha që në rrugë. A, jo! Zyra është zyrë. Ka autoritet. Të tremb ca, të bën më serioz e më të përgjegjshëm.»

— Ulu, Gjushi, ulu! — tha si me keqardhje. Tërhoqa një karrige dhe u ula mu pranë derës.

— Pa hë?

— Ju më keni thirrur.

«E shikon? Këtu sillesh me edukatë. Ka lezet!»

— Më foli një çikë Cilja mbrëmë dhe... pata një shqetësim.

— Dje isha në Padinat.

Ai sepse ndryshoi. Dukej si i penduar që e nisi atë bisedë.

— Po Zhukat, ç'thonë Zhukat? Do të venë te gjashtëdhjeta?

— Unë e kisha fjalën për Padinat.

«Hë, kokëforti!»

Ai kafshoi buzën e poshtme dhe e nduku një copë herë.

— Edhe?

— Të merr të qarët!

— Mirë, de, e mora vesh që të vjen keq. Po të ishe kthyer nga Padinat pa e bërë qejfin qeder, nuk do të më vinte mirë. Mirë. Shqetësimin ta kesh, ama të kesh dhe respekt. Ciles i kishe folur ca si kaluar. Për këtë të thirra.

— Jo për Padinat!

— Ç'Padina?! Ç'do t'u bëjmë Padinave në këtë kohë?

Mbeta si i shastisur. S'e merrja dot me mend se si mund të zhvendoseshin kështu problemet. Nga shqetësimi për grurin e dobët, te një tjetër, i vockël, që paskështa folur kaluar!

M'u ndezën faqet. Kushedi si më flakëruan sytë. Ai më pa që diçka po bluaja me vete. E ka aftësinë e të vëzhguarit ky Gjushi, i kishte thënë një ditë Ciles, ka tru e i dhimbset profesioni. Megjithatë i do rrëzuar ca hunda, sa s'e ka marrë revanin. Qetë s'duhet të jenë të dobët, se ngulen në brazdë, po as shumë të fortë, se të lodhin!...

Pra, ai kishte frikë se mos nesër unë e lodhia, ndaj po m'i hiqte veshët, që të rrija urtë? Më hipi dhe më tepër inati, megjithatë u përmbajta.

— Unë bëj çudi me ty, — i thashë. — Të cmoj e të nderoj, po si është e mundur të mos shqetësohesh për atë gjendje?

Ndoni kërcëlliti dhëmbët.

— Po ti, kapedan, s'ke përgjegjësi ti?

— Kur fillova punën unë, Padinat ishin mbjellë.

— Justifikimet nuk më pëlqejnë mua!

U mata t'i kundërshtoja.

— Mos ma pre fjalën! Frikacakët i kam zët, ta dish! Kush kërkon t'ia lërë doçin tjetrit, s'është burrë. Mirë. Ta zëmë se e ka fajin përgjegjësi i sektorit. Ose unë si kryetar. Na u vu kapela, e hëngrëm djathin e Koles ne e dikush fërkoj barkun. Mirë. Po ç'duhej të kishim bërë sipas teje?

— Më mirë të themi ç'duhet të bëjmë.

— Ashtu qoftë.

— Mot Padinat t'i mbjellim me fasule ko-kërrvogël.

— E?

— Është bimë prashitëse. Me prashitjen e parë prishen disa mbirje të tërshërës. E pasuron tokën me azot e për vitin tjetër na siguron një prodhim të grurit dy-tri herë më të madh. Fasulja vetë do të japë prodhim me vlerë dy herë më të lartë nga ajo që marrim sot prej grurit.

E shfaqja mendimin tim thjesht, shtruar e lehtë, që të kapërcente mbi zemërimin e befë të kryetarit. Ai më pa me vëmendje, por jo me inat. Zgjdhja që paraqita, i pëlqeu. Dukej që s'e kishte shkuar ndër mend më parë.

— Mirë e ke ti, mor djalë, po s'na lënë. S'e bëjmë dot.

— Kush nuk na lë?

— Struktura e planit.

— Ç'është kjo strukturë, pse bëhet gogol?

Ndoni m'i nguli sytë. Unë s'i shqita të mitë.

— Është problem rrethi, — tha kryetari ngadalë, si për t'i vënë kapak bisedës.

— Aq më keq.

— Ç'do të thuash ti me këtë?

— Ta ngremë zërin në rreth.

— Ti kujton se unë kam heshtur? E kam bërë problem në seksion kushedi sa herë.

— Ta çojmë më lart.

— Ku, ore, në qeveri?!

— Edhe në qeveri, po të jetë nevoja.

— Por që andej vjen plan, or bir! Qeveria ia dërgon rrethit, rrethi ekonomive. Si Padinat tona kanë dhe ekonomitë e tjera dhe njësoj veprojnë edhe ato, duke e kompensuar me punë e prodhim më të madh në fushë.

Iu duk se u shpreh qartë, fare qartë. Pas kësaj u ngrit e vajti te dritarja. Domethënë mba-

ruam, ç'pret më? Unë s'kisha mbaruar. Desha të vijoja, po më parë ai t'ë më përfillte. Kur ai u kthye e më pa si me habi, i thashë:

— Kryetar, po s'e bëtë ju, do ta bëj unë.

— Çfarë?

— Do të dërgoj një letër lart.

— Letra dërgojnë të pazotët, smirëzinjtë.

— Unë dua të di kush më pengon të rrit prodhimin. Ai po, mund të jetë smirëzi e i pazoti,

— Ore, je në të ti? Të thashë një herë, struktura e planit s'varet nga ne. Ajo është...

— Atëherë na pengon ajo, dua të them: burokracia e planit.

Kryetar Ndoni psherëtiu me keqardhje. Ndoshta për kokëkrisjen time. Ndoshta se iu bë që me burokraci të planit unë kisha parasysh pikërisht atë. S'e kishte menduar të tillë takimin me mua. Biseda hyri në një rrugë pa krye. Ai, me sa dukej, donte ta mbyllte, por pa lënë përshtypjen që nuk e vlerësonte, as që po tërhiqej.

— Të pyeta për Zhukat, — tha. — Ato ngrenë peshë. Se Padinat, Padina janë. Ja, do ta rritësh rendimentin tre, katër apo pesë kuintalë për hektar. Në ta e varke shpresën ti? Ti je dialë i zoti, me kapacitet. Lodhe kokën për gjëra më me bukë. Mirë? E lëmë me kaq?

Ai u ngrit. Ishte zbutur e bërë dele, si thonë, dhe s'donte tjetër, vec të më përcillte urtë e butë pa telashe. Unë u cmerita. Jo, edhe kështu s'e desha. Pse një ndryshim kaq i ndjeshëm e i meniëhershëm?

Brodha shtë nëpër dhomë si për ta gjetur përgjigjen diku. Zyrë e mirë, e bukur. Karrice të reja e të bukura, tryezat po ashtu. Zyra e kryetarit e mirë duhet të jetë, unë s'them io.

Ndoni u ul, diçka shënoi në kalendar, u ngrit

përsëri, po si me përtim. Një jastëçkë e butë shkau nga karrigia dhe ra në dysheme. Ai e pa, e mori, e shtroi me dorë dhe u ul përsëri. Unë ia kisha qepur sytë e po e shikoja me ngulm. Ashtu, i përhumur në ca hamendje të miat. Mos vallë atij i kishte hyrë në qejf zyra? Ku ta dish. Dhe trembej mos e humbte karrigen?...

Ishte një mendim kalimthi. Deri në atë çast herë zieja nga inati, herë më vinte të qeshja me përpjekjet e tij për të më treguar vendin sa s'qe vonë. Por, sapo më lindi dyshimi tjetër, diçka u përmbys brenda meje. Papritur më erdhi keq. Ndjeva keqardhje, po përse? Për kë? E them me të vërtetë, paçka se ndokush mund të më marrë për mendjemadh. Çudi, ë? Sikur ai të më thoshte: «Gjushi, njeri jam dhe unë, ç'më di ti?» a ndonjë gjë tjetër si këtë, do t'i kërkoja ndjesë. E them me gjithë mend. Por ai nuk foli.

Vazhdonim të heshtnim. Ndoni, ngaqë s'po dinte ç'të bënte, u ngrit e vajti te dritarja. Unë aty, i ngulur në vend. Më ikej e s'më ikej, më rrihej e s'më rrihej.

— Mirë, Gjushi, gjene bisedojmë.

— Kur?

Ndoni pa orën.

— Një herë tjetër.

Mëdyshjet e mia u shtuan. Vërtet thua? Ti s'ke për ta hapur më këtë bisedë. Për tjetër gjë më thirre.. Me ato që thashë unë, ti u trembe për vete, u trembe për mua. Thua vërtet u trembe? Nuk të njoh për të tillë. Unë isha akoma nxënës, kur ti kishe mbaruar studimet e ishe kthyer në fshat. Atë kohë ra zjarr në plevicat e kooperativës. U sul gjithë fshati, u sule dhe ti. Si tani më kujtohet kur hipe në çatinë që gati po shembej. Dhe dole nga zjarri me vetulla e flokë të përzhitur. O, janë ca gjëra që zor t'i

harrojë njeriu! Kurse tani... Frikacak ti?! S'më vjen ta besoj!...

— Druaj se bëhet vonë, — thashë qetë-qetë.

Ai më pa gjithë kërshëri si i befasuar. Fjalët e mia ishin më dy kuptime. Ndoni është njeri i zgjuar. Ai e mori menjëherë kuptimin e dytë. E mori e u vrenjt edhe më shumë. Mua më rrodhën fjalët ujë e s'u përmbajta:

— Tani e besoj që e ke ngritur problemin e pengesës që sjell struktura e planit, por jo me këmbënguljen për ta zgjidhur. Mbase e ke si një shfajësim për mosrealizimet. S'e di. Ç'më duhet mua, ke thënë, mos jam më i mençur se të tjerët? Por...

Ai priti i ndehur.

— Ti s'ke dëshirë të ndeshesh. I ciruhesh ndeshjes...

Nuk i thashë që i bënte shërbim karriges.

Ndonin e përshkoi një dridhmë. Sytë i shkrepinë. U ngrit vetiu e më erdhi pranë i hakërruar. Pastaj ndërroi mendje e shkoi sërish te dritarja e hapur. Fryu një shkulm ere dhe perdjia ia mbuloi kokën.

— E di që po të duroj si shumë?

Foli fare qetë, po u duk menjëherë që ishte tepër i prekur e mezi e zotëronte veten.

— Si të duash. Më fal.

Mua më shpëtoi një psherëtimë. Vërtet, kush isha unë që po sillesha aq shpenguar, sikur ai të ishte një shoku im a një më i vogël se unë?! Ndoshta djersita. E kalova pulovrin sa nga njëri krah në tjetrin, bëra të flisja, po s'më doli zë. Një të kthyer dhe e kapa me vrull dorezën e derës.

— Ku shkon?

Mbeta atje. Dera që hapur përgjysmë.

— S'të tha njeri që mbaruam.

E mbylla derën e u ktheva. Dhe ia ngula sytë. Ç'do të më thoshte? Kisha shkuar larg, e kisha tepruar, më vinte zor. Edhe ai po më shikonte. Nuk e merrja dot me mend se ç'bluante brenda. Do të doja shumë, shumë, por... Ai më shikonte e sikur s'dinte ç'të bënte më tej. Përse e mbajta? Çfarë do t'i them? Cili është ky e ç'kërkon këtu? Po unë, kush jam unë e ç'po bëj? Këto pyetje ia lexoja në sy.

— Si the ti, nesër bëhet vonë?

— Bëhet.

Ai m'i nguli sytë. Pyeste, hakërrohej. Shikim fort i trazuar. Thashë me vete se mos nuk e kisha thënë qartë mendimin tim e mos më kishte keqkuptuar. Desha të shtoja e t'i thosha që njeriu është mirë t'i dalë përpara vonesës.

— A, Gjushi, Gjushi! — ia bëri ai.

— M'u bë si qortim. Kaq rëndë e kishin dogëndisur fjalët e mia? Desha ta shihja prapë në sy, po ai s'm'i dha. Pse foli ashtu? Të më kujtonte që isha i vogël ende për t'i shitur mend atij? Apo i vinte keq për mendjemadhësinë time?

— Shoku Ndoni!...

— Ë?

— Unë desha të them... mua...

Ai erdhi e u ul përballë meje. Ma bëri me shenjë të rrija dhe njëherë m'u duk se do ta niste nga e para. Ia shkoi dorën ballit të zgjeruar. Trazoi ca fije flokësh e i bashkoi, duke e mbushur disi një brazdë të gjerë, që i fillonte në ballë e i ngjitej lart, në çaçkë të kokës. Pastaj krejt papritur i hodhi një sy orës dhe, si të më kërkonte të falur që më mbajti, tha ngadalë, si i lodhur:

— Mirë, Gjushi, shko.

Trëndafil i vyshkur

1

Në të perënduar, që nga qafa e Voskopojës, dielli hodhi një tufë rrezesh të përflakura. Ishte si një përshëndetje e vonë, ndaj dhe ca si e trishtuar. Vuli lëvizi kanatin e dritares. Rrezet u përplasën në pasqyrën e gardërobës. Pasqyra ishte e vjetër, me anët të çkërmitura, njëlloj si korniza e dalë boje. Megjithatë asaj i pëlqente dhe kur e kur shihej në të, qoftë dhe kalimthi. Ja, si tani që bëri sikur ndiqte rrezet flakëruese. Dy sy shkëndijues, një fytyrë e përskuqur. Die-lli ia jepte atë përskuqje?

Vuli i fërkoj faqet me duar dhe kafshoi lehtë buzën e poshtme. Si atëherë.

«Ç'e ke atë trëndafil aty?»

«Ku?»

«Në buzë. Një gonxhe e bukur, e bukur...»

Asaj i pati ardhur turp e kishte kafshuar buzën. Trëndafilu atë çikje donte: kishte shpërthyer...

Dhe ajo mban në dorë një trëndafil, një gonxhe me ato fletët e buta si të rrumbullta, që nuk arritën të hapen plotësisht, të freskët, të porsakëputur.

Kur të shkojë ai, do t'ia hedhë në rrugë. Do t'ia hedhë dhe me të shpejtë do ta mbyllë dritaren.

Pse s'po kalonte akoma?

Sytë në sokak, mendjen në përgjim. Sokaku i heshtur, si i shkretë.

— Vuli!

Vajza vuri dorën në zemër. Një gjemb e shpoi në gisht. Ajo u kujtua për trëndafilin. Po ta shihte e ëma me të në dorë... Iu bë një e keqe e madhe. Ku ta vinte? Trëndafilu po u jep-te ngjyrën e vet faqeve të saj. Ajo u hutua dhe më shumë.

— Vuli, moj!

Iu dha ta fuste nën jastëk, në anën ku flinte ajo vetë, dhe nxitoi nga dera. Po në të dalë sytë i vajtën te pezuli i dritares. Atje po! E mori trëndafilin dhe e vuri mbi pezul. Po të shkonte ai, do ta vinte re dhe do ta kuptonte që Vuli e kishte pritur.

Prapë shpejtoi nga dera.

Kishte një si ngutje tek e ëma. Si atëherë kur nxitonte për të bërë paqtimin e shtëpisë dhe njerëzit i zinin këmbët. Mirëpo nuk qe e shtunë.

— Pasa, Nulla, merrni dhe Letën e shkoni ca nga teto Vita.

Në atë shtëpi emrat përdorëshin të përgjys-

muar. I saji nga Parashqevi, Parashqevuli në Vuli. Aspasia, më e madhja ndër motrat, thirrej Pasa. Athinulla Nullë. Violeta, i vetmi emër disi i ri, Letë. U kishin kafshuar nga një copë, sikur s'e meritonin të tërin. Emri i babait kishte pësuar vetëm një ckërmitje. Një fshikje e lehtë ia pati hequr gërmën e parë, nga Apostol në Postol. Vetëm emri i nënës kishte mbetur cuditërisht i nprekur. Krisavgji. Kur Vuli e pati thënë njëherë këtë vëzhgim të sajën, e ëma qe ngrëfosur. Unë erdha e pajosur si zonië, i qe përgjigjur. Vuli nuk e pati marrë vesh ç'kishte dashur të thoshte e ëma me ato fjalë, kurse i ati kishte mbledhur buzët si për të thënë: «S'ke ç'i bën!»...

Krisavgjia shtroi me dorë një jastëk. lëvizi nga vendi një karrige, e hapi dhe e mbylli dollapin.

— Tashti vien yt atë. — tha.

Vuli parandieu një gjë të vecantë. Siellia e së ëmës nuk qe aspak e zakonshme. «Tashti vien yt atë». Domethënë kemi një punë me ty. Dhe motrat i përcollti te teto Vita. Pra, ishte një punë që hëpërhë duhej ta mësonte vetëm ajo.

Zemra e vajzës së re e nisi sërish vrapimin. Po jo si herën e parë, atje prapa dritares. Ishte në prag të lumturisë, të cilën e jetonte në vetete, ashtu, ende të papërcaktuar, ndaj e ndiente dhe më të fortë. Parandjenja e beftë e trembi.

— Po përse, mama?

— Të vijë ai njëherë. Për mirë është. S'të pritet ty?

I ati hyri gati pa u ndier.

Vuli ia mori nga dorë xhaketën. E vari me frikë, se mos i mbetej në dorë kur të peshonte mbi gozhdë, se e dinte që jaka e mëngët ishin tretur.

— Të ka dalë një fat i mirë, — i tha Vulit i

ati, pa e parë në sy e duke i mëshuar çdo fjale. a
thua se trembej mos i shkoqeshin nga mendimi.

Një krisje. Në vend të zemrës vetëm një bo-
shllëk. Përtej boshllëkut ca hapa që ndalojnë pa-
pritur në sokak. Dritarja e hapur përgjysmë.
kortina e mënjanuar, trëndafili mbi pezul. Të
gjitha në një vështrim. Një vështrim i zbrazët.
i zbehtë. Vetëm një tik-tak i vrazhdë e mono-
ton. Ora e murit theu heshtjen që ndehej si një
fije merimange. O, pse të ndehej kjo fije?

— Ti s'po e pyet tët atë cili është?

Vuli dëgjo i dhe s'dëgjo i. Asai i flisnin? Cili
ishte? Mandi u shfaq i tëri. Në këmbë, midis
nënës e babait. Qesh, dhe e ndara ndërmiel dy
dhëmbëve të sipërm i iep aq shumë bukuri! Të-
rë bukuria e tij mblidhet aty, tek ajo e ndarë.
Sa cudi!

«E sikur të jem unë?»

«Vërtet, vërtet?! Oh!»

Një pandehmë aq e dëshiruar. Vetëm kaq.
Vuli përpëliti qerpikët.

— S'ka gjë, gjene flasim.

2

Motrat flenë. O, sa gjumë të qetë bëjnë! Vuli
s'ka gjumë. Vërtet kishte ca kohë që e zinte
gjumi pak vonë, pasi i pëlqente të rrinte një
copë herë zgjuar, si në pritje të një diçkaje të
këndshme, të këndshme, që do të vinte patjetër.
Madje ajo nganjëherë ngrihej e mbante vesh.
Hapa të lehtë në rrugë. Sa të njohur! Sa të da-
shur! E lehtë pendë drejt e te dritarja. E më-
njanonte pakëz kortinën. Mandi atje, larë nga
drita e hënës. Krahu i padukshëm e i gjatë i
dashurisë vetëm sa e çikte, po ç'det i gjerë lum-

turie i hapej përpara!... Pastaj futej në rroba pa e fikur buzëqeshjen. Ashtu buzëqeshur e zinte gjumi...

Ndryshe kësaj nate.

I hap sytë edhe më. Jo, s'është në ëndërr. Një gjë e papritur. «E papritur? Unë i kapërceva të njëzetat. E kam kohën. Ca më parë mund të m'i kishin thënë këto fjalë. Por tani... Pse m'u duk kaq e habitshme tani? Pse s'e kam shkuar asnjëherë ndër mend këtë?»

Si ai filizi i njomë që, megjithëse i brishtë, çan koren e tokës dhe bën majë në hapësirën plot ajër e dritë, dashuria e saj sundonte mbi të. Fejesa, martesë, vetë jeta, gjithçka, gjithçka të shkruara në të. I mendonte ndonjëherë? Edhe po. Por gjithnjë tok me dashurinë, me sytë e dashurisë. Ashtu bëheshin të mira, të këndshme, cak i lumturisë, që s'e përfytyronte dot ndryshe.

Nga kaltërsia e pafund e përplasën në ballë e gurë. Menjëherë. Me nja dy fjalë që i ati ia tha, pa e parë në sy. Pse nuk e pa në sy? Ndosh-ta dhe ai e kuptonte që ato fjalë asaj nuk do t'ia pranonte zemra. Me kë lidhej ai fat që i pas-kësh trokitur në derë? Cili qe ai? I ati nuk ia tha. Vuli nuk e pyeti. Mos ishte Bombi? Bombi i thoshin një gjatamani që ato ditë ishte kthyer nga Amerika. Thuhej që kishte ardhur të mar-tohej. Korça ziente nga pandehmat. Ai vërtitej nëpër qytet me një kostum gri me vija dhe një borsalinë në kokë. Ishte i plotë nga trupi, po ca si i shpëlarë. Si një manekin që ekspozon vesh-jet. Ai ekspozonte veten. Një kandidat për dhën-dër. I dukur, i veshur mirë, me xhepin kukurrec. Xhepin nuk ia kishte parë njeri, po këto të tëra aty të çonin.

Vuli sillet në shtrat. Shtrati kuis me ankim. Ajo nuk i mbledh dot mendimet. Gjumi nuk po

i vjen. Lumturia qëndron diku në ajër e trembur. Kërkon të marrë arratinë dhe ajo, po seç e pengon. Si një zog i plagosur, ka frikë mos e zënë.

Ngrihet e shkon te dritarja. Mbështet faqen në xham. Rruga është e shkretë. Qetësia e natës sikur fsheh një pabesi. Ja, drita e hënës nuk i arrin dot hijet e strehëve. Hije strehësh, hija e një porte. Në një qoshe hija zgjatet e zgjatet. Si në përgjim. Në përgjim të pabesisë. Ajo ia qep sytë si për t'ia prerë hovin befasisë. Në trurin e saj përsëriten fjalët: «O atë, o hiç! Mandin e asnjë tjetër! Më mirë të vdes, sesa...»

Po pse s'po dukej ai? Të mos kishte kaluar asaj rruge? Këtë natë duhej të vinte. Apo kishte vajtur fjala deri në veshin e tij? Dhe ai kushedi ç'kujton. Ndoshta mendon që Vuli s'e do më. Ndoshta mendon se Vuli e ka dhënë fjalën për atë tjetrin. Ndoshta... Ku ta dijë ai, ku ta dijë!... Befas e sheh veten të vdekur. Ajo në arkivol dhe njerëzit përreth. Ai vërsulet midis njerëzve dhe bie në gjunjë para saj. Si s'e dija unë? Lërmëni këtu! S'ka më jetë për mua!...

Përpëlit qerpikët. Kapakët e syve prapë i rëndohen.

3

Atë që e la në mes i ati, e plotësoi e ëma, Krisavgjia. Fati që i kishte ardhur në derë, ishte vërtet Bombi. Përputhja e pandehmës me të vërtetën se ç'kishte diçka shqetësuese. Bombi kishte hyrë në gojët e qytetit. Lum si ajo ku do ta hedhë mollën ai! Mjerë ajo! Po pse lum? Po pse mjerë? Dhe molla e tij ra mbi kokën e Vullit. E që ishte pikërisht ajo e zgjedhura e tij

apo fati i tij pas gjithë atyre thashethemeve, a s'do të mjaftonte për t'u tronditur? Le pastaj që, e përhumbur në ngrohtësinë e dashurisë së saj, ajo kurrë s'e kishte menduar se dhe vetë hynte në ato «lum» e «mjerë». Pra, edhe e lirë të ishte zemra e saj, kjo zgjedhje do ta bënte të luhatej. Se thashethemet nusen e ardhshme të Bombit e kishin vënë kështu ndërmjet lumturisë e mjerimit.

— Jo! — i tha së ëmës.

— Moj, ti!!!

— Nuk dua.

— Mbylle grykën, të thonë! Ta këput kokën! Ç't'i shash? I pashëm, i prepsur, nga soj i mirë. Do të jesh zonjë.

— Në fund të dynjasë...

— Pika ty! Po ku ka si Amerika, moj? E ke dëgjuar ti si ua jep xhevapin njerëzve Miti i Vanës? Si është Amerika, e pyesin. Siç e thotë emri, përgjigjet. Ç'thotë emri? Ja, atë: ha, merr dhe ik!

— Ua, ç'i mençur!

— Mbylle! Ky është kësmeti yt. Kësmeti nuk kthehet. Pastaj, se mos do të rrini tërë jetën atje. Sa të bëni ca prokopi. Ç'thua ti, ne s'kemi mall për ty? Nuk ma ka ënda mua të përkund ata të tutë? E, moj çupë!...

Krisavgjia u përlot. Vulin e mbërtheu butësia e mallëngjimit. Më pas ajo donte ta ngiste prapë dhe një herë atë bisedë, po nuk i erdhi mbarë. Motrat ende s'dinin gjë dhe Vuli nuk mund të hapej në sy të tyre. Se dhe prindërit hëpërhë po e mbanin të fshehtë. Ndoshta ishte një fjalë e thënë kalimthi. Ndoshta vetë Bombi gjente ndonjë tjetër. Ah, sikur!

Motrat flinin dy nga dy. Nulla me Letën në një krevat, Vuli me Pasën në tjetrin. Dy të voglat çuçuritën sa çuçuritën e s'u ndien më. Pasa po qëndiste ndenjmur mbi shtrat. Deshi të qëndiste dhe Vuli. Sa të merrej me një gjë. Dikur Pasa zgjati kokën, pastaj e la punën dhe iu afrua Vulit.

— Më paska kërkuar Cilka i Games, po babai s'pranoi.

— Pse?

— Kërkoj 50 napolona prikë.

Vuli e pa motrën me dhimbshuri. Ajo ishte e gjatë, e dobët, me preka në fytyrë. **E gjora Pasë!** Për vajzat e shëmtuara duhej prikë më e madhe.

— Ky Bombi si shumë vërtitet nga sokaku ynë. Ma hodhi një llaf teto Vita. T'i hyjmë për ty, më tha.

Vuli mënt klithi. Pasa vente me shpresë... Ku ta dinte ajo!

S'i mbajti dot lotët. U ngrit e vajti te dritarja. Bënte fresk. Hëna - si një natë më parë. E zbehtë, përqeshëse. O, sa e bukur i dukej kur Mandi mbështetej e rrinte aty përballë, larë nga drita e saj! Akoma nuk kishte thelluar nata, po rrugica ngjante fare e shkretë.

Dy veta s'e kanë të njëjtin hall, pa le të jenë dhe motra. Vuli po torturohej nga lajmi që i dhanë prindërit, Pasa e ëndërronte atë fat. Ajo e shihte që po i ikte mosha dhe jepej pas çdo shprese që i dilte në shteg. Shpresa e fundit qenkësh Bombi. Ai u vërvitka në sokakun e tyre. Vuli vetëm një herë e kishte parë. Një herë dhe fare rastësisht. Ishte bërë kureshtare, doemos. Po Bombi vajtka posaçërisht për të.

Kureshtjen e saj ai e kishte marrë se i vinte për mirë, si interesim a dëshirë, kushedi. Dhe pastaj kishte kërkuar dorën e saj...

Kërcitën dërrasat e korridorit. Vuli u përmblodh dhe me nxitim u fut në rroba. Pasa vijonte punën e saj me një pamje **ëndrrimtare** në fytyrë. Po vinte e ëma. Ato e njohën nga hapat. Kur shkelte ajo, ndihej një si lëkundje në gjithë shtëpinë. Krisavgjia hapi derën e zgjati kokën.

— Akoma e mbani llambën ndezur ju? S'ia kemi vaktin të harxhojmë kot.

Vajzat s'i folën. E shojtën dritën e ranë të flinën.

Pasa e mbuloi kokën. Pas pak u dëgjuan të gërhiturat e saj. Nganjëherë rënkonte në gjumë e vërtitej në krahun tjetër. Vuli sytë në tavan. Koka i rëndonte, sytë i dhembnin. Do të ngrihej e të vente matanë. T'u zbrazej njëherë...

5

Ajo eci në majat e gishtërinjve. Prindërit nuk kishin fjetur. Po bisedonin, se zërat dëgjoheshin deri në korridor. Vulit ia zuri veshi emrin e saj dhe i mbajti këmbët. Po, për të po flisnin. Vuli u zu ngushtë. Hall të hynte tek ata, meqë po bisedonin për të, hall të kthehej, se mund ta pikasnin e do të kujtonin që ajo i përgjonte. Mbeti aty dhe padashur përgjoi.

— Ë, të ishte për të madhen, more Postol...

— Ç'ma lëndon plagën dhe ti!... Kur më tha Nuni që ai kishte thënë «O marr çupë nga të Postolit, o bëhet njëra!», s'ta them dot ç'gëzim pata. E po, thashë, i doli fati Pasës së gjorë.

Pas saj na hapej dera... Mirëpo vete në Amerikë tjetri. E do të re, e do me shkollë, e do të bukur. Që të jetë e çekes. Vuli i ka të tëra.

— Kush dëgjon botën...

— Bota llaf e sehir do. Neve a na bëhet mirë? Bota do të shohë të mirën tonë e do ta mbyllë gojën. Vuli është e zgjuar. Atij po i ka zënë lopata ujë. Që në të parë duket njeriu. Limokondor. E martojmë Vulin larg, ama sigurojmë pajën e çupave të tjera.

— Ashtu, xhanëm, sikur thashë unë. Po...

— Çfarë, me pishmanllëk e ke ti?

— Jo, more, ç'është ai llaf! Po... Vulin e kam më të mënçmen. Sesi më vjen. E barkarisim gjer prapa diellit, sikur e kemi të gjetur.

Postoli psherëtiu.

— Ç't'i bësh fukarallëkut, pa e di unë... Më vjen turp të bashkohem me një shok. S'guxoj dot të hyj në një kafene... Po paska perëndi dhe për ne! Unë gjithnjë kam thënë me vete se një ditë do të na qeshë buza. Vuli u bë se-bep. Tashti nuk ua kam merakun të tjerave. Se, kur ke, di ç'bën. Dhe njerëzit ta gjejnë më kollaj derën.

— Çupa e nënës!...

Vuli nuk mundi të dëgjonte më. Si një gotë e mbushur buzë më buzë që nuk nxë asnjë pikë të vetme, zemra e saj s'e mbante dot dhe mbjen e re. Pra, ajo po sakrifikohej. Babai e dinte, nëna e dinte. U dhimbsej dhe atyre, u dhimbsej shumë, por e bënin nga halli. Vuli larg, çeqet afër. I hapej një plagë shtëpisë e i mbylleshin shumë të tjera.

Qau pa zë mu aty, në korridor, te pragu i dhomës së prindërve. Aq u ngashërye, saqë për pak do të hynte e t'u thoshte të mos e kishin

fare merakun e saj. Ajo ishte aq e zonja, sa të bënte një sakrificë që...

Nuk mendoi se mund të gjendej ndonjë zgjidhje tjetër. Nuk i qortoi më prindërit. Ashtu si e kishin gjetur të udhës që ta hiqnin nga shkolla se s'u dilte, po ashtu e kishin menduar edhe këtë lidhje. Ndaj heshti e s'e kundërshtoi më fejesën me Bombin. Ishte shpresa e re e madhe për njerëzit e saj dhe ajo nuk do ta prapste shortin e ri.

«Mandi është kaq i mirë. Ai do të vuajë shumë, shumë. Edhe unë do të vuaj shumë. Plagë përjetë do ta kem. Atë do të dua e vetëm atë. Unë do t'ia them e ai do të më kuptojë. Do t'i vërë zemrës gur, siç do t'i vë edhe unë.»

6

Fejesa, të shkelurat, martesë u bënë me nxitim, pasi Bombi nuk mund të rrinte më. Vuli bënte ç'i thoshin, si një mekanizëm i kurdisur. E ka nga malli, se do të vejë larg, thoshin ca. I vjen keq për Krisavgjinë e Postolin që e shkrinë tërë ç'kishin e u nderuan në fejesën dhe martesën e saj, ia bënë ca të tjerë. Vetëm ajo e dinte. Nuk ia tha askujt, s'e ndau me asnjë. Zemra iu bë si një hon i thellë. Nuk ndiente asgjë. Ishte e thatë, e ftohtë. I bëhej se të gjitha këto i ndodhnin një tjetre, të cilën ajo as e donte, as nuk e mëshironte. Nganjëherë i dukej se ishte në një ëndërr që po zgjaste shumë, shumë. Dikur do të mbaronte, dikur ajo do të zgjohej... Por nuk pati asnjë frenim. Asnjë zgjim. Ajo mbyllte sytë dhe, duke mos qenë e zonja të bënte gjë, thoshte me vete: «O,

sikur të jem në ëndërr! O, sikur e gjithë kjo të jetë veç një ëndërr!»



Kaluan disa muaj. Postoli në merak. Krisavgjia në padurim.

— Kaq larg qenka kjo e përnxirë Amerikë, more Postol?

— Larg është.

Megjithatë një lajm a një letër mund të kishte ardhur.

Ai kthehej përditë në postë. Ata të postës ia dinin hallin dhe, sa hynte, ia bënë me shenjë «jo», duke provuar dhe vetë njëfarë dhembjeje.

Dhe, sapo erdhi letra e parë, postieri trokiti së pari në shtëpinë e tij.

Ishte një zarf i madh, i gjatë, me vija të kuqe e blu anash, me një vulë «PAR AVION» dhe një tjetër «AIR MAIL». Më poshtë adresa. Dora e Vullit.

— Të keqen nëna! — u përgjërua Krisavgjia dhe e puthi zarfin.

Postoli e vërtiti në dorë që ta gjente nga hapej. Duart i dridheshin. Zuri ta griste në qoshe, po pati frikë.

— Një thikë, moj!

E priste me aq kujdes atë zarf të madh, a thua se letra ishte një qenie e gjallë e dashur dhe ai druhej të mos i shkaktonte dhembje. Duart gjithnjë i dridheshin, sytë e të dyve mbi zarf. Kur e hapi, Postoli nxori një letër me katër faqe. Asgjë tjetër. Letra e parë dhe vetëm letër? Krahët iu varën. Kujtesa i solli vetiu shqetësimin e së shoqes në ditën e das-

mës së Vullit: «More burrë, si të djegur në bërryl më ngjajnë këta krushqit. Trokë të jetë ky djalë?» Ai e kishte qetësuar duke i thënë se dasma bëhej me ngut, pasi ai do të ikte. Pastaj navloja...

Midis shqetësimit të atëhershëm të së shoqes dhe mungesës së çekut në letrën e parë të Vullit, u krijua një lidhje. Një lidhje që fliste dyfish. Ai e ndjeu deri në palcë, po prapë s'deshi ta besonte. Kushedi, ndoshta çeku vinte më vete.

— Këndoje, të marrim vesh si janë njëherë!
— tha me padurim Krisavgjia.

Postoli e lexoi më parë për vete. Kur e mbaroi, duart sikur iu shkrehën e letra i ra përdhe. Krisavgjia u ul ta merrte dhe, ashtu ulur, ngriti kokën.

— Ç'thotë, Postol?

— E ka marrë malli shumë.

— Po tjetër?

Postoli nuk u përgjigj menjëherë.

— Tjetër? Ja, atë, dhëndri nuk është si e pa-ndehnim.

Ajo ia vuri duart në gjunjë dhe e pa në sy me një si përpëlitje.

— Kostumin ia kishte marrë hua një shoku.

— Na paska gënijer, ditëziu!

Ai psherëtiu thellë. Një herë, dy.

— Jo, nuk na gënjeu. Kishte hall dhe ai. Po i ikte mosha e donte të martohej. I leckosur nuk mund të vinte, de!

— Bijë, o bijë!

Gruaja shtrëngoi zarfin e bukur me vija anash. Sytë nga i shoqi. Ai ngeli i ngrirë, i zymtë si vetë zhgënjimi.

Telefon nga Voskopoja

Hynë me druajtje, po shikimin drejt tij. Dhe ai ende pa folur i pa në sy, në fillim vajzën, pastaj djalin. E kanë këtë zakon mësuesit. Po mbase bëj gabim që e ngushtoj. Njeriu i mirë gjithnjë ballas e shikon bashkëbiseduesin. Pa ndonjëherë ta do puna të zhbirosh në është i çiltër a i djallëzuar, a përputhen fjalët me atë ç'ka në zemër e në mendje, pra a janë të vërteta apo të gënjeshtra ato që ai të thotë.

Në sytë e nxënësve lëvrinte një dëshirë. Deri këtu shkoi zhbirimi. Ç'ishte ajo dëshirë, përse, me se lidhej, nuk e përcaktoi dot.

— Shoku drejtor, ne duam... — ia nisi djali.

— Duam të vemi në Voskopojë! — nxitoi si me ngut vajza.

— Cilët «ne»?

— Klasa e tretë C.

— I thatë mësueses kujdestare?

Nxënësit panë njëri-tjetrin, pastaj drejtorin, si të çuditeshin me pyetjen e tij. Njëherë mendoi ta bisedonte më parë me mësuesen kujdestare, mandej t'u jepte përgjigje, mirëpo kjo do të krijonte te nxënësit përshtypjen e njëfarë zyrtarizmi, ndaj i tha djalit ta thërriste Valin. Djali nxitoi të dilte për të kryer porosinë, kur në zyrë hyri nëndrejtor Halimi.

— Hë, ç'doni?

— Duan të venë ekskursion në Voskopojë, — e sqaroi drejtori.

— Pa shih!

Edhe Halimi i pa me vërejtje sa njërin, tjetrin, por të dy i bënë bisht shikimit të tij.

— Pak vende të bukura kemi afër Korçës që ju na dashkeni të veni gjer në Voskopojë? Shkoni në Belvedere! Shkoni në Bozdovec!

— Kemi vajtur.

— Kur kështu?

— Kur ishim të vegjël.

— Pa shih, tani qenkeni të mëdhenj ju!

Sytë e nxënësve u përpëlitën me shqetësim e nervozizëm. Të dy u kthyen nga drejtori dhe ky kujtoi se po i kërkonin ndihmë, po ata më tepër treguan përçmim për fjalët e Halimit.

— Shkoni ju dhe le të vijë këtu mësuese Vali! — tha drejtori.

Ata dolën. Halimi seç shënoi në regjistër e s'u ndie më. U bë i gjallë kur Vali hyri në zyrë.

— Ti i kishe dërguar këtu ata qytykët? — i tha asaj me inat.

— Ç'qytykë? Dhe ç'janë këto shprehje?!

— Pa shih! U fyeve ti! Ata të tutë vijnë drejt e te drejtori sikur ne s'kemi me se të merremi. Dhe përse, pa! Ty s'të bën përshtypje kjo?

— Valin e thirra unë! — tha me të rreptë drejtori.

Halimi shtangu një çast, pastaj i rikthye punës së tij me regjistrat, sikur të thoshte: «Ama kështu na qenka puna? S'plaske, atëherë!»

Drejtori i tregoi Valit për kërkesën e nxënësve të saj.

Vali sesi mbeti. Qerpikët i drodhën nxituar. Bëri të pyeste diçka, po s'foli dot. Shikonte drejtorin, pastaj Halimin. Njëherë u kthye me vrull nga dera, po u kujtua që nxënësit e kishin shoqëruar deri atje e s'kishin hyrë brenda.

— Të mos më thonë fare mua!...

Dhe sytë iu njomën. Sytë iu njomën e zëri iu zbut.

— Si kështu?!

Drejtori po bënte habi. E pra, i ishin dukur të sjellshëm, shumë të edukuar. Mirëpo këtë s'duhej ta bënin. Pa i thënë më parë mësueses kujdestare... Kaq gjë tanimë duhej ta dinin.

— Atëherë merru ti me ta. Po të jesh dakord dhe ti, shkoni!

— Unë?! — ajo e pa e çmeritur. — Po unë...

— dhe u kthye nga Halimi si t'i kërkonte ndihmë.

— Vali është me spondiloartrozë, — shpjegoi ftohtë ai.

— Më fal, s'e dija.

Drejtori u zu ngushtë, mësuesja qëndroi si e përhumbur.

— Ekskursionet unë i kam pasur shumë dëshirë. Dhe shkoja përherë. Me kohë i bëja dhe nxënësit si veten. Me të vërtetë, që kur u sëmura unë, as ata s'kanë vajtur. Tani po e shkoja ndër mend. Sa gabim!... Dhe tani... O, qenka e rëndë! Më erdhi keq, shumë keq. Më falni!...

Ai e kuptoi që nxënësit nuk i kishin thënë asaj pikërisht për këtë, se e dinin që do të pre-

kej. Të mençur, ë? Të mençur e të ndjeshëm. Kjo ia bëri ata më të dashur dhe dëshirën e tyre e vlerësoi edhe më shumë. Klasa e tretë C do ta bënte ekskursionin. Këtë e vendosi menjëherë. Po ai kishte hallin e mësueses. Duhej ta qetësonte. Dhe t'i merrte mendimin si e qysh të bëhej më mirë ai ekskursion.

— Po ç'faj kanë ata? Ata duhet të venë! — tha ajo papritur.

— Po si mendon ti, apo t'i nisim vetëm?

— Vetëm?! — kërceu Halimi. — Unë të këshilloj të mos e bësh këtë gabim. Lihen vetëm në një rrugë aq të gjatë? Apo s'i kanë mësuar djallëzitë! Ja, edhe këtu çift erdhën! Dhe duan të venë aq larg...

— Nuk bën t'i shohim gjërat kështu...

— Ashtu?!

Halimi rrudhi vetullat.

— Po ç'të bëjmë, thua ti?

Mbase Halimit iu duk që drejtori po tërhiqej, se ngriti kokën e i dha gjoksit përpara.

— Meqë do t'ua plotësosh dëshirën, të nisim dhe një mësues të mirë me ta.

Ai u mëshoi fjalëve, a thua lëshonte kërcunjt. Vali e pa atë, drejtorin, u mat ç'ç të thoshte, po s'e tha. Me sa dukej, dhe ajo i druhej nëndrejtorit.

Aty për aty drejtorit i pëlqeu mendimi i tij. Heshtjen e Valit e mori për miratim.

— S'e ke keq, — i tha Halimit. — Atëherë kështu, — shtoi për Valin.

Ajo psherëtiu e u ul në një karrige.

— Jo, s'është mirë, s'bën, — tha.

— Ç'flet, moj! — ia pati Halimi.

— Halim, ti e di, kemi biseduar dhe një herë tjetër për këtë problem.

— Hëm! — ia bëri Halimi.

— Po të veja unë, do të qe ndryshe. Unë jam mësuesja e tyre kujdestare, si të thuash, pjesëtare e kolektivit. Me mua mund të vinin dhe mësues të tjerë e të mos binte në sy, do të dukej krejt e natyrshme. Kurse pa mua mësuesi tjetër do t'u duket si rojë. Ja, kjo s'më pëlqen. Me peshën e mosbesimit ekskursioni do t'u bëhej i bezdisshëm, aspak i këndshëm.

Ajo thoshte një të vërtetë. Është mosha kur të rinjtë kërkojnë respekt e besim.

— Këto unë i quaj sentimentalizma. — tha Halimi.

Mësuesja qeshi hidhur.

— Kështu më the dhe atëherë ti.

Kur ajo ishte e sëmurë, klasa e tretë C kishte bërë një mbrëmje. Në mungesë të saj Halimi kishte dërguar një mësues. Qëlloi një nga ata që kudo e kurdoherë kanë hall se mos ndodhë gjë e u bie përgjegjësia. Gjatë gjithë mbrëmjes ai u përpoq t'i mbante nxënësit nën kontroll, bëri çmos të mos i shpëtonte asgjë, duke vëzhguar çdo lëvizje të tyre. Edhe kur e ftonte ndonjë vajzë për të kërcyer, ai kokën lart si misrok në përgjim.

Dhe ata ishin fyer, fyer rëndë. Asaj nuk i hiqeshin nga mendja sytë e përlotur të Aldës, që iu ankua të nesërmen, kur vajti e pa në spital. Pse, ç'jemi ne? Ç'na di ne ai?...

Drejtori e dëgjoi me shumë vëmendje dhe iu bë se edhe ajo vetë ishte përlotur si nxënësja e saj.

— Pra, ti mendon të shkojnë vetëm?

— Pse të mos venë? Kjo do të rritë besimin e tyre ndaj shkollës e ndaj vetes.

— Mirë, do ta shohim, — tha drejtori.

Ai u mor me një punë tjetër. Po nuk ishte i qetë. Ta shohim, mirë, po si? Njëherë mendoi

të shkonin në ekskursion të tria klasat e treta. Ashtu bëhej mirë, se do të venin edhe disa mësues. Por jo, jo, edhe kësaj mosbesimi do të ndehte mjegullën e vet fyese. Kurse kësaj radhe gjithë halli ishte që ajo mjegull të davaritej e të mos shqetësonte më njeri. Me merakun e saj mësuese Vali i kishte hapur një dritare të re dhe nëpërmjet saj ai shikonte mjaft qartë atë që në kushte të zakonshme edhe e harron e nuk ia vë veshin.

Janë ende të vegjël, mendoi. Këtu Halimi ka të drejtë. Po ai e unë s'kemi qenë të vegjël? Eh, ku kishte ekskursione atëherë! Ishin vitet e para pas Çlirimit. Unë veja në shkollë me një kapotë ushtarake të vëllait, që arrinte gjer përdhe. Po isha i bëshëm e i fortë. Po t'u thosha gjëkafshë shokëve, copë bëheshin. Çudi, si e kisha fituar gjithë atë autoritet? Shpesh bënim punë vullnetare... Eh, tjetër kohë ajo!... Po pse tjetër? Ai djali vërtet vjen ca më i imët, por ndoshta kjo është butësia e një kohe më të begatë. Sa për shpirtin, sa për prirjet e moshës pse të mos jenë po ato? Në ç'aksion nuk na kanë nderuar?...

Ndërsa mendonte kështu, arriti në përfundimin që Vali kishte të drejtë. Jo se do të bëhej udhë, po kësaj here ia vlente guximi. Ishte një rast i veçantë, si një provë, dhe nuk duhej t'i trembeshin.

Të nesërmen e thirri mësuese Valin e nëndrejtor Halimin e u tha ç'kishte menduar. Halimi e pa me inat e si me keqardhje.

— Do ta hash! — tha rëndë-rëndë.

Vali nënqeshi. Nënqeshja e saj në fillim ishte përçmuese ndaj qëndrimit të nëndrejtorit, pastaj erdhi e u zgjerua në një mirësi të ngrohtë e

nxitëse për ta çuar punën deri në fund. Thirri ata të dy. Alda quhet ajo vajza?

— Po. Dhe djali Betim. Alda është kujdestare e klasës, Betimi sekretar i organizatës së rinisë.

— U shkon fjala në klasë, i dëgjojnë?

— Si s'i dëgjojnë? Alda merakoset më shumë se unë kur ndokush merr notë të keqe. Betimin e kemi sportist.

Kur ata të dy u gjendën përsëri përpara drejtorit e ai u tha që do të ishin përgjegjës për ekskursionin, sytë e tyre u përshkënditën. Tanimë drejtori s'kishte ç'të zhbironte dhe i pa më nge, me ngrohtësi. Sytë e Betimit ishin ngjyrëkafe, me ca quka të blerta si vezë turtulli, kurse të Aldës të kaltër e të kthjellët.

Edhe Vali po i shihte me përgjërëm. Ndihej e kënaqur, shumë e kënaqur që drejtori po silllej me aq përzemërsi me nxënësit e saj. Vetë ata ishin të prekur, gjithë emocion.

— Shoku drejtor, të jeni i sigurt se ne...

Mësuesja e ndjeu thellë lehtësimin. Kështu, pra, klasa e tretë C do ta bënte ekskursionin. Nxënësit do të shkonin vetë, siç kishte propozuar ajo, Vali, kujdestarja e tyre. Deri këtu fare mirë. Ajo provoi ndjenjën e mirënjohjes, po dhe të përgjegjësisë. Kjo sikur i rëndonte disi kënaqësisë, s'e linte të hapej e të bëhej e plotë. Ishte përgjegjësia e një veprimi të pazakontë. Ajo vetë e mbante të gjithën. Drejtori në mendimin e saj ishte bazuar...

Po ç'kam kështu, tha me vete, ç'po ndodh me mua? Në vend që të gëzohem, unë po ha vetëm sikur kam bërë ndonjë faj! Dhe s'jam frikacake, as e lëkundur nuk jam...

Mirëpo vazhdimisht i vinte në mend ajo shprehje ogurzezë e Halimit dhe në zemër sikur i frynte një erë e akullt.

Çdo e keqe ka dhe një të mirë, thotë një fjalë. Paralajmërimi i rreptë i nëndrejtorit bëri që si ajo dhe drejtori ta merrnin me shumë seriozitet ekskursionin e klasës së tretë C. Gjithë ato ditë punuan me nxënës të veçantë e me tërë klasën. S'lanë gjë pa shkoqitur. Ç'është Voskopoja e ç'duhet parë aty. Përse bëhet ekskursioni e si bëhet. Ç'është shoqëria e miqësia e të tjera si këto. Vali u jepte gjithfarë udhëzimesh, deri dhe ç'të vishnin e ç'të mbathnin për një rrugëtim të tillë të gjatë në kohë dimri. Ajo e kujtoi drejtorin të merrte në telefon kampin e pushimit të punëtorëve në Voskopojë. Drejtori i kampit pranoi që nxënësit të flinin atje atë natë.

Dhe ja, erdhi e shtuna.

Qëlloi një ditë e vrenjtur pus. Pas pak zuri llohë. Pllaskat e mëdha e të rënda të dëborës ngjiteshin nëpër rroba. Deri sa vjati në shkollë, Vali e shkundi nja katër herë çadrën. Na dështoi ekskursioni, thoshte me vete me një keqardhje të singertë, sidoqë një ndjenjë e dytë e mezidukshme gërcite keqardhjen dhe bënte majë si një kënaqësi rehatie. Ajo nuk donte të bëhej e vogël e t'i jepej asaj ndjenje.

U mblodhën nxënësit e klasës. Më shpejt se çdo herë tjetër. Me çanta shpine, veshur e mbathur për marshim. Kishin ngjeshur në kokë kapela, kapuçe të ndryshme. Disa vajza ishin mbështjellë me shalle të leshta. Për çudi, çadër s'kishte marrë asnjë, si ta kishin bërë me fjalë.

— Si i bëhet, Betim? E sheh ç'dëborë bie, moj Alda?

Drejtori ishte në hall.

— Do të shkojmë, nuk kthehemi ne! — thanë ata.

Dhe u nisën. Me atë llohë e me ato ujëra

që përmbytnin rrugët, ekskursioni bëhej akoma më i vështirë. Jo vetëm ajo e drejtori, po e gjithë shkolla e ndiente ekskursionin e klasës së tretë C si një provë të fortë. Natyrisht asaj i rëndonte më tepër. Nuk është e lehtë ta japësh besimin, po ca më e zorshme ta fitosh atë. Nganjëherë mësuesen e brente një ndjenjë pendimi. Një mëdyshje cfilitëse kishte zënë ta mundonte. Gjithë ato ditë të përgatitjes ekskursioni i qe dukur i lehtë, madje ngjarje e gëzuar edhe për atë vetë. Kot ishin shqetësuar në fillim. Por, sapo ata u nisën, iu shpif ajo mëdyshja. Në vështrim të parë nga koha e keqe. Po jo, s'ishte vetëm koha. Nja dy mësues sesi e shikonin. Nëndrejtor Halimi nënqeshte me qesëndi dhe Valit i bëhej se midis buzëve atij i kishte ngehur shprehja; «Do ta hash!», me të cilën tanimë sikur krenohesh.

Bënte ç'bënte dhe i afrohej drejtorit si për të marrë zemër a si për t'i dhënë ajo atij. I vinte keq edhe për atë. Edhe ai sesi dukej, megjithëse nuk e bënte veten, madje njëherë i tha që guximi e besimi janë në themel të edukatës socialiste.

Po, ishte në ankth. Përfytyrimet e saj merrnin trajta nga më të çuditshmet. Përpiqej t'i kapte fytyrat e nxënësve, po ato i treteshin në pllaskat e mëdha të dëborës dhe përhumbnin. Nuk e mbante dot në përfytyrim as shikimin kurajoz të Betimit, as kthjelltësinë e syve të bukur të Aldës. Gjithçka fshihej pas njollave të mëdha e të ftohta të llohës, që vazhdoi gjatë.

Si mbaroi mësimin, vajti në shtëpi. Bëri të hante drekë, po siç u ul, u ngrit. Kishte merak për ekskursionistët. Dhe merak shpesh i merrte atë ngjyrimin e keq të mëdyshjes. Iu duk se kishte ndërmarrë një barrë të rëndë. Dhe deli-

kate. Mbase duhej të ishte treguar më e matur. Mos duhej t'ua kishte vënë veshin ca më shumë këshillave të Halimit? I vinte inat që arrinte në këtë përfundim. Madje ndonjëherë i dukej se inati ndaj tij e kishte nxitur ta bindte drejtorin. E kishte vlerësuar më shumë sesa duhej besimin te nxënësit e saj, apo ishte mëria ndaj nëndrejtorit, ja, ashtu, për atë qëndrimin e tij kundërshtues e fytes? Eh, eh!... T'ua thyente zemrën nxënësve, s'ishte mirë. Po si pate me vete nxënësit, nuk shkon mbarë puna në shkollë. Ca më tepër edukimi i tyre. T'ua plotësosh dëshirat e mira, i bën me krahë e veç të mbara mund të presësh. Po a ishte dëshirë e tillë ajo e tyrja? Mos vallë vërtet ishte nxi-tuar?...

Dhe ora mezi ecte. Dy herë e kërkoi në telefon Voskopojën, po centralistja tha që linja nuk punonte. S'i rrihej, u ngrit e vajti përsëri në shkollë. Sa u çudit kur e gjeti atje drejtorin. Kush ka merak, s'bie në rehat. Ai ishte në hall si ajo. Po mundahej të lidhej me Voskopojën.

— Aman, moj shoqe, kemi një punë ashtu! Të lutem shumë, shih se ndoshta është bërë lidhja! — i lutej centralistes.

Kur e pa Valin, i erdhi disi çehreja.

— Si thua, të kenë vajtur?

Ndërsa kërkonte Voskopojën, centralistja i tha se e kërkonte Voskopojë.

— Merre! — tha me zë të dredhur Vali.

— Alo! Alo! Ti Betim je? Si vajtët? Si jeni? Të gjithë mirë?...

Linja prapë u ndërpre.

— Epo, kanë vajtur! Gjysma e së keqes.

Drejtori psherëtiu i lehtësuar. Ashtu dhe mësuesja.

Ky lehtësim vijoi nja një orë. Pastaj diçka e grisi. Kishin vajtur, mirë. Po më tej? Një natë dimri përpara. Si do të kalonte ajo natë? Si do të silleshin ata atje, në kamp? A do të kishin zjarr për t'u ngrohur e tharë? Po kthimi? Dëbora mund të ngarkonte edhe më tepër...

U vu në merakun e saj gjithë familja. Nuk zinte vend asnjë bisedë tjetër. Vente nga vente, fjala kthehej te Voskopoja. Vali hamendësonte, i shoqi dhe e vjehrra herë e miratonin, herë e kundërshtonin. Gjithsesi të dy donin që ajo të qetësohej. Ajo e kuptonte këtë, po, për t'u qetësuar, nuk qetësohej dot.

— Po pse i nisët, moj nuse? — ia pati më në fund e vjehrra.

— Ou, ç'thua dhe ti, mama!

— Mirë të thotë. Kur e kishit me kaq frikë, pse i dërguat?

Valit këtu i digjte. Po, këtu kishte një pjesë të së vërtetës.

Dhe një e dy e te telefoni.

— U rregullua linja e Voskopojes? Akoma? Çudi, s'ka qëlluar ndonjëherë të priten linjat!

Centralistja ia mësoi emrin dhe hallin. Do të të marr vetë unë, ç'ke ti, i thoshte si duke i kërkuar ndjesë.

Pas pak ra zilja e telefonit.

— Mami, Voskopoja! — thirri vajza e vogël.

Vali brofi e në çast u gjend në korridor, te telefoni. Të dyja vajzat e djali pas saj.

— Alo, Voskopoja!

— Ç'Voskopoje, moj? Ç'është kjo Voskopoje?

Në anën tjetër u dëgjua një zë i njohur e një e qeshur shpotitëse.

— Ama ç'e gjete! — e ngacmoi djali motrën e vogël.

— E, mirë, le të mos e gjej! Ti ç'ke? S'e do mamin ti?

— Heshtni, se është daja Petro! — u tha e ëma e mallëngjyer nga përkujdesjet e tyre...

Kur u rregullua linja e Voskopojës, vajti vonë e kampi nuk përgjigjej. E mori dhe një herë pas gjysmë ore, po përsëri s'u përgjigj njeri.

Kaloi me të keq një natë që iu duk tmerrësisht e gjatë, nga më të gjatat në jetën e saj. E priste me padurim mëngjesin për të telefonuar përsëri. Nata mezi kaloi e mëngjesi mezi erdhi. Sytë te ora. Qëkurse zbardhi e deri sa vajti ora 7, mëngjesi çapitej ngadalë e me plogështi. Ngriti receptorin. Voskopojën? Ja, tani.

Doli vetë drejtori i kampit.

— Ti mësuesja je? I ke për bukuri. Po bëjnë gjimnastikën e mëngjesit. E do përgjegjësen? Na, moj Alda, eja në telefon! Foli!

— Alo! Alo! — u dëgjua matanë zëri i ëmbël e i ngrohtë me ca dridhje emocioni.

— Alda, si je, mirë?

— Mirë.

— U lodhe?

— Hiç fare!

— E, e, mos e tepro tani!

— Të betohem, presore! Gjatë rrugës kujtonim ata liceistët...

— Ç'liceistë?

— Të njëqindët, pra, që dolën partizanë në mitingun e Voskopojës. Ti vetë na ke folur për ta.

— Oh, po!

— Sa të hamë mëngjes, do të vemi te lapidari. Pastaj do të ngjitemi te kampi i pionierëve.

— Mirë janë të gjithë?

— Shumë mirë.

— Po kënaqeni?

— Shumë, shumë! Kur të kthehemi do të bëjmë hartime të bukura...

Mësuesja e uli receptorin ngadalë, butë, sikur të trembej se mos thyhej. S'iu dha ta pyeste për ndonjë gjë tjetër, madje nuk u kujtua as ta falënderonte drejtorin e kampit. Gëzimi e kënaqësia i vërshuan në shpirt. Avulluan si flull-ska sapuni pikëpyetjet e mëdyshjet. Paskëshin qenë veç ca sajime shterpa e të pështira. I kishte atje dhe mirë e bukur të guximshmit e saj, besëdhënësit e saj. Ata ishin fort të kënaqur dhe ajo gjithashtu.

Një këngë më shumë

— Dezi! — thirri Ndrekoja.

Me nja dy hapa, si duke kërcyer, vajza me emrin Dezi u afrua, duke tundur lezetshëm buklën e flokëve lidhur pas.

— Tashti po, tashti do ta pimë atë kafën, — tha Ndrekoja.

— Pse thua kafe, ne mund të duam akullorë, — foli vajza.

— Sipas dëshirës, mos e prish qejfin ti. Gone, e di që jemi të fejuar?

— Jo, mo, të bëhet mirë?

— S'do mend që më bëhet. Po ti ç'm'i përdredh buzkat, mos pret të këmbejmë unazat? Ë, në je bërë pishman...

— Sa i lig!...

Ajo e goditi lehtë, në faqe.

E hijshme, e afruar, më bëhej se e njihja

po aq sa Ndrekon. Ai trupmadh me shikim prej fëmije, ajo e brishtë dhe e bukur. E çiltërsia, thashë me vete, i bashkon e i bën çuditërisht të ngjashëm.

Dezi iu kthye bisedës për përgatitjen e ansambilit. Shpalosi një fletë që të bënte ndonjë shpjegim për repertorin e deri ku kishin vajtur me Dilon, që tanimë ishte prej disa ditësh sëmurë, po Ndrekoja tha që s'ishte nevoja, pasi rrugës ne nuk kishim biseduar as për hënën e yjet, as për vajzat çapkëne.

Megjithatë unë i hodha një sy repertorit.

— Thuaje troç, nuk e kemi zënë ca si ters? Me këto këngë grupi ynë s'ka larmi, as një çikë erë fabrikë s'ndihet. Ndoshta prandaj i këndojmë pa gjongël, si me pahir, sa për të shkuar radhën. Dhe kemi ecur pak, fare pak.

M'u desh t'i pranoja ato që tha ajo, veç shtëva që, me sa e njihja unë atë ansambël, amatorët kishin vokal të mirë.

— Demek, gjalpë i mirë në lëkurë të qenit — ia këputi Ndrekoja.

— Jo tamam ashtu, — e ndreqi Dezi.

— Ngre dorën unë! Ti si poete ua di më mirë kuptimin këtyre fjalëve.

— Poete? — u interesova unë.

— Posi, bën vjersha, — tha Ndrekoja dhe e pa në sy me një nënqeshje plot dashamirësi.

Vajza u skuq e ktheu kokën anash.

— Shkruaj ndonjëherë. Ashtu kot, kur më shkrepet.

— Një vjershë për fabrikën ia pranoi dhe Diloja. Tha që do ta bënte këngë, — sqaroi djali.

— Ehtë! — ia bëri poetja.

— Hoqi dorë?

— S'më ka thënë gjë. Por, në u bëftë kaq

me të keq kënga!... Mua, kur më hipën në kokë të shkruaj një poezi, më ziejnë ndjenjat e mendimet dhe s'rri dot e qetë pa i hedhur në letër. Ngado që vete, çfarëdo që bëj, aty e kam mendjen. Kurse ai... u bë një muaj e ca që ia kam dhënë...

— Po tashti ka një vjershë tjetër. Për takimin me shokun Enver, ore! E ka qëndisur, Gone. ta them unë ty!

Vajza prapë u skuq. Natyrisht u bëra kurioz për poezinë e saj të re. Dezi nuk kishte kopje me vete, po e mbante mend dhe nisi ta recitonte ngadalë. Ndrekos s'i pritej e nganiëherë ndërhynte për të thënë ndonjë varg. Edhe ai e dinte përmendësh. Ishte një poezi me të vërtetë e bukur, e thjeshtë dhe e sinqertë, shumë e sinqertë dhe tepër e ngrohtë. Ajo e shkroi në faqen e pasme të programit. Ë lexova përsëri. Poezia më çoi në ato ditë të gëzuara. Dezi e pikësi që më pëlqeu dhe kënaqësia i shkëlqeu në sy. Tiparet iu zbutën edhe më e u bë ëndërrimtare.

— Ai erdhi te ne e u interesua për gjithçka. Drejtoresha më mori pranë e i tha fjalë të mira për mua. Ai më përqafoi si bijën e vet. Punëtorë e mirë, vajzë e bukur, tha, a je fejuar? Unë isha kaq e prekur, kaq e emocionuar, sa nuk flisja dot. Nuk di si u ndodh aty edhe Ndrekoja. Ja ku e ka, shoku Enver, i thënë. Punëtor dhe ti? — iu kthye Ndrekos. Punëtor, shoku Enver. Vetë. këtu, i lidhët telat? Nierëzit përreth dëshën. qeshi dhe Ai e na afroi edhe më të dyve. — Na bëj një fotografi me këtë çift të ri punëtorësh, i tha fotoreporterit. Mirë, bukur, m'u kthye mua. Më duket se shkoni me njëri-tjetrin, apo jo, drejtoreshë? Dhe ta bëni këtu dasmën, në këndin e kuq të fabrikës.

ta bëni... S'kam provuar gëzim më të madh. Të gjithëve u shkëlqenin sytë nga lumturia. Mend çaheshin muret nga hareja. Atë ditë të gjithë ishim poetë...

Rrëfimi e mallëngjeu. M'u përcoll dhe mua ngazëllimi i saj. M'u kujtua mbrëmja kur shoku Enver doli nga shtëpia e kulturës. Sheshi përpara ishte mbushur plot, si në një miting të madh. Ai i pa njerëzit, ngriti dorën t'i përshëndeste, bëri të ikte e s'i ikej. Pastaj u fut midis tyre. Duar të shumta i zgjateshin e Ai i shtrëngonte me plot dashuri.

*Hej, qytet, qyteti im
Zemrat dyert hapin...*

* * *

Në shqetësimet e mia u pleks dëshira për ta parë këngë atë poezi. Të nësërmen shkova në Tiranë me shërbim. Gjithë rrugës më vinin në kokë, pa i kërkuar, vargjet e saj. Herë të veçuar e herë në grup. Vargjet më pëlqenin. Po është pak të thuash kaq. Ato më ngjallnin përfytyrime të shumta e të bukura.

Ashtu i dalldisur qëndrova para shtëpisë së Lelos. Shtyhesha tek ai se më thoshte mendja që i shkonte për shtat ky lloj krijimi. Ana tjetër që më nxitte që se e njihja. Njëherë patëm shkuar bashkë në një ekspeditë folklorike. Leloja incizonte këngë që i këndonin fshatarët. Kur mbeteshim vetëm, e hapte magnetofonin dhe i dëgjonte. Njërën gisht e fuste në vesh, kurse me treguesin e dorës tjetër ndiqte lehtëzi ritmin e këngës. Rrinte me fytyrë ndehur përpara e symbyllur. Dëgjonte e mrekullohej.

E gjeta fare vetëm. Ishte në një çast dehjeje, kur krijuesit i ecën dhe ndihet i lehtë e i gjerë, i gëzuar, i lumtur, sa i bëhet se bota e tërë është e tij e për të.

— Po i jap fund. A do të dëgjosh ndonjë pjesë?

As që priti përgjigjen time. Fluturoi e ra mbi një pullë pranë pianos së hapur, u përkul e zuri t'i binte me pasion. Tingujt rendnin pas njëri-tjetrit, dridheshin në ajër, ngjisheshin e mbushnin dhomën.

Nuk kam parë njeri më të gëzuar e më të frymëzuar. Flokët i ishin shpupuritur, xhaketën e bizhamave e kishte kopsitur keq e njëri cep i jakës i ngrihej në sup si vesh lepuri. Faqet i ndritnin, sytë i vetëtinin.

Papritur ndaloi e u hodh drejt e në këmbë.

— Ore, e di që ne krijuesit jemi egoistët më të mëdhenj? Ti vjen kushedi përse, ndërsa unë...

— Unë u kënaqa shumë. Ke bërë një vepër të bukur, shumë të bukur që të ngre e të rrëmben. A e di që pata dëshirë të kërcej?

— Ashtu?! — Atij i erdhi mirë e qeshi me gjithë shpirt. Mirë, xhanëm. Plastë ai krijues që nuk i pëlqen t'ia lavdërojnë krijimin. Por, hë si e ke punën? Ç'kemi andej?

I thashë se kisha vajtur në Tiranë për ca punë të institucionit dhe me atë rast do të shihja edhe ndonjë gjë për repertorin e një ansambli punëtor, që po përgatisja. I fola për poezinë e Dezit. I fola ashtu si do t'i flisja vetes. Ai më dëgjoi me vëmendje. Dikur e vuri gishtin në vesh dhe po më ndiqte shumë i përqëndruar. Domethënë po i bënte përshtypje. Kjo më ngrohu.

— Kjo poezi ka muzikalitet, është vetë këngë. Unë e përfytyroj...

Ai hapi sytë e u përmend.

— Po, ti e përfytyron. Duket nga pasioni që të ka rrëmbyer. E ke bërë?

Pyetja e papritur më përshkoi si një dritmë. Ai besonte se unë mund ta bëja një këngë të tillë?!

— Njohuritë s'të mungojnë, fantazinë e ke. Le, po s'të mungon as frymëzimi! Se, ato që më shprehe mua, or djalë, janë frymëzimi vetë!

Unë bëra një lëvizje penguese me dorë. Ai nuk ia vari fare asaj lëvizje.

— Është, si të them unë...

Nuk i zura në gojë që kisha vajtur tek ai pikërisht për atë këngë. Jo se ma preu vrullin me ato që më tha. Më tepër u druajta, ngaqë e pashë sa shumë ishte i zënë me baletin.

Sa ika prej tij, po mendoja kujt tjetër t'i thosha. Po u kujtova për orën. Ishte vonë. Nesër, thashë dhe u nisa për në hotel. Rrugës nuk shikoja asnjeri e asgjë. Isha si i hutuar. As vetë s'e kuptoja ç'ndjenja më kishin kapluar. Nganjëherë më silleshin në kokë fjalët e Lelos. Hë, ia bëja me vete pa e ditur për se. Ç'është e vërteta, fjalët e tij ishin shumë ngacmuese. Më ngrohnin e më turbullonin në të njëjtën kohë. Doja të isha vetëm, t'u jepesha ndjenjave të mia, të meditoja.

Më erdhi mirë që në dhomë nuk kishte njeri tjetër. Pa e hapur dritën, u zhvesha e rashë në shtrat. Nga dritarja e madhe, sa tërë faqja e murit, vinte drita e bardhë e neoneve. Po që andej hynin gjithfarë zhurmash. Udhëtimi, dëshira ngacmuese, përfytyrimi, bisedat me Lelon, baleti i tij — të gjitha përziheshin në kokën time dhe më sillnin një si nanurisje. Më përvijoheshin herë qartë e herë ngatërruar copëza prej tyre. Ndërrimet bëheshin çuditërisht shpejt.

Befas më erdhi në vesh një valë duartroki-

tjesh. Ajo u zmadhua e iu shtuan brohoritje të shumta. Ca tinguj të fuqishëm mbushën ajrin me një kumbim në tone të larta. U përplasën në mur e jehuan. Jehona doli nga dritarja gjithë duke u rritur...

I hapa sytë rrëmbyer. Tingujt u sfumuan. Bashkë me to dhe gjithë përjetimet. Po ç'që kështu, më pati zënë gjumi apo sa do të më zinte? Ëndërr e zhgjëndërr? Brohoritje, e nëpër to dhe sipër tyre një valëzim tingujsh melodiozë. Tingujt në vend të entuziazmit. Mos vallë... Si kështu, hapja e këngës?...

Një ndjesi e ngrohtë, e ngrohtë m'u derdh në zemër. Tërë trupi m'u shkri në të. U hodha drejt e në këmbë. Gjumi m'u davarit. Ndihesha i freskët sikur kisha fjetur një natë të gjatë dimri. Zura të ecja me vrull nëpër dhomë. Kisha dëshirë të dilja në korridor ku mund t'i bëja hapat të mëdhenj e të shpejtë.

Dikur tingujt u bënë më të guximshme e më të shtruar, shfaqeshin e shtoheshin përbri njëri-tjetrit, duke u ngjeshur kush e kush më parë në një trup të vetëm.

Brenda një ore m'u përvijua hapja e këngës dhe strofa. Ja, po e shihja prerjen e një valleje popullore. Refreni? S'ka si bëhet refren më i gëzueshëm! Poezia e gjithë po vishej me tinguj. Shkrirë e bërë një tinguj e gërma. Përpiqesha ta mbaja përfytyrimin që të mos më shkoqej. Plotësova pikat e dobëta ku ai mend këputej.

Pra, vërtet po e krijoia këngën? Nuk denkësh tallur me mua Leloja? Besa po, unë po bëja këngë! Poezinë e Dezit këngë, si Dezi vetë në atë çast frymëzimi. Kur më pati folur për të. Po, or, po, kënga vetë! Mirëpo... si do t'ia bëja që ta ruaja të plotë? Tingujt nuk hidhen në letër

njëlloj si fjalët. Ata nuk mund t'i kapësh e t'i vësh në një sirtar. Duhej një piano. A kishte piano hoteli? Sa keq që s'u kishte shkuar ndër mend të mbanin një piano për raste të tilla!.. Në tavernë ishte një fizarmonikë. Sikur... Eh, po tani qe vonë. Le që, kush të lë njëherë! Njerëzit në hotel pushojnë, nuk i ka pickuar zekthi si mua... Po sikur të veja te Leloja? Bah, çmendim i marrë!..

Më në fund e bëra me mend ta gdhija pa gjumë. Ndryshe nuk mund t'i mbaja në kokë ata tinguj të ëmbël që mbështilleshin e shpëstilleshin herë shpejt e herë ngadalë si në një shirit magnetofoni dhe jehonin në dhomë, duke më sjellë një dehje mahnitëse...

Me të dhënë mëngjesi, trokita te kompozitori.

— Hë? — ia bëri ai përgjumësh.

— A mund të punoj ca në piano?

— Posi! Të punosh, posi!

Ai më futi brenda dhe e ndezi dritën.

— Ja ku ke dhe fletore. Eh, unë budallai, që s'të thashë të rrije mbrëmë këtu! Po ti pse s'më the vetë? Mirë mua që më doli mendsh, po ti... Nejse, jepi tani!

U ula në piano dhe në çast u hutova. M'u bë se kot kisha vajtur, s'dija nga të nisja. Shikoja tastierat farfuritëse, fletoren e hapur... Provova një akord. Pastaj një tjetër. Tingujt u drodhën si me ankim. Melodia marramendëse më kishte avulluar nga koka. Por ja tek zuri të më kthehej. Në fillim lehtë e lehtë, disi e sfumuar, më tej me vrull, si një lumë i rrëmbyer. Na kërkoje? Zërna tani! Kështu sikur më thoshin tingujt e shumë. Si t'ia bëja? Cilët të kapja më parë? O, çpunë e zorshme! Po tingujt vetë u rreshtuan me një rregullsi të habitshme, gi-

shtërinjtë e mi lëvizën mbi tastierë dhe pianoja u bind e u nënshtua çuditërisht shpejt.

E përvijova këngën. M'u duk e bukur, shumë e bukur, dhe e fuqishme, e rrallë. Ngaqë m'u duk e atillë, m'u ngroh shpirti e më erdhi një dëshirë e zjarrtë të thosha diçka, të bëja diçka. Me një pulsim të nxituar zemra ndoqi tingujt e ëmbël e u shkri në ta. Ndihesha i lehtë dhe më bëhej se do të ngrihesha lart, tok me tingujt e mi.

As që e mora vesh si e kur arrita t'i hedh një e nga një nga tastierat në letër. Pas kësaj u qetësova. U qetësova e mbeta i hutuar. Vërtet e kisha mbaruar?!

Leloja erdhi prapë. E mori fletoren dhe i hodhi një sy kalimthi. Pastaj iu kthye me vëmendje, më largoi me një shenjë të dorës, u ul vetë e zuri të luante në piano atë që kisha shkruar unë.

Ishte e para herë që bëja një kompozim të vërtetë dhe prisja zemërdredhur. Herë më dukej se kisha bërë një këngë të shkëlqyer, herë një budallallëk me brirë. Fytyrën ma kishin mbuluar bulëza djerse. Gëlltitesha dendur. Pritje më të ethshme s'kam provuar.

Jehona e tingujve mbaroi. Ishin tingujt e mi dhe, megjithëse prisja aq i dëshiruar një fjalë nga Leloja, sepse m'u dhimbs që ata reshtën. Leloja ma shkeli syrin.

— Òre trim, e di që ke bërë një këngë të bukur? Këngë, jo këngushkë!

Ai më përfshiu në krahët e tij.

— Të është goditur. Jam shumë, shumë i gëzuar. Pata besim dhe vërtet ia dōle me sukses. Ti ishe dashuruar me temën. Mbresat dhe dëshira për t'i parë të mishëruara në këngë, ishin pjekur në një pikë dhe ky është vetë frymëzi-

mi. Besa po, brirë s'ka. Ta pikasa që mbrëmë,
qerrata, dhe më bëhet qejfi edhe për këtë!

Fliste shpejt, me kënaqësi, ndërsa unë e dëgjoja i habitur.

— Tani ti merr një sy gjumë. Ndërkohë unë do t'i bëj ca rregullime teknike. Që sot do t'i vihëm ta orkestroj dhe pastaj, o trim, udhë të mbarë e me të tjera! Se vetë nuk vjen kënga, aq më tepër një këngë si kjo.

Me gjithë dëshirën e vullnetin truri im atë çast nuk regjistronte asgjë dhe kokën e kisha fare bosh.

— Tani, përpiku të flesh ca.

I thashë që gjumi kishte marrë vrapin që në mbrëmje dhe kushedi ku kishte arritur.

Ai qeshi rishtas.

— Profesionale, — vërejti. — Do të të bëj një kafe me shumë sheqer dhe pastaj ti shetit një copë herë në rrugë a në oborr. Kënga u bë e doli e bukur. Kjo është kryesorja.